

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I DREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

**ASPEKTI LIGJOR I NDËRHJRJES HUMANITARE
DHE ZHVILLIMI I DOKTRINËS PËRGJEGJËSIA PËR
TË MBROJTUR – RASTE STUDIMI KOSOVA DHE
SIRIA**

Kandidat:

MSc. Shefki SHTËRBANI

Mentor:

Prof. dr. Jeton SHASIVARI

Shtator, 2021

Deklarata e Autorësisë

Vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi. Nën përgjegjësinë time personale deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një komisioni tjetër për vlerësim dhe nuk është publikuar. Punimi nuk përmban materiale të shkruara nga ndonjë person tjetër përveç të rasteve të citimit dhe referimit.

MSc. Shefki SHTËRBANI

Ky punim i doktoraturës është shkruar sipas kriterëve të përcaktuara të Rregullores për Studimet e ciklit të tretë, të miratuar më 15 korrik 2014 nga Senati i Universitetit të Evropës Juglindore.

Falënderim

Pas një pune disavjeçare të angazhimit në hulumtimin tim shkencor, falë të Madhit Zot në fund doli në dritë ky punim i doktoratës. Por gjatë punimit të kësaj teze të doktoratës u ndihmova nga shumë njerëz për të cilët e shfrytëzoj rastin që t'i falënderoj.

Së pari, në veçanti dëshiroj të falënderoj mentorin tim, Prof. dr. Jeton Shasivari, i cili më udhëzoi dhe më këshilloi gjatë gjithë këtij rrugëtimi. Përkushtimi dhe përkrahja e tij ishte shumë e rëndësishme për përfundimin e këtij disertacioni të doktoratës. Gjithashtu, mirënjohje të veçantë për bashkëpunim dhe komente shumë të vlefshme për këtë punim u shpreh edhe anëtarëve të Komisionit profesional: Prof. dr. Asllan Bilalli, Prof. dr. Bekim Nuhiu dhe Prof. dr. Besa Arifi. Gjithashtu i jam falënderues në veçanti edhe Prof. dr. Gentian Zyberit, të cilin kisha fatin ta takoj zyrtarisht në UEJL në fillim të punimeve të mia të doktoratës, nga i cili kam marrë shumë komente dhe sugjerime, të cilat kanë qenë një udhërrëfyes i veçantë për mua dhe shumë i vlefshëm për këtë disertacion të doktoratës.

Falënderoj Abdylkadër Muçajn, Dardan Vuniqin dhe Dardan Berishën për vërejtjet dhe propozimet e tyre.

E fundit, por jo për nga rëndësia, është familja ime: prindërit Fuadi dhe Zylfija dhe motra ime Drilona nga të cilët e kam marrë dashurinë dhe mbështetjen e vazhdueshme për të arritur atë që kam dashur më së shumti.

Prizren, shtator 2021

Përkushtim

*Ky punim i doktoratës u përkushtohet familjarëve të mi Elezit, Mehmetit dhe Imihanes të
vrrarë nga forcat serbe në luftën e fundit në Kosovë më 1999.*

Abstrakti

Ky hulumtim shkencor ka për qëllim trajtimin e të drejtës së ndërhyrjes humanitare, si dhe zhvillimin e doktrinës së Përgjegjësisë për të Mbrojtur (PpM) në këndvështrimin e së drejtës ndërkombëtare. E drejta e ndërhyrjes humanitare ka qenë pjesë e diskutimeve që 600 vite më parë, nga studiues të shumtë, mirëpo, ky hulumtim fokusohet më shumë në perspektivën e ndërhyrjes humanitare që nga themelimi i OKB-së më 1945 e tutje. Debati më i madh ka filluar në kohën kur Karta e OKB-së e ndalon përdorimin e forcës në përgjithësi dhe këtë zhvillim shumë studiues të së drejtës ndërkombëtare e panë si ndalim i të drejtës për ndërhyrje humanitare. Mirëpo, kjo periudhë është fillimi i mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Prandaj praktika e shteteve e veçanërisht ndërhyrja e NATO-s në Kosovë ka marrë reagime universale dhe ka ngjallur diskutime se ndërhyrja humanitare për qëllim të mbrojtjes së qytetarëve të ndonjë shteti nga krimet mizore pa mandatin e OKB-së, është e ligjshme apo përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Në këtë hulumtim trajtohen raste të caktuara të supozuara si ndërhyrje humanitare, në veçanti ndërhyrja e NATO-s në Kosovë, e cila kishte nxitur mjaft shumë reagime që nga diskutimet në OKB, diskutimet nga shtetet, si dhe në shkrimet e shumë studiuesve me argumentet pro dhe kundër ligjshmërisë së saj. Edhe pse nga shumë shtete dhe argumentime doktrinare ndërhyrja humanitare është në kundërshtim me Kartën e OKB-së, nga analiza e rastit të Kosovës, duke marrë parasysh përkrahjen ndërkombëtare, ndërhyrja e NATO-s mund të konsiderohet si legjitime dhe kjo mund të përbëjë një pikë mjaft të fuqishme për krijimin e një norme zakonore për të drejtën e ndërhyrjes humanitare në të ardhmen. Ndërhyrja ushtarake në Kosovë, dështimet për të reaguar në disa situata të krimeve mizore, ka bërë që të krijohet doktrina e PpM-së një koncept i cili mendohet se do të zëvendësonte ndërhyrjen humanitare dhe, i cili nuk përfshin vetëm ndërhyrjen ushtarake, por edhe parandalimin e krimeve mizore. Kjo doktrinë ka për qëllim që përgjegjësia ndaj qytetarëve së pari i takon shtetit dhe se sovraniteti, nuk është një privilegj por, një përgjegjësi dhe vetëm kur shteti nuk është në gjendje ose nuk dëshiron t'i mbrojë qytetarët e vet, atëherë vjen në pyetje përgjegjësia e bashkësisë ndërkombëtare deri tek autorizimi për përdorimin e forcës ushtarake dhe kjo me autorizim të Këshillit të Sigurimit në bazë të Kapitullit VII të Kartës në rastet kur ka gjenocid, krim kundër njerëzimit, spastrim etnik dhe krime lufte. PpM-ja ende nuk është normë ligjore, por ajo më shumë përbën një normë morale dhe politike. Në bazë të analizës së zhvillimit të përgjegjësisë për të mbrojtur

nga dokumentet e OKB-së, praktikës shtetërore dhe shkrimeve të studiuesve, gjejmë se përgjegjësia për të mbrojtur është një doktrinë ndonëse mirë e hartuar dhe pjesë e institucioneve të OKB- së që nga viti 2005, por ka dështuar në zbatimin e shtyllës III, pra në situatat kur Këshilli i Sigurimit duhet të autorizojë përdorimin e forcës ushtarake, ashtu siç kërkon koncepti i PpM-së. Kjo për shkak se, si në të kaluarën edhe në situatat e përgjegjësisë për të mbrojtur, Këshilli i Sigurimit ka qenë selektiv dhe shtetet e përhershme në këtë Këshill kanë përdorur veto me çka e kanë penguar parandalimin e krimeve mizore. Kjo është parë më së miri në rastin e Sirisë, ku vlerësimi mbizotërues është se Këshilli i Sigurimit ka dështuar të veprojë. Prandaj, mangësia e kësaj doktrine qëndron në atë se çka duhet të bëhet në rastet kur Këshilli i Sigurimit dështon për të vepruar? Por një gjë është e sigurt, Këshilli i Sigurimit nuk duhet të përdorë veto në raste të mizorisë, sepse shtetet ose ndonjë organizatë ndërkombëtare përsëri do të përdorë atë si një pretekst për ndërhyrjen humanitare në vend të PpM-së.

Fjalët kyqe: ndërhyrja humanitare, përgjegjësia për të mbrojtur, lufta e drejtë, OKB, sovraniteti i shteteve, të drejtat e njeriut, e drejta e vetos

Abstract

This scientific research aims to address the right to humanitarian intervention, as well as the development of the doctrine of Responsibility to Protect (R2P) from the perspective of international law. The right to humanitarian intervention has been part of the discussions in the last 600 years ago, by many scholars, however, this research focuses more on the perspective of humanitarian intervention since the founding of the UN in 1945 onwards. The biggest debate started at a time when the UN Charter prohibits the use of force in general, and this development of many scholars of international law saw it as a ban on the right to humanitarian intervention. However, this period is the beginning of international protection of human rights. Therefore, the practice of states, especially the NATO intervention in Kosovo, has received universal reactions and has aroused discussions that humanitarian intervention in order to protect the citizens of any state from cruel crimes without a UN mandate, is legal or constitutes violation of international law. This research deals with certain cases alleged as humanitarian intervention, in particular the NATO intervention in Kosovo which had provoked quite a lot of reactions from discussions in the UN, discussions from states, as well as in the writings of many scholars with arguments pro and against its legality. Although from many countries and doctrinal arguments the humanitarian intervention is contrary to the UN Charter, from the analysis of the Kosovo case, taking into account the international support, the NATO intervention can be considered legitimate, and this may constitute a strong enough point for establishing a customary norm for the right of humanitarian intervention in the future. Military intervention in Kosovo, failures to respond to some cruel crime situations, has led to the creation of the R2P doctrine a concept which is thought to replace humanitarian intervention and which includes not only military intervention but also the prevention of cruel crimes. This doctrine aims that responsibility to citizens first belongs to the state and that sovereignty is not a privilege but a responsibility and only when the state is unable or unwilling to protect its citizens, then comes the responsibility of the international community to authorize the use of military force and this with the authorization of the Security Council under Chapter VII of the Charter in cases where there is genocide, crime against humanity, ethnic cleansing and war crimes. R2P is not yet a legal norm, but it is more of a moral and political norm. Based on the analysis of the development of the responsibility to protect from UN documents, state practice and scholarly writings, we find that the responsibility to protect

is a well-crafted doctrine and part of UN institutions since 2005, but has failed to implement Pillar III, i.e., in situations where the Security Council must authorize the use of military force, as required by the R2P concept. This is because, as in the past, in situations of responsibility to protect the Security Council has been selective and the permanent states in this Council have used vetoes which have prevented the prevention of cruel crimes. This is best seen in the case of Syria, where the prevailing assessment is that the Security Council has failed to act. Therefore, the shortcoming of this doctrine lies in what should be done in cases where the Security Council fails to act? But one thing is for sure, the Security Council should not veto in cases of cruelty, because states or any international organization will again use it as a pretext for humanitarian intervention instead of the R2P.

Keywords: humanitarian intervention, responsibility to protect, just war, UN, sovereignty of states, human rights, the right of veto

PËRMBAJTJA

Falënderim	III
Abstrakti.....	V
Abstract.....	VII
Shkurtesat	XII
PARATHËNIE	1
Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit	3
Metodologjia e Hulumtimit.....	4
Struktura e punimit.....	5
PJESA E PARË	7
KAPITULLI I	7
1. LINDJA DHE ZHVILLIMI I TË DREJTËS SË NDËRHYRJES HUMANITARE	7
1.1. Historiku i ndërhyrjes humanitare.....	7
1.1.1. Ndalimi i përdorimit të forcës dhe ndërhyrja humanitare pas shekullit njëzet.....	10
1.2. Karta e Kombeve të Bashkuara dhe e Drejta e Ndërhyrjes: Neni 2(4) i Kartës.....	11
1.3. Përkufizimi i ndërhyrjes humanitare.....	19
1.4. Debati dhe kundërthëniet	23
1.5. Lufta e drejtë dhe e padrejtë	27
1.5.1. Teoria e luftës së drejtë e Michael Walzer	29
KAPITULLI II.....	37
2. LIGJSHMËRIA DHE LEGJITIMITETI I NDËRHYRJES HUMANITARE	37
2.1. Ligjshmëria e ndërhyrjes humanitare para Kartës së OKB-së.....	37
2.2. Ndërhyrja humanitare pas miratimit të Kartës së OKB-së	39
2.2.1. Argumentet në favor të ndërhyrjes	40
2.2.2. Argumentet kundër ndërhyrjes	42
2.3. Legjitimiteti i ndërhyrjes humanitare	46
2.4. Ndërhyrja humanitare: sovraniteti kundrejt të drejtave të njeriut.....	48
2.5. Ndërhyrja humanitare dhe zhvillimi i një jus cogens.....	52
2.6. Praktikat e ndërhyrjes nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare	54
2.6.1. Ndërhyrja e Indisë në Pakistanin Lindor 1971	55
2.6.2. Tanzania dhe Uganda.....	56
2.6.3. Iraku 1991-1992	57
2.6.4. Liberia 1990-1997	58
2.6.5. Sierra Leone	60
2.7. Ndërhyrja humanitare dhe Këshilli i Sigurimit	63

2.8. Asambleja e Përgjithshme dhe Rezoluta “të bashkuar për paqe” (1950).....	65
PJESA E DYTË.....	68
KAPITULLI III.....	68
3. LIGJSHMËRIA DHE LEGJITIMITETI I NDËRHYRJES SË NATO-s NË KOSOVË	68
3.1. Konteksti historik dhe fillimi i krizës humanitare në Kosovë	68
3.2. Kriza Humanitare dhe përgjigjja ndërkombëtare para ndërhyrjes së NATO-s	78
3.3. Konferenca dhe Marrëveshja e Rambujesë.....	86
3.4. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë	91
3.4.1. Kritikë e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s	94
3.5. Ligjshmëria dhe legjitimiteti i ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë.....	96
3.5.1. Argumentet për ligjshmërinë dhe legjitimitetin	98
3.6. Krijimi i një opinio juris pas Kosovës.....	104
3.7. Propozimet për ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare në të ardhmen	108
KAPITULLI IV	112
4. PËRGJEGJËSIA PËR TË MBROJTUR: NGA NJË IDE NË NJË NORMË NË ZHVILLIM	112
4.1. Nga ndërhyrja humanitare te përgjegjësia për të mbrojtur: sfondi i lindjes dhe i zhvillimit të saj	112
4.1.1. Raporti i KNNSSH-së i vitit 2001.....	114
4.1.2. Çështja e autoritetit	117
4.1.3. Sovraniteti si përgjegjësi	118
4.2. Institucionalizimi i PpM-së: OKB-ja dhe përgjegjësia për të mbrojtur.....	122
4.2.1. Rezultati i Samitit Botëror 2005.....	122
4.2.2. PpM dhe krimet masive	125
4.2.3. Zbatimi i PpM-së: Tri shtyllat e Raportit të vitit 2009.....	131
4.2.4. Këshilli i Sigurimit dhe PpM	133
4.2.5. Këshilli i Sigurimit në veprim - ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Libi	136
4.2.6. Iniciativa Braziliene: “Përgjegjësia duke mbrojtur”	144
4.2.7. Këshilli i Sigurimit dhe PpM pas Libisë	150
4.2.8. Roli i Asamblesë së Përgjithshme në zhvillimin e PpM-së	157
4.2.9. Roli i Sekretarit të Përgjithshëm në PpM.....	160
4.2.10. Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe PpM.....	162
4.3. Kontributi i organizatave regjionale.....	164
4.4. Aktorët e tjerë dhe shoqëria civile	171
4.5. Statusi ligjor i PpM-së: A është vërtet një normë e re?	172
4.6. PpM midis suksesit dhe kritikës	177
KAPITULLI V	183

5. SIRIA DHE PËRGJEGJËSIA PËR TË MBROJTUR	183
5.1. Sfondi i konfliktit në Siri.....	183
5.2. Përgjegjësia ndërkombëtare në krizën e Sirisë	189
5.3. Këshilli i Sigurimit dhe PpM në Siri	200
5.4. Dështimi për të vepruar në Siri dhe e ardhmja e PpM-së	202
KONKLuzionet dhe Rekomandimet	204
<i>INDEKSI I KUPTIMEVE.....</i>	<i>229</i>
<i>INDEKSI I AUTORËVE</i>	<i>233</i>

Shkurtesat

AP	Asambleja e Përgjithshme
KS	Këshilli i Sigurimit
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
LA	Liga Arabe
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
KNNSSH	Komisioni Ndërkombëtar për Ndërhyrje dhe Sovranitet Shtetëror
PpM	Përgjegjësia për të Mbrojtur
NATO	Organizata e Paktit Veri Atlantik
LDB	Lufta e dytë botërore
KESHAP	Komuniteti Ekonomik i Shteteve të Afrikës Perëndimore
GMKESHAP	Grupit të Monitorimit të Komitetit Ekonomik të Shteteve të Afrikës Perëndimore
MOKBSL	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
RFSJ	Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë
RFJ	Republikën Federale të Jugosllavisë
BRSS	Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
OJQ	Organizatat Jo Qeveritare
MVVK	Misioni Vëzhgues Diplomantik në Kosovë
KLKBR	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

BE	Bashkimi European
MVK	Misioni për Verifikim në Kosovë
GJPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
TPNJ	Tribunali për Krimet të Luftës në ish-Jugosllavi
TNR	Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën
PdM	Përgjegjësia duke Mbrojtur
MMOKBS	Misioni Mbikëqyrës i OKB-së në Si

PARATHËNIE

Përdorimi i forcës, sot në të drejtën ndërkombëtare ndaj shteteve tjera, është i ndaluar. Përfundimisht, kur ajo kryhet në pajtueshmëri me Kartën e OKB-së (Organizata e Kombeve të Bashkuara), si vetëmbrojtje individuale dhe kolektive dhe përdorimi i forcës me autorizim të Këshillit të Sigurimit. Por, shtrohet çështja se, a mund të ndërhyhet në një shtet në rast se ka shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe jashtë zbatimit të Kartës së OKB-ve, ku si një e drejtë mjaft e përfolur dhe në qendër të së drejtës ndërkombëtare, paraqitet ndërhyrja humanitare.

Ndërhyrja humanitare është një temë aktuale dhe mjaft e debatueshme në të drejtën ndërkombëtare. Kjo për faktin e mungesës së bazës ligjore ndërkombëtare që e rregullon këtë çështje. Ndërhyrjet humanitare nga ana e disa shteteve kanë ngjallur debate për ligjshmërinë e tyre në të drejtën ndërkombëtare, ku kundërshtohet nga shtete dhe autorë të ndryshëm si dhe grupi tjetër i shteteve që përkrahin një ndërhyrje të kufizuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kur ato janë në rrezik. Si rezultat i kësaj, janë propozuar mënyra të tjera për të ndaluar katastrofat humanitare ku si një doktrinë juridike në zhvillim paraqitet doktrina e ashtuquajtur: *Përgjegjësia për të Mbrojtur* (PpM) ose në anglisht: *Responsibility to Protect* (R2P). Sipas kësaj doktrine, shtetet obligohen për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe në rast se një gjë e tillë nuk ndodh, atëherë të ndërhyhet ushtarakisht me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe spastrimet etnike. Debatet e shumta nga ana e shteteve dhe mungesa e konsensusit ndërkombëtar në lidhje me ndërhyrjen në shtete të tjera dhe respektimi i sovranitetit në anën tjetër, kanë bërë që në shumë raste të mos ketë konsensus ndërkombëtar, si dhe të zbehet gatishmëria e shteteve për të ndërhyrë në shtetet e tjera me qëllim të shpëtimit nga katastrofat humanitare.

Viteve të fundit është zhvilluar doktrina e Përgjegjësisë për të Mbrojtur, ku Bashkësia Ndërkombëtare duhet të legalizojë sanksionet ndaj shteteve, të cilat e keqpërdorin sovranitetin e tyre për të bërë krime të ndaluara sipas të drejtës ndërkombëtare.

Qëllimi dhe rëndësia e hulumtimit

E drejta për ndërhyrje humanitare është bërë një ndër temat më të diskutuara në të drejtën ndërkombëtare, në veçanti pas Luftës së Dytë Botërore me themelimin e OKB-së dhe ndalimin e përdorimit të forcës në përgjithësi nga Karta e OKB-së. Ndërhyrjet humanitare nga

shtetet dhe organizatat ndërkombëtare në dekadat e fundit kanë ngjallur shumë reagime në mesin e studiuesve të së drejtës ndërkombëtare, nëse një e drejtë për ndërhyrje humanitare është e ligjshme ose jo. Kjo marrë parasysh se në të drejtën ndërkombëtare moderne zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe zbehja e sovranitetit absolut të shteteve kanë tensionuar debatin për këtë temë. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë më 1999 ka bërë që të ringjallet dhe të zgjerohet më shumë diskutimi për ndërhyrje me qëllim të mbrojtjes së drejtave të njeriut dhe atë pa mandatin e OKB-së, në rastet kur ka krime në masë ndaj popullatës civile në ndonjë shtet.

Njëzet vjet më parë, në vitin 2001 lindi një koncept i ri i quajtur Përgjegjësia për të Mbrojtur (PpM), që e zhvendosi debatin e ndërhyrjes humanitare, ku qëllimi kryesor nuk është vetëm ndërhyrja ushtarake, por dhe parandalimi. Ky është një koncept i ri i zhvilluar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara nga viti 2005 dhe tani i ngulitur në diskutimet dhe rezolutat e organizatave ndërkombëtare, shteteve dhe studiuesve.

Të dyja konceptet janë trajtuar në këndvështrime të ndryshme juridike, politike, historike, filozofike etj. Qëllimi i këtij hulumtimi është të kontribuojë në debatin juridik me qëllim për të kuptuar argumentet juridike nga perspektiva të ndryshme, se në të drejtën ndërkombëtare aktuale: a është e ligjshme e drejta e ndërhyrjes humanitare? Si janë argumentuar ndërhyrjet humanitare të shteteve në një shtet dhe a kanë ndikuar këto ndërhyrje në përkrahjen dhe zhvillimin e saj? Çka nënkupton koncepti i PpM-së dhe cili është statusi ligjor i këtij koncepti? Të gjitha këtyre pyetjeve kërkimore si dhe pyetjeve të tjera të shumta do të mundohemi t'u japim përgjigje në këtë hulumtim.

Pas një pune mbi 5-vjeçare në hulumtimin dhe studimin e këtyre koncepteve nga këndvështrimi i së drejtës ndërkombëtare dhe analizës së ndërhyrjeve të shteteve në shtete të tjera, në veçanti ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë për qëllime humanitare dhe dështimit të bashkësisë ndërkombëtare në Siri, pastaj, analiza dhe krahasimi i perspektivave të ndryshme nga organizatat ndërkombëtare, shtetet dhe studiuesit e njohur të së drejtës ndërkombëtare, janë mjaft të rëndësishme për të kuptuar aktualitetin e ndërhyrjes humanitare dhe përgjegjësisë për të mbrojtur. Të gjitha këto perspektiva të përfshira, duke përdorur burimet më kredibile të mundshme në këtë hulumtim, mundohen të paraqesin një gamë më të përgjithshme me qëllim që t'u ofrohet lexuesit dhe studiuesit të së drejtës ndërkombëtare në gjuhën shqipe pasqyra e koncepteve të ndryshme në kuadër të argumentimve të ndryshme juridike në të drejtën ndërkombëtare.

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit

Pyetja kërkimore e përgjithshme e këtij hulumtimi ka të bëjë me:

- Cilat janë përparësitë e doktrinės së përgjegjësisë për të mbrojtur ndaj asaj të ndërhyrjes humanitare lidhur me mbrojtjen e popullsisë nga krimet masive, me fokus në rastet e Kosovës dhe Sirisë?

Ndërsa, nën pyetjet kërkimore të këtij hulumtimi janë:

1. Cili është statusi ligjor i doktrinės së ndërhyrjes humanitare?
2. Cili është statusi ligjor i doktrinės së përgjegjësisë për të mbrojtur?
3. Cilat janë dallimet kryesore mes dy doktrinave?
4. Si janë përdorur këto doktrina në rastet e Kosovës dhe Sirisë?
5. A ekziston mundësia që këto doktrina të keqpërdoren nga ana e shteteve dhe çfarë mund të bëhet që të evitohet kjo gjë?

Nga ana tjetër, ky hulumtim synon t'i testojë hipotezat e formuluar si në vijim:

Hipotezat gjenerale:

H1. Ndërhyrja humanitare dhe zhvillimi i doktrinės së përgjegjësisë për të mbrojtur është në rritje e sipër dhe gëzon përkrahje nga bashkësia ndërkombëtare për të parandaluar katastrofat humanitare.

H2. Cilat janë përparësitë e doktrinės së përgjegjësisë për të mbrojtur në raport me ndërhyrjen humanitare, lidhur me mbrojtjen e popullsisë nga krimet masive.

Hipotezat e veçanta:

H1. Doktrina e ndërhyrjes humanitare ka një status të rregulluar ligjor.

H2. Doktrina e përgjegjësisë për të mbrojtur ka një status të rregulluar ligjor.

H3. Doktrina e ndërhyrjes humanitare dhe doktrina e përgjegjësisë për të mbrojtur janë zbatuar në rastin e Kosovës dhe të Sirisë.

H4. Doktrina e ndërhyrjes humanitare dhe doktrina e përgjegjësisë për të mbrojtur mund të keqpërdoren nga ana e shteteve.

H5. Doktrina e përgjegjësisë për të mbrojtur ka ndryshuar të drejtën ndërkombëtare.

Metodologjia e hulumtimit

Me qëllim të arritjes të objektivave kryesore të hulumtimit do të përdoren metoda të ndryshme të hulumtimit shkencor. Përdorimi i metodave të ndryshme kualitative dhe kuantitative që do të ndihmojnë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për qëllime të këtij hulumtimi. Hulumtimi bazohet në shfrytëzimin e burimeve primare dhe sekondare për shtjellimin konceptual të së drejtës së ndërhyrjes humanitare dhe përgjegjësisë për të mbrojtur, duke përfshirë legjislacionin ndërkombëtar, rishikimin e literaturës, analizën e rasteve të studimit, rasteve gjyqësore, duke bashkëngjitur rezoluta dhe raporte relevante për këtë hulumtim.

Përdorimi i metodave kualitative në këtë hulumtim do të jenë: metoda historike, metoda e analizës, metoda krahasimtare, metoda normative dhe metoda e studimit të rasteve individuale. Përdorimi i metodës historike mundëson kuptimin dhe pasqyrimin më të mirë të së drejtës së ndërhyrjes humanitare në të kaluarën, duke përshkruar lindjen dhe zhvillimin e të drejtës së ndërhyrjes humanitare dhe të përgjegjësisë për të mbrojtur. Me metodën e analizës do të zbërthehen kuptimet e këtyre doktrinave si dhe zbatimi i tyre në raste individuale. Me metodën krahasimtare do të krahasohen rastet e ndryshme nga praktika ndërkombëtare, si dhe qëndrimet e ndryshme për ndërhyrjen humanitare dhe krahasimin e ndërhyrjes humanitare me doktrinën e përgjegjësisë për të mbrojtur, duke analizuar edhe dallimet mes tyre. Ndërkaq, metoda normative do të ndihmojë trajtimin nga këndvështrime të ndryshme të statusit ligjor të ndërhyrjes humanitare dhe të doktrinës së përgjegjësisë për të mbrojtur, prandaj, përmes kësaj metode do të paraqitet statusi ligjor aktual në të drejtën ndërkombëtare të dy doktrinave. Gjithashtu, përdorimi i metodës së studimit të rasteve individuale është i rëndësishëm për të kuptuar më hollësisht trajtimin dhe përdorimin e ndërhyrjes humanitare dhe përgjegjësisë për të mbrojtur dhe këndvështrimet e ndryshme në secilin nga këto raste të trajtuar në këtë hulumtim.

Ndërsa përdorimi i metodës kuantitative në këtë hulumtim është paraqitja në mënyrë statistikore e të dhënave të numrit të rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, dhe nga organet e tjera të OKB-së, të cilat i referohen doktrinës së përgjegjësisë për të mbrojtur për periudhën e viteve 2006-2019.

Struktura e punimit

Ky disertacion i doktoratës përbëhet nga abstrakti, parathënia, pesë kapituj, konkluzionet dhe rekomandimet, literatura si dhe indeksi i emrave.

Kapitulli i parë me titull ***“Lindja dhe zhvillimi i të drejtës së ndërhyrjes humanitare”*** shqyrton idetë e para të ndërhyrjes humanitare në të kaluarën, e drejta për luftë sipas kuptimit filozofik, duke vazhduar me aktet e para juridike ndërkombëtare, të cilat e ndalojnë përdorimin e forcës në përgjithësi dhe me këtë rast do të elaborohet pozita e të drejtës për ndërhyrje humanitare në këto dokumente, në veçanti në Kartën e OKB-së. Përveç, trajtimit të instrumenteve ndërkombëtare, një trajtim i përgjithshëm në këtë kapitull do të kenë edhe debatet dhe diskutimet e studiuesve të njohur të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me qëndrimet e tyre për ndërhyrjen humanitare.

Në kapitullin e dytë me titull ***“Ligjshmëria dhe legjitimiteti i ndërhyrjes humanitare”*** do të trajtohet ligjshmëria e ndërhyrjes humanitare në të drejtën ndërkombëtare, së pari në analizën e ndërhyrjes humanitare nga instrumentet ndërkombëtare dhe pastaj këndvështrimet e studiuesve të njohur dhe ballafaqimin e argumenteve të tyre pro dhe kundër të drejtës për ndërhyrje humanitare. Në këtë kapitull një peshë të rëndësishme do ta ketë edhe trajtimi i aspektit të legjitimitetit të ndërhyrjes humanitare. Po ashtu, një pjesë e këtij kapitulli do t’i kushtohet krijimit të një norme zakonore të së drejtës për ndërhyrje humanitare si nga perspektiva e studiuesve, ashtu edhe nga disa raste praktike të ndërhyrjeve humanitare ndër vite.

Kapitulli i tretë me titull ***“Ligjshmëria dhe legjitimiteti i ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë”*** shqyrton ndërhyrjen humanitare nga këndvështrimi i rastit të Kosovës. Në fillim përmban një përshkrim të shkurtër të historikut të konfliktit dhe të krizës humanitare në Kosovë disa vite para ndërhyrjes së NATO-s. Pastaj përgjigja ndërkombëtare si nga OKB-ja, organizatat regjionale, shtetet, për krizën humanitare e deri te ndërhyrja ushtarake e NATO-

s në Kosovë. Duke parë që ndërhyrja në Kosovë është shumë e debatuar. Përqendrimi dhe analiza kryesore në këtë kapitull do të jetë te ligjshmëria e ndërhyrjes, legjitimiteti i saj dhe në fund se a përbën ndërhyrja e NATO-s në Kosovë një normë të re zakonore për të drejtën e ndërhyrjes humanitare.

Në kapitullin e katërt me titull ***“Përgjegjësia për të mbrojtur: nga një ide në një normë në zhvillim”***, kjo doktrinë do të trajtohet si një normë e re në zhvillim, duke përshkruar se si lindi ideja që në vend të “ndërhyrjes humanitare” të flitet dhe të punohet për “përgjegjësinë për të mbrojtur”. Prandaj në fillim do të flitet për sfondin e lindjes dhe paraqitjes së PpM-së, duke kaluar në zhvillimin e këtij parimi në OKB. Përqendrimi kryesor do të jetë zhvillimi i kësaj doktrine nga Institucionet e OKB-së, siç janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Sigurimit, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe Këshilli për të Drejtat e Njeriut. Përveç këtyre institucioneve, një rol të rëndësishëm në zhvillimin e PpM-së kanë edhe disa organizata regjionale dhe shoqëria civile, të cilat do të elaborohen thukët në këtë kapitull. Edhe me rastin e trajtimit të PpM-së do të përqendrohem te ndërhyrja e NATO-s në Libi si dhe ideja e Brazilit për “përgjegjësinë duke mbrojtur”, ku do të përfshihet zbatimi i PpM-së dhe qëndrimet e shteteve në raport me të. E fundit për nga radha por jo edhe për nga rëndësia, gjithsesi se është edhe statusi ligjor i kësaj doktrine pasi që PpM është pranuar nga raportet dhe rezolutat e institucioneve të OKB-së vetëm nga viti 2005 e këndej. Së bashku me të në fund të kapitullit do të ballafaqohen botëkuptimet e ndryshme të studiuesve dhe qëndrimet e shteteve midis suksesit dhe dështimit të kësaj doktrine.

Kapitulli i pestë dhe i fundit, me titull ***“Siria dhe përgjegjësia për të mbrojtur”*** do të përmbajë një përshkrim të shkurtër të paraqitjes së konfliktit dhe dhunës në Siri, duke vazhduar me përgjigjen ndërkombëtare si nga OKB-ja dhe Liga Arabe, ashtu edhe nga shtetet individuale. Më pas, fokusi i këtij kapitulli do të jenë veprimet e Këshillit të Sigurimit në Siri dhe dështimi i saj për të vepruar dhe për të zbatuar PpM-në në Siri.

PJESA E PARË

KAPITULLI I

1. LINDJA DHE ZHVILLIMI I TË DREJTËS SË NDËRHYRJES HUMANITARE

1.1. Historiku i ndërhyrjes humanitare

Origjina e doktrinës së ndërhyrjes humanitare mund të gjurmohet në periudhën e kryqëzatave. Në shekullin e trembëdhjetë, Shën Tomas Akuini propozoi që "një vend sovran ka të drejtë të ndërhyjë në punët e brendshme të një vendi tjetër" kur ky i fundit në masë i keqtrajton qytetarët e vet.¹ Njohja e hershme e doktrinës së ndërhyrjes humanitare i atribuohet më së shumti veprave të autorit holandez të shekullit të 17-të Hugo Grotius, i cili shpesh quhet "babai i së drejtës ndërkombëtare".² Grotiusi e mohon të drejtën për rezistencë ndaj shtypësit, mirëpo ai e konsideron si të drejtë të përdorë luftën për të parandaluar keqtrajtimin nga një shtet ndaj qytetarëve të vet, ndërsa mohoi të drejtën e rezistencës ndaj shtypjes nga sundimtari. Kjo një rregull paksa tronditëse, sepse nuk mund të jetë e lehtë të kuptohet - pse ai lejon një shtet të huaj për të ndërhyrë në luftë, në emër të të shtypurve, ndërsa ua mohon të persekutuarve të drejtën për vetërezistencë. Lauterpacht thekson se si pjesë e përgjigjes është, ndoshta, se ai mbajti idenë që luftëra të tilla ndërhyrëse që të lejoheshin vetëm në raste ekstreme që përkojnë kryesisht me ato në të cilat mbreti e shfaq veten si armik të popullit të tij dhe në të cilat rezistenca është e lejuar.³ Megjithatë, kjo është deklarata e parë e besueshme e parimit të ndërhyrjes humanitare - parim që ekskluziviteti i juridiksionit vendor ndalon aty ku fillon zemërimi ndaj njerëzimit.⁴

Ideja e Grotius për ndërhyrjen humanitare më vonë u mbështet nga shumë studiues të tjerë. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë ato u pasqyruan në shumicën e botimeve në këtë temë.

¹ Las Cuevas, 'Exceptional Measures Call For Exceptional Times: The Permissibility Under International Law of Humanitarian Intervention to Protect a People's Right to Self-Determination', (2007), 37(2) Houston Journal of International Law 495.

² Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention: Legalizing the Use of Force to Prevent human Right Atrocities', (1992), (16)1 article 4 Fordham International Law Journal 127 [tani e tutje: Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention']; shih gjithashtu: Danish Institute of International Affairs, *Humanitarian Intervention, Legal and Political Aspects* (1999); Jonah Eaton, 'An Emerging Norm- Determining the Meaning and Legal Status of the Responsibility to Protect', (2011), (32)4 775.

³ H. Lauterpacht, *The Grotian Tradition in International Law*, (1946) The British Year Book of International Law, (Oxford University Press 1946) 46.

⁴ Ibid.

Edhe pse gjatë shekullit XIX parimi i mosndërhyrjes gradualisht fitoi terren dhe përgjithësisht pranohet se deri në fund të shekullit XIX, shumica e studiuesve të së drejtës pranonin të drejtën e ndërhyrjes humanitare.⁵ Mendohet se në v. 1800, përveç luftërave për pushtim dhe kolonializëm, shtetet angazhohen në luftëra me nivele të ndryshme të ndërhyrjes humanitare. Shumë prej këtyre ndërhyrjeve u ndërmorën nga shtete të fuqishme europiane për t'i dhënë fund masakrave të civilëve të krishterë në territorin e Perandorisë Osmane.⁶ Kështu, Britania e Madhe, Franca dhe Rusia ndërhyjnë në vitin 1827 në luftën midis Greqisë dhe Turqisë Revolucionare, sepse opinioni publik ishte i tmerruar nga mizoritë e kryera gjatë kësaj lufte.⁷ Oppenheim besonte se nuk mund të mohohet që opinioni publik dhe qëndrimi i pushteteve të jenë në favor të ndërhyrjeve të tilla dhe ndoshta mund të thuhet se me kalimin e kohës e drejta e kombeve do të njohë rregullin që ndërhyrjet në interes të njerëzimit janë të pranueshme me kusht që ato të ushtrohen në formën e një ndërhyrjeje kolektive.⁸

Gjatë shekullit të 19-të, një shtet sovran kishte liri të shpallte luftë ndaj një shteti tjetër, por nëse nuk arrinte të vepronte kështu, ai mund të sulmonte vetëm në "baza të paqarta për justifikim". Ndërhyrja Ruse në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Bullgari më 1877-78,⁹ pretendonte ndërhyrjen humanitare në rajon, por Britania e Madhe e konsideronte ndërhyrjen ruse si një "kapje pushteti". Në mënyrë të ngjashme publiku i Shteteve të Bashkuara (SHBA) bëri thirrje për ndërhyrje në Kubë për arsye humanitare, Presidenti McKinley artikuloi motivet, duke përfshirë shqetësimet për sigurinë e qytetarëve amerikanë dhe ruajtjen e tregtisë së pasurisë së SHBA-së dhe sigurinë kombëtare.¹⁰ Një shembull tjetër relevant i praktikës shtetërore gjatë kësaj epoke ndodhi në vitin 1912, kur Greqia, Bullgaria dhe Serbia ndërhyjnë në Maqedoni për t'i dhënë fund keqtrajtimit të të krishterëve, gjithashtu nga Perandoria Osmane.¹¹ Në vitin 1920 arsyetimi për ndërhyrjen u zgjerua për të përfshirë

⁵ Danish Institute of International Affairs 1999 *Humanitarian Intervention, Legal and Political Aspects*, (1999) 11 [tani e tutje: Danish Institute of International Affairs, '*Humanitarian Intervention*'].

⁶ Chelsea O'Donnell, 'The Development of the Responsibility to protect: An Examination of the Debate Over the Legality of Humanitarian Intervention', (2014). (24)557, *Duke Journal of Comparative & International Law*, 299.

⁷ L. Oppenheim, *International Law A Treaties*, (I) (Longmans, Green and Co. 1905) 186.

⁸ Po aty.

⁹ Tania Von, 'Closing the gap between Legitimacy and legality of Humanitarian Intervention: Lessons from East Timor and Kosovo', (2012) *UCLA J. INT'L L. and & for AFF* 43 [tani e tutje: Tania Von. 'Closing the gap between Legality and Legitimacy of humanitarian Intervention'].

¹⁰ Ibid 44.

¹¹ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 129.

mbrojtjen e shtetasve jashtë vendit,¹² ku disa argumentuan se ndërhyrja e shteteve për mbrojtjen e shtetasve jashtë vendit dhe vetëmbrojtja, ishte e ligjshme nën të drejtën zakonore para miratimit të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe ka vazhduar të jetë kështu edhe pas miratimit të saj.¹³ Mbrojtja e shtetasve është mbështetur nga qeveria Britanike për të mbrojtur ndërhyrjen e saj të armatosur në Egjipt përgjatë krizës së Kanalit të Suezit në vitin 1956; po ashtu është avancuar nga SHBA-ja për ndërhyrjen e saj në Granadë në vitin 1983 dhe në Panama në vitin 1989.¹⁴ Gjithashtu, edhe raste të tjera të ndërhyrjeve të këtilla do të trajtohen në vazhdim të punimit.

Deri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shumica e studiuesve të së drejtës ndërkombëtare pranuan se ekziston një e drejtë për ndërhyrje humanitare (*l'intervention d'humanite*). Një shtet që kishte abuzuar me sovranitetin e vet, me trajtimin brutal dhe tepër mizor të atyre që ishin në pushtet, qofshin shtetas apo jo, është konsideruar të jetë detyruar të veprojë nga shteti, i cili ishte i gatshëm të ndërhyjë.¹⁵ Një pakicë e konsiderueshme e autorëve hodhën poshtë edhe këtë doktrinë duke iu referuar parimit të ngurtë të mos ndërhyrjes.¹⁶ Sipas Ian Brownlie, doktrina ishte e paqartë dhe protagonistët e saj i dhanë një sërë formash. Disa autorë e kufizuan atë në veprim për të çliruar një komb të shtypur nga një tjetër; disa e konsideronin objektin e saj për t'i dhënë fund krimeve dhe masakrave; ndërsa disa i referoheshin 'tiranisë', të tjerë për mizori ekstreme; disa për persekutimin fetar dhe së fundi, disa e ngatërruan këtë çështje, duke e konsideruar si ndërhyrje të ligjshme në rast të një qeverisjeje të dobët ose 'keqtrajtimi' që shpinte në anarki.¹⁷

¹². Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty (ICISS), *The Responsibility to Protect* (2001), International Development Research Centre, 16 [tani e tutje: Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty].

¹³. Milena Sterio, 'Humanitarian Intervention, Post-Syria: Legitimate and Legal?', (2014) (40) 1, Article 3, Brooklyn Journal of International Law, 119-120 [tani e tutje: Milena Sterio, 'Humanitarian Intervention'].

¹⁴. Ibid 120.

¹⁵. Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, (Seventh Edition, Oxford University Press, 2008) 742 [tani e tutje: Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*]; shih gjithashtu: Malcolm N. Shaw, *International Law*, (Sixth Edition, Cambridge University Press, 2008) 1156.

¹⁶. Encyclopedia of Public International Law, *Use of Force War and Neutrality Peace Treaties*, (North-Holland Publishing Company, 1982) 2012.

¹⁷. Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 742.

1.1.1. Ndalimi i përdorimit të forcës dhe ndërhyrja humanitare pas shekullit njëzet

Në shekullin XX, doktrina e ndërhyrjes humanitare fillon të zhduket nga praktika shtetërore dhe humbet gradualisht në të drejtën ndërkombëtare. Pas Luftës së Parë Botërore, ligjshmëria e përdorimit të forcës u reduktua në rastet e vetëmbrojtjes, ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.¹⁸ Pra, siç duket, deri në shekullin XX, nuk ekzistonte asnjë ndalim i përdorimit të forcës dhe shtetet ishin të lira t'i drejtoheshin luftës. Edhe pse teoria mesjetare e *bellum justum* ishte zhvilluar nga teologët, mirëpo kurrë nuk ishte një rregull i vlefshëm në të drejtën ndërkombëtare. Kështu forca lejohej të përdoret në marrëdhëniet midis shteteve pa asnjë kusht. Kështu vijoi të ishte situata ligjore pothuajse deri në vitin 1919.¹⁹

Pasi u themelua Organizata e Lidhjes së Kombeve, e cila me Konventën e saj²⁰ ofron potencialin që ndërhyrja humanitare të kryhet në nivel rajonal dhe ndërkombëtar dhe jo në baza të njëanshme, me masa të duhura institucionale për të parandaluar abuzimin. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe shtetet tentonin të largoheshin nga përdorimi i forcës për të mbrojtur të drejtat e njeriut ose përndryshe thuhet se ndërhyrja me qëllim të kryerjes për këtë arsye, shpesh kishte interes në përfitimet territoriale.²¹ Konventa nuk përcaktonte saktësisht ndalimin e fillimit të dhunës së çfarëdo përmase.²² Pra, *inter alia*, ajo nuk arriti të vendoste një ndalim të përgjithshëm të luftës, edhe pse Neni 10-të i Konventës sugjeronte një interpretim të tillë.²³ Më 1928, Konventa u plotësua nga Traktati i Përgjithshëm për heqjen dorë nga lufta, si një instrument i politikës kombëtare, i njohur ndryshe si: Pakti "Briant

¹⁸ Danish Institute of International Affairs, 'Humanitarian Intervention', 12.

¹⁹ Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*, (Volume I, 3rd edn., Oxford University Press, Volume I 2012) 482 [tani e tutje: Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*].

²⁰ Covenant of the League of Nations, (28 April 1919), <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/3dd8b9854.html>> qasur 18 Prill 2018.

²¹ Tania Von. 'Closing the gap between Legality and Legitimacy of humanitarian Intervention', 44.

²² Martin Dixon, *E Drejta Ndërkombëtare* (Botuar në gjuhën shqipe nga: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2011) 406. [tani e tutje: Martin Dixon, *E Drejta Ndërkombëtare*].

²³ Por, nëse lexohet neni 10 në lidhje me nenet 12, 13, dhe 15, Konventa e Lidhjes së Kombeve, ngjashëm me Traktatet Briant Kellog, thjeshtë parashikonte një moratorium ('periudha e ftohjes') për të gjitha rastet e konfliktit të armatosur, ndërsa vetëm në raste të veçanta anëtarët e Lidhjes së Kombeve u privuan nga liria për të shkuar në luftë. Anëtarët e Lidhjes ishin të detyruar të mos i nënshtroheshin luftës përpara se marrëveshja të paraqitesh në zgjidhje gjyqësore, arbitrazhin, ose Këshillin e Lidhjes. Përkrahja e luftës ishte e ndaluar në raste se ishte miratuar një raport unanimitet nga Këshilli i Lidhjes (Neni 15(6)). Meqë në praktikë, shumica e mos marrëveshjeve të paraqitura në Këshill nuk u miratuan unanimitet, ky mekanizëm i lidhjes nuk provoi të ishte një ndalim efektiv i luftës. Vetë në raste se Këshilli nuk mund arrinte të miratonte në mënyrë unanime një raport, 'anëtarët e lidhjes e rezervojnë të drejtën për të ndërhyrë veprime të tilla që i konsiderojnë të nevojshme për ruajtjen e të drejtës dhe drejtësisë' (Neni 15 (7)), *shih*: The Covenant of the League of Nations, (28 April 1919) e vlefshme në: <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/3dd8b9854.html>>; Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*, 482- 483).

Kellog”.²⁴ Traktati përmbante vetëm dy nene thelbësore, sipas Nenit 1, palët deklarojnë solemnisht në emër të popujve të tyre se “ata dënojnë përdorimin e forcës si një zgjidhje e polemikave ndërkombëtare, dhe heqin dorë nga ajo si një instrument i politikave kombëtare në marrëdhëniet me njëri-tjetrin”,²⁵ ndërsa me Nenin 2 palët pajtohen që “zgjidhja e të gjitha mos marrëveshjeve ose konfliktet e çfarëdo natyre dhe origjine që mund të lindin midis tyre, zgjidhen me mjete paqësore”.²⁶ Në sa kohë që Pakti përmbante një ndalim të luftës, nuk ishte i zbatueshëm. Por kjo nuk e përjashtoi atë nga prodhimi i efekteve mbi pasojat ligjore të luftës të ndiqen për shkelje të Paktit.²⁷ Kështu, për herë të parë, u formulua një ndalim i përgjithshëm i luftës ku i nënshtrohen vetëm të drejtës së vetëmbrojtjes. Ky përjashtim nuk përmendet shprehimisht në tekst, por pa dyshim përfaqëson një marrëveshje të heshtur midis palëve.²⁸ Po ashtu, Pakti Briand-Kellog la ndikimin e tij edhe në mënyra të tjera, së pari, ai shërbeu si burim frymëzimi dhe modeli për tekstet e mëvonshme dhe shërbeu për ndalimin e përgjithshëm të përdorimit dhe kërcënimit të forcës, siç parashihet me Nenin 2(4) të Kartës së OKB-së dhe, së dyti, disa studiues theksuan se mund të jetë rasti i praktikës shtetërore në fund viteve 20-ta deri te Karta e OKB-së për paligjshmërinë e përdorimit të forcës, sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare.²⁹

1.2. Karta e Kombeve të Bashkuara dhe e Drejta e Ndërhyrjes – Neni 2(4) i Kartës

Karta e OKB-së e miratuar në vitin 1945 ndryshoi krejtësisht të drejtën ndërkombëtare duke nxjerrë jashtë ligjit pothuajse të gjitha mjetet e njëanshme për përdorimin e forcës.³⁰ Sipas Nenit 2(3), anëtarët e organizatës duhet të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre

²⁴ Numri i anëtarëve të këtij Pakti ishte 63, duket përfshirë anëtarët e Lidhjes së Kombeve, me përjashtim: Argjentina, Bolivia, El-Salvadori dhe Uruguaji, shih: Lesaffer, R. C. H. (2011). Kellogg-Briand Pact (1928). In R. Wolfrum (Ed.), *Max Planck Encyclopedie of Public International Law* (Oxford University Press).

²⁵ General Treaty for the Renunciation of War (Kellogg- Briand Pact 27 August 1928), article 1, e vlefshme në: <<https://iilj.org/wp-content/uploads/2016/08/General-Treaty-for-the-Renunciation-of-War-Kellogg-Briand-Pact.pdf>>

²⁶ Po aty, Neni 2. Pakti nuk përcakton një detyrim të qartë të shteteve për të zgjidhur mosmarrëveshjet me mjete paqësore, por vetëm për të ‘kërkuar’ një zgjidhje përmes mjeteve të tilla. Ai nuk shton detyrimet e Konventës së Lidhjes së kombeve. Nuk kishte asnjë parashikim për kërcënimin e luftës. Pakti nuk e kufizoi në asnjë mënyrë të drejtën për të përdorur luftën midis shteteve jo- nënshkruese apo edhe shteteve nënshkruese me shtetet jo-nënshkruese. Dhe se pakti nuk parashikonte sanksione. Shih: Lesaffer, R. C. H. (2011). Kellogg-Briand Pact (1928). In R. Wolfrum (Ed.), *Max Planck Encyclopedie of Public International Law* (Oxford University Press) 6.

²⁷ Randall Lesaffer, *Kellogg-Briand Pact (1928)*, Max Planck Encyclopedia of Public International Law, (Oxford University Press, 2011) 6 [tani e tutje: Randall Lesaffer, ‘Kellog- Briand Pact (1928)’].

²⁸ Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*, 483.

²⁹ Lesaffer, Randall, Randall Lesaffer, ‘Kellogg- Briand Pact (1928)’, 7.

³⁰ Barry M. Benjamin, ‘Unilateral Humanitarian Intervention’, 129.

ndërkombëtare në një mënyrë paqësore. Më tej Karta ndalon në mënyrë shprehimore përdorimin e forcës në nenin 2(4), si vijon:

“Të gjithë anëtarët do të shmangin në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare kërcënimin apo përdorimin e forcës kundër integritetit territorial apo pavarësisë politike të çdo shteti, ose të çdo mënyre tjetër që nuk përputhet me qëllimet e Kombeve të Bashkuara”³¹

Si i tillë, neni 2(4) përcakton një ndalim të përgjithshëm të përdorimit të forcës. Më saktësisht, zgjerohet ndalimi i forcës përtej luftës, duke përfshirë lloje të tjera të përdorimit të njëanshëm dhe kërcënimit të forcës. Prandaj ajo siguron ndalimin e forcës si një parim të përgjithshëm dhe autoritar.³² Rëndësia e Nenit 2(4) njihet po ashtu nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), në rastin *Aktivitetet e Armatosura në Territorin e Kongos* ku theksoi se neni 2(4) është gurëthemeli kryesor i Kartës së Kombeve të Bashkuara,³³ me vlefshmëri universale; madje edhe për ato pak shtete që nuk janë anëtare të Kombeve të Bashkuara.³⁴ Ky ndalim i përdorimit të forcës në nenin 2(4) përfaqëson të drejtën zakonore ndërkombëtare apo si *jus cogens*, siç është pranuar nga GJND-ja në rastin *Nikaragua*.³⁵ Është e arsyeshme të supozohet se gjykata po i referohej në parim të drejtës zakonore ekzistuese në vitin 1945, së bashku me çdo zhvillim të mëvonshëm.³⁶ Por interpretimi i saj ka krijuar shumë debate³⁷ dhe teksti i kësaj dispozite ende nuk është paqartësi.³⁸

³¹ The United Nations Charter, (United Nations 1945), e vlefshme në: <<https://www.un.org/en/about-us/un-charter>> [tani e tutje: The United Nations Charter 1945].

³² Mügr Kinancıoğlu, ‘The Principles of the non-intervention at the United Nations. The Charter Framework and the legal debate’, (2005), European Institute and Visiting Fellow, Centre for International Studies, 17.

³³ *Armed Activities on the Territory of the Congo (Democratic Republic of the Congo v Uganda)* [2005] ICJ Rep 168, para. 148.

³⁴ Peter Malanczuk, *Akehurst’s Modern Introduction to International Law*, (7th revised ed., Taylor & Francis e-Library, 2002) 309 [tani e tutje: Peter Malanczuk, *Akehurst’s Modern Introduction of International Law*].

³⁵ Christine Gray, ‘The Use of Force and the International Legal Order’, (Book Chapter), 591; Ndalimi i përdorimit të forcës përveç se është i obliguar nga e drejta e traktateve ndërkombëtare, ku palët duhet të përmbahen nga përdorimi i forcës kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shtetit tjetër, por se përodimi i forcës ekziston edhe në të drejtën zakonore ndërkombëtare një *opinio juris*, për karakterin detyrues të këtij abstenimi, *Shih: Case Concerning Military and Paramilitary Activities in and Against Nicaragua* (Nicaragua v. United States of America), (Merits, Judgment.), [1986] ICJ Rep 1986 par. 187- 190.

³⁶ Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 732.

³⁷ Christine Gray, *The Use of Force and the International Legal Order*, (3rd ed., Oxford University Press: 2003) 591-592 [tani e tutje: Christine Gray, *The Use of Force and International Legal Order*].

³⁸ René Värk, ‘The use of force in the modern World: Recent Developments and Legal Regulation of the Use of Force’, (2003) (2)10 Baltic Defence Review, 29.

Neni 2(4) është i hartuar mirë, për aq sa flet për "kërcënimin ose përdorimin e forcës" dhe jo të "luftës". 'Lufta' ka një kuptim teknik (por jo të saktë) në të drejtën ndërkombëtare dhe shtetet shpesh angazhohen në armiqësi, duke mohuar se ata janë teknikisht në gjendje lufte; armiqësitë e tilla mund të shkojnë nga incidentet e vogla kufitare në operacione të gjera ushtarake, siç ishte, p.sh.: përpjekja anglo-franceze për të zënë zonën që rrethon Kanalin e Suezit në vitin 1956.³⁹ Ndalimi i forcës në nenin 2(4) përfshin kërcënimin, por edhe përdorimin e forcës. Megjithatë, gjuha e nenit 2(4), as nuk e përkufizon dhe, as nuk e cilëson termin "forcë". Pikëpamja mbizotëruese është se nocioni i "forcës" në nenin 2(4) nuk shtrihet në të gjitha llojet e forcës, siç është forca politike dhe ekonomike, por nënkupton vetëm forcën e armatosur.⁴⁰ Edhe *travaux préparatoires* të Kartës së OKB-së ilustrojnë faktin se vetëm forca ushtarake është shqetësim për përdorimin e forcës. Në Konferencën e San Franciskos, një propozim nga Brazili për ta zgjeruar ndalimin e forcës edhe në detyrimin ekonomik, ishte refuzuar në mënyrë eksplicite.⁴¹

Shtetet e zhvilluara dhe ato në zhvillim janë të ndarë në kuptimin e "forcës". Të parët pohojnë se kjo do të thotë vetëm forcat e armatosura, ndërsa shtetet në zhvillim pohojnë se ajo përfshin gjithashtu detyrimin politik dhe ekonomik. Megjithatë, kjo ndarje është ndoshta më shumë simbolike sesa e një rëndësie praktike; detyrimi ekonomik tani është i ndaluar shprehimisht në Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme,⁴² siç është *Deklarata për Marrëdhëniet Miqësore*.⁴³ Në interpretimin e saj të parimit të refuzimit nga kërcënim i ose përdorimi i forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke përcaktuar se shtetet duhet të përmbahen nga marrëdhëniet ndërkombëtare nga kërcënim i apo përdorimi i forcës, deklarata i referohet vetëm forcës ushtarake. Gjithashtu, ajo përcakton llojet e tjera të detyrimit në kontekstin e parimit të përgjithshëm të mosndërhyrjes në çështjet brenda

³⁹ Peter Malanczuk, po aty, fq. 309.

⁴⁰ Mügr Kinancıoğlu, 'The Principles of the Non-Intervention at the United Nations. The Charter Framework and the legal debate', (2005), European Institute and Visiting Fellow, Centre for International Studies, London, 18-19 [tani e tutje: Mügr Kinancıoğlu, 'The Principles of the Non-Intervention at the United Nations'].

⁴¹ Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*, (Oxford University Press, Volume I (3rd Edition) 2012) 485.

⁴² Christine Gray, Christine Gray, *The Use of Force and International Legal Order* 592; shih gjithashtu: *Declaration on Principles of International Law concerning Friendly Relations and Co-operation among States in accordance with the Charter of the United Nations*, (A/RES/25/2625).

⁴³ UN General Assembly, *Declaration on Principles of International Law concerning Friendly Relations and Cooperation among States in accordance with the Charter of the United Nations*, (24 October 1970), (A/RES/2625(XXV)), e vlefshme: <<https://www.refworld.org/docid/3dda1f104.html>> qasur 20 Janar 2021.

juridiksionit të brendshëm të një shteti.⁴⁴ Praktika mbizotëruese e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare i trajton vetëm rastet që përfshijnë forcën ushtarake që bie në ndalimin e përdorimit të forcës dhe kështu konfirmon leximin e ngushtë të saj. Ndërsa llojet e tjera të detyrimit ekonomik nuk janë të mbuluara nga neni 2(4) i Kartës, por mund të jenë nën parimin e përgjithshëm të mosndërhyrjes.⁴⁵

Gjithashtu, problemi i ‘forcës indirekte’, neni 2(4) mund të kufizohet në ndalimin e përdorimit të forcës, por një ndalim i tillë nga ana tjetër duhet të trajtohet më gjerësisht. Jo vetëm që është i ndaluar përdorimi i drejtpërdrejtë i forcës, por edhe përdorimi i forcës indirekte të armatosur. Nocioni i forcës indirekte i referohet pjesëmarrjes së një shteti në përdorimin e forcës nga një shtet tjetër (p.sh., duke lejuar që pjesë të territorit të tij të përdoren për veprime të dhunshme kundër një shteti të tretë), si pjesëmarrjen e një shteti në përdorimin e forcës nga bandat jo zyrtare të organizuara në mënyrë ushtarake, si forca të parregullta, mercenarë, ose rebele kundër një shteti tjetër. Në veçanti, shtetet perëndimore që ishin prekur nga ajo formë e përdorimit të forcës, ishin përpjekur ta ndalonin përdorimin e forcës indirekte nga një interpretim në nivel të së drejtës ndërkombëtare nga një interpretim më i gjerë i nenit 2(4). Si rezultat i përpjekjeve të tyre, se është praktikisht e padiskutueshme sot, si në shkrimet e autorëve, ashtu edhe në praktikën e OKB-së, se Neni 2(4) shtrihet në përdorimin e forcës indirekte. Megjithëse, sipas komentarit për Kartën e OKB- së të Bruno Simma, rëndësia e konsensusit të tillë nuk duhet mbivlerësuar, pasi është akoma e paqartë se cilat forma të pjesëmarrjes në akte dhune të kryera nga grupe të organizuara ushtarake mund të thuhet se përbëjnë ‘forcë’ brenda kuptimit të Nenit 2(4) të Kartës.⁴⁶ Në lidhje me atë se çfarë lloje të aktiviteteve mund të përbëjnë përdorimin e forcës, GjND-ja, në rastin *Nikaragua* konstatoi se jo çdo veprim i ndihmës duhet të kualifikohet si përdorim i forcës. Gjykata dallonte, nga njëra anë, armatosjen dhe trajnimin e forcave të armatosura të opozitës, të cilat

⁴⁴ Mügr Kinancioğlu, ‘The Principles of the Non-Intervention at the United Nations’, 18 ; ‘Deklarata për Marrëdhënie Miqësore’ e AP- së përcakton edhe fora të tjera të mos ndërhyrjes në një shtet tjetër, më pak të rënda se përdorimi i forcës, shih: UN General Assembly, (A/RES/2625(XXV), 24 October 1970; *Armed Activities on the Territory of the Congo (Democratic Republic of the Congo v Uganda)* [2005] ICJ Rep 168, para. 191.

⁴⁵ Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*, 485.

⁴⁶ Ibid 486. Nga Deklarat e AP- së për Marrëdhëniet Miqësore, megjithatë, mund të nxirret një specifikim e cila përshkruan ndalimin e forcës indirekte, ku parasheh se: çdo shtet ka për detyrë të përmbahet nga organizimi apo, inkurajimi i organizimit të forcave të parregullta, ose bandave të armatosura, ose mercenarët për inkursion në territorin e shtetit tjetër. Çdo shtet ka për detyrë të përmbahet nga organizimi, nxitja, ndihma, ose pjesëmarrja në akte të luftës civile, ose akte terroriste në një shtet tjetër, ose ndërmarrjes së aktiviteteve brenda territorit të vet, të drejtuara drejtë kryerjes së akteve të tilla, kur akte të tilla përfshijnë një kërcënim ose përdorim të forcës”. UN General Assembly, (A/RES/2625(XXV), 1970), para. 8-9.

mund të përbënin një përdorim të paligjshëm të forcës nga SHBA-ja dhe, nga ana tjetër, furnizimin e fondeve të opozitës, ndonëse është padyshim një përzierje në punët e brendshme të Nikaraguas, megjithatë nuk përbën në vetvete një përdorim të forcës.⁴⁷ Megjithatë Bruno Simma në Komentarin e Kartës konkludon se fusha e ndalimit të përdorimit të forcës nuk është ende e qartë në lidhje me problemin e ndihmës së aktiviteteve armiqësore. Nëse neni 2(4) është shkelur në një rast të caktuar, mund të përcaktohet vetëm duke marrë parasysh dhe vlerësuar të gjitha rrethanat përkatëse.⁴⁸

Një tjetër debat lidhur me këtë dispozitë, ka të bëjë me ndalimin e përdorimit të forcës ‘kundër integritetit territorial’ dhe ‘pavarësisë politike’, ashtu siç parashihet me nenin 2(4) të Kartës mund të parashtrohet pyetja se a mund të ketë përdorim të forcës që nuk dëmton integritetin territorial ose pavarësinë politike të një shteti?⁴⁹ Në Komentarin e Kartës së OKB-së, sipas Bruno Simma termi, ‘integritet territorial dhe ‘pavarësi politike’ nuk kanë për qëllim kufizimin e përdorimit të forcës. Përkundrazi, të dy mënyrat e përdorimit të forcës mbulojnë çdo lloj forme të mundshme të përdorimit të forcës.⁵⁰ Ndërsa, sipas një pikëpamjes lejuese, nëse përdorimi i forcës nuk sjell humbje ose pushtimin e përhershëm të një territori, nuk e vë në rrezik zotësinë e një shteti “që është vënë në shenjë”, për të marrë vendime të pavarura që nuk bie në kundërshtim me qëllimet e OKB-së, ai nuk është i padrejtë.⁵¹

Kështu, debati nëse neni 2(4) është një ndalim i gjerë ose i ngushtë për përdorimin e forcës ka tejkaluar luftën e ftohtë. Në praktikë, pak shtete u mbështetën hapur në një interpretim të ngushtë të nenit 2(4) për të justifikuar përdorimin e tyre të forcës gjatë luftës së ftohtë. Miratimi i dukshëm i argumentit kufizues për nenin 2(4) nga ana e Mbretërisë së Bashkuar në GJND në rastin e *Kanalit të Korfuzit*, argumentoi se ndërhyrja e saj me forcë në ujërat territoriale të Shqipërisë për të rikuperuar dëshmi (se cili shtet ishte përgjegjës për hedhjen e minave detare që kishte çuar në shkatërrimin e dy anijeve britanike) nuk shkeli nenin 2(4),

⁴⁷ Christine Gray, *International Law and the Use of Force*, (3rd ed., Oxford University Press, 2008) 30 [tani e tutje: *Christine Gray, International Law and the Use of Force*] Sipas mendimit të Gjykatës, ndërsa armatosja dhe trajnimi i opozitës me siguri mund të thuhet se përfshinte kërcënimin ose përdorimin e forcës kundër Nikaraguas, kjo nuk është domosdoshmërisht kështu në lidhje me të gjithë ndihmën e dhënë nga qeveria e SHBA-ve. Në veçanti, gjykata konsideron se furnizimi i opozitës me fonde, sigurisht përbën një veprim i ndërhyrjes në punët e brendshme të Nikaraguas, por, nuk përbën në vetvete një përdorim të forcës. Shih; *Case Concerning Military and Paramilitary Activities in and Against Nicaragua* (Nicaragua v. United States of America), (Merits, Judgment.), [1986] ICJ Rep 1986, para 228.

⁴⁸ Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*, 487.

⁴⁹ Christine Gray, *The Use of Force and the International Legal Order*, 593.

⁵⁰ Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*, 489.

⁵¹ Martin Dixon, *E Drejta Ndërkombëtare*, 409.

sepse veprimi i saj nuk kërcënonte integritetin territorial dhe pavarësisë politike të Shqipërisë. Gjykata e hodhi poshtë këtë kërkesë.⁵² Mendimi se Neni 2(4) duhet të interpretohet gjerësisht, mbështetet nga rasti i *Kanalit të Korfuzit*.⁵³

“Gjykata mund të konsiderojë vetëm të drejtën e supozuar të ndërhyrjes si manifestim i një politike të forcës, siç ka bërë në të kaluarën shkaktimin e abuzimeve më serioze dhe të tilla që, pavarësisht nga defekti aktual në organizatën ndërkombëtare, nuk munden të gjejnë një vend në të drejtën ndërkombëtare”.

Gjykata e GJND-së vazhdoi duke arsyetuar se:

*“Ndërmjet shteteve të pavarura, respektimi i sovranitetit territorial është fundament bazë në marrëdhënieve ndërkombëtare. Gjykata njeh se dështimi i plotë i Qeverisë Shqiptare për të eliminuar detyrat e veta pas shpërthimeve dhe natyrën e hollësishme të shënimeve të saj diplomatike janë rrethana lehtësuese për veprimin e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Por për të siguruar respektimin e të drejtës ndërkombëtare... Gjykata duhet të deklarojë se veprimi i Marinës Britanike përbënte një shkelje të sovranitetit shqiptar”.*⁵⁴

Megjithatë, *travaux préparatoires*⁵⁵, puna përgatitore e Kartës është mjaft e qartë dhe ky formulim është prezantuar pikërisht për të dhënë garanci për shtetet e vogla dhe nuk kishte për qëllim të kishte një efekt kufizues.⁵⁶ Në mënyrë të ngjashme kishte indikacione se Izraeli gjithashtu bëri një interpretim të ngushtë të nenit 2 (4) mbi Entebe të Ugandas në vitin 1976; kur rrëmbyesit i ndërruan kursin një avioni nga drejtimi i Tel Aviv në drejtim të Ugandës, forcat izraelite ngritën një operacion shpëtimi të suksesshëm në Ugandë. Argumenti kryesor i Izraelit në KS të OKB-së ishte shprehimisht i bazuar në mbrojtjen e shtetasve të saj.⁵⁷

⁵² Christine Gray, *The Use of Force and the International Legal Order*, 594.

⁵³ Peter Malanczuk, *Akehurt's Modern Introduction of International Law*, 310.

⁵⁴ Corfu Channel case (Judgement) [1949] Rap. 1949 I.C.J. para. 35.

⁵⁵ *Travaux préparatoires*, përdoret për të përshkruar dëshminë dokumentare të negociatave, diskutimeve dhe hartimit të në teksti përfundimtar të traktatit etj.

⁵⁶ Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 732.

⁵⁷ Christine Gray, *International Law and the Use of Force*, 32.

Por në literaturën e së drejtës ndërkombëtare, ndalimi i përdorimit të forcës dhe kufijtë e saj në të drejtën ndërkombëtare kanë mbetur subjekt i një polemike të gjatë, të frymëzuar nga hendeku i gjerë midis retorikës zyrtare dhe praktikës aktuale jo konsistente të shteteve në funksion të konflikteve të shumta të armatosura që prej 1945 dhe mosefektivitetin e sistemit të sigurisë kolektive të OKB-së gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, gjë që ka shtruar pyetjen, nëse norma e përcaktuar në nenin 2(4) ende mund të konsiderohet e vlefshme.⁵⁸ GjND-ja ka konfirmuar se rregullat e Kartës së OKB-së mbi përdorimin e forcës ishin pjesë e së drejtës zakonore me karakterin e normave të *jus cogens*. Ndalimi i përdorimit të forcës rrjedh nga koncepti tradicional i Kartës për sovranitetin e shtetit. Sovraniteti nënkuptonte se shtetet ishin të lira të angazhoheshin në çfarëdo sjelljeje që ata e shihnin të përshtatshme brenda kufijve të tyre. Për më tepër, shtetet nuk mund të ndërhyjnë në punët e brendshme të shteteve të tjera, pavarësisht se sa të qarta mund të ishin këto çështje.⁵⁹ Rrjedhimisht, kërkesa për parimet e interpretimit të traktatit është i domosdoshëm për të zgjidhur konturat e nenit 2(4) dhe për të përcaktuar nëse ndërhyrja humanitare është absolutisht i ndaluar. Të bësh kështu, siguron depërtim në kuptimin modern të dispozitës, si dhe qëllimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara.⁶⁰

Si rezultat, për të përcaktuar kufijtë e vërtetë të nenit 2(4), duhet të shqyrtohet praktika e mëvonshme. Prandaj, nëse një normë zakonore është ngritur dhe nëse Neni 2(4) dhe Karta lejojnë ndërhyrjen humanitare, në fakt janë dy pjesë të së njëjtës hetim. Kështu, Karta nuk e ndalon absolutisht një normë zakonore të ndërhyrjes humanitare. Megjithatë e panevojshme, gjykata mund të shikojë edhe punën përgatitore ose *travaux préparatoires* të Konferencës së San Franciskos, për të arritur në përfundimin se Neni 2(4) nuk është absolut.⁶¹

Mirëpo interpretimet ligjore - autoritare të Kartës së OKB-së kanë nxjerrë përfundime të ndryshme mbi ndërhyrjen humanitare.⁶² Kundërshtarët e ndërhyrjes humanitare mund të argumentojnë në mënyrë legjitime se Karta u krijua në prag të Luftës së Dytë Botërore për të parandaluar shtetet nga abuzimi i pushtetit të tyre dhe pushtimi i sovranitetit të të tjerëve -

⁵⁸ Peter Malanczuk, *Akehurst's Modern Introduction of International Law*, 311.

⁵⁹ Milena Sterio, 'Humanitarian Intervention', 113-114.

⁶⁰ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention: Examining Viable Arguments Before The International Court Of Justice', (2012) (40)1-3, DENV. J. INT'L L. & POL'Y, 171. [tani e tutje: Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention'].

⁶¹ Ibid 173.

⁶² Jannifer M. Welsh, *Humanitarian Intervention, and International Relations*, (Oxford University Press, 2004) 74 [tani e tutje: Jannifer M. Welsh, *Humanitarian Intervention, and International Relations*].

abuzimi që gjatë Luftës së Dytë Botërore çoi në mizoritë më të tmerrshme të botës që ishin parë ndonjëherë.⁶³ Sipas një argumentimi të përgjithshëm ligjor, Karta e OKB- së me nenin 2(4) ndalon të gjitha përdorimet e forcave ushtarake, duke përfshirë këtu edhe ndërhyrjen humanitare, ku si përjashtime të vetme të lejuara për përdorimin e forcës janë veprimet e ndërmarra për vetëmbrojtje dhe veprimet nën autorizimin e Këshillit të Sigurimit (KS).⁶⁴ Madje, jo vetëm përdorimi i forcës, por edhe të gjitha kërcënimet e forcës *prima facie* janë të paligjshme. Prandaj një kërcënim është i lejuar vetëm, nëse forca aktuale e kërcënuar është e pranueshme që do të thotë se ai bie në nenin 42 (Kapitulli VII) ose nenin 51 të Kartës.⁶⁵ Marrë në tërësi, Karta e OKB-së, siç duket, nuk adreson drejtpërdrejt çështjen e ndërhyrjes humanitare, qoftë nën kujdesin e OKB-së apo nga shtetet që veprojnë në mënyrë të pavarur. Megjithatë Karta parashtrohet një sërë qëllimesh dhe rregullash, të cilat janë të rëndësishme për ndërhyrjen humanitare.⁶⁶

Duke marrë parasysh debatet e ndryshme për shkak të ndërhyrjeve të shteteve për qëllime humanitare në ndonjë shtet tjetër dhe shumë herë këto ndërhyrje kanë ngjallur polemika për ligjshmërinë e ndërhyrjeve humanitare, për qëllim të këtij punimi fokusi i Kapitullit II dhe III do të jenë pikërisht këndvështrime të ndryshme, si nga praktika e shteteve,

⁶³ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention', 171.

⁶⁴ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 130; Nëse mjetet që nuk kanë të bëjnë me përdorimin e forcës, siç janë, ndërprerja e plotë e marrëdhënieve ekonomike, diplomatike, pra shteti i cili nuk i zbaton masat e caktuara nga KS- ja, (Neni 41) atëherë, KS- ja ka të drejtë të autorizojnë përdorimin e forcës, me veprimet e forcave ajrore, detare, ose tokësore për të rivendosur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare (Neni 42). Ndërsa Neni 51 i Kartës, lejon të drejtën e vetëmbrojtjes individuale dhe kolektive nëse ndodh një sulm i armatosur kundër një anëtar të OKB- së, shih: *The Charter of the United Nations* (26 June 1945), i qasshëm në: <<https://www.un.org/en/charter-united-nations/>>

⁶⁵ James A. Green and Francis Grimal, 'The Threat of Force as an Action in Self-Defense Under International Law', (2011) (44)285, *Vanderbilt Journal of Transnational Law*, 295. Edhe pse përkufizimi i një 'kërcënimi të forcës' ka marrë shumë më pak konsideratë në shkrimet e studiuesve të së drejtës ndërkombëtare, se ai i 'përdorimit të forcës'. Kjo për faktin se, kërcënim i forcës rrallë ka qar në praktikën e shteteve në një rast që është argumentuar nën nenin 2(4) të Kartës. Kjo nuk do të thotë se kërcënim i forcës nuk ka ndodhur kurrë, por, në shumicën e rasteve ato i paraprinin përdorimit të forcës. Ndërsa, në anën tjetër praktika e shteteve zbulon një shkallë të lartë të tolerancës ndaj kërcënimeve të forcës, një arsye vendimtare se siç duket shumica nga këto kërcënime legjitimohen nga e drejta e vetëmbrojtjes nën nenin 51 të Kartës së OKB- së. Por, edhe është e vështirë të cilësohet se cilat janë veprimet e caktuara të një shteti e të cilat përbëjnë kërcënim të forcës. Nuk është e mjaftueshme që një shtet tjetër të reagojë ose besojë se po reagon ndaj një kërcënimi të supozuar të forcës. Vetëm një kërcënim i drejtuar drejt një reagimi specifik nga ana e shtetit të synuar, është i paligjshëm sipas kushteve të Nenit 2(4) të Kartës së OKB- së, shih: Bruno Simma, "*Charter of the United Nations: A Commentary*", 491; GJND- ja në Mendimin Këshillëdhënës për '*Ligjshmërinë e Kërcënimit apo Përdorimit të Armëve Bërthamore*', parashihte që në raste se ky "kërcënim" në kundërshtim me nenin 2(4) të Kartës, varet nëse përdorimi i parashikuar i armëve të tilla edhe në raste se synohej të ishte si mjet mbrojtës do të shkelte kërkesën e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Në cilën do nga këto rrethana, përdorimi apo kërcënim për të përdorur atë, do të ishte i kundërligjshëm sipas Kartës, shih: *Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons*, (Advisory Opinion), [1996]. C.J. Reports 1996, para. 48.

⁶⁶ Jannifer M. Welsh, *Humanitarian Intervention, and International Relations*, 72.

ashtu edhe doktrinarë për ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare në të drejtën ndërkombëtare.

1.3. Përkufizimi i ndërhyrjes humanitare

Përkufizime të ndryshme janë paraqitur lidhur me ndërhyrjen humanitare. Duke marrë parasysh konceptin klasik, i cili mund të gjurmohet në kohë të lashta të së drejtës ndërkombëtare, që “përfshin çdo përdorim të forcës nga një shtet kundër një shteti tjetër me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe lirisë së qytetarëve të këtij shteti të fundit të cilët nuk dëshirojnë ose nuk kanë mundësi ta bëjnë vetë”.⁶⁷ Një variant i këtij lloji të ndërhyrjes humanitare është çdo veprim të forcës së armatosur nga një shtet me qëllim të mbrojtjes së shtetasve të vet apo të shteteve të treta, të kërcënuar jashtë vendit, megjithatë ky lloj i ndërhyrjes humanitare është diskutuar si një aspekt i vetëmbrojtjes.⁶⁸ Adam Roberts ndërhyrjen humanitare, në kuptimin klasik, e përkufizon si “veprim shtrëngues nga një ose më shumë shtete që përfshijnë përdorimin e forcës së armatosur në një shtet tjetër pa pëlqimin e autoriteteve të saj dhe me qëllim të parandalimit të vuajtjeve ose vdekjes së përhapur të qytetarëve”.⁶⁹ Roberts beson se përkufizimet e dekadave të fundit nuk ndryshojnë rrënjësisht nga përkufizimi klasik.⁷⁰ Ndërsa Juan Cuevas ndërhyrjen humanitare e përkufizon si “përdorim të forcës nga një shtet, një grup shtetesh, një organizatë ndërkombëtare, përveç Kombeve të Bashkuara, në një shtet tjetër, me qëllim që të ndalojë ose parandalojë gjenocidin ose shkelje të tjera të mëdha, sistematike dhe të përhapura të të drejtave themelore të njeriut që ndodhen brenda territorit të atij shteti, që prek qytetarët e tij”. Ai përjashton ndërhyrjen nga një shtet i jashtëm për shtetasit e tyre.⁷¹ Në të kaluarën ndërhyrja humanitare fillimisht i referohej një ndërhyrjeje nga shtetet kryesisht perëndimore për të shpëtuar qytetarët e tyre që gjinden jashtë vendit, por me kalimin e kohës përkufizimi

⁶⁷ Encyclopedia of Public International Law, Use of Force· War And Neutrality Peace Treaties, North-Holland Publishing Company, (1982) 211.

⁶⁸ Ibid 2012.

⁶⁹ Adam Roberts, ‘The So-Called ‘Right’ of Humanitarian Intervention’, Yearbook of International Humanitarian Law (3)2000, (Oxford University Press 2000) 5 [tani e tutje: Adam Roberts, ‘The So-Called ‘Right’ of Humanitarian Intervention’].

⁷⁰ Ibid.

⁷¹ Juan Carlos De Las Cuevas, ‘Exceptional Measures Call for Exceptional Times: The Permissibility Under International Law of Humanitarian Intervention to Protect a People’s Right to Self-Determination’, (2015) (37)2 Houston Journal of International Law, 495.

i konceptit të ndërhyrjes u zgjodh në mënyrë të atillë që të përfshijë mbrojtjen e shtetasve të huaj nga trajtimi çnjerëzor i qeverisë së tyre.⁷² Holzgreffe ndërhyrjen humanitare e përkufizon si “kërcënim ose përdorim i forcës përtej kufijve shtetëror nga një shtet (ose grup shtetesh) që synon parandalimin ose përdorimin e shkeljeve të përhapura dhe të rënda të drejtave themelore të njeriut, të individët të ndryshëm nga qytetarët e tij, pa lejen e shtetit brenda territorit të cilit zbatohet forca”. Me përcaktimin e ndërhyrjes humanitare në këtë mënyrë, Holzgreffe me këtë përkufizim qëllimisht përjashton dy lloje të sjelljeve të cilat zakonisht i asocion ky term. Ato janë: ndërhyrjet jo të detyrueshme, siç është kërcënimi ose përdorimi i sanksioneve ekonomike, diplomatike apo sanksione të tjera; dhe ndërhyrjet me forcë të cilët kanë për qëllim mbrojtjen dhe shpëtimin e shtetasve të vetë shtetit ndërhyrës.⁷³

Një përkufizim bashkëkohor i bërë nga Instituti Danez për Marrëdhënie Ndërkombëtare në një raport të vitit 1999, ndërhyrjen humanitare e përkufizon si:

“Ndërhyrja humanitare përcaktohet si veprim shtrëngues nga shtetet që përfshijnë përdorimin e forcës së armatosur në një shtet tjetër pa pëlqimin e qeverisë së tij, me ose pa autorizim nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, me qëllim të parandalimit ose vendosjes për të ndaluar shkeljet e mëdha dhe masive të drejtave të njeriut apo të drejtës ndërkombëtare humanitare”⁷⁴

Ndërhyrja humanitare, në formën e saj bashkëkohore u shfaq vetëm në vitet e 90-ta, si një koncept në marrëdhëniet ndërkombëtare vetëm pasi veprimi ushtarak në emër të individëve që vuajnë u bë një zakon politik në fillim të viteve të 90-ta, mirëpo rrënjët e saj mund të gjurmohen përsëri në debatet filozofike të së drejtës natyrore në shekullin XVI ku studiuesi spanjoll Suarez vuri në dukje se legjitimiteti i ndërhyrjes nuk duhet të lejohet përveçse në rrethana në të cilat ndodhin masakrat e njerëzve të pafajshëm dhe gabime të

⁷² Jennifer M. Welsh, *Taking Consequences Seriously: Objections to Humanitarian Intervention, Humanitarian Intervention and International Relations*, (Oxford University Press, 2006) 7 [tani e tutje: Jennifer M. Welsh, *Taking Consequences Seriously*].

⁷³ J. L. Holzgreffe, The humanitarian intervention debate, *Humanitarian Intervention, Ethical, Legal and Political Dilemmas*, (1st ed., Cambridge University Press 2003) 18.

⁷⁴ Danish Institute of International Affairs, *Humanitarian Intervention, Legal and Political Aspects* (1999) 11.

ngjashme.⁷⁵ Siç edhe u tha më sipër, disa përkufizime të dekadave të fundit kanë përfshirë disa shtjellime, por nuk e ndryshojnë rrënjësisht përkufizimin klasik. Në mënyrë konfuze, në vitet e 90-ta termi ndonjëherë është përdorur, veçanërisht nga disa agjenci për ndihmë humanitare, me një kuptim shumë më të gjerë dhe më pak të saktë: shumica e veprimeve në një situatë emergjente humanitare, jo domosdoshmërisht duke përfshirë përdorimin e forcës së armatosur dhe jo domosdoshmërisht kundër pëlqimit të qeverisë.⁷⁶ Mjetet jo të detyrueshme nuk janë pjesë e nocionit të ndërhyrjes humanitare, por përkundrazi duhet të përfshihen në konceptin e "ndihmës humanitare". Kështu që, ndërhyrja humanitare ndryshon nga ndihma humanitare (siç është ajo e dhënë nga organizata humanitare si Oxfam, World Vision, dhe Action Aid).⁷⁷

Nga pikëpamja e së drejtës humanitare është kontradiktë në kuptimin e të folurit për 'ndërhyrje' humanitare ose 'ndërhyrje', pasi termi 'humanitar' duhet të rezervohet për të përshkruar veprimet që synojnë të lehtësojnë vuajtjet e viktimave. Sipas argumentimit të Anne Ryinker, ndërhyrja humanitare i referohet ndërhyrjes së armatosur, e cila shpesh kryhet me një axhendë politike. E drejta ndërkombëtare humanitare njeh të drejtën për të ofruar ndihmë humanitare dhe ndihma e paanshme humanitare nuk mund të dënohet si ndërhyrje ose shkelje e sovranitetit kombëtar të një shteti.⁷⁸ Pra, termi 'humanitare' përdoret gjerësisht në mesin e punonjësve të organizatave joqeveritare humanitare. Pra, në këtë kontekst ky term është përdorur për të treguar një shqetësim altruist, shqetësim apolitik për mirëqenien e njeriut.⁷⁹

Kështu, Komisioni Ndërkombëtar për Ndërhyrje dhe Sovranitet Shtetëror (KNNSSH) edhe pse e pranon vazhdimësinë e gjatë të termit 'ndërhyrje humanitare', nuk preferon ta përdorë më këtë term dhe një ndër arsytet se pse ky komisioni preferon të mos e përdorë termin 'humanitare', është bërë në përkrahje të kundërshtimeve shumë të forta nga agjencitë humanitare, organizatat humanitare dhe punëtorët humanitarë drejt çdo

⁷⁵ Jennifer M. Welsh, *Taking Consequences Seriously*, 7-8.

⁷⁶ Adam Roberts, 'The So-Called 'Right' of Humanitarian Intervention', 5.

⁷⁷ James Pattison, *Humanitarian Intervention & The Responsibility to Protect, Who Should Intervine?*, (Oxford University Press, 2010) 26 [tani e tutje: James Pattison, *Humanitarian Intervention & The Responsibility to Protect, Who Should Intervine?*].

⁷⁸ Anne Ryniker, The ICRC's position on "humanitarian intervention", (2001) (83)842, RICR Juin IRRC, 529.

⁷⁹ Aidan Heir, *Humanitarian Intervention And Introduction*, (Pelgrave Macmillan, 2010) 12 [tani e tutje: Aidan Heir, *Humanitarian Intervention And Introduction*].

militarizimi të fjalës “humanitare”.⁸⁰ Kundërshtimi i termit “ndërhyrje humanitare” është megjithatë jo i dobishëm. Siç përmend James Pettison, PpM-ja është edhe me e gjerë edhe më e ngushtë se ndërhyrja humanitare. Rreziku është se kundërshtimi i përgjithshëm i ndërhyrjes humanitare do të transferojë në nocionin e përgjegjësisë për të mbrojtur dhe për këtë arsye mund ta vë në rrezik kontributin e mundshëm të këtij të fundit përtej ndërhyrjes humanitare (p.sh., pranimi i sovranitetit si përgjegjësi).⁸¹ Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan adresoi në një simpozium të organizuar nga Akademia Ndërkombëtare e Paqes (ANP), në vitin 2000, duke shprehur mendimin se është veçanërisht në përkrahje të kësaj dëshire për të ndarë veprimet humanitare nga ndërhyrja ushtarake,⁸² ku, ndër të tjera, thotë: “le të largohemi menjëherë nga përdorimi i termit “humanitar” për të përshkruar operacionet ushtarake”. Ai pohon se ndërhyrja ushtarake mund të ndërmerret për motive humanitare.⁸³ Sipas Annan, “një ndërhyrje e tillë ushtarake nuk duhet, sidoqoftë, të ngatërrohet me veprime humanitare. Përndryshe, ne do ta gjejmë veten duke përdorur fraza si “bombardimi humanitar” dhe njerëzit së shpejti do ta marrin shumë cinikë për tërë idenë.”⁸⁴ Në anën tjetër, Annan deklaroi se “punëtorët humanitarë ndonjëherë mund të mendojnë se ndërhyrja ushtarake kërkohet në një situatë të caktuar. Por ata nuk do ta konsideronin atë si pjesë të punës së tyre”.⁸⁵ Pavarësisht lutjes së Annan’it, termi “ndërhyrje humanitar”, Aidan Hehir argumenton se ky term vazhdon të përdoret gjerësisht. Organizatat tradicionale humanitare miratuan një qëndrim apolitik, duke refuzuar të merreshin me çështje të drejta ose të gabuara, duke e përdorur në vend të kësaj *ndihmë* dhe *nevojë humanitare*.⁸⁶ Sidoqoftë kohët e fundit gjallërimi i neutralitetit është sfiduar nga të ashtuquajturat ‘humanistë të rinj’, të cilët kundërshtojnë qasjen tradicionale. Këta humanistë të riin ndonjëherë kanë qenë ndër përkrahësit më të zëshëm të ndërhyrjes ushtarake. Bernard Kouchner, anëtar themelues i organizatës Mjekët pa kufij (MPK), ka mbrojtur vazhdimisht meritat e ndërhyrjes nga jashtë. Ai ishte veçanërisht një përkrahës i zëshëm i ndërhyrjes së

⁸⁰ *Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty*, (2001) International Development Research Centre, 9-11, shih gjithashtu: Aidan Heir, *Humanitarian Intervention And Introduction*, 2010.

⁸¹ James Pattison, *Humanitarian Intervention & The Responsibility to Protect, Who Should Intervine?*, 25.

⁸² Aidan Heir, *Humanitarian Intervention And Introduction*, 13.

⁸³ Press Release (SG/SM/7632 20 November 2000).

⁸⁴ Ibid.

⁸⁵ Ibid.

⁸⁶ Aidan Heir, *Humanitarian Intervention And Introduction*, 13.

NATO-s në Kosovë më 1999 dhe më vonë mbështeti rrëzimin e Saddam Hyseinit në 2003.⁸⁷ Kështu, ndërsa organizatat humanitare kanë qenë kritike ndaj përdorimit të termit 'humanitare' si një mbiemër për të përshkruar ndërhyrjen ushtarake, shumë prej tyre kanë adoptuar një qasje që domosdoshmërisht dobëson dallimin midis veprimeve humanitar dhe ndërhyrjes humanitare, me grupe të angazhuara në të parën, shpesh duke kërkuar thirrje për të fundit.⁸⁸ Prandaj pavarësisht se janë bërë përpjekje për të ndryshuar termin e diskursit, më së shumti nga KNNSSH-ja, 'ndërhyrja humanitare', ashtu siç argumenton edhe Hehir, mbetet shumë i përdorur, megjithëse mund të keqpërdoret. Mirëpo kjo vështirësi të ndryshohet duke pasur parasysh se sa i ngulitur ky term është bërë në leksionin akademik dhe publik. Qasja pragmatike këtu është se megjithatë në diskursin mbizotërues pranohet që termi të përdoret dhe të provohet të sqarohen tipare dalluese.⁸⁹

1.4. Debati dhe kundërthëniet

Sistemi ndërkombëtar bazohet në premisën se shtetet sovranë kanë të drejtën e mosndërhyrjes, të jenë të lira nga përfshirja e padëshiruar në punët e tyre të brendshme. Megjithatë ndërhyrjet humanitare që nga viti 1991 kanë kundërshtuar imunitetin sovran të shteteve në emër të mbrojtjes së civilëve.⁹⁰ Madje, disa argumentojnë se ndërhyrja humanitare është "problem i djeshëm dhe lufta kundër terrorizmit që nga shtatori i vitit 2001, e bënë atë të vjetër dhe tani qeveritë përqendrohen në interesat e tyre thelbësore kombëtare".⁹¹ Edhe pas kundërshtimeve, ndërhyrja humanitare sipas Taylor Seybolt, ka të ngjarë të jetë e rrallë, por jo edhe të zhduket. Duke pasur parasysh normat e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhunën e vazhdueshme, precedentët e ndërhyrjeve humanitare në të kaluarën dhe aftësinë ushtarake të disponueshme, është e arsyeshme të pritët që liderët politikë nganjëherë të shqetësohen për mirëqenien e civilëve. Mirëpo edhe retorika e rrejshme humanitare duhet të merret gjithashtu seriozisht.⁹² Më tutje ai pohon se

⁸⁷ Ibid 13- 14.

⁸⁸ Ibid.

⁸⁹ Ibid 20.

⁹⁰ Taylor B. Seybolt, *Humanitarian Military Intervention The Conditions for Success and Failure*, (Stockholm International Peace Research Institute, Edited by: Oxford University Press, 2008) 1 [tani e tutje: Taulor B. Seybolt, *Humanitarian Military Intervention*].

⁹¹ Ibid 4.

⁹² Ibid 4-5.

nëse nuk merren parasysh këto shqetësime, atëherë në të ardhmen do të jetë më pak e mundur të ndërhyhet kur vërtet civilët kanë nevojë, nëse pretendimi i motiveve humanitare dyshohet për keqpërdorimet e të kaluarës, si një kërkesë e tillë ose një veprim që nuk është aprovuar nga OKB-ja.⁹³ Debati mbi ndërhyrjen humanitare është zhvilluar gjithashtu edhe midis premisave morale dhe juridike. Debati moral pretendon se shqetësimi kryesor është mirëqenia njerëzore, pavarësisht se çka nënkupton e drejta ndërkombëtare dhe shtetet duhet të ndërhyjnë për të ndihmuar të tjerët, ndërsa pluralistët argumentojnë kundër ndërhyrjes humanitare, pasi ato kanë implikime kryesore në rendin ndërkombëtar.⁹⁴

Sipas Aidan Hehir, fundi i luftës se ftohtë katalizoi një interes të përtërirë të ndërhyrjes humanitare. Heqja e kufizimeve të vendosura nga bipolariteti paraqiti mundësi për angazhim ndërkombëtar si OKB-ja, po ashtu nga vendet perëndimore, ku dhe disa paralajmëruan agimin e një epoke me progresive humanitare. Kur OKB-ja miratoi aksionin në Kuvajt, po ashtu zonën e ndalim fluturimit në Irak, u duk si diçka për disponim pro aktiv, ku Kombet e Bashkuara të liruara nga ngërçi i luftës së ftohtë janë gati të përmbushin vizionin historik të themeluesve të tij.⁹⁵ Një botë ku respektimi i të drejtave të njeriut gjen një vend midis të gjitha kombeve. Ky vizion u ngrit nga fuqitë sunduese të një bote papritmas unipolare, në rritjen e optimizmit. Hehir argumenton ngjarjet pasuese në Ballkan dhe Ruandë, të cilat e zvogëluan këtë optimizëm, por dyfishuan bindjet themelore për lobimin pro ndërhyrjes, shtoi thirrjet për veprim humanitar. Ky tension për të drejtat e njeriut ndërmjet OKB-se dhe shteteve perëndimore ku kërkohet “të bëhet diçka”, e formësoi shumë debatin politik në vitet e 90-ta.⁹⁶ Kështu Mbretëria e Bashkuar mori drejtimin pas ndërhyrjes në Kosovë, duke argumentuar që KS-ja duhet të formulojë kritere ose atë që ai i quajti “udhëzime”, për të vendosur se kur ndërhyrja është e lejuar. Këtë iniciativë e promovoi Sekretari i atëhershëm i jashtëm Britanik, Robin Cook. Së pari, SHBA-ja ishte jashtëzakonisht e gatshme për të vendosur një proces që mund të kufizojë lirinë e tij të veprimit në çështjet e ardhshme. Uashingtoni dëshiron të shmangë çfarëdo presioni që do ta vinte në pozitë për të vepruar për shkak se ka nënshkruar një numër kriteresh. Kundërshtimi i SHBA-së për të arritur marrëveshje është i ndarë nga Kina. Ajo dëshiron ta ruajë lirinë e saj të veprimit. Ndërsa e

⁹³ Ibid 6.

⁹⁴ Karina Z. Butler, *A Critical Humanitarian Intervention Approach*, (Palgrave Macmillan, 2011) 8.

⁹⁵ Aidan Hehir, *Humanitarian Intervention after Kosovo Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society* (1st ed. PALGRAVE MACMILLAN, 2008) 2.

⁹⁶ Ibid.

dyta frikësohet që çdo iniciativë për kriteret do ta bënte më të guximshme doktrinën e ndërhyrjes së njëanshme humanitare. Draft- dokumenti i paraqitur nga Mbretëria e Bashkuar në KS në fund të vitit 1999 përcakton disa parametra për ndërhyrje të ligjshme. Sipas Nicholas Wheeler, ideja e iniciativës së Mbretërisë së Bashkuar, është që ta linte mundësinë që shtetet perëndimore të mund të veprojnë jashtë autorizimeve të KS-së në çështjet e ardhshme.⁹⁷ Pra, në rast se shtetet perëndimore ndërhyjnë përsëri në ndonjë situatë pa mandat të OKB-së, ideja ishte që shtetet mund të apelonin në udhëzimet e rena dakord nga KS-ja, si një bazë legjitime për veprim. Një tjetër propozim ishte që AP-ja të diskutojë çështjen e ndërhyrjes humanitare me synime për të rënë dakord për një dokument kornizë. Sigurisht, çdo marrëveshje për nxitjen e mekanizmit “Të Bashkuar për Paqe” në të ardhmen presupozohet si një marrëveshje brenda Asamblesë së Përgjithshme (AP). Shtetet të cilat janë kundër ndërhyrjes humanitare, ofrojnë të shohin një debat mbi kriteret, ata dëshirojnë të përdorin biseda të gjata dhe shpesh torturuese në AP për të “varrosur” këtë ide.⁹⁸ SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar e ndien mundësinë e shmangies së veto-s në një rast të veçantë, por nuk deshë ta ngrejë çështjen për legjitimitimin e veto-s. Për më tepër ky pozicion mbështetet nga Kina dhe Rusia, të cilët bëjnë përpjekje për ta ruajtur epërsinë e tyre në KS, pasi është organi i vetëm në të cilin vazhdojnë të kenë ndikim më të madh në arenën globale.⁹⁹

Polemikat ishin të theksuara në disa raste të ndërhyrjeve humanitare të cilat vazhdojnë edhe më tutje. Kështu, disa vende veprimin e NATO-s në Kosovë e konsiderojnë si precedent; të tjerët e konsiderojnë si ndërhyrje kundërproduktive, e cila pati një efekt pervers në zhvendosjen e shqiptarëve të Kosovës për një kohë shumë të shkurtër. Shtetet në kuadër të OKB-së e konsiderojnë ndërhyrjen si të kundërligjshme, të tjerët si Gjermania dhe SHBA-ja, edhe pse e mbështesin këtë operacion, argumentojnë se nuk duhet të përdoret si precedent për të ardhmen.¹⁰⁰ Shtetet në përgjithësi janë të ndara edhe për sa i përket interpretimit të traktatit të rëndësishëm dhe praktikës shtetërore, se a e lejon neni 2(4) i Kartës së OKB-së ndërhyrjen humanitare? Shtetet në favor të ndërhyrjes e panë nenin 2(4) të Kartës si të hapur me kalimin e kohës dhe jo si një kuptim fikse. Ata nuk argumentojnë se ndërhyrja humanitare ka ekzistuar para vitit 1945, por mbështesin pjesërisht se të drejtat e njeriut janë zhvilluar në

⁹⁷ Nicholas J Wheeler, ‘Legitimizing Humanitarian Intervention: Principles and Procedures’, (2001) (2) Melbourne Journal of International Law, 15.

⁹⁸ Ibid 16.

⁹⁹ Ibid 16- 17.

¹⁰⁰ Christine Gray, *Christine Gray, International Law and the Use of Force*, 47.

masë nga viti 1945. Ndërsa, shtetet të cilat e kundërshtojnë interpretimin e nenit 2(4) për lejimin universal të ndërhyrjes humanitare, e panë atë si një ndalim i cili nuk mund të ndryshojë.¹⁰¹ Shtetet të cilat janë në favor të ndërhyrjes humanitare, ndërhyrjen e autorizuar në Jugosllavi dhe në Somali, ose e ndërmarrë nga një organizatë rajonale dhe i miratuar nga OKB-ja, si në Sierra Leone, tregojnë ekzistencën e ndërhyrjes humanitare. Ky ishte qëndrim i Sllovenisë në KS dhe i Belgjikës në GJND.¹⁰² Pastaj, theksi i vazhdueshëm në Rezolutat e KS-së nga disa shtete tregon se ato po paraqesin një doktrinë të autorizuar të KS-së; ato nuk po diskutojnë për një të drejtë të njëanshme të ndërhyrjes humanitare. Sipas Christine Gray, kundërshtimi i vazhdueshëm nga Kina, Rusia dhe lëvizja e jo të bashkuarve për ndërhyrje humanitar tregon se doktrina është larg që të pranohet në të drejtën ndërkombëtare. Vendimi i shteteve për të mos mbështetur ndërhyrjen në Afganistan në vitin 2001 dhe në Irak në vitin 2002 është tregues i statusit të saj të diskutueshëm.¹⁰³ Në përgjithësi edhe disa vende aziatike refuzojnë ndërhyrjen perëndimore të cilin ata e konsiderojnë si një imponim i vlerave perëndimore në ato aziatike.¹⁰⁴ Posaçërisht vendet e Asociacionit jug-lindor të vendeve aziatike, e sidomos shtetet e vogla dhe të mesme janë të shqetësuara dhe të ndara sa i përket ndërhyrjes humanitare. Ato në raste të ndërhyrjes më shumë e shohin si më shumë si çështje e fuqive politike, sesa për arsye morale.¹⁰⁵ Pavarësisht kësaj, përpjekjet në drejtim të angazhimit më fleksibil dhe pranimi të ndërveprimit të zgjeruar po vazhdojnë. Për shembull, roli i luajtur nga Filipinet dhe Tajlanda në përpjekjet paqeruajtëse në Timorin Lindor sugjerojnë që disa vende aziatike janë më pozitive në lidhje me ndërhyrjen humanitare sesa të tjerët.¹⁰⁶

Roli të rëndësishëm në debatin për ndërhyrjen humanitare ka luajtur edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan, i cili intensifikoi debatin mbi ndërhyrjet humanitare pas operacioneve ushtarake në vitin 1999 dhe ndërhyrjes pa autorizim të KS-së të OKB-së. Sfidat e tij për qeveritë për të rënë dakord mbi udhëzimet për përdorim të forcës quan në publikimin e raportit të Komisionit KNNSSH në vitin 2001, që quan në propozimin e përgjegjësisë për të mbrojtur.¹⁰⁷ Kundërshtimi i termit 'ndërhyrje humanitare' pas raportit të Komisionit KKNSSH,

¹⁰¹ Ibid 48.

¹⁰² Ibid 49.

¹⁰³ Ibid 50.

¹⁰⁴ Watanabe Koji, 'The Debate on Humanitarian Intervention, Humanitarian Intervention: The Evolving Asian Debate' (2003) (ed. Watanabe Koji), Tokyo: Japan Center for International Exchange, 12.

¹⁰⁵ Ibid 16.

¹⁰⁶ Ibid.

¹⁰⁷ Taulor B. Seybolt, *Humanitarian Military Intervention*, 1.

sispas të cilit në vend të përdorimit të termit 'ndërhyrje humanitare', për disa arsye për të cilat do të flasim më gjerësisht në kapitullin IV, përdorin termin 'përgjegjësia për të mbrojtur'¹⁰⁸, si një parim që është duke u zhvilluar në OKB dhe ka hyrë gjerësisht në diskursin akademik.

1.5. Lufta e drejtë dhe e padrejtë

Përpyjekjet e para për të bërë dallimin ndërmjet luftërave të drejta dhe të padrejta janë paraqitur qysh në periudhën antike. Shprehjen "luftë e drejtë" e ka përdorur Aristoteli me qëllim që të sigurote paqe midis qytet-shteteve greke, për t'i rindërtuar ato nga shkatërrimet e luftës. Por me kaq mbyllej rrethi, sepse ndaj popujve të tjerë vlenin rregulla të tjera.¹⁰⁹ Tradita e luftës së drejtë u zhvillua nga filozofët e krishterë, në mënyrë paralele nga filozofët Islamë me supozimin e subjekteve politike që mund të merreshin me forcë ushtarake do ta shihnin veten, deri në njëfarë mase, si të kufizuar nga konsideratat morale kur ky përdorim i forcës ishte i duhur.¹¹⁰ Nga paraqitja e krishterimit e deri në ditët e sotme është bërë dallimi midis luftërave të drejta (të lejuara) dhe luftërave të padrejta (të ndaluara). Teorinë mbi luftërat e drejta e kanë zhvilluar teologët e kishës katolike, si: Shën-Augustini, Tomas Akuini, Vitoria, Suares etj. Shën Augustini (354-430) konsideronte se lufta është e lejueshme, nëse është e drejtë. Të këtilla janë luftërat për mbrojtjen e shtetit nga armiqët e jashtëm ose për dënimin e padrejtë, kur një popull apo një qytet kundër të cilit janë drejtuar aktet armiqësore, nuk i ka dënuar padrejtësitë që kanë bërë qytetarët e tij, ose nuk i kanë kthyer ato që janë marrë pa të drejtë.¹¹¹ Thelbësore për teorinë e luftës së drejtë dhe kthimi te Agustini është një theks në legjitimitetin e një lufte të ndërmarrë nga udhëheqësi i një shoqërie, nëse dhe vetëm nëse shërben për një kauzë të drejtë. Për Augustinin, lufta mund të ndërmerrej vetëm për të arritur paqen dhe thjesht në veçanti parandalimin e dëmtimit të pafajshmëve.¹¹² Autori

¹⁰⁸ ICISS 'The Responsibility to Protect', 16. [tani e tutje do të përdorim termin "Përgjegjësia për të mbrojtur", me shkurtesën në gjuhën Shqipe "PpM", ndërsa vesirioni origjinal në gjuhën Angleze përdoret shkurtesa "RtoP" ose "R2P"].

¹⁰⁹ Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, (botimi i plotësuar dhe i ndryshuar, Furkan ISM-Shkup, Prishtinë, 2009) 532 [tani e tutje: Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*].

¹¹⁰ David M. Mednicoff, 'Humane wars? International law, Just War theory and contemporary armed humanitarian intervention' (2006) (2) *Law, Culture and the Humanities*; 373, 378 [tani e tutje: David M. Mednicoff, 'Humane wars? International law'].

¹¹¹ Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, 532.

¹¹² David M. Mednicoff, 'Humane wars? International law', 379.

i njohur i së drejtës, Vitoria e lejon luftën, nëse ajo ishte luftë mbrojtëse; luftë për t'u hakmarrë për cenimin e së drejtës; luftë për kthimin e asaj që është marrë pa të drejtë (dëmshtëpërblimi) dhe lufta që e urdhëron perëndia (luftërat kundër të paaftëve dhe heretikëve janë të dashura për Perëndinë).¹¹³ Vitoria pohon se shkak i vetëm për të filluar luftën është kur dëmi është shkaktuar.¹¹⁴ Ndërsa edhe doktrina islame e bënte dallimin midis luftës së drejtë dhe luftës së padrejtë. Sipas saj, lufta vetvetiu s'është e keqe as e pamoralshme, por e cila gjithçka varet nga qëllimi i saj. Nëse lufta bëhet për pushtimin e tokave të huaja ose me qëllim plaçkitjeje ajo është për t'u dënuar, por nëse ajo zhvillohet për t'u mbrojtur, për liri të qytetarëve, ose në interes të përgjithshëm të njerëzimit, ajo është e arsyeshme dhe e moralshme.¹¹⁵

Edhe pse formulimi i doktrinës së luftës së drejtë nga Agustini dhe Aquini që theksonin rëndësinë e kauzës për ndihmë ndaj të pafajshmëve, të menduarit e luftës së drejtë pas mesjetës prirën të heshtin gjykimet e studiuesve në favor të autoritetit sovran.¹¹⁶ Shkrimtarët si Grotius dhe Pufendorf përfshinë teorinë e luftës së drejtë në të drejtën ndërkombëtare, por ngritja e shtetit modern dhe pranimi juridik (dhe filozofik) i sovranitetit shtetëror shtyu teorinë në sfond.¹¹⁷ Sipas Lauterpacht, në shtjellimin e luftës së drejtë Grotius nuk bëri asnjë përparim të dukshëm në trajtim tashmë të hollësishëm të temës nga paraardhësit e tij. Merita dhe kontributi i tij qëndron në theksin që i vë temës. Se një luftë të jetë e drejtë, duhet të ekzistojë një shkak juridik për një arsye, siç thekson ai, lufta fillon kur përfundon zgjidhja gjyqësore. Nga kjo rrjedh se një luftë e ndërmarrë për të zbatuar një kërkesë e cila "nuk është detyrim nga këndvështrimi i drejtësisë së rreptë" nuk është një luftë e drejtë.¹¹⁸ Grotius, përjashton luftërat e ndërmarra me qëllim të dobësimit të vendit fqinj.¹¹⁹

Kjo ide e mendimit të hershëm i luftës së drejtë dhe që buron nga ideja fetare e bamirësisë, se konflikti i armatosur duhet të fillohet për t'i ndihmuar njerëzit në nevojë, bie ndesh me theksin e të drejtës bashkëkohore ndërkombëtare për vetëmbrojtjen si shkak i

¹¹³ Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, 532.

¹¹⁴ Michael Walzer, *Arguing About War*, (Yale University Press, 2004) 4 [tani e tutje: Michael Walzer, *Arguing About War*].

¹¹⁵ Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, 532.

¹¹⁶ David M. Mednicoff, 'Humane wars? International law', 379.

¹¹⁷ Michael Walzer, *Arguing About War*, 5.

¹¹⁸ Professor H. Lauterpacht, *The Grotian Tradition in International Law*, (The British Year Book of International Law, Oxford University Press, 1946) 37.

¹¹⁹ Ibid 37- 38.

arsyeshëm i luftës.¹²⁰ Me theksin për paprekshmërinë e integritetit të shtetit sovran, sipas David Mendnicoff, e drejta ndërkombëtare nuk është e predispozuar të bëjë dallime të qarta, se kur vendet ose shtetet mund të justifikojnë ndërhyrjen humanitare të vendit tjetër.¹²¹ Për ta kuptuar më mirë teorinë e luftërave të drejta në të drejtën ndërkombëtare, ditët e sotme, do të shohim më poshtë perspektivën e njërit prej studiuesve më të njohur modern Michael Walzer dhe konceptin e tij për këtë teori.

1.5.1. Teoria e luftës së drejtë e Michael Walzer

Në epokën e pas luftës së ftohtë, ne kemi parë një ndikim në rritje të mënyrës së menduarit të Michael Walzer për marrëdhëniet ndërkombëtare, si një formë e idealizmit realist ose, sipas fjalëve të tij ‘moral politik’.¹²² Që prej shek. XVIII, çështja se cila kornizë disiplinore ofron mjete më të frytshme për të menduar për luftën dhe paqen kanë qenë objekt reflektimi kritik. Për shembull, Imanuel Kant hodhi poshtë mundësinë që juristët si Grotius, Pufendorf dhe Vattel të mund të ofrojnë ndonjë pasqyrë të çështjes së trazuar se si mund të arrihet paqja në botë. Për Kant juristët e tillë ishin thjesht “keq ngushëllues”. Ashtu si Kanti, Walzer kërkon të zhvillojë parime të përgjithshme që mund të udhëzojnë aktorët morale që kërkojnë të sjellin paqe të përhershme, sikurse Kant dhe ai hedh poshtë kontributin që studiuesit e së drejtës ndërkombëtare mund ta japin për një projekt të tillë.¹²³ Ai parashtrohet pyetje për të cilat i ka trajtuar lidhur me ndërhyrjet, se a mund të jetë detyrë e dikujt për të ndërhyrë? Walzer adreson këtë pyetje në botimin e tretë dhe katërt të librit “Luftërat e Drejta dhe të Padrejta”. Dhe ai i konsideron pyetjet e mëtejshme: nëse është detyrë të ndërhyhet dhe detyrë e kujt është kjo? A është e kufizuar në shpëtimin e viktimave për gjenocid, spastrim etnik dhe gabimeve të ngjashme?¹²⁴ Walzer, konsideron se meqë e drejta ndërkombëtare pozitive është rrënjësisht e paplotë, është gjithmonë e mundur që interpretimi i tij nën dritën

¹²⁰ David M. Mednicoff, ‘Humane wars? International law’, 379.

¹²¹ Ibid 378.

¹²² Anne Orford, ‘Moral Internationalism and the Responsibility to Protect’, (2013) (24)1, The European Journal of International Law, (Published by Oxford University Press 2013) 83, doi: 10.1093/ejil/chs092 [tani e tutje: Anne Orford, ‘Moral Internationalism and the Responsibility to Protect’].

¹²³ Ibid, 84.

¹²⁴ Terry Nardin, ‘From Right to Intervene to Duty to Protect: Michael Walzer on Humanitarian Intervention’, (2013) (24)1 The European Journal of International Law, (Published by Oxford University Press 2013) 67, 68 doi: 10.1093/ejil/chs085 [tani e tutje: Terry Nardin, ‘From Right to Intervene to Duty to Protect: Michael Walzer on Humanitarian Intervention’].

e parimeve morale dhe referimin e rezultateve si “e drejtë pozitive”. Ndoshta kjo është ajo që duhet të bëhet për të përmirësuar sistemin ligjor dhe për të bërë atë më tërheqës sesa është aktualisht.¹²⁵ Siç thekson ai në parathënien e tij të botimit më të fundit, kur një qeveri është e angazhuar për vrasjen e shumë qytetarëve të saj e bëjnë atë një kandidat legjitim për transformim të dhunshëm. Dhe fuqia ndërhyrëse kërkon domosdoshmërisht njëfarë përgjegjësie për krijimin e një qeverie alternative.¹²⁶

Nuk është për t’u habitur, pra, që diskutimi i Walzer- it se ndërhyrja humanitare gjurmon ngjarjet politike dhe debatet, nga pushtimi i Indisë në vitin 1971 në Pakistanin Lindor - rast ku ai mbështet luftën e drejtë dhe të padrejtë, deri te bombardimi i NATO në vitin 1999 në luftën e Kosovës, pushtimin në Irak dhe në vitin 2011 ndërhyrja në Libi.¹²⁷ Ai vazhdon më tutje se raste të qarta të “ndërhyrjes humanitare” janë shumë të rralla. Dhe për këtë Walzer pohon se nuk ka gjetur asnjë rast të vetëm, por vetëm raste të përziera ku intervenimi humanitar është njëri nga to. Kështu që do të duhet të marrim parasysh rëndësinë morale të motiveve të përziera.¹²⁸ Walzeri më tutje thotë se kundër skllavërimit ose masakrimit të kundërshtarëve politikë, pakicat kombëtare dhe sekteve fetare nuk mund të ketë ndihmë, përveç kur ndihma vjen nga jashtë. Dhe kur një qeveri kthehet në mënyrë të kundërligjshme kundër njerëzve të vet, ne duhet të dyshojmë në vetë ekzistencën e komunitetit politik me të cilin mund të zbatohet ideja e vetëvendosjes.¹²⁹ Sipas tij, pushtimi Indian i Pakistanit Lindor (Bangladesh) në vitin 1971 është shembulli më i mirë i ndërhyrjes humanitare. Indianët ishin kaq të shpejtë, duke mposhtur ushtrinë pakistaneze, por jo duke zëvendësuar atë dhe duke mos vendosur kontroll politik mbi Bangladeshin, por ndërhyrja cilësohet si humanitare, sepse ishte një shpëtim i përcaktuar në mënyrë rigorozë dhe të ngushtë.¹³⁰ Ndërhyrja Indiane ishte, pra, të mposhten forcat pakistaneze dhe t’i dëbonte ata nga Bengali. Qëllimi ishte i ndryshëm nga ai i ndërhyrjes dhe për arsye morale. Sipas Walzer, “njerëzit që iniciojnë masakra humbasin të drejtën e tyre për të marrë pjesë në proceset normale (edhe në ato normalisht të dhunshme) të vetëvendosjes së brendshme. Humbja e tyre ushtarake është e nevojshme moralisht.

¹²⁵ Michael Walzer, *Just And Unjust Wars, A Moral Argu'ment with Historical Illustrations*, (Fourth Edition, Basic Books New York 2006) xxii [tani e tutje: Michael Walzer, *Just And Unjust Wars*].

¹²⁶ Terry Nardin, ‘From Right to Intervene to Duty to Protect: Michael Walzer on Humanitarian Intervention’, 78.

¹²⁷ Ibid 68.

¹²⁸ Michael Walzer, *Just And Unjust Wars*, 101- 102.

¹²⁹ Ibid 101.

¹³⁰ Ibid 105.

Qeveritë dhe ushtritë e përfshira në masakra janë identifikuar lehtësisht si qeveri dhe ushtri kriminale (ata janë fajtorë sipas kodit të Nurembergut për "krime kundër njerëzimit")¹³¹ Morali të paktën nuk është pengesë për veprime të njëanshme, për aq kohë sa nuk ka alternative të menjëhershme në dispozicion. Në rastin Bengali nuk kishte asnjë. Pa dyshim, masakrat ishin një çështje me interes universal, por vetëm India u interesua për to.¹³² Kështu, ai nuk beson se veprimi i ndërmarrë nga OKB-ja apo ndonjë koalicion i fuqive të mëdha do të kishte cilësi morale më të mira se ajo e sulmit Indian. Për Walzer, ndërhyrja humanitare është e justifikuar kur është një nismë (me pritje të arsyeshme të suksesit) për të vepruar, në raste "që shokojnë ndërgjegjen morale të njerëzimit."¹³³

Ndërsa, në anën tjetër, Walzer kundërshton ndërhyrjen e SHBA-së në Vietnam në vitet 1960 dhe 1970. Sipas tij, SHBA-ja ndërhyri ushtarakisht në Vietnam jo për të përmbushur angazhimin e tij në një shtet tjetër, por për të ndjekur politikën e vetëdijes së vet.¹³⁴ Ai mendoi se lufta ishte e padrejtë që në fillim, por se ky nuk ishte pozicioni i dukshëm; kishte argumente në favor të luftës (ishte, në fund të fundit, një luftë kundër tiranisë komuniste). Padrejtësia e saj u konfirmua kur u bë e qartë se nuk po luftonin vetëm kundër kryengritësve Viet Kong; ai thotë se ne ishim në luftë me shoqërinë rurale të Vietnamit. Walzer pretendon se mënyra se si luftuan amerikanët dhe vdekjet për të cilët ishin përgjegjës, demonstrojnë përfundimisht se duhet të ndalnin luftën.¹³⁵

Sipas Rajan Menon, Walzer e merr sovranitetin seriozisht, por jo për arsyet e bazuara në siguri, të nxitura nga realistët të cilët ai i kundërshton si indiferent ndaj moralit. Mendimi i Walzer është se sovraniteti meriton respekt jo vetëm sepse është një shtyllë për stabilitetin ndërkombëtar, por edhe meqë mbron bashkësinë ndërkombëtare nga ndërhyrjet e jashtme.¹³⁶ Kështu, ndalimi i agresionit dhe mosndërhyrja janë, sipas Walzer, parimet kryesore në paradigmen legaliste. Paradigma legaliste përjashton çdo përpjekje për të ndaluar masakrimin e një shteti tjetër, duke treguar kështu që ligji nuk mund të llogaritet për realitetit

¹³¹ Ibid 106.

¹³² Ibid 107.

¹³³ Ibid.

¹³⁴ Ibid 99.

¹³⁵ Michael Walzer, 'Coda: Can the Good Guys Win?', (2013) (24)1, , The European Journal of International Law (Published by Oxford University Press 2013) 433, 440, doi: 10.1093/ejil/chs096 © The Author, 2013.

¹³⁶ Rajan Menon, *The Concept of Humanitarian Intervention*, (Oxford University Press 2016) 49 [tani e tutje: Rajan Menon, *The Concept of Humanitarian Intervention*].

morale të ndërhyrjes së ushtrisë.¹³⁷ Për Wazer, shteti ekziston për të mbrojtur jetën e individit dhe jetën e përbashkët brenda territorit. Nëse shteti dështon të përmbush këtë funksion, ajo nuk do të kualifikohet më për parimin e mosndërhyrje- mbrojtja e një shteti të tillë nuk do të ketë asnjë justifikim moral. Ky do të jetë rasti kur një grup lufton brenda vendit për çlirim kombëtar, në situata të luftës civile ku një pale po mbështetet nga një fuqi e huaj ose në rast të shkeljeve të drejtave të njeriut. Argumenti që bën për ndërhyrje të tilla hapin rrugë për lufta të drejta, të cilat po luftonin në vetëmbrojtje kundër agresionit. Por arsyetimi për të ndërhyrë në emër të mbrojtjes për vetëvendosje ose të drejta të njeriut duhet të gjykohet me shumë kujdes.¹³⁸

Walzer beson se njerëzit me të drejtë mund të revoltohen kundër qeverisë së tyre mizore dhe shtypëse, por ai thekson 'se kjo liri nuk mund të transferohet në shtetin e huaj dhe të bëhet një e drejtë e pushtimit ose ndërhyrjes.¹³⁹ Sipas Rajan Menon, kjo mund të sugjerojë se Walzer dënon ndërhyrjet në punët e një qeverie të jashtme mizore, por ajo nuk ndalon ndërhyrjet nga jashtë që kanë për qëllim shpëtimin e qytetarëve, të cilët i nënshtrohen dhunës. Ai nuk ka simpati për mosveprimin përballë mizorive.¹⁴⁰ Walzer përcakton ndërhyrjen humanitare si përgjigje ndaj shkeljeve të drejtave të njeriut ku e dallon atë nga llojet e tjera të ndërhyrjes: ndërhyrja për të mbrojtur shtetasit e vet, ndërhyrja në një luftë civile dhe ndërhyrja për të ndihmuar një bashkësi kombëtare për të fituar pavarësinë e vet.¹⁴¹ Ai mbron ndërhyrjen në baza humanitare si të justifikuar vetëm si përgjigje të krimeve tronditëse kur nuk ka ndonjë mjet tjetër, si mënyrë për t'i çliruar njerëzit nga shtypja. Pra, sipas tij, ekziston një përjashtim, ndërhyrja humanitare, kur një qeveri kryen krime të mëdha kundër njerëzve, nuk mund të thuhet se i përfaqëson ata.¹⁴²

Prandaj Wazler përkrah dhe ndërhyrjen humanitare në Kosovë. Sipas tij, fushata serbe duhet të ketë qenë e planifikuar para fillimit të bombardimeve. Në Kosovë realitete të ashpra të spastrimit etnik, "duke pasur parasysh rekordin serb në Bosnje dhe mobilizimin e ushtarëve në kufijtë e Kosovës dhe refugjatët pothuajse në lëvizje, ndërhyrja ushtarake duket plotësisht

¹³⁷ Anne Orford, 'Moral Internationalism and the Responsibility to Protect', 89.

¹³⁸ Ibid 90.

¹³⁹ Rajan Menon, *The Concept of Humanitarian Intervention*, 50.

¹⁴⁰ Ibid.

¹⁴¹ Terry Nardin, 'From Right to Intervene to Duty to Protect: Michael Walzer on Humanitarian Intervention', 68.

¹⁴² Ibid 69.

e justifikuar, madje e detyrueshme”.¹⁴³ Disa nga aktet ushtarake të njëanshme, disa (ndërhyrja Nigeriane dhe tani në Kosovë) ishin të autorizuara si aleanca rajonale. Walzer pohon se shumë njerëz të majtë dëshirojnë një botë ku OKB-ja dhe vetëm OKB-ja do të vepronte në raste të tilla. Por duke pasur parasysh strukturën oligarkike të KS-së, nuk është e mundur të mbështetesh në këtë lloj veprimi; në pjesën më të madhe në listën e Walzer, ndërhyrja e OKB-së do të kishin bërë veto një nga oligarkët. Ai, madje, as nuk është i bindur se bota do të ishte përmirësuar duke pasur për shpëtim vetëm një agjent ndërkombëtar.¹⁴⁴ Lidhur me ndërhyrjen humanitare dhe luftërat e drejta janë paraqitur edhe kundërshti me të cilat është marr Walzer.¹⁴⁵ Një ndër kundërshtimet më të zakonshme është se ndërhyrjet janë selektive. Si mund një shtet të kërkojë ndërhyrje në një rast dhe të kundërshtojë në një tjetër? Mund të kërkohet një arsyetim për çdo ndërhyrje, por si këndvështrim, pyetja retorike është e pakuptimtë, sepse vendimi për të ndërhyrë në një rast të veçantë varet nga konsideratat prudeciale dhe morale. Dhe kjo është pamja e Walzer. Ai kishte sugjeruar arsye të detyrueshme morale për të ndërhyrë në Tibet, Çeçeni dhe Timor Lindor, por rreziqet do të kishin qenë marramendëse dhe shkaqet për sukses të vogla.¹⁴⁶

Nardin thotë se një kundërshtim më i besueshëm është se ndërhyrja humanitare cenon të drejtat e shtetit ndërhyrës. Kur një shtet i drejtohet forcës ushtarake, ajo i ekspozon ushtarët e saj në lëndime dhe vdekje. Ai është marrë vetëm me çështjen që pyetja, nëse vullnetarët duhet të marrin rreziqet e luftimit si forcë ndërhyrëse e paqeruajtëse duhet të kryhet nga vullnetarët, sepse megjithatë shteti mund të ketë për detyrë të ndërhyjë, individët nuk mund të jenë të detyruar të rrezikojnë jetën e tyre. Mirëpo Terry Nardin nuk është i bindur nga ky argument, shtetet nuk duhet t’u shërbejnë vetëm interesave të tyre, por edhe atyre të huaj. Nëse një vend ndërhyr për t’i mbrojtur të pafajshmit, atëherë shteti mund t’i përballojë në mënyrë të arsyeshme edhe kostot.¹⁴⁷ Gjenocidi në Ruandë, për të siguruar një shtet nuk ndërhyri për të penguar, forcoi këtë tension ndërmjet moralit dhe politikës në mënyrë dramatike. Këtu bota u ul dhe shikoi. Problemi që Nardin thotë se bashkohet me Walzer për të dhënë një vëzhgim, është vetëm kur është e mundur të ndërhyjë, nuk është e mirë kush

¹⁴³ Michael Walzer, *Arguing About War*, 102

¹⁴⁴ Ibid 103.

¹⁴⁵ Terry Nardin, ‘From Right to Intervene to Duty to Protect: ‘Michael Walzer on Humanitarian Intervention’, 71

¹⁴⁶ Ibid.

¹⁴⁷ Ibid 72.

është ai. Walzer sugjeron se ndoshta, detyra bie me më shumë në vende që mund të ndërhyjë shpejt dhe në mënyrë efektive.¹⁴⁸

Çështja Libiane është e rëndësishme këtu. Mendimi i Walzer ishte kundër ndërhyrjes në Libi ose të paktën kjo ishte në kohën kur filloi ndërhyrja. Ai kundërshtoi ndërhyrjen nga errësira e skajeve të tij deri te mungesa e mbështetjes nga vende të tjera Arabe, veçanërisht Egjipti, i cili ndan një kufi me Libinë dhe ka aftësi ushtarake për të ndërhyrë në mënyrë efektive. Por arsyeja kryesore është se aksioni ushtarak kundër forcave të Gadafit nuk është, sipas mendimit të Walzer, një ndërhyrje humanitare për të kundërshtuar një masakër. Rrëzimi i tiranëve dhe vendosja e demokracisë duhet të jetë punë lokale dhe në këtë rast, për fat të keq, vendasit nuk mund ta bënin atë.¹⁴⁹ Nardin argumenton se Walzer ka kontribuar në mirëkuptimin tone të ndërhyrjes humanitare, duke siguruar një llogari koherente të saj si një praktikë historike, duke treguar vendin e saj në strukturën e teorisë së luftës së drejtë, duke ndriçuar çështjet morale dhe politike që shtron. Ai nuk bën asnjë justifikim për të shmangur ngatërresat filozofike dhe duke u përqendruar në çështje thelbësore morale dhe politike.¹⁵⁰ Në librin e tij 'Arguing about war' Walzer vazhdoi me argumente për luftën e drejtë edhe tridhjetë vjet pas librit të tij të famshëm 'Luftërat e Drejta dhe të Padrejta'.¹⁵¹ Walzer këtu trajton dy kritika të teorisë së luftës së drejtë. E para është, sipas vetë atij dhe të tjerë që mbrojnë dhe aplikojnë teorinë janë duke e moralizuar luftën dhe duket se atë janë duke e bërë më të lehtë atë. Ai pohon se kur përcaktojmë kritere, të cilët lufta dhe sjellja në luftë mund të gjykohej, ne hapim rrugë për gjykime të favorshme. Shumë nga këto gjykime do të jenë ideologjike, partizane ose hipokrite në karakter dhe për rrjedhojë, subjekt ndaj kritikës, por disa prej tyre, duke pasur parasysh, do të kenë të drejtë: disa luftëra dhe disa akte lufte rezultojnë të jenë "të drejta" a mundet kjo të jetë kështu, kur lufta është kaq e tmerrshme? Por thjesht argumenton se është term arti këtu, do të thotë e justifikueshme, e mbrojtur, madje edhe e domosdoshme moralisht (duke pasur parasysh alternativat) dhe kjo është gjithçka që do të thotë.¹⁵² Sipas Walzer, ekzistojnë akte agresive dhe akte mizorie, të cilat

¹⁴⁸ Ibid 74- 75.

¹⁴⁹ Ibid 76.

¹⁵⁰ Ibid 82.

¹⁵¹ Michael Walzer, *Arguing About War*, IX.

¹⁵² Ibid XI

duhet të rezistojmë me force, nëse është e nevojshme. Ai sugjeronte se përdorimi i forcës ushtarake për të ndaluar vrasjet në Ruandë do të ishte, sipas tij, një luftë e drejtë.

Kritika e dytë e teorisë së luftës së drejtë është se ajo i inkadron luftërat në mënyrë të gabuar. Ajo përqendron vëmendjen tone në çështjet e menjëhershme në fjalë para se të fillojë lufta - në rastin e luftës së fundit në Irak, në inspektime, çarmatosje, armë të fshehura etj. Dhe më pas zhvillimin e luftës, betejë pas beteje dhe kështu shmang pyetjen më të madhe në lidhje me ambiciet perandorake dhe luftën globale për burim dhe fuqi. Sipas tij, luftërat agresive, luftërat për pushtim, luftërat për t'u zgatur sferat e ndikimit dhe krijimin e shteteve satelitetë, luftërat ekonomike janë luftëra të padrejta.¹⁵³ Walzer pohon se lufta e drejtë është një teori e bërë për kritikë. Por kjo nuk d.m.th. që çdo luftë duhet të kritikohet. Ai thotë se kur mbrojtja luftën e fundit në Afganistan, disa nga kritikët pohuan se që nga unë kishin kritikuar luftën Amerikane në Vietnam dhe shumë nga luftërat në Amerikën Qendrore, se unë tashmë nuk jam konsistent. Po ai mbron vetën duke demonstruar me një shembull, ku sipas tij kjo është sikur të thuash që një mjek që diagnostifikon një pacient me kancer është i detyruar të sigurojë një diagnozë të ngjashme për të gjithë pacientët tjerë.¹⁵⁴

Walzer mbron gjykimet e tij për luftërat e drejta dhe të padrejta, atij i pëlqen të mendojë se ka qenë mjaft i qëndrueshëm. Por pranon se ka ndryshuar theksin e argumenteve për disa gjëra që i duket e drejtë për ta pranuar këtu. Më tutje argumenton se përballë numrit të madh të tmerreve kohët e fundit - me masakra dhe spastrim etnik në Bosnje dhe Kosovë; në Ruandë, Sudan, Sierra Leone; Kongo dhe Liberi; në Timorin Lindor (dhe më herët në Kamboxhia dhe Bangladesh) - pranon se është bërë ngadalë i gatshëm të bëjë thirrje për ndërhyrje ushtarake. Më tutje, pohon se nuk e ka hedhur supozimin kundër ndërhyrjes që e ka mbrojtur në librin e vet, por se e ka parë më të lehtë për të tejkaluar supozimin. Gjithashtu kërkon të njohë nevojën për një zgjerim të luftës së drejtë. Ku *jus ad bellum* dhe *jus in bello* janë elementet e saj standarde, të përpunuara për herë të parë nga filozofët. Tani sipas Walzerit, duhet t'i shtojmë atyre dhe *jus post bellum* (drejtësia pas luftës).¹⁵⁵ Anne Orford argumenton se Walzer dëshiron të krijojë një kod të përbashkët moral, për të gjykuar drejtësinë e luftës përmes një angazhimi të duhur në botën reale. Sipas Orford, ai dëshiron të zëvendësojë të drejtën

¹⁵³ Ibid.

¹⁵⁴ Ibid XII

¹⁵⁵ Ibid Xii- Xiii.

ndërkombëtare në favor të një rendi moral të bazuar në argumentet e bëra nga qytetarët e zakonshëm për arsye demokratike.¹⁵⁶ Orford shton se periudha në të cilën Walzer po e shkruante librin *Luftërat e drejta dhe të padrejta*, u formua nga debatet e ndezura në të drejtën ndërkombëtare, kuptimi dhe kufijtë e angazhimit për mospërdorimin e forcës dhe më gjerësisht për mos ndërhyrje.¹⁵⁷ Ndërhyrja humanitare atë kohë përcaktohej si anakroniste e cila ishte e lidhur ngushtë me imperializmin. Gjatë luftës së ftohtë, vetë shtetet nuk deshën të justifikonin mjetin e forcës së tyre si 'ndërhyrje humanitare'. Kështu, deri sa ndërhyrja e Indisë në Pakistanin Lindor, ndërhyrja e Vietnamit në Kamboxhia dhe ndërhyrja e Tanzanisë në Ugandë, që të gjitha janë arsyetuar nga komentuesit si shembuj të luftës së ftohtë të ndërhyrjes humanitare, asnjë prej shteteve nuk justifikoi veprimin e tyre si ndërhyrje humanitare në atë kohë. Kjo nuk është se qeveria Indiane, Vietnameze dhe Tajlandeze kishin mungesë të një sensi të drejtësisë ose një llogari të moralit që ishte adekuate për veprimet e tyre, por sepse ata e konsideronin ndalimin e ndërhyrjes së njëanshme në Kartën e OKB-së si një deklaratë morale.¹⁵⁸

Oxford sugjeron se duke hedhur poshtë debatet juridike, Walzer nuk kishte pse të merrej me këto mosmarrëveshje të thella interpretuese që ekzistonin në atë kohë mbi qëllimin e rendit juridik ndërkombëtar ose kuptimin që duhej bërë për përdorim të veçantë të forcës. Walzer mund të paraqiste disa parime morale si të vlefshme në mënyrë universale dhe të injorojë çdo mosmarrëveshje interpretuese mbi kuptimin e atyre parimeve dhe të zbatueshmërisë së tyre në situata konkrete.¹⁵⁹ Pavarësisht kritikave, Michale Walzer mund të themi se kishte rikthyer diskutimin për luftërat e drejta dhe të padrejta, edhe pse një ide e lindur shekuj më herët dhe zhvillimin e normave pozitive në të drejtën ndërkombëtare, të cilat e kanë zhvendosur debatin e ndërhyrjes humanitare në përdorimin e argumenteve ligjore për një të drejtë të tillë, Walzer edhe ndërhyrjet humanitare aktuale i argumenton në dritën e teorisë së luftës së drejtë duke shmangur debatin ligjor të saj.

¹⁵⁶ Anne Orford, 'Moral Internationalism and the Responsibility to Protect', 85- 86.

¹⁵⁷ Ibid 91.

¹⁵⁸ Ibid 93- 94.

¹⁵⁹ Ibid 96.

KAPITULLI II

2. LIGJSHMËRIA DHE LEGJITIMITETI I NDËRHYRJES HUMANITARE

2.1. Ligjshmëria e ndërhyrjes humanitare para Kartës së OKB-së

Doktrina e ndërhyrjes së njëanshme humanitare është soditur, diskutuar dhe debatuar për më shumë se 600 vite me radhë.¹⁶⁰ Ajo ishte një doktrinë e bazuar në të drejtën natyrore të krijuar shekuj më parë. Referencat historike për këtë doktrinë janë jashtëzakonisht të rëndësishme pasi shoqëria nuk duhet thjesht të deklarojë se çfarë duhet të bëhet tani, por duhet të marrë parasysh evolucionin e ndërhyrjeve të humanizmit.¹⁶¹ Qysh në shekullin e XIII-të, Shën Thomas Akuini bëri referenca për të drejtën e një sovrani për të ndërhyrë në punët e brendshme të një tjetri, nëse subjektet keqtrajtoheshin shumë.¹⁶² Më pas, në shekullin e 17-të, Hugo Grotius zbuloi për herë të parë një teori të ndërhyrjes humanitare. Në gjysmën e fundit të shekullit XIX dhe në rastin e shek. XX, ndërhyrja humanitare u pranua gjerësisht si pothuajse një drejtësi e një shteti. Karta e OKB- së megjithatë, këtë gjë nuk e lejoi.¹⁶³

Doktrina e ndërhyrjes humanitare pas Grocius ishte kryesisht një argument teorik. Përfshirja specifike e doktrinës së ndërhyrjes humanitare nga një shtet ndërhyrës u ngrit kryesisht në gjysmën e fundit të shekullit XIX. Sidoqoftë, shembulli i parë i praktikës shtetërore kur doktrina e ndërhyrjes humanitare u përdor për të justifikuar forcën ushtarake ndodhi në vitin 1829, kur Franca, Britania dhe Rusia zbatuan ushtarakisht Traktatin e Londrës 1827 me qëllim parandalimin e gjakderdhjes në Greqi.¹⁶⁴ Sipas Barry Benjamin, këto dhe praktika të tjera shtetërore bëri që disa autorë të konkludojnë se para hartimit të Kartës së OKB- së, e drejta zakonore ndërkombëtare, përmes praktikës shtetërore dhe sipas mendimit të studiuesve, padyshim se njohën ligjshmërinë e ndërhyrjes.¹⁶⁵

¹⁶⁰ Steve G. Simon, 'The Contemporary Legality Of Unilateral Humanitarian Intervention', (1993), California Western International Law Journal, 117 [tani e tutje: Steve G. Simon, 'The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention'].

¹⁶¹ Ibid 121.

¹⁶² Ibid 122.

¹⁶³ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 129.

¹⁶⁴ Ibid 128.

¹⁶⁵ Ibid 129.

Ndërsa në fillim të shek. XX, shumica e autorëve vazhduan të njohin ekzistencën e doktrinë së ndërhyrjes humanitare.¹⁶⁶ Argumentet që tregojnë një pranim të së drejtës së njëanshme për të ndërhyrë në baza humanitare deri në fillim të shekullit XX janë mbështetur mirë. Andaj, Steve Simon argumenton se doktrina e ndërhyrjes së njëanshme humanitare u pranua të paktën për gjashtëqind vite, ishte mishëruar në të drejtën zakonore ndërkombëtare, dhe me kusht që një shtet të mund të ndërhynte ose për të mbrojtur jetën ose të drejtat e njeriut të individëve, përgjithësisht të shtetasve të tyre, por ndonjëherë shtetasit e shteteve synuese, të cilët u kërcënuan ndërsa jetonin në shtete të tjera . Doktrinat ndryshuan ndjeshëm pas Luftës së Dytë Botërore. Pas Luftës së Parë Botërore, kombet u tronditën për mundësinë e një lufte tjetër botërore, dhe ndërsa komb et filluan të mos besojnë njëra-tjetrën, lejohet lejimi i përdorimit të forcës.¹⁶⁷

E drejta ndërkombëtare konvencionale e periudhës pas formimit të Lidhjes së Kombeve ngadalë filloi të përkulet drejt ndalimit të përdorimit të njëanshëm të forcës nga shtetet. Pakti Briand- Kellogg i vitit 1928 ishte një përpjekje për të ndaluar përdorimin e forcës. Disa komentues e interpretuan këtë pakt si ndalimin e përdorimit të forcës nga shtetet kundër shteteve të tjera, përfshirë ndërhyrjen humanitare. ' Të tjerët e dënuan atë si një "pasardhës të shkurtër të optimizmit Wilsonian" dhe një "parathënie ironike për dekadat e mbytura të gjakut dhe çelikut, vitet 1930 dhe 1940". Prandaj, komentuesit, si zakonisht, nuk ishin dakord për efektin e traktateve në fillim të shekullit XX.¹⁶⁸ Pamja në epokën para Luftës së Dytë Botërore hodhi poshtë ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare. Përveç kësaj, disa komentues konkluduan se një e drejtë e njëanshme nuk ekzistonte sepse çështjet e përdorura për të mbështetur pretendime të tilla nuk ishin aspak humanitare, por fasada për vetveten - ndërhyrje e interesuar.¹⁶⁹ Por, sipas disa studiuesve, siç argumenton dhe Simon Chesterman, se ndërhyrja humanitare nuk ishte e lejuar edhe para Kartës së OKB- së. Sipas tij ekziston një keqkuptim i përhapur se para nenit 2(4) të Kartës, e drejta e ndërhyrjes humanitare ishte e njohur në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹⁷⁰ Ndërsa, Stive Simon argumenton se nga

¹⁶⁶ Steve G. Simon, 'The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention', 122.

¹⁶⁷ Ibid 123.

¹⁶⁸ Ibid 124.

¹⁶⁹ Ibid.

¹⁷⁰ Simon Chesterman, 'Legality Versus Legitimacy: Humanitarian Intervention, the Security Council, and the Rule of Law', (2002) (33)3, International Peace Academy, (SAGE Publications), 297 [tani e tutje: Simon Chesterman, 'Legality Versus Legitimacy: Humanitarian Intervention'].

ajo që u diskutua më sipër, ka prova të bollshme që sugjerojnë një të drejtë për ndërhyrje të njëanshme humanitare që ka ekzistuar para Luftës së Dytë Botërore.¹⁷¹ Në këtë pikë të historisë, statusi i të drejtës zakonore për përdorimin e njëanshëm të forcës për ndërhyrje humanitare ishte i errët. Gjashtëqind vite ndërhyrje juridike humanitare kohën e fundit kishin hasur afërsisht njëzet e pesë vite kundërshtimi të butë. Karta e OKB-së synonte të sigurojë dritën udhëheqëse për sjelljet ndërkombëtare. Miratimi i Kartës së OKB-së megjithatë, vazhdoi trendin e pjesës së hershme të shekullit të XX-të duke mos shprehur qartë gjendjen e të drejtës në lidhje me ndërhyrjen humanitare.¹⁷²

2.2. Ndërhyrja humanitare pas miratimit të Kartës së OKB-së

Pikë fillestare për ta trajtuar ligjshmërinë dhe legjitimitetin e ndërhyrjes humanitare është neni 2(4) i Kartës së OKB-së. Që nga miratimi i Kartës së OKB-së dhe ndalimi i përdorimit të forcës kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shteteve anëtare neni 2 (4), ka pasur debate nëse forca e armatosur mund të përdoret në mënyrë të ligjshme për të mbrojtur të drejtat e njeriut, të drejtat e popullsisë të një shteti tjetër. Shprehja “ndërhyrje humanitare”, e krijuar për të përshkruar praktikën e përdorur here pas here në një periudhë që zakonisht vazhdon të zbatohet për këtë ide.¹⁷³ Karta e OKB-së në nenin 2(4) ndalon përdorimin e forcës për çfarëdo arsye, përveç vetëmbrojtjes dhe përdorimit të forcës me autorizim të KS-së.¹⁷⁴ Pyetja më e shpeshtë që parashtrohet është se a lejohet ndërhyrja humanitare sipas të drejtës ndërkombëtare?¹⁷⁵ Kjo mund të ketë mbështetje në të drejtën para Kartës dhe mund të ketë qenë shumë mirë e pranuar në shek. XIX në bazë të së drejtës ndërkombëtare. Sidoqoftë, kjo është e vështirë që të pajtohet me nenin 2(4) të Kartës.¹⁷⁶ Praktika ka qenë në përgjithësi jo në favor të konceptit, kryesisht sidomos për të justifikuar

¹⁷¹ Steve G. Simon, ‘The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention’, 124.

¹⁷² Ibid.

¹⁷³ Nigel S. Rodley and Basak Cali, ‘Kosovo Revisited: Humanitarian Intervention on the Fault Lines of International Law’, (2007) (7)2, Human Rights Law Review (Published by Oxford University Press), 275- 276, doi:10.1093/hrlr/ngm003 [tani e tutje: Nigel S. Rodley and Basak Cali, ‘Kosovo Revisited: Humanitarian Intervention on the Fault Lines of International Law’].

¹⁷⁴ Barry M. Benjamin, ‘Unilateral Humanitarian Intervention’, 136.

¹⁷⁵ Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention. Humanitarian Intervention in International Law*, (State University of New York Press, Albany, 2009) 57 [tani e tutje: Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*].

¹⁷⁶ Malcolm N. Shaw, *International Law*, (Sixth Edition, Cambridge University Press, 2008) 1155.

ndërrhyrjet e shteteve më të fuqishme në territoret e shteteve më të dobëta. Megjithatë, Malcolm Shaw përmend se nuk është e pa konceptueshme që në disa situata, bashkësia ndërkombëtare mund të përmbahet nga miratimi i një qëndrimi dënues ku një numër i madh i jetës kanë shpëtuar në rrethana shtypjesh të rënda nga një shtet i qytetarëve të tij për shkak të një ndërrhyrjeje të jashtme. Për më tepër, është e mundur që një e drejtë e tillë mund të evoluojë në raste të një nevojë ekstreme humanitare.¹⁷⁷

Meqë, Karta e OKB-së nuk specifikon ndërrhyrjen humanitare, ajo ka lënë hapësirë për diskutime të shumta nga shtetet dhe autorët e së drejtës ndërkombëtare. Në këtë pjesë do të trajtohen disa argumente pro dhe kundër ndërrhyrjes humanitare.

2.2.1. Argumentet në favor të ndërrhyrjes

Edhe nëse ndërrhyrja humanitare mund të konsiderohet e paligjshme në të drejtën ndërkombëtare, është në rritje numri i autorëve që e legalizojnë atë. Ata besojnë se një interpretim i rishikuar i Kartës do të përcaktonte ligjshmërinë e ndërrhyrjes humanitare. Një interpretim i tillë buron nga të kuptuarit e kushteve në të cilët është hartuar Karta, me çrast interpretimi i praktikës mund të mbështesë si paligjshmërinë ashtu edhe ligjshmërinë e ndërrhyrjes humanitare.¹⁷⁸ Argumentet në favor të ndërrhyrjes humanitare pohojnë se neni 2(4) në thelb përfshin përdorimin e forcës që nuk është kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shteteve dhe për këtë arsye përdorimi i një force të tillë është në përputhje me qëllimet e Kartës së OKB- së, ku ka qëllim promovimin e të drejtave të njeriut. Prandaj, ndërrhyrja humanitare nuk bën pjesë në këtë ndalim.¹⁷⁹

Për një seri të arsyeshme, një numër autorësh argumentojnë se ndërrhyrja humanitare duhet të jetë e ligjshme. Këta argumentojnë se kur një qeveri kryen abuzime ndaj të drejtave të njeriut dhe kur organizatat ndërkombëtare nuk arrijnë të parandalojnë këto abuzime, një shtet duhet të ketë të drejtën për ndërrhyrje të njëanshme humanitare, brenda shtetit të caktuar, për të parandaluar ato abuzime. Arsyetimi ligjor, moral dhe praktik ofron një mbështetje të ligjshmërisë së ndërrhyrjes humanitare. Për më tepër, komentuesit pretendojnë

¹⁷⁷ Ibid 1156.

¹⁷⁸ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 134.

¹⁷⁹ Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*, 62.

se praktika shtetërore që është zhvilluar që nga fillimi i Kartës mbështet mjaftueshëm legalizimin e ndërhyrjes humanitare. Disa komentues deklarojnë se argumentet ligjore e mbështesin ndërhyrjes humanitare. Është e njohur se shtetet që bëjnë shkelje të egra të të drejtave të njeriut, e humbasin legjitimitetin e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare.¹⁸⁰ Për më tepër, këta autorë e pranojnë se në praktike, masat e sigurisë kolektive të OKB-së zakonisht nuk arrijnë të parandalojnë shkeljet masive të drejtave të njeriut. Ekzistojnë shumë raste të dështimeve të sigurisë kolektive. Shembujt e fundit përfshijnë ish-Jugosllavinë, Somalinë, Sudanin dhe Irakun.¹⁸¹ Kritikët e pozicionimit kanë avancuar një numër të madh kundërshtimesh të ndërhyrjes humanitare. *Së pari*, ekziston një trup i konsiderueshëm i mendimit se ndërhyrjen humanitare mund të përdorim ligjërisht, vetëm nëse është ndërmarrë nën autoritetin e KS-së. Rritja e rëndësisë së të drejtave të njeriut është reflektuar në gatishmërinë e KS-së. Sipas të drejtës ndërkombëtare, KS-ja ka përgjegjësi kryesore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Kjo nuk do të thotë se në rast kur KS-ja nuk është në gjendje të ndërmarrë veprime në një rast të veçantë, për shembull për shkak të veto-s, ose kërcënimit me veto nga një anëtar i përhershëm i KS-së, asnjë veprim nuk është i mundur. Shtetet kanë ndërhyrë për arsye humanitare pa autorizim nga KS-ja në raste ekstreme dhe veprimi i tyre është pranuar nga shumica e shteteve dhe në disa raste, më pas është aprovuar nga KS-ja. “Për më tepër një interpretim i së drejtës ndërkombëtare i cili do të ndalonte ndërhyrjen për të parandaluar diçka aq të tmerrshme sa Holokausti, përveç nëse në anëtar i përhershëm mund të bindet të heq dorë nga veto-ja e tij, do të ishte në kundërshtim me parimet mbi të cilat bazohet e drejta ndërkombëtare moderne”.¹⁸² *Së dyti*, shpesh kundërshtohet se nuk ka konsensus për ekzistencën e një të drejte të ndërhyrjes humanitare. Sidoqoftë, nuk është një kundërshtim bindës. Christopher Greenwood potencon se e drejta ndërkombëtare nuk kërkon unanimitet midis shteteve, e lëre më midis studiuesve dhe ka polemika për shumë parime të së drejtës ndërkombëtare. *Së treti*, një kundërshtim i mëtejshëm shpesh për ndërhyrje humanitare është se do të ishte e hapur për abuzim. Të gjithë të drejtat mund të keqpërdoren. P.sh. Greenwood përmend se e drejta e vetëmbrojtjes pa dyshim se ka qenë subjekt keqpërdorimi por asnjëherë në mënyrë serioze nuk është

¹⁸⁰ Barry M. Benjamin, ‘Unilateral Humanitarian Intervention’, 138- 139.

¹⁸¹ Ibid 140.

¹⁸² Christopher Greenwood, ‘Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo’, (1999) (X) Finnish Yearbook of International Law, 141, 170 [tani e tutje: Christopher Greenwood, ‘Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo’].

sugjeruar që e drejta ndërkombëtare nuk duhet të përfshijë të drejtën e shtetit për vetëmbrojtje.¹⁸³

Për ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare, Ian Hurd përdor tre argumente të veçanta. Të tre argumentet bëjnë rastin e tyre duke bashkuar një interpretim të praktikës së fundit shtetërore me një teori të së drejtës ndërkombëtare, por ata tërheqin interpretime të ndryshme të praktikës dhe çojnë në implikime të dallueshme. *E para*, sugjeron që ndalimi i luftës në nenin 2 (4) ka humbur forcën e tij ligjore duke u shkelur vazhdimisht nga shtetet në praktikë. *E dyta*, sugjeron që mjedisi normativ i politikës botërore ka ndryshuar në mënyrën që rregulli i mosndërhyrjes është zvogëluar përballë përparimit të një norme të humanizmit. Këto ndryshime normative, pretendohet, se kanë nxitur ndryshime pasuese në ligjet formale dhe kanë bërë të ligjshëm atë që dikur ishte e paligjshme. *Më në fund*, nganjëherë argumentohet se të dy konceptet e sovranitetit dhe ndërhyrjes humanitare janë në të vërtetë plotësuese dhe jo kontradiktore, në kuptimin që sovraniteti është i kushtëzuar nga një qeveri që respekton detyrimin për të mbrojtur njerëzit e vet. Kjo pikëpamje argumenton se ndërhyrja humanitare është e ligjshme sepse mbrojtjet ligjore për shtetet sovrane pushojnë së ekzistuari nëse shteti është i angazhuar në llojet më të këqia të abuzimeve të qytetarëve të tij.¹⁸⁴

2.2.2. Argumentet kundër ndërhyrjes

Argumenti kryesor kundër doktrinës ligjore të ndërhyrjes humanitare është se ajo do të hapte derën e ndërhyrjes “pretekstuale”. Për shkak se kjo doktrinë është e bazuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe në doktrinën juridike dhe për shkak se është kaq e diskutueshme, asnjëherë nuk është krijuar një standard i pranuar në mënyrë universale për rregullimin dhe vlerësimin e ndërhyrjes humanitare.¹⁸⁵ Përkrahësit e këtij mendimi argumentojnë se shtetet që dëshirojnë të përfshihen në luftë, shumë lehtë mund të thirren

¹⁸³ Ibid 170.

¹⁸⁴ Ian Hurd, ‘Is Humanitarian Intervention Legal? The Rule of Law in an Incoherent World’, (2011) (25)33 *Ethics & International Affairs*, 25, no. 3 (2011), (Carnegie Council for Ethics in International Affairs), 303, doi: 10.1017/So89267941100027X [tani e tutje: Ian Hurd, ‘Is Humanitarian Intervention Legal?’].

¹⁸⁵ John J. Merriam, ‘Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention’, (2001) (33)1, *Case Western Reserve Journal of International Law*, 126 [tani e tutje: John J. Merriam, ‘Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention’].

në doktrinë si pretekst për qëllime të paligjshme, egoiste ose politike.¹⁸⁶ Ndërsa, argumenti se ndërhyrja për qëllime humanitare nuk është kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike, është refuzuar kryesisht dhe mendimi juridik mbizotërues është se gjuha e nenit 2(4) nuk kishte për qëllim të krijojë zbrazëtira ndaj ndalimit të përgjithshëm të forcës. Edhe nëse këto terme nuk synojnë të jenë përjashtime nga rregulli 2(4), nuk duket se ndërhyrja humanitare nuk arrin të ketë efekt në integritetin territorial dhe pavarësinë politike. Deri sa ndërhyrja humanitare zhvillohet brenda një territorit të një shteti dhe ka për qëllim parandalimin e aparatis qeverisës të një shteti për të kryer politikë, është e paligjshme nën një interpretim të rreptë të nenit 2(4), e njëjta gjë është e vërtetë në lidhje me argumentin se ndërhyrja humanitare nuk është në kundërshtim me qëllimet e OKB- së.¹⁸⁷ Komentuesit të cilët mbrojnë paligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare argumentojnë se veprimet ushtarake të së kaluarës së fundit, d.m.th. praktikat shtetërore, nuk mbështesin legalizimin e ndërhyrjes së njëanshme humanitare. Këta argumentojnë se, shtetet të cilat kanë ndërhyrë në të kaluarën këtë gjë e kanë bërë për përfitime politike, e jo për motive humanitare. Ata gjithashtu argumentojnë se nuk ka precedent të vlefshëm për ndërhyrje humanitare. Në të kaluarën kur një shtet mund të argumentonte në mënyrë të arsyeshme se ndërhyri për qëllime humanitare, e profilizuan ndërhyrjen si vetëmbrojtje.¹⁸⁸ Në këndvështrimin e praktikës, komentuesit që kundërshtojnë ligjshmërinë e saj, argumentojnë se çështja e Indisë e mbështet këndvështrimin e tyre. Ata deklarojnë se ndërsa interesat humanitare ishin të përfshira, India qartë kishte motive të ulëta, jo humanitare. Rasti i Tanzanisë është një shembull tjetër se si një shtet nuk arriti të thërrasë ndërhyrjen humanitare për përdorimin e forcës ushtarake kur mund të kishte mundësi. 'Sundimi i Presidentit Idi Amin në Ugandë nga 1971 deri në 1979 ishte i njohur gjerësisht si jashtëzakonisht brutal dhe shtypës, dhe u krahasua me sundimin e Hitlerit.¹⁸⁹ Çështja e paligjshmërisë së ndërhyrjes humanitare qëndron në gjuhën e thjeshtë të Kartës së OKB- së. Neni 2(4) ndalon përdorimin e forcës. Karta përfshin referenca për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore për individët, të cilat konsiderohen si mbështetje e një lloji të humanizmit. Sidoqoftë, këto nuk i bashkëngjiten asnjë angazhimi ligjor nga nënshkruesit dhe kështu nuk krijojnë mundësi për një ndërhyrje të

¹⁸⁶ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 135.

¹⁸⁷ Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*, 62.

¹⁸⁸ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 136- 137.

¹⁸⁹ Ibid.

armatosur. Pra të drejtat e njeriut në Kartë lindin nga një kontekst jo detyrues, ato nuk krijojnë angazhime ligjore dhe as nuk modifikojnë ndalimin e përdorimit të forcës.¹⁹⁰ Për një ekspert ligjor, është e qartë se e drejta ndërkombëtare ekzistuese nga Karta e deri më sot nuk gjen vend për një kategori juridike të ndërhyrjes humanitare. Së bashku krejt këto pretendime çojnë në përfundim se përdorimi i forcës (përveç vetëvetëmbrojtjes) është i parëndësishëm në të drejtën ndërkombëtare dhe përpjekja për t'u përgjigjur emergjencave humanitare që refuzojnë të bashkëpunojnë, përfundojnë duke u përballur me të njëjtën ndalesë.¹⁹¹

Noam Chomsky, duke argumentuar kundër ndërhyrjes së njëanshme humanitare thekson se, shkeljet e të drejtave të njeriut janë me të vërtetë të zakonshme dhe nëse do të ishte e lejueshme për t'i korrigjuar ato me përdorim të jashtëm të forcës, nuk do të kishte asnjë ligj që do ta ndalonte përdorimin e forcës nga pothuajse çdo shtet, kundër ndonjë shteti tjetër. Ai beson se të drejtat e njeriut duhet të shfajësohen dhe padrejtësitë të rregullohen me mjete paqësore, jo duke hapur derën e agresionit dhe shkatërrimin e parimit kryesor në të drejtën ndërkombëtare: ndalimin e luftës dhe përdorimin e forcës.¹⁹² Disa studiues argumentojnë se nëse dikur ekzistonte një zakon dhe një praktikë rudimentare e ndërhyrjes, themelimi i OKB- së e refuzoi atë në mënyrë efektive, duke e ndaluar ndërhyrjen ushtarake, ndonëse, Karta e OKB- së nuk e ndalon në mënyrë të qartë ndërhyrjen humanitare.¹⁹³ Për Eizen, në tekstin e Kartës ekzistojnë rregulla të buta, të cilat mundësojnë ndërhyrjen e njëanshme humanitare, ndërsa në rastin më të mirë ka rregulla kontradiktore dhe të paqarta. Sipas tij, nëse dikush i lexon rregullat e Kartës në mënyrë të përshkruar, se ajo lejon të drejtat e njeriut, por nuk e lejon përdorimin e forcës, supozohet se korniza e saj nuk ka dashur përdorimin e njëanshëm të forcës për të qenë një përgjigje për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Andaj, ai beson se Karta është e pamjaftueshme për të qeverisur siç duhet ndërhyrjen humanitare¹⁹⁴ Rrjedhimisht, kornizës së Kartës së OKB- së i mungojnë kriteret parimore për përcaktimin e kushteve të mirëqenies njerëzore, të cilët e lejojnë ndërhyrjen humanitare; ekzistojnë vetëm përcaktime *ad hoc* të KS-së, në të cilin mbizotërojnë shtetet e fuqishme. Ndërkaq, Karta kërkon nga anëtarët të promovojnë të drejtat e njeriut, vetë dokumenti nuk

¹⁹⁰ Ian Hurd, 'Is Humanitarian Intervention Legal?', 298- 299.

¹⁹¹ Ibid 301.

¹⁹² Noam Chomsky, *Rogue States: The Rule of Force in the World Affairs*, (South End Press 2000) 50.

¹⁹³ John J. Merriam, 'Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention', 120.

¹⁹⁴ Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*, 63.

specifikon cilat janë ato standarde. Kjo është arsyeja përse Karta është e pamjaftueshme për të qeverisur ndërhyrjen humanitare.¹⁹⁵

Që nga mbarimi i Luftës së Ftohtë, nga Iraku Verior në Timorin Lindor, një vazhdim i situatave urgjente që përfshijnë vuajtjet masive ka rezultuar me ndërhyrje ushtarake të jashtme që ishin mbi baza humanitare. Ka pasur situata si në Bosnjë dhe Ruandë, shembuj me një arsye të fortë për të ndërhyrë, por nuk ka pasur asnjë veprim, ose është vepruar shumë vonë. OKB-ja ka qenë qendër e pashembullt e operacioneve në terren dhe e debateve për ndërhyrje humanitare. Shtetet anëtare nuk pajtohen fuqishëm në këtë çështje dhe organet e OKB-së kanë pikëpamje dhe role të ndryshme dhe nganjëherë kontardiktore lidhur me të. Në zemër të vështirësisë të OKB- së sipas Adam Roberts, qëndron një paradoks. Në 45 vitet e para saj, ishte e lidhur me parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve. Pastaj në epokën e Luftës së Ftohtë OKB- ja u sqarua me një model ndërhyrjeje, shpesh të paktën humanitare.¹⁹⁶ Roberts konsideron se Karta thellësisht shihet si jo ndërhyrëse në qasjen e saj. Sipas tij, askund Karta nuk adreson drejtpërdrejtë çështjen e ndërhyrjes humanitare, qoftë nën kujdesin e OKB-së, ose kur shtetet veprojnë në mënyrë të pavarur. Megjithatë, sipas Roberts Karta lë hapësirë për ndërhyrje humanitare në dy mënyra kryesore. *E Para*, lind nga të drejtat themelore të njeriut, të cilat janë të shpallura si qëllime themelore të OKB- së në Preambulën dhe në Nenin 1. Këto referenca dhe të gjitha ato që rrjedhin prej tyre, bënë shumë për të vërtetuar se OKB- ja nuk ishte tregti e thjeshtë e bashkimit të shteteve, siç ishte dukur shpesh, por ishte një organ që kishte një tërheqje të vërtetë për individët. OKB-ja përfshin në qëllimet e saj, Nenin 1(2) dhe Nenin 1(3). *Mënyra e dytë*, me të cilën Karta mund të lë hapësirë për ndërhyrje humanitare ka të bëjë me mundësinë e një ndërhyrje nën kujdesin e KS të OKB-së. Në nenin 2 (7), të cituar më sipër, fraza përfundimtare lejon masat e zbatimit brenda shteteve nën kapitullin e VII-të të Kartës.¹⁹⁷

Gjithashtu, është zhvilluar debati pas Luftës së Ftohtë se ka ndonjë të drejtë për ndërhyrje humanitare në të drejtën ndërkombëtare? Përfundimi i Roberts, që rrjedh nga shqyrtimi i çështjeve për dhe kundër një të drejte të tillë, aktualisht nuk ka ndonjë përgjigje të përgjithshme me një fjalë për këtë pyetje. As nuk ka ndonjë gjasë që një përgjigje e tillë do të

¹⁹⁵ Ibid 64- 65.

¹⁹⁶ Adam Roberts, *The united Nations and Humanitarian Intervention*, (Edited by Jennifer M. Welsh: *Humanitarian Intervention and International Relations*'), (Published in the United States by Oxford University Press 2004) 71 [tani e tutje: Adam Roberts, 'The united Nations and Humanitarian Intervention'].

¹⁹⁷ Ibid 72- 74.

dalë në të ardhmen e afërt. Ajo që e drejta ndërkombëtare mund të ofrojë janë, parimet korrektuese, strukturat dhe kriteret për vendimmarrje të ligjshme, dëshmi e një zakoni në zhvillim dhe një perspektive e gjerë për një çështje të urgjencës bashkëkohore. E drejta mund të tregojë një përgjigje të veçantë për një situatë të veçantë, por nuk pritet të sigurojë një përgjigje të përgjithshme të zbatueshme për një gamë të gjerë çështjesh.¹⁹⁸

2.3. Legjitimiteti i ndërhyrjes humanitare

Nga ata të cilët e kundërshtojnë ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare në parim do të bien dakord që ka hapësirë për zbutjen e pasojave të pafavorshme të paligjshmërisë, kur ndërhyrja vlerësohet si “legjitime”. Mbrojtësit e një doktrine të ndërhyrjes humanitare në mënyrë të pashmangshme duhet të adresojnë gjithashtu nenin 2(4) të kartës së OKB- së.¹⁹⁹ Larg të qenit një veprim i cili është në kundërshtim me qëllimet e OKB- së, ai është në mbështetje të një qëllimi kryesor të organizatës, gjegjësisht arritjes së të drejtave të njeriut. Prandaj do të ishte ‘formalizëm i thatë’ që një popull të vuaj ose shkatërrohet thjesht se një anëtar i OKB- së, duke vepruar për arsye që nuk ka të bëjë me merita të çështjes, ushtron Veto- n e tij duke parandaluar autorizimin nga KS- ja.²⁰⁰ Sipas Roberts, në një paradoks të jashtëzakonshëm, rezultati i një numri të madh të zhvillimit ligjor në periudhën pas 1945 është një përplasje e pakonkurueshme e dy organeve mbresëlënëse të së drejtës ndërkombëtare. Nga njëra anë ekziston një organ i ligjit që kufizon të drejtën e shteteve për të përdorur forcën, dhe nga ana tjetër një organ të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare. Rastet e vështira që shkaktojnë kërkesën për ndërhyrje në baza humanitare nuk tregojnë shenja të zhdukjes.²⁰¹ Ndërhyrjet të bazuara të paktën pjesërisht në baza humanitare janë rezultat i realiteteve të qëndrueshme të sistemit bashkëkohor politik dhe juridik ndërkombëtar. Padyshim që do të ketë raste të reja, qoftë vetëm si nevoja të rastit dhe të jashtëzakonshme.²⁰²

¹⁹⁸ Adam Roberts, ‘The So-Called ‘Right’ of Humanitarian Intervention’, 3.

¹⁹⁹ Nigel S. Rodley and Basak Cali, ‘Kosovo Revisited: Humanitarian Intervention on the Fault Lines of International Law’, 281.

²⁰⁰ Ibid.

²⁰¹ Adam Roberts, ‘The So-Called ‘Right’ of Humanitarian Intervention’, 44.

²⁰² Ibid 51.

Për Adam Roberts ka mundësi të gjendet një doktrinë e qëndrueshme e ndërhyrjes humanitare. Varet nga ideja e një grupi kushtesh dhe kriteresh që duhet të zyrtarizohen, që do të ndihmonin të përcaktonin se në një rast të veçantë të ndërhyrjes humanitare do të ishte e justifikuar. Marrëveshja për këto kriterë do të ishte një dëshmi për një doktrinë në zhvillim dhe gjithashtu mund të jetë një mbrojtje kundër abuzimeve. Ideja e kriterëve të përgjithshme ka në histori të gjatë, duke përfshirë “luftërat e drejta”. Sipas Roberts, shumica e përpjekjeve për të hartuar kriterë për ndërhyrje humanitare adresojnë çështjet e mëposhtme: 1. Fushëveprimi i mizorive, 2. Përgjegjësia ndaj mizorive. 3. Shterja e mjeteve juridike paqësore dhe të bazuara në pajtim, 4. Autorizimi dhe legjitimimi i ndërhyrjes, 5. Interesat dhe shqetësimet e fuqive ndërhyrëse, 6. Qëllimet dhe rezultatet e ndërhyrjes, 7. Respektimi i normave humanitare nga forcat ndërhyrëse.²⁰³

Sipas Institutit Danez për marrëdhënie ndërkombëtare ka argumente të forta morale dhe juridiko- politike për legjitimitetin e ndërhyrjes humanitare edhe pa autorizim të KS- së dhe në rastet e plotësimit të disa kushteve, siç janë: 1. “Lufta e drejtë” - domosdoshmëri morale, 2. Ndërhyrja është e nevojshme në raste ekstreme për të ruajtur praktikën dhe moralin legjitimitetit të së drejtës ndërkombëtare, 3. Veprimi i gabuar për të korrigjuar gabime më të mëdha - rregulli i urgjencës, 4. Ndërhyrja humanitare nuk cenon thelbin e sovranitetit shtetëror, 5. Ndërhyrja humanitare mund të rrisë respektimin e të drejtave të njeriut në shtetet e dobëta, 6. Nevoja për zbatimin e drejtës ndërkombëtar, përkundër paralizimit të KS- së, 7. Ndërhyrja humanitare pa autorizim nga KS- ja me qëllim të zbatimit të standardeve të larta rajonale.²⁰⁴ Ky institut e parasheh disa kriterë themelore ku legjitimiteti i intervenimit humanitar mund të strukturohet në pesë tituj: (i) Shkeljet serioze të drejtave njerëzore ose të drejtën ndërkombëtare humanitare (ii) Kur KS dështon të veprojë (iii) Ndërhyrja e njëanshme, multilaterale dhe regjionale? (iv) Vetëm ndërhyrje të domosdoshme dhe proporcionale (v) Ndikimi i Shtetit ndërhyrës.²⁰⁵ Ndërsa, kërkesat minimale që kanë të bëjnë me parimet ligjore të njohura sipas institutit danez për marrëdhënie ndërkombëtare, janë: 1) që KS- ja të mos veprojë (e në mënyrë efektive), 2) që ndërhyrja të drejtohet kundër shkeljeve të mëdha dhe masive të drejtave të njeriut ose ligjit ndërkombëtar humanitar dhe 3) që përdorimi i forca

²⁰³ Ibid 33.

²⁰⁴ Danish Institute of International Affairs, *Humanitarian Intervention, Legal and political Aspects*, 1999 (1999) 99- 101 [tani e tutje: Danish Institute of International Affairs, *Humanitarian Intervention*].

²⁰⁵ Ibid 106.

është e nevojshme dhe aplikohet në mënyrë proporcionale. Për institutin këto janë argumente të forta morale dhe politike me krijimin e një urdhri ndërkombëtar ligjor. Këto argumente sipas këtij instituti flasin në favor të legjitimitetit të ndërhyrjes humanitare pa mandate të KS- së në rastin kur ndodhin krime të rënda ndaj individëve dhe KS- ja është bllokuar.²⁰⁶ Megjithëse, ndërhyrja humanitare pa autorizim të KS- së në përgjithësi nuk është në përputhje me nenin 2(4) të Kartës së OKB- së, ende nën të drejtën ndërkombëtare mund të ekzistojë një e drejtë e ndërhyrjes humanitare në raste të jashtëzakonshme.²⁰⁷

Legjitimiteti i ndërhyrjes humanitare është argumentuar në masë të madhe sidomos pas argumenteve për të legjitimuar ndërhyrjen Organizatës së Paktit Veri- Atlantik (NATO) në Kosovë. Më gjerësisht, për legjitimitetin në rastin konkret do të trajtohet në kapitullin vijues.

2.4. Ndërhyrja humanitare – sovraniteti kundrejt të drejtave të njeriut

Ndërhyrja humanitare ka qenë në qendër të së drejtës ndërkombëtare për shumë vite sepse në mënyrë të pashmangshme hedh disa norma ndërkombëtare, normat si forca kundërshtare: sovraniteti dhe ndalimi i forcës për të parandaluar mizoritë ndaj të drejtave të njeriut dhe sipas kësaj ndërhyrja humanitare bie ndesh me sovranitetin.²⁰⁸ Megjithëse, ka pasur një konsensus se koncepti i sovranitetit ka pasur ndryshime thelbësore nga miratimi i kartës së OKB- së 1945, por prapë disa studiues mbeten prapa idesë tradicionale për sovranitetin absolut.²⁰⁹ Karta e OKB- së specifikisht në nenet 2(4) dhe 2(7), ndalojnë kërcënimin dhe përdorimin e forcës ndaj integritetit territorial dhe pavarësisë politike të një

²⁰⁶ Ibid 124- 125; përveç rasteve dhe kushteve të cilat i parasheh Instituti danez për Marrëdhënie Ndërkombëtare në një raport të vitit 1999, në lidhje me legjitimitetin e ndërhyrjes humanitare, raporti parasheh edhe disa rrezeqe të mundshme në raste të ndërhyrjeve humanitare, ato janë: Rreziqet e ndërhyrjes humanitare: 1. Rrezikimi i rendit juridik ndërkombëtar, 2. Bërja e një vrimë të zezë në ndalimin e përdorimit të forcës, 3. Problemet e ndarjes së anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, 4. Minimi i autoritetit të KS- së , 5. Ndërhyrja humanitare mund të minojë rendin politik në shtetet e dobëta. 6. Rreziqet e zbatimit të standardeve të larta rajonale përmes rregullimit ushtarak, 7. Ai rrezik natyror i abuzimit, 8. Pabarazia dhe abuzimi - ndërhyrja e fuqishme kundër shteteve të dobëta, shih: Danish Institute of International Affairs, *HUMANITARIAN INTERVENTION*, 101.

²⁰⁷ Ibid 84.

²⁰⁸ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention', 167.

²⁰⁹ Richmond, Daphné 'Normativity in International Law: The Case of Unilateral Humanitarian Intervention', (2003) (6)1, Article 2, 60. Yale Human Rights and Development Journal: Vol. 6: Iss. 1, Article 2 2003 [tani e tutje: Richmond, Daphné 'Normativity in International Law'].

shteti dhe ndalojnë përzierjen në punët e brendshme të një shteti.²¹⁰ Mirëpo, edhe të drejtat e njeriut janë një ide revolucionare e kartës. Karta thekson rëndësinë e të drejtave të njeriut në mbarë botën. Mbrojtja e të drejtave të njeriut është ide revolucionare e kartës. Karta e OKB- së thekson rëndësinë e të drejtave të njeriut në mbarë botën. Këto tensione në kartë, ndërmjet sovranitetit dhe promovimit të drejtave të njeriut, duhet të zgjidhen.²¹¹ Një grupi përkrahësve të ndërhyrjes humanitare mund të tregojnë pjesën e dytë të Kartës së OKB- së neni 1(1), i cili parashikon ‘masat efektive’ për t’u përgjigjur kërcënimeve për paqen, neni 29 dhe 1(3) dhe neni 55.²¹²

Dispozitat e Kartës kanë krijuar tensione të nënkuptuara midis koncepteve të së drejtës ndërkombëtare të sovranitetit, mosndërhyrjes dhe të drejtave të njeriut. Në fakt, sistemi i OKB- së krijoi një paradoks. Nocioni se një vend sovran do të jetë në gjendje të qeverisë token e saj pa ndërhyrje nga kombet e jashtme është një koncept i njohur dhe i përhershëm brenda të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe në shek. XX kjo e drejtë u bë disi më e kufizuar.²¹³ Dajana Kumbaro, tregon se ky tension aktual ndërmjet sovranitetit dhe ndërhyrjes humanitare, duhet të shikohet në zhvillimin e të drejtave të njeriut pas shpalljes së kartës. Artikujt për të drejtat e njeriut janë zhvilluar në të drejtën ndërkombëtare. Ato janë jashtë juridiksionit ekskluziv të shteteve, duke kapërcyer parashikimet e nenit 2(7) të kartës. Ky zhvillim ka qenë i vazhdueshme për shkak të rëndësisë morale dhe politike të drejtave të njeriut.²¹⁴ Për të garantuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, traktatet për të drejtat e njeriut parashohin mekanizma mbrojtës. Megjithatë lidhur me përdorimin e tyre nga shtetet, nuk kanë asnjë përgjigje përfundimtare nga GjND-ja dhe komiteti për të drejtë ndërkombëtare. Një pjesë e të drejtave mbesin rekomandime për shtetet, andaj mbrojtja e të drejtave të njeriut në nivel universal ka nevojë të përmirësohet. Megjithatë, ne ditët e sotme mbetet e qartë se organet e OKB- së adresojnë çështje të drejtave të njeriut.²¹⁵

²¹⁰ The United Nations Charter 1945.

²¹¹ Steve G. Simon, ‘The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention’, 127- 128.

²¹² Matthew C. Cooper, ‘A Note To States Defending Humanitarian Intervention’, 171- 172.

²¹³ Steve G. Simon, ‘The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention’, 124- 125.

²¹⁴ Dajana Kumbaro, *The Kosovo Crisis in an International Law Perspective: Self-Determination, Territorial Integrity and the NATO Intervention*, (2001) (Final Report, For: North Atlantic Treaty Organisation, Office of Information and Press, 2001) 51 [tani e tutje: DAJENA KUMBARO, *The Kosovo Crisis in an International Law Perspective*].

²¹⁵ Ibid 52.

Sovraniteti shtetëror ka qenë gjithmonë pjesë qendrore në të drejtën ndërkombëtare dhe është njohur në mënyrë të qartë në nenin 2(7) të Kartës. Për një kohë të gjatë, çështjet e të drejtave të njeriut konsideroheshin se binin nën këtë dispozitë, KS-ja nuk pranoi të vepronte pavarësisht shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, me përfundimin e luftës së ftohtë, KS-ja gjeti jetë të re dhe filloi të veproje, sipas nenit 42 të Kapitullit VII të Kartës, për të ndërhyrë në situata ekstreme njerëzore.²¹⁶ KS-ja ka ndërruar debatin e diskutimit të bëra në lidhje me ndërhyrjen humanitare dhe sovranitetit janë hequr nga praktika e diskutimit. Konceptet e “sovranitetit” sipas Matthew Cooper nuk parandalojnë më ndërhyrjen humanitare.²¹⁷ Theksimi i të drejtave të njeriut nga karta e OKB-së, me rritjen e rëndësisë së tyre në të drejtën ndërkombëtare, nuk mund të pretendohet se abuzimi i tyre është punë e brendshme e shteteve. Shtete si Kina, Rusia dhe shtete tjera vazhdimisht pohojnë të drejtën e tyre për të vepruar siç duan brenda juridiksionit të vet.²¹⁸ Në historinë e saj, OKB-ja ka pranuar më shumë si aksione për vendosjen e të drejtave të njeriut, që mund të përdoren si zbehje të sovranitetit. Si pasojë, përkrahësit e ndërhyrjes humanitare argumentojnë se OKB-ja ka miratuar se sovraniteti është dytësor në raport me vlerësimin për të drejtat e njeriut. Më në fund neni 2(4) nuk parashikon situata kur KS-ja është bllokuar, andaj përkrahësit e ndërhyrjes humanitare argumentojnë se ndërhyrja duhet të mbështetet si masë ndalese kur KS-ja është bllokuar nga veprimi i menjëhershëm.²¹⁹

Eric Einze vë në dukje se ekzistenca e një numri të konsiderueshëm traktatesh shumëpalëshe për të drejtat e njeriut, juridikisht të detyrueshme, mund të konkludohet në mënyrë të arsyeshme që të drejtat e njeriut të kodifikuara në këto traktate nuk janë më brenda juridiksionit thelbësor të shteteve, si çështje juridike në lidhje me nenin 2(7).²²⁰ Për Einze ekzistojnë dy problem të mundshme për të drejtën si një bazë ligjore për ndërhyrje humanitare nga këto instrumente. *Së pari*, është e diskutueshme nëse këto instrumente përmbajnë gjuhën që kërkon përdorimin e forcës, ose shkelje të sovranitetit shtetëror, për të zbatuar dispozitat në të. Ndërsa, Einze konkludon se në mënyrë të arsyeshme që traktatet e të drejtave të njeriut kanë pasur një ndikim të thellë në ato çështje që duhet mbajtur brenda juridiksionit të një shteti, për qëllime të nenit 2(7), e njëjta nuk mund të thuhet në lidhje me

²¹⁶ Matthew C. Cooper, ‘A Note To States Defending Humanitarian Intervention’, 174.

²¹⁷ Ibid 176.

²¹⁸ John J. Merriam, ‘Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention’, 121.

²¹⁹ Ibid 122- 123.

²²⁰ Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*, 65.

sigurimin e një përjashtimi nga neni 2(4). *E dyta*, është çështja nëse ndonjë nga këto traktate adreson në mënyrë adekuate shqetësimin themelor të së cilës të drejtat e njeriut në këto traktate mund të jenë subjekt i ndërhyrjes humanitare.²²¹ Megjithatë, asnjë nga fuqitë perëndimore nuk dëshirojnë të promovojnë një braktisje të plotë të parimit të mosndërhyrjes, por, ata pohojnë se gjenocidi dhe shkelje të rënda të drejtave të njeriut nuk mund të jenë thjesht një çështje e brendshme. Kina dhe Rusia kanë qenë të ndjeshëm në lidhje me çështje të tilla për shkak të shqetësimeve të tyre rreth grupeve separatiste brenda kufijve të tyre. Për këtë arsye, ata duket se hezitojnë të pranojnë masa që anashkalojnë parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti Sovran. Sa i përket qeverive të botës së tretë, ekziston në frikë e gjerë e ndërhyrjes humanitare mund të përdoret si pretekst për ndërhyrje ushtarake të fuqive të forta, në shtete të dobëta. Kjo frikë lidhet me kujtimin e kolonializmit.²²² Sipas Nigel Rodley, shumë qeveri praktikant e të cilëve përfshijnë shkeljet thelbësore të drejtave të njeriut do të preferojnë nocionin e sovranitetit për të kapërcyer shqetësimet për të drejtat e njeriut.²²³

Kundërshtarët e ndërhyrjes humanitare mund të argumentojnë se Karta e Uru në prag të luftës së dytë botërore (LDB) për të parandaluar shtetet të abuzonin me pushtetin dhe sovranitetin e shtetit tjetër- abuzim me të gjatë luftës së dytë botërore çoi në egoizmin e mizorive më të ashpra që bota ka parë ndonjëherë.²²⁴ Realistët argumentojnë se qeveritë nuk janë vetë legjitime por legjitimiteti i qeverive varet nga respektimi i të drejtave të njeriut. Një kohë, sovraniteti i një kombi ishte absolut. Me kalimin e kohës, bota ndërkombëtare i përgjigjet ndryshimeve. Një koncept që ka ndryshuar në mënyrë dramatike që nga mesjeta është nocioni i sovranitetit. Koncept të cilin e përkrah dhe Steve Simon.²²⁵ Për Richemond Daphné, një regjim i paqartë për konceptin tradicional nuk ka garanci specifike për ruajtjen e integritetit të shtetit të synuar ku ndodhin ndërhyrje humanitare. Megjithatë, një normë e re do të sigurojë se nuk ka kufizime të padrejta për sovranitetin e shtetit të synuar, gjatë rrjedhës së ndërhyrjes. Udhëzimet do të përcaktojnë se si do të bëhet ndërhyrja. Një normë e re e kodifikuar do të mbronte sovranitetin nga regjimi aktual, i cili bazohet në kuptimin tradicional

²²¹ Ibid 66.

²²² Danish Institute of International Affairs, *HUMANITARIAN INTERVENTION*, 78.

²²³ Nigel S. Rodley and Basak Cali, 'Kosovo Revisited: Humanitarian Intervention on the Fault Lines of International Law', 285.

²²⁴ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention', 171.

²²⁵ Steve G. Simon, 'The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention', 142- 143.

të sovranitetit. Në të njëjtën kohë interpretimi modern i sovranitetit u jep mbrojtje individëve duke lejuar ndërhyrjen edhe kur OKB-ja bllokohet. Kështu, kodifikimi do t'i mbroj të dyja. Daphné pohon se një nënshtrim përfundimtar i sovranitetit ndaj të drejtave të njeriut nuk është pranuar gjerësisht, cilado mënyrë pranohet, një konsensus duket se ka dalë për t'i ekuilibruar sovranitetin dhe të drejtat e njeriut. Sipas një norme të re të kodifikuar, të drejtat e njeriut do të përbënin parimin kryesor, ndërsa sovraniteti do të ishte varësi.²²⁶

Me gjithë përpjekjet për kuptimin tradicional të sovranitetit nga shtete si Kina, Rusia dhe vende të tjera, dhe argumentimi se Karta e OKB-së e ndalon rreptësisht cenimin e sovranitetit të shtetit, viteve të fundit nuk mund të mohohet fakti se me avancimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e tyre ndërkombëtare, një numër i madhe i shteteve dhe studiuesve të së drejtës ndërkombëtare, kanë filluar që mos ta shohin sovranitetin si një e drejtë absolute për të bërë gjithçka brenda vendit. Dhe kur ka abuzime të mëdha të drejtave të njeriut është detyrë e bashkësisë ndërkombëtare dhe shteteve që pavarësisht sovranitetit, të ndërhyrjet dhe t'i mbrojnë qytetarët e atij vendi, kur shteti i vet nuk dëshiron ose nuk është në gjendje t'i mbrojë ato.

2.5. Ndërhyrja humanitare dhe zhvillimi i një jus cogens

Ekzistojnë mendime se një zakon i përgjithshëm dhe praktik i ndërhyrjes humanitare njihet qysh në shek. XIX-të.²²⁷ Por, me miratimin e kartës së OKB-së siç kemi parë më lartë, qëndrimet dhe mendimet lidhur me një ndërhyrje humanitare nga e kaluara, duket se kanë ndryshuar. Andaj, në këtë pjese po e trajtojmë vetëm mendimet lidhur me krijimin e një norme zakonore ndërkombëtare për ndërhyrje humanitare. Tradicionalisht pohohet se zëri i OKB-së ka qenë në lidhje me ndalimin e forcës. Sidoqoftë, praktika e ndërhyrjes ka vazhduar në epokën e OKB-së.²²⁸ Veprimet shtetërore gjatë 50 viteve të fundit i kanë mbijetuar formimit të OKB-së. Mirëpo, parimet e të drejtave të njeriut që formojnë gurë themelin e OKB-së janë ndërtuar mbi themele shumë të dobëta. Sidoqoftë, është po aq e qartë se jo çdo

²²⁶ Richemond, Daphné 'Normativity in International Law', 61- 62.

²²⁷ John J. Merriam, 'Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention, 219.

²²⁸ Ibid 123.

ndërhyrje e bazuar në një pretendim të nevojës humanitare është një ndërhyrje ligjore.²²⁹ Kështu, zhvillimi i së drejtës zakonore ndërkombëtare ka qenë prej kohësh çështje e disa mosmarrëveshjeve midis shteteve dhe midis studiuesve. Studiues të shumtë kanë kundërshtuar këtë pozicion. Një arsye për kundërshtim, përderisa kjo qasje ka të bëjë me ndryshimin e rregullave, duket se do të kërkojë shkelje të së drejtës zakonore ndërkombëtare.²³⁰ Sipas Byers dhe Chesterman, mund të dëshmojnë përpjekje për të zvogëluar kohën e nevojshme për zhvillimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare. Ekziston një supozim, i nënkuptuar, se zhvendosja gjeopolitike të viteve 1989- 91 e bënë praktikën e mëparshme të një rëndësie të vogël në përcaktimin e ekuilibrit bashkëkohor të ndikimit të interesave.²³¹ Për Byers dhe Chesterman, një reformë e rëndësishme për krijimin e normave të reja zakonore të së drejtës ndërkombëtare është e vështirë dhe e pasigurt. Një ndryshim përmes krijimit të një norme zakonore krijon paligjshmëri. Kështu p.sh. aktet e para për krijimin e një norme që krijojnë sovranitetin në favor të drejtave të njeriut, do të shkulte rregullat ekzistuese të sovranitetit. Sipas tyre, një reformë e tillë e shpejtë nuk ka të ngjarë.²³² Madje një pjesë e praktikës së ndërhyrjes humanitare nga shtetet që kanë kontribuar potencialisht në formimin e një rregulle të re zakonore, sipas Eric Einze, nuk mund të konsiderohet si pjesë e praktikës shtetërore për ndërhyrje humanitare, sepse ato janë autorizuar nga KS- ja dhe janë plotësisht të ligjshme.²³³ Andaj, Einze mendon se para adresimit të KS- së, është e rëndësishme të rishikohen incidente të ndryshme bashkëkohore, të zgjeruara zakonisht si ndërhyrje humanitare që kanë kontribuar potencialisht në një rregull zakonor.²³⁴

Disa që e shfaqin nevojën për ndërhyrje, avokojnë për një proces gradual, nga rasti në rast, do të rezultojnë në një rregull të ri të së drejtës zakonore ndërkombëtare nuk kërkojnë autorizim të KS- së.²³⁵ Për ta parë qëndrimet e shteteve dhe mundësinë për zhvillimin e një

²²⁹ Ibid 126.

²³⁰ Michael Byers and Simon Chesterman, 'Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law, (Humanitarian Intervention Ethical, Legal, and Political Dilemmas Edited by J. L. HOLZGREFE AND ROBERT O. KEOHANE, Cambridge University Press 2003) 188 [tani e tutje: Michael Byers and Simon Chesterman, 'Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law'].

²³¹ Ibid 194.

²³² Ibid 135- 136.

²³³ Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*, 74.

²³⁴ Ibid 75.

²³⁵ Michael Byers and Simon Chesterman, 'Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law, 140.

opinio juris të ndërhyrjes humanitare, më poshtë do të trajtohen disa raste praktike të ndërhyrës humanitare, pas themelimit të OKB- së.

2.6. Praktikët e ndërhyrjes nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare

Para trupave ndërkombëtar vendimmarrëse siç është zhvillimi i OKB- së, e drejta ndërkombëtare kryesisht bazohet në rregulla zakonore. Këto rregulla zakonore rrjedhin nga veprimet e shteteve, të quajtura "praktikë e shtetit". "Me kalimin e kohës, "praktika shtetërore" bëhet normë dhe kështu, legjitime. Sidoqoftë, kur interpreton një zinxhir praktikash shtetërore, ndonjëherë është e vështirë të dallosh motivet e vërteta të veprimeve të shtetit. Shqyrtimi i këtyre motiveve themelore është i rëndësishëm sepse ato përcaktojnë legjitimitetin e praktikës shtetërore, dhe kështu veprimin juridik në bashkësinë ndërkombëtare.²³⁶ Veprimet e ndërmarra nga shtetet që nga zbatimi i Kartës një tregues i rëndësishëm nëse shtetet besojnë se ata posedojnë të drejtën zakonore për të ndërhyrë në mënyrë të njëanshme humanitare.²³⁷ Vëmendje më e madhe i është dhënë, për shembull, ndërhyrjeve të ndërmarra në vitet 1970 nga India në Pakistanin Lindor, Vietnami në Kamboxhia dhe Tanzania në Uganda.²³⁸

Argumentohet se praktika e fundit shtetërore mbështet legalizimin e ndërhyrjes humanitare. Këto komente argumentojnë se precedentët ekzistojnë për të mbështetur një teori të tillë. Këta studiues përmendin, ndër të tjera, rastin e Kongos të vitit 1964, rasti i Indisë 1971 dhe çështja e Tanzanisë të vitit 1979. Në secilin nga këto raste, krimet masive të drejtave të njeriut po ndodhin dhe shtetet e ndërhyrjes ushtarake, për të parandaluar abuzimet të mëtejshme.²³⁹ Në vitet e luftës së ftohtë, shumica e anëtarëve të OKB- së kishin arsye të dyshonin për çdo doktrinë dhe praktikë të ndërhyrjes humanitare, ku ndërhyrjet dhe propozimet për të ndërhyrë nga njëra prej superfuqive dhe aleatëve të tyre si konsideruara si e dyshimtë. Në mesin e viteve 1960 e tutje, anëtarët e rinj post- kolonial të OKB- së nuk ishin gati të toleronin një kthim të doktrinės së ndërhyrjes humanitare, të cilat ata i shoqëruan me

²³⁶ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 131.

²³⁷ Ibid 143.

²³⁸ Adam Roberts, The United Nations and Humanitarian Intervention, 180.

²³⁹ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 142- 143.

epokën e kolonizimit. Praktika e OKB- së për ndërhyrje ushtarake nuk ishte plotësisht e qëndrueshme, shihej në përgjithësi se dënonte ato.²⁴⁰ Sidoqoftë, duke kaluar në vitet 1990, një trend dallues i kapërcyer ishte i dukshëm: shtetet filluan të ndërhyjnë për arsye humanitare dhe ata filluan ta bëjnë këtë më të qartë me mbështetjen e organizatave rajonale. Së pari, në 1992, SHBA- ja dhe Britania e Madhe dhe forcat e Koalicionit ndërhyjnë në Irak, pa autorizim të KS- së, për të mbajtur zonat e ndalim fluturimit mbi pjesën veriore dhe Irakut jugor për të mbrojtur përkatësisht popullsinë Kurde dhe Shi'ite. Së dyti, Komuniteti i Shteteve të Afrikës Perëndimore (KESHAP) u angazhua në dy ndërhyrje humanitare, një në Liberi që filloi në fillim të viteve 1990 dhe në Sierra Leone e cila drejt fundit në të njëjtën dekadë. Përsëri, në asnjërën situatë, KS -ja nuk autorizoi ndërhyrjen para përdorimit të masave të detyrueshme të KESHAP. Në fund, më i dukshëm dhe shumë i ekzaminuar ndërhyrjes humanitare është, sigurisht, një ndërhyrje e paautorizuar nga NATO në 1999 dhe rajone përreth në 1999.²⁴¹ Në vitet e luftës së ftohtë, me gjithë politikat dhe aktet e caktuara të qeverive përmbajnë elemente justifikimi për ndërhyrje humanitare. Karta e OKB- së ishte pare gjerësisht si duke luftuar kundër një ndërhyrje të tillë nga shtetet.²⁴² Para se të kalojmë në rastin e Kosovës në kapitullin II të këtij studimi, si një rast i veçantë i ndërhyrjes humanitare të NATO- s në Kosovë, cila u përcoll me deklarata mjaft të pastra të ndërhyrjes humanitare në raport me një të drejtë ligjore dhe reagime gati universale nga shtetet dhe juristët e së drejtës ndërkombëtare²⁴³. Prandaj, në përgjithësi veprimet e ndërmarra nga shtetet që nga zbatimi i kartës janë një tregues i rëndësishëm nëse shtetet besojnë se ata ende posedojnë të drejtën zakonore për të ndërhyrë në mënyrë të njëanshme për qëllime humanitare.²⁴⁴

2.6.1. Ndërhyrja e Indisë në Pakistanin Lindor 1971

Në vitin 1971, një përgjigje të një masakre në Bengali nga qeveria Pakistaneze, qeveria Indiane përdori një force ushtarake në shkallë më të gjerë në Bengali Lindor nga qeveria për të ndaluar shkeljet masive të drejtave të njeriut. Reagimet e komentuesve ndaj kësaj

²⁴⁰ Adam Roberts, *The United Nations and Humanitarian Intervention*, 79.

²⁴¹ Ibid 79.

²⁴² Adam Roberts, 'The So-Called 'Right' of Humanitarian Intervention', 16.

²⁴³ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention', 188.

²⁴⁴ Steve G. Simon, 'The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention', 143.

ndërhyrje paraqiten dy pikëpamje të ndryshme të ndërhyrjes dhe rezultatit. Klasikët argumentojnë se India dështoi të pretendonte se ndërhyrja ishte për qëllime humanitare. Disa studiues arritën në përfundime se qeveria indiane justifikoi veprimet e tyre ushtarake përmes argumenteve të ndërhyrjes humanitare. Të tjerët argumentuan, në vend se të dënonin Indinë për shkelje të nenit 2(4) në të vërtetë pranuan në mënyrë të nënkuptuar një përjashtim të nenit 2(4) në këtë shembull të veçantë të ndërhyrjes humanitare. KS- ja nuk arriti të miratojë asnjë rezolutë lidhur me këtë shkelje të drejtave të njeriut dhe humanitare.²⁴⁵ KS- ja u mbledh për të debatuar për një rezolutë që kërkon tërheqjen e menjëhershme të forcave indiane. Njëmbëdhjetë shtete, përfshirë të gjitha anëtarët e botës së tretë votuan për të. Sovjetikët me Poloninë kundërshtuan dhe kështu rezoluta dështoi. Tri ditë më vonë, AP- ja, me shumicë prej 104 dhe 1 dhe 10 abstenime, kaloi në thelb të njëjtin kontekst.²⁴⁶

Ndërhyrja në Pakistan nga dikush shihet si një rast i vijës kufitare të një ndërhyrje të ligjshme.²⁴⁷ India ndërhyri në Pakistanin Lindor për ti ndaluar abuzimet të cilat me siguri do të mund të vazhdonin pa veprimin e Indisë, prandaj u konsiderua edhe si një shembull i ndërhyrjes humanitare.²⁴⁸ Pas pushtimit të Indisë e cila mposhti shpejtë forcat pakistaneze dhe kështu mundësoi lindjen e Bangladeshit shtet të pavarur. India justifikoi veprimin e saj si vetëmbrojtje të ligjshme kundër përmbajtjes së refugjatëve të shkaktuara nga brutaliteti Pakistanez. Ajo thirri domosdoshmërinë për të ndaluar dhe gjenocidin dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.²⁴⁹

2.6.2. Tanzania dhe Uganda

Një tjetër shembull i dyshimtë së drejtës së ndërhyrjes humanitare ka ndodhur midis Tanzanisë dhe Ugandës. Në vitin 1978, trupat e presidentit Adi Amin nga Uganda pushtuan fqinjin e saj Tanzaninë, aneksuan mbi 700 milje katror të territorit të mëparshëm Tanzaninan, para se të tërhiqeshin përsëri në Ugandë brenda muajit. Pas dy muaj e gjysmë bisedimesh të

²⁴⁵ Ibid 148- 149.

²⁴⁶ Thomas M. Franck, *Interpretation and change in the law of humanitarian intervention*, HUMANITARIAN INTERVENTION (Ethical, Legal, and Political Dilemmas Edited by J. L. HOLZGREFE AND ROBERT O. KEOHANE, Cambridge University Press 2003) 217 [tani e tutje: Thomas M. Franck, *Interpretation and change in the law of humanitarian intervention*].

²⁴⁷ Steve G. Simon, 'The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention', 149.

²⁴⁸ Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention', 143.

²⁴⁹ Thomas M. Franck, *Interpretation and change in the law of humanitarian intervention*, 216.

paqartë, Tanzania ndërmori aksion ku sulmoi trupat e Amin.²⁵⁰ Qeveria e Aminit, gjatë tetë viteve tetë viteve që sundoi Ugandën, ishte qartë përgjegjës për një regjim brutal dhe shtypës që vrau 300,000 Ugandas.²⁵¹ Edhe pse Uganda (e drejtuar nga Liberia) u përpoq të protestonte para Sekretarit të Përgjithshëm të OKB- së dhe kërkoi veprim nga KS- ja, por ato protesta ishin të pasuksesshme.²⁵² As KS- ja e as Sekretari i Përgjithshëm i OKB- së nuk dënoi përdorimin e forcës nga Tanzania. Në mënyrë të ngjashme udhëheqësit e kombeve afrikane ishin në heshtje falënderues që Amin u rrëzua nga pushteti. Ende mbetet pyetja se nëse kjo ndërhyrje ishte ushtrim i ligjshëm i ndërhyrjes humanitare. Disa studiues e kanë konsideruar të paligjshëm pushtimin e Tanzanisë për shkak të metodave që ata përdorën. Megjithatë, studiues të së drejtës ndërkombëtare besojnë se përdorimi i metodave ilegale në një ndërhyrje nuk është një argument për eliminimin e së drejtës, por, më tepër një argument për krijimin e një liste të kriterëve që duhet të ndiqen që një ndërhyrje humanitare të konsiderohet e ligjshme.²⁵³

2.6.3. Iraku 1991-1992

Në vazhden e “Operacionit Stuhia e Shkretëtirës”, anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare ndërhyrja në Irak, pa autorizim të KS- së, për të ruajtur zonat e ndalim fluturimit në pjesën veriore dhe jugore të Irakut për të mbrojtur popullsinë Kurde dhe Shiite në veri. Në prill të vitit 1991, disa shtete kanë kërkuar takim për situatën në Irak si një kërcënim për paqen dhe sigurinë.²⁵⁴ KS- ja në prill të vitit 1991 miratoi rezolutën 688 ku kërkoi Iraku që të kontribuojë për largimin e kërcënimit për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare në rajon, menjëherë t'i japë fund këtij shtypjeje.²⁵⁵ Kështu, kjo rezolutë nuk u miratua nën kapitullin VII të kartë as nuk vendos zonën nën qiell të sigurt dhe as zonë ndalim fluturimi. Kërcënimi vinte nga Kina dhe Rusia për çfarëdo veprimi të KS- së për përdorim të forcës. Mungesa e autorizimit nga KS- ja nuk e ndaloi megjithatë, ndërhyrjen humanitare. Me 17 Prill 1991 u ndërmor aksioni nën udhëheqjen e SHBA-s ë, Britanisë së madhe dhe Francës, në mbështetje të jashtëzakonshme

²⁵⁰ Steve G. Simon, ‘The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention’, 149.

²⁵¹ Ibid 150.

²⁵² Thomas M. Franck, *Interpretation and change in the law of humanitarian intervention*, 219.

²⁵³ Steve G. Simon, ‘The Contemporary Legality of Unilateral Humanitarian Intervention’, 150.

²⁵⁴ Matthew C. Cooper, ‘A Note To States Defending Humanitarian Intervention’, 181- 182.

²⁵⁵ UN, S/RES/688 (1991) 2.

nga Gjermania, Italia dhe Holanda. Një pjesë e madhe e veriut u shpall zone “ndalim fluturimi”. Faza e dytë e ndërhyrjes e cila pasqyron të parën filloi në Gusht të vitit 1992. Përkundër dënimeve nga AP- ja për shkelje dhe abuzimeve të drejtave të njeriut, një gjë e tillë nuk ndodhi nga KS- ja. Zona e ndalim fluturimit zgjati në të dyja rajonet deri në vitin 2003. Arsyeja kryesore për ndërhyrje të paautorizuar ishte domosdoshmërisht humanitare. Dhe shtetet ndërhyrëse deklaruan se ishin duke vepruar nën Rez. 688.²⁵⁶

2.6.4. Liberia 1990-1997

Duke korresponduar me ndërhyrjen në Irak, shkelja mizore e të drejtave të njeriut në Afrikën Perëndimore nuk mund të injorohet. Pas viteve të përleshjeve dhe grusht- shteteve të dështuara, në fund të vitit 1989 Charles Taylor dhe trupat e tij rebele të Frontit Kombëtar Patriotik të Liberisë pushtuan përtej kufirit të Bregut të Fildishtë për të sfiduar presidentin Liberian Samuel Doe,²⁵⁷ ku situata kishte degjeneruar në masakër etnike që kërcënoi të pushtonte tërë vendin.²⁵⁸ Taylor filloi fushatën e tij në qarkun Nimba, shtëpia e grupeve etnike Gio dhe Mano, të cilët vuajtën shumë nga Doe. Ndërsa konflikti vazhdoi, mbi gjysmën e popullsisë së vendit prej 2.6 milion u zhvendos brenda vendit (për shembull popullsia në Monrovia u rrit nga 600,000 në 1991 në afërsisht një milion në kulmin e krizës) dhe jashtë (si Liberianët që u strehuan në vendet fqinje u vlerësuan në 700,000).²⁵⁹ Më 7 gusht 1990, Komiteti i Përhershëm i Ndërmjetësimit KESHAP- it krijoi një Grup Ushtarak Vëzhgues (GMKESHAP), për të ndihmuar në zgjidhjen e një konflikti të brendshëm të armatosur që kishte shpërthyer në Liberi një vit më parë.²⁶⁰

Në mënyrë të ngjashme me zonat e “ndalim fluturimit” të njëkohshëm në Irak, ndërhyrja u krye paralelisht nga OKB- ja dhe KS- ja, por ajo u drejtua nga forcat e një organizate rajonale pa marr autorizim nga KS- ja.²⁶¹ Që nga fillimi KESHAP- i ndërmori disa hapa për arritjen e

²⁵⁶ Matthew C. Cooper, ‘A Note To States Defending Humanitarian Intervention’, 182- 183.

²⁵⁷ Ibid 184.

²⁵⁸ ‘ECOWAS and the Subregional Peacekeeping in Liberia’, (The Journal of Humanitarian Assistance, SEPTEMBER 25, 1995) <<https://sites.tufts.edu/jha/archives/66>> qasur: 11 Maj 2019.

²⁵⁹ Ibid.

²⁶⁰ Ibid.

²⁶¹ Matthew C. Cooper, ‘A Note To States Defending Humanitarian Intervention’, 184.

marrëveshje paqësore. Përsëri ndërhyrja në Liberi ishte domosdoshmëri humanitare, përkatësisht për të mbrojtur jetën e qytetarëve dhe adresimin për kërcënim të paqes dhe sigurisë. Sidoqoftë, KESHAP vendosi në mënyrë të qartë përdorimin e forcës pa autorizim të KS- së.²⁶² Ndërhyrja në Liberi u ngrit qartë në nivelin e një veprimi përmbarues, dhe KESHAP-it i mungonte çdo lloj autorizimi nga OKB- ja, kur ndërhyri në Liberi, duke e bërë ndërhyrjen e tij teknikisht të paligjshme sipas Neneve 53 (1) dhe 2 (4) të Kartës. Sidoqoftë, Presidenti i KS "lavdëroi përpjekjet e bëra nga kreu i shtetit dhe qeverisë (KESHAP) për të promovuar paqen dhe normalitetin në Liberi" në janar 1991.²⁶³ KS- ja në Nëntor të vitit 1992 miratoi Rez. 788 ku i dha një mbështetje KESHAP- it për ndërhyrjen në Liberi, duke e konsideroi situatën si kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare veçanërisht në Afrikën Perëndimor dhe miratoi veprimin e KESHAP- it në Liberi.²⁶⁴ KS- ja miratoi një rezoluta tjetër në Mars 1993, Rez. 813 ku përsëri lavdëroi përpjekjet e KESHAP- it për përpjekjet për vendosje të paqes dhe sigurisë në Libi. Gjithashtu, fton për asistencë humanitare nga shtetet dhe organizatave ndërkombëtare për viktimat e konfliktit në Liberi.²⁶⁵ Sipas Peter Jenkins kjo rezolutë përfshinë kontributin e OKB- së në Liberi përmes vëzhguesve dhe përfshirjen e pare të gjuhës humanitare. Përgjigja e OKB- së ndaj ndërhyrjes në KESHAP qëndrojnë në lëvdatat fillestare për KESHAP me gjithë natyrën e paligjshme të verimit.²⁶⁶ Veprimet e KESHAP- it në Liberi janë të rëndësishme për diskutimin juridik të ndërhyrjes rajonale humanitare. Jo vetëm që përdorimi i forcës në Liberi ishte i pari i këtij lloji nga "bashkësia ekonomike" nën- rajonale, por mungesa e autorizimit fillestar të OKB- së dhe përgjigjet pasues të saj, sigurojnë një precedent domethënës për ndërhyrjet e ardhshme nga organizatat rajonale të motivuara nga humanizmi.²⁶⁷ Cooper, konsideron se veprimet e KESHAP- it në Liberi janë provë jo vetëm të një norme zakonore të ndërhyrjes së pavarur humanitare, por zbulon besimin e organizatës që karta nuk e ndalon një veprim të tillë.²⁶⁸

²⁶² Ibid 186.

²⁶³ Peter A. Jenkins, 'The Economic Community of West African States and the Regional Use of Force, (2007) (35)2, DENV. J. INT'L L. & POL'Y, 344 [tani e tutje: Peter A. Jenkins, 'The Economic Community of West African States and the Regional Use of Force'].

²⁶⁴ UN, S/Res/788 (1992).

²⁶⁵ UN, S/Res/813 (1993).

²⁶⁶ Peter A. Jenkins, 'The Economic Community of West African States and the Regional Use of Force', 346.

²⁶⁷ Ibid 342.

²⁶⁸ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention', 186.

2.6.5. Sierra Leone

Jo vetëm që konflikti në Sierra Leone ishte i ngjashëm me Liberinë, por ishte edhe një lidhje e drejtpërdrejte, pasi Charles Talbor, i dërgoi forcat ushtarake rreth kufirit të Liberisë në Mars të vitit 1991 në shenjë hakmarrje për sigurimin e Sierra Leones. Brenda 18 muajve, së paku, 400.000 civilë janë zhvendosur dhe në prill u rrëzua qeveria.²⁶⁹ Duke parë këto, KESHAP përsëri ndërmoi veprime. Dhe pas një grusht-shtetit të majit 1997, organizata lëshoi një komunikatë, duke kërkuar: që asnjë shtet të mos e njeh regjimin e instaluar nga grusht-shteti i 25 Majit 1997 dhe që të bëhet çdo përpjekje për rivendosjen e qeverisë legjitime. Edhe pas kësaj në fund të vitit 1997, rebelët nuk u çarmatosen dhe mjetet diplomatike nuk kishin sukses, në fillim vit 1998, KESHAP u përfshi në një kampanjë të bombardimeve dhe forcave tokësore.²⁷⁰ Në Sierra Leone ndërhyrja e KESHAP- it në vitin 1997, përsëriti përvojën Liberiane. Dhe pasi filloi operacioni i KESHAP, KS- ja miratoi një rezolutë e cila mirëpret përpjekjet për ndërmjetësim, por nuk miratoi posaçërisht përdorimin e saj të forcës.²⁷¹ Më pas, rezoluta e KS- së 1132 duke vepruar nën kapitullin VII-të Kartës së OKB- së. KS-ja “shpreh mbështetjen e saj të fortë për përpjekjet e Komitetit KESHAP për të zgjidhur krizën në Sierra Leone”,²⁷² por e cila nuk e autorizoi shprehimisht ndërhyrjen e armatosur të KESHAP.²⁷³ Duke vepruar gjithashtu nën Kapitullin VIII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, autorizon KESHAP duke bashkëpunuar me qeverinë e zgjedhur demokratike të Sierra Leone.²⁷⁴ KS- ja vlerësoi rolin e rëndësishëm që KESHAP kishte vazhduar të luante në zgjidhjen e krizës. Ai inkurajoi grupin vëzhgues ushtarak KESHAP në përpjekje për të nxitur paqen dhe stabilitetin në Sierra Leone, në përputhje me Kartën e OKB- së.²⁷⁵

Më vonë, në Korrik të vitit 1998 KS- ja miratoi një rezolutë tjetër ku falënderoi rolin pozitiv të KESHAP dhe GMKESHAP në përpjekjet e tyre për të rivendosur paqen, sigurinë dhe stabilitetin në të gjithë vendin me kërkesë të Qeverisë së Sierra Leone,²⁷⁶ ku njëherit dhe

²⁶⁹ Ibid.

²⁷⁰ Ibid 187.

²⁷¹ Thomas M. Franck, Interpretation and change in the law of humanitarian intervention, 222.

²⁷² UN, S/RES/1123 (1997) 3.

²⁷³ Thomas M. Franck, Interpretation and change in the law of humanitarian intervention, 222.

²⁷⁴ UN, S/RES/1132 (1997) 8.

²⁷⁵ UN, Press Release, SC/6481, (26 February 1998).

²⁷⁶ UN, S/RES/1181 (1998) 5.

vendosi të krijojë UNSAMIL për një periudhë gjashtë mujore, si mision vëzhgues.²⁷⁷ Autorizimi formal i KS- së për veprimet e GMKESHAP²⁷⁸ erdhi me rezolutën tjetër 1270 e miratuar në Tetor të vitit 1999 që përsëri vlerësoi rolin e GMKESHAP për rolin që vazhdon të luajë në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit dhe mbrojtjen e popullsisë në Sierra Leone dhe miratoi mandatin e ri të GMKESHAP, ku dhe vendosi të krijojë misionin e OKB-së në Sierra Leone (MOKBSL) të veprojë nën Kapitullin e VII-të të Kartës.²⁷⁹

Peter Jenkins përmend se arsyetimet kryesore të paraqitura nga KESHAP dhe qeveria nigeriane që përdorën forcën ishin arsyet për vetëmbrojtje.²⁸⁰ Sipas tij, OKB- ja me Rezolutën 1132 dërgoi mesazh kontradiktor në reagimin e saj ndaj ndërhyrjes, e cila dënoi shkeljet e të drejtave të njeriut në Sierra Leone dhe shpalli konfliktin si kërcënim për paqen. Me embargon e vendosur nga Rezoluta, KESHAP ishte i kufizuar për “zbatim të rreptë”, pasi mungonin detyrimet nga kjo Rezolutë. Por, ngjashëm si në Nigeri, Jenkins thotë se KS- ja miratoi përdorimin në dukje të paligjshme të forcës nga ECOWAS përkundër mandatit delikat me Rezolutën 1132.²⁸¹ Megjithatë, disa argumentuan si në Liberi edhe në Sierra Leone, KESHAP e justifikon ndërhyrjen si ndërhyrje të domosdoshme humanitare. Në rastin e njëjtë si në Liberi, KESHAP e justifikoi ndërhyrjen si ndërhyrje humanitare.²⁸² Nga ajo që u tha më sipër duket se, KS i ka dhënë aprovim prapaveprues për KESHAP- in për ndërhyrjet në Liberi dhe Sierra Leone.²⁸³

Këto ngjarje në Liberi dhe Sierra Leone për Thomas Frank mund të interpretohen si mbështetëse në dy propozime. *Së pari*, një iniciativë rajonale e ndërmarrë pa autorizim të mëparshëm mund të tolerohet kur emergjenca është e dukshme, nuk ka perspektivë të një operacioni ushtarak të udhëhequr nga OKB-ja dhe organizatë rajonale duket se veprojnë me motive të pastërta dhe jo vetëm për të përparuar ambiciet kombëtare. *Së dyti*, një ndërhyrje humanitare, edhe nëse nuk është autorizuar nga KS-ja në përputhje të plotë me kushtet e Kartës, më vonë mund të vlerësohet në mënyrë retroaktive nga KS-ja.²⁸⁴ Që nga vitet 1990,

²⁷⁷ Ibid para. 6.

²⁷⁸ Thomas M. Franck, Interpretation and change in the law of humanitarian intervention, 222.

²⁷⁹ UN, S/Res/1270/ (1999).

²⁸⁰ Peter A. Jenkins, ‘The Economic Community of West African States and the Regional Use of Force’, 347.

²⁸¹ Ibid 348.

²⁸² Matthew C. Cooper, ‘A Note To States Defending Humanitarian Intervention’, 186- 187.

²⁸³ Simon Chesterman, ‘Legality Versus Legitimacy: Humanitarian Intervention’, 300.

²⁸⁴ Thomas M. Franck, Interpretation and change in the law of humanitarian intervention, 223.

në bashkëpunim me zhvillimet e praktikës në këtë fushë, ka pasur avokim të një të drejte të përgjithshme të ndërhyrjes humanitare, qoftë si e drejtë ekzistuese, apo e drejtë në proces të krijimit. Çështje për të pohuar për një të drejtë për ndërhyrje humanitare në moralin politik dhe të drejtën ndërkombëtare ka filluar shumë para viteve të 90-ta.²⁸⁵ Adam Roberts argumenton se praktika aktuale e shteteve që nga viti 1945, dhe arsyetimet që kanë dhënë për veprimet e tyre ushtarake, sugjerojnë që koncepti i ndërhyrjes humanitare ka tërheqje dhe dobi të konsiderueshme. Edhe qeveritë që kanë kundërshtuar një doktrinë të përgjithshme të ndërhyrjes humanitare në veçanti kanë njohur në mënyrë implicite forcën e çështjes për të.²⁸⁶ Ndërsa, James Pettions argumenton se është e dyshimtë nëse një e drejtë e ndërhyrjes humanitare mund të interpretohet se ekziston vetëm në bazë të këtyre ndërhyrjeve të pakta. Dhe problemi sipas tij është se ka pasur raste të pakta të ndërhyrjeve humanitare të paautorizuara për të konsideruar se plotësojnë kërkesat e një *opinio juris*. Kështu në rastin më të mirë një ligj i tillë në proces të shfaqjes nuk është vërtetuar ende. Prandaj, sipas tij pozitivistët ligjorë kanë të drejtë në këtë pikë se sipas të drejtës ndërkombëtare aktuale, ndërhyrje të ligjshme janë vetëm ato ndërhyrje që bëhen me autorizim të KS-së.²⁸⁷

Nga ajo që u pa më sipër në rastet e ndërhyrjeve nga shtetet dhe organizatat regjionale është e vështirë të pohohet se këta ndërhyrje në vetëvete çuan në një normë zakonore të ndërhyrjes humanitare, për shkak të pretendimeve të shteteve në disa raste duke pretenduar vetëmbrojtjen si një justifikim ligjor. Sidoqoftë, me të drejtë ashtu siç beson edhe Adam Roberts, ato përfaqësojnë një zhvillim të njohjes së ndërhyrjes humanitare e cila mund të meritojë një vend të caktuar në të drejtën ndërkombëtare. Pra, më e rëndësishmja është se shtetet kërkojnë të justifikojnë veprimet e tyre për arsye të ndërhyrjes humanitare në mënyrë të ngjashme me një *opinio juris*, edhe pse nuk e bëjnë këtë gjë në mënyrë të qartë duke pretenduar “ligjshmëri” përmes ndërhyrjes humanitare.²⁸⁸

²⁸⁵ Adam Roberts, ‘The So-Called ‘Right’ of Humanitarian Intervention’, 19.

²⁸⁶ Ibid 22.

²⁸⁷ James Pattison, *Humanitarian Intervention & The Responsibility to Protect, Who Should Intervine?*, 50.

²⁸⁸ Adam Roberts, ‘The united Nations and Humanitarian Intervention’, 180.

2.7. Ndërhyrja humanitare dhe Këshilli i Sigurimit

Funksionimi i KS-së shpejt u paralizua nga Lufta e Ftohtë por, autorizimi i KS-së filloi ngadalë. Para përfundimit të Luftës së Ftohtë, të vetmet raste veprimi ishin: Lufta Koreane dhe Blokada e Rodezisë së Jugut. Një dekadë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë pati një shpërthim për këto veprime. Që nga viti 1990, Këshilli ka autorizuar në mënyrë shumë të qartë një ose më shumë shtete, organizata rajonale, ose 'koalicione vullnetare'.²⁸⁹ Në mbarë botën udhëheqësit politik, aktivistët dhe studiuesit u përpoqën të parashikojnë se si mund të ndryshojë roli i KS-së nga bllokimi i luftës së ftohtë.²⁹⁰ Edhe pse konflikti ndër-shtetëror duket se do të zvogëlohej me përfundimin e Luftës së Ftohtë, bota filloi të provojë një ringjallje të konflikteve të brendshme, të ilustruara me konfliktet në Bosnjë dhe Ruandë. Gjatë vitit 1994 gjatë gjenocidit në Ruandë bota mbeti pasive ndërsa, një milion njerëz u masakruan. Në Bosnjë, komuniteti ndërkombëtar, i cili veproi përfundimisht me veprim të KS-së, për t'i dhënë fund konfliktit, por shumica e kritikëve menduan se u bë shumë pak dhe shumë vonë.²⁹¹ Megjithatë, operacionet paqeruajtëse në Somali, Haiti, Ruandë dhe Bosnje u pasuan nga operacionet e veprimit kur ata dëshmuar paaftësinë për të zbatuar mandatin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, operacionet e zbatimit u pasuan nga vendosja e paqeruajtësve në Somali, Haiti dhe Timorin Lindor për më tepër, KS i ka dhënë një aprovim prapaveprues për KESHAP, GMKESHAP në Liberi (1990–92) dhe Sierra Leone (1997–98), dhe në operacionet nga Misioni Ndër-Afrikën për të monitoruar zbatimin e marrëveshjeve mes Bangui dhe Francës në Republikën e Afrikës Qendrore (1997–98), si dhe autorizimin e diskutueshëm për zonën në Irak (1991) dhe kërcënimet dhe sulmet ajrore të NATO-s në lidhje me operacionet në Kosovë (1998–99). Shumica e këtyre operacioneve, sipas Simon Chesterman mund të karakterizohen si "të karakterit humanitar". Sipas Chesterman, një ironi e sigurisë kolektive në vitet 1990 është se pikërisht kur u duk se fundi i Luftës së Ftohtë do të lejonte një KS më të unifikuar, por në realitet aty ku KS nuk kishte vullnet për të vepruar mbeti i heshtur. Një nga ilustrimet e mundshme të kësaj pike është rasti i Sudanit.²⁹² Chesterman mendon se ekziston një rrezik i vërtetë që Kombet e Bashkuara do të përdorin vetëm kur është e nevojshme dhe gjeo-

²⁸⁹ Simon Chesterman, 'Legality Versus Legitimacy: Humanitarian Intervention', 299.

²⁹⁰ Rosa Brooks, 'Humanitarian Intervention: Evolving Norms, Fragmenting Consensus', (2014) (29)161, Maryland Journal of International Law 162 [tani e tutje: Rosa Brooks, 'Humanitarian Intervention'].

²⁹¹ Ibid 163.

²⁹² Simon Chesterman, 'Legality Versus Legitimacy: Humanitarian Intervention', 300- 301.

politikisht i përshtatshëm ose i dobishëm për ta bërë këtë gjë. Mirëpo, ai beson se pavarësisht se janë shprehur rezerva në lidhje me natyrën e autorizimit të OKB-së për të përdorur forcën, dekada e viteve 1990 ishte e jashtëzakonshme për faktin se mbështetja duhej të ishte në institucionet ndërkombëtare.²⁹³

Meqenëse KS-ja ka autorizuar në mënyrë të qartë ndërhyrjet, mund të duket se pranon që ndërhyrja humanitare është, ose së paku, paraqet një domosdoshmëri rasti. Sidoqoftë, edhe në rastet kur aprovoi ndërhyrjet kryesisht në baza humanitare, KS përdori argumentimin duke theksuar veçantinë e situatës së adresuar. Kështu, miratimi i KS për raste të veçanta të ndërhyrjes humanitare ka ndaluar miratimin e përgjithshëm të doktrinës.²⁹⁴ Kritikë të shumtë të ndërhyrjes humanitare pranojnë se, nën Kapitullin e VII-të të Kartës së OKB-së Këshilli ka të drejtë të ndërmarë një spektër të gjerë veprimesh ushtarake në rastet kur ekziston një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ata argumentojnë se ekziston shumë pak në Kartë ose traktate tjera, të cilat mund të interpretohen si mbështetje për ndërhyrje humanitare pa autorizim të KS-së.²⁹⁵ Në rast se KS-ja nuk është në gjendje të veprojë, çështja adresohet nga AP-ja. Në veçanti, për krizat afatgjata, mund të duket se ekziston një logjikë e caktuar në ndjekjen e kësaj procedure. Sidoqoftë, anëtarët e përhershëm të KS-së nuk tregojnë asnjë shenjë se dëshirojnë të shohin fuqitë e tyre në çështjet e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare të transferuara në AP dhe ka të ngjarë që kundërshtojnë përpjekjet në këtë drejtim. Sipas Adam Roberts ka dy vështirësi serioze në këtë procedurë, edhe atë: e para, përvetësimi i shumicës së dy të tretave ka të ngjarë të jetë i ngadaltë dhe i rëndë dhe një proces i tillë kërkon kohë dhe është një luks në një emergjencë ekstreme dhe, e dyta, AP-ja ka vetëm fuqi të bëjë rekomandime, e jo vendime për përdorimin e forcës.²⁹⁶

Megjithëse dëshira e autorizimit nga KS-ja për çdo ndërhyrje humanitare është pranuar gjerësisht, shumë autorë që do të sfidonin një të drejtë për ndërhyrje humanitare, kanë vështirësi në lidhje me analizën e autorizimit absolut thelbësor. Një përfundim i tillë do të nënkuptonte që të pranosh se Rusia dhe Kina kanë një veto absolute ndaj ndërhyrjes, me efekt që çdo qeveri mund të llogarisë në mbështetjen e tyre në OKB dhe mund të angazhohet

²⁹³ Ibid 303- 304.

²⁹⁴ Adam Roberts, 'The So-Called 'Right' of Humanitarian Intervention', 29.

²⁹⁵ Ibid 29.

²⁹⁶ Ibid 38- 40.

në vrasje masive me një shkallë të pa ndëshkueshmërisë. Andaj, nuk është për tu habitur roli i organizatave rajonale në lidhje me çështjet e ndërhyrjes humanitare.²⁹⁷

2.8. Asambleja e Përgjithshme dhe Rezoluta “të bashkuar për paqe” (1950)

Komuniteti ndërkombëtar adresoi kolektivisht mundësinë e shpeshtë të mosveprimit nga ana e KS-së qysh në vitin 1950, përballë mosveprimit të KS-së në përgjigje të vetos Ruse gjatë Luftës Koreane.²⁹⁸ AP-ja miratoi Rezolutën 377 (V), e cila u emërua si Rezoluta: të Bashkuar për Paqe,²⁹⁹ e miratuar me iniciativën e shteteve perëndimore.³⁰⁰ Në Rezolutë, AP-ja thuhet se në rast kur KS-ja, për shkak të mungesës së unanimitetit të anëtarëve të përhershëm, nuk arrin të ushtrojë përgjegjësinë e tij parësore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare në çdo rast kur duket se ekziston një kërcënim për paqen, prishjen e paqes, ose akti i agresionit, AP-ja do të marrë në konsideratë çështjen menjëherë me qëllim që të bëjë rekomandime të duhura anëtarëve për masa kolektive, duke përfshirë në rast të shkeljes së paqes ose aktit të agresionit përdorimin e forcës së armatosur kur është e nevojshme, për të ruajtur ose rivendosur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare”.³⁰¹ Në zbatimin e Rezolutës, AP-

²⁹⁷ Ibid.

²⁹⁸ Matthew C. Cooper, ‘A Note To States Defending Humanitarian Intervention’, 178.

²⁹⁹ UN, General Assembly Res. 377 (A) (1950).

³⁰⁰ Simon Chesterman, ‘Legality Versus Legitimacy: Humanitarian Intervention’, 195. Miratimi i kësaj rezolute erdhi si përgjigje ndaj strategjisë së Unionit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) për të bllokuar çdo vendosmëri nga KS-ja për masat që duhet ndërmarr me qëllim të mbrojtjes së Republikës Koreane kundër agresionit ndaj tyre nga Koreja e Veriut. Në fazën fillestare të këtij konflikti të armatosur, në qershor 1950, KS-ja ka qenë në gjendje të rekomandojë anëtarët e OKB- së që “të japin ndihmë Republikës Koreane për të ndaluar sulmin e armatosur dhe rivendosur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare në zone Rez. 83 (1950) e 27 Qershor 1950). Rezoluta mundi të kalojë pasi BRSS, në atë kohë bojkotoi mbledhjet e Këshillit të Sigurimit. Ata besonin se me mungesën e tyre në mbledhjet e KS- së ajo nuk do të jetë në gjendje të kryej funksionin e tij duke u bazuar në nenin 27 par. 3 të kartën e OKB- së. Sidoqoftë, shumica e anëtarëve të KS- së ishin të mendimit se mungesa e tyre në sallën e mbledhjeve nuk mund ta pengojë Këshillin në marrjen e vendimeve, e miratuar më pas dhe nga GJND- ja, shih: Legal Consequences for States of the Continued Presence of South Africa in Namibia (South West Africa) notwithstanding Security Council Resolution 276 (1970), Advisory Opinion, I.C.J. Reports 1971, p. 16, shih gjithashtu: Christian Tomuschat, ‘Uniting for Peace General Assembly resolution 377 (V)’, (Introductory Note, Audio Visual Library of International Law, 2008) <<https://legal.un.org/avl/ha/ufp/ufp.html>> qasur: 20 qershor 2019. Duke pasur parasysh se protestat e saj mbetën të pafrytshme, BRSS- ja dërgoi përsëri, pasi që në Gusht 1950, një delegacion në mbledhjet e KS votoi kundër një rezolute të sponsorizuar nga SHBA- ja. Për të kapërcyer këtë ngërç, SHBA- ja, nën udhëheqjen e Sekretarit të saj të Jashtëm Dean Acheson, arritën të bindin AP- në që ajo duhet të pretendojë për përgjegjësi në lidhje me ndihmën e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Rezultati i këtyre projekteve ishte rez. 377 A (V), Christian Tomuschat, ‘Uniting for Peace General Assembly resolution 377 (V)’, (Introductory Note, Audio Visual Library of International Law, 2008), : <<https://legal.un.org/avl/ha/ufp/ufp.html>> qasur: 20 qershor 2019.

³⁰¹ UN, General Assembly Res. 377 (A) 1950, 1.

ja parasheh mbajtjen e mbledhjeve në seanca speciale urgjente brenda njëzet e katër orëve nga kërkesa e saj. Seanca e tillë e jashtëzakonshme emergjente thirret nëse kërkohet nga KS-ja me votën e ndonjë shteti anëtarë ose nga një shumicë e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara.³⁰² Por për disa autorë si Christian Tomuschat ashtu siç tregon qartë edhe gjuha e Rezolutës, AP-ja nuk mund të jetë kurrë një zëvendësim i plotë i KS-së në këtë fushë. Në përputhje me rrethanat, përmenden vetëm "rekomandime", d.m.th., deklarata pa ndonjë efekt juridik detyrues.³⁰³ Megjithatë Rezoluta u pa edhe si një fillim i ndërhyrjes së pavarur humanitare në epokën moderne.³⁰⁴ Në përgjithësi, zbatimi i mëpasshëm i Rezolutës dhe përgjigja e bashkësisë ndërkombëtare ilustron një mbështetje të gjerë shtetërore për pozicionin që KS-ja nuk është përgjegjëse i vetëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, por as nuk mban një monopol mbi përdorimin e forcës. Më e rëndësishmja për Cooper se rezoluta pohon se shtetet do të justifikohen, në rrethana të kufizuara, duke vepruar pa autorizim të KS-së. Me pak fjalë, kjo Rezolutë ofron një alternativë për KS-në kur kërcënohet paqja dhe siguria dhe shpall se autorizimi nuk është gjithmonë i nevojshëm që shtetet të justifikohen në përdorimin e forcës³⁰⁵, ndërsa nga ana tjetër, nevoja për mbajtjen e seancave të tilla është ulur ndjeshëm.³⁰⁶

Natyrisht se elementi thelbësor i Rezolutës 377 A (V) ishte pohimi se AP, nëse e vlerëson të përshtatshme, mund të rekomandojë veprime kolektive, përfshirë përdorimin e forcës. Tomuschat vë në pah se në sensin thelbësor, Rezoluta është zbatuar vetëm një herë në krizën Koreane në vitin 1951 me Rezolutën 498 (V) të 1 shkurtit 1951. Rezoluta nuk i referohet në mënyrë të qartë Rezolutës "Të Bashkuar për Paqe", por thekson se KS-ja, 'për shkak të mungesës së unanimitetit të anëtarëve të përhershëm, nuk ka arritur të ushtrojë përgjegjësinë e tij kryesore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare'.³⁰⁷ Kjo Rezolutë ka potencialin që të shkatërrojë fuqinë e ekuilibruar mirë brenda OKB-së. Por, në të vërtetë do të përdoret kundër KS-së vetëm në rastet e pakënaqësisë politike të anëtarëve të përhershëm. Pavarësisht nga epërsia e tyre e madhe, anëtarët e OKB-së janë të dobët në

³⁰² Ibid.

³⁰³ Christian Tomuschat, 'Uniting for Peace General Assembly resolution 377 (V)', (Introductory Note, Audio Visual Library of International Law, 2008) <<https://legal.un.org/avl/ha/ufp/ufp.html>> qasur: 20 qershor 2019 [tani e tutje: Christian Tomuschat, 'Uniting for Peace General Assembly resolution 377 (V)'].

³⁰⁴ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention', 178.

³⁰⁵ Ibid 179.

³⁰⁶ Christian Tomuschat, 'Uniting for Peace General Assembly resolution 377 (V).

³⁰⁷ Ibid.

përpjekjet për të kundërshtuar vendimet e marra nga KS-ja. Për aplikimin e kësaj Rezolute me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të paktën do të kishte nevojë për mbështetje nga një prej anëtarëve të përhershëm të KS-së.³⁰⁸

³⁰⁸ Ibid.

PJESA E DYTË

KAPITULLI III

3. LIGJSHMËRIA DHE LEGJITIMITETI I NDËRHJRJES SË NATO-s NË KOSOVË

3.1. Konteksti historik dhe fillimi i krizës humanitare në Kosovë

Qëllimi i këtij kapitulli nuk është trajtimi në kontekstin historik të pozitës së Kosovës në të kaluarën. Mirëpo, disa momente historike para ndërhyrjes së NATO-s vlerësohen të rëndësishme që të përmenden. Origjina e konfliktit etnik shpesh pretendohet se daton para qindra viteve. Megjithatë, është e vërtetë se tregimet dhe mitet përreth Kosovës janë mbajtur gjallë me shekuj në legjenda dhe balada,³⁰⁹ që nga Beteja për Kosovën, të zhvilluar në Fushë Kosovë me 28 qershor 1389. Një ushtri e madhe koalicioni e udhëhequr nga fisnikët serbë, hungarezë, bullgarë, boshnjakë dhe shqiptarë u mbledhën në rrafshin e gjerë të Kosovës për t'u përballur me ushtrinë osmane. Ndërsa beteja mbaroi, ajo që mbeti është se ushtria turke që mbajti terrenin ndërsa trupat e mbijetuara serbe (Llazari dhe Brankoviç) dhe boshnjakët (Vlatko Vukoviç) u tërhoqën. Sidoqoftë, edhe turqit u tërhoqën gjithashtu, sepse Sulltan Bajeziti duhej të nxitonte përsëri në lindje për të siguruar pozicionin e tij si sulltani i ri kundër vëllezërve të tij; po ashtu, ai nuk kishte trupa të mjaftueshme për të kryer një sulm kundër të krishterëve në Ballkan.³¹⁰ Vitet pas Betejës së Kosovës u shënuan me një rritje të veprimtarisë ushtarake osmane; territore të caktuara u aneksuan drejtpërdrejtë dhe sundimi iu imponua princërve dhe fiseve të ndryshme deri atëherë të pavarura.³¹¹ Vetëm në fund të shek. të XIX-të u ringjall si pjesë e rrëfimeve të lëvizjeve rivale serbe dhe shqiptare.³¹² Principatat serbe dhe malazeze përfituan nga lufta Ruso-Osmane e v. 1877-8 për të pushtuar Kosovën, duke sjellë kështu serbët dhe malazezët në konfliktin e parë të tyre serioz me shqiptarët. Pas humbjes së Portës në Mars të v. 1878, Rusia i imponoi administratës Osmane Traktatin e ashpër të Shën Stefanit. Sipas kushteve të Marrëveshjes së Paqes të nënshkruar nga Rusia

³⁰⁹ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report *Conflict *International Response *Lessons Learned*, (2000) Oxford University Press, 33 [tani e tutje: The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*].

³¹⁰ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, (Columbia University Press New York, 1998) 12- 13 [tani e tutje: Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*].

³¹¹ Ibid 16.

³¹² The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 33.

dhe Porta në Shën Stefan më 3 mars të vitit 1878, pjesa më e madhe e territorit të çliruar duhej të caktohej në një Bullgari të zgjeruar. Serbia e cila tani fitoi pavarësinë e saj të plotë nga Porta e kishte kufirin e saj të shtrirë për të përfshirë Mitrovicën dhe një pjesë të madhe të Sanxhakut të Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër e Kosovës mbeti nën kontrollin Osman. Mali i Zi i mori rajonet kryesisht me popullsi shqiptare si: Pejën, Ulqinin, Hotin, Plavën, Gucinë dhe Podgoricën. Të indinjuar nga caktimi i territorit të banuar nga shqiptarët ndaj shteteve sllave në Shën Stefan, shqiptarët formuan me shpejtësi komitetet lokale të mbrojtjes së vilajeteve të Kosovës, Shkodrës dhe Manastirit.³¹³ Si përgjigje, aktivistët nacionalistë shqiptarë vendosën të thërrasin një mbledhje urgjente të përgjithshme të të gjithë liderëve shqiptarë. Dhe kështu, më 10 qershor të vitit 1878, në Prizren mbërritën mbi 300 delegatë kryesisht nga Kosova dhe Maqedonia Perëndimore, por duke përfshirë një pjesë të vogël të përfaqësuesve nga Shqipëria e Jugut. Për shqiptarët, qëllimi kryesor i Lidhjes së Prizrenit ishte të organizonte kundërshtimet politike dhe ushtarake për shpërndarjen e territorit të banuar nga shqiptarët dhe të bënte kërkesë ndaj Sulltanit që të bashkonte katër vilajetet e Janinës, të Manastirit, të Shkodrës dhe të Kosovës në një njësi politike dhe administrative. Megjithatë ajo që konsiderohej si territor shqiptar në atë kohë nuk ishte i lehtë për t'u përcaktuar, kështu që Lidhja e Prizrenit mbeti e unifikuar për çështjen e mbrojtjes së integritetit territorial të shqiptarëve.³¹⁴

Megjithatë, pushtimi serb i Kosovës në vitin 1912, paraqet një kthesë vendimtare në raportet mes serbëve dhe shqiptarëve, pasi për më shumë se pesë shekuj Kosova ishte nën sundimin Osman.³¹⁵ Shteti i ri Jugosllav i shpallur më 1 dhjetor të vitit 1918 zyrtarisht u quajt "Mbretëria e Serbëve, e Kroatëve dhe e Sllovenëve" dhe u formua nga Mbretëria Serbe, Mbretëria e Malit të Zi dhe nga disa pjesë të Austro-Hungarisë, duke përfshirë edhe Slloveninë dhe territoret Kroate.³¹⁶ Sa për Kosovën, ajo u përfshi vetëvetiu në këtë proces, sepse konsiderohej si një pjesë integrale e Mbretërisë Serbe. Të gjithë komentuesit e asaj kohe, si dhe të gjithë historianët e mëvonshëm, si duket e kanë pranuar këtë ide si një fakt të qartë dhe legjitim. Noel Malcolm konsideron se e vërteta megjithatë, sa u përket fakteve legjitime

³¹³ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, 42- 43.

³¹⁴ Ibid 44.

³¹⁵ Oliver Jens Schmitt, *Kosova Histori e Shkurtër e një Treve Qendrore Ballkanike*, (Botuar në shqip: KOHA 2012) 134.

³¹⁶ Noel Malcolm, *Kosova Një Histori e Shkurtër*, (botuar në shqip: KOHA 2011) 342 [tani e tutje: Noel Malcolm, *Kosova Një Histori e Shkurtër*].

është ndryshe. Kosova ligjërisht kurrë s'ka qenë e bashkuar me shtetin serb. Kur Kosova u pushtua në vitet 1912-1913 në Serbi, ishte në fuqi ende Kushtetuta e vitit 1903. Ai konsideron se aneksimi i Kosovës dhe ligjshmëria e inkorporimit të saj nuk është bërë në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe juridikisht njohja e Kosovës ishte bërë jo si pjesë e Serbisë, por si pjesë e Jugosllavisë, ku për pasojë shqiptarët e Kosovës nuk u bënë qytetarë serbë, por, më në fund u bënë qytetarë të Jugosllavisë³¹⁷

Konflikti në Kosovë gjithashtu duhet të kuptohet në kontekstin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Kosova ishte një nga tetë njësitë përbërëse të Jugosllavisë. Kishte gjashtë Republika (Serbia, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina) dhe dy krahina autonome në Serbi (Vojvodina dhe Kosova).³¹⁸ Struktura thelbësore e shtetit federativ, si një federatë prej gjashtë republikash dhe dy krahinash, ishte miratuar nga udhëheqja komuniste që në fillim të vitit 1943; ndonëse pozita e Kosovës në atë strukturë mbeti e paqartë edhe për një kohë të gjatë.³¹⁹ Në bazë të këtij vendimi, Kryesia e "Kuvendit Popullor" të Serbisë më 3 shtator të vitit 1945 miratoi Ligjin për formimin e "Rajonit autonomi të Kosovës dhe "Metohisë" që u shpall si pjesë përbërëse e Serbisë.³²⁰ Megjithatë Kushtetuta e re Jugosllave u shpall në vitin 1963, e cila nuk i ndryshoi themelet ose statusin e autonomisë së Kosovës ose Vojvodinës, por ajo u kritikua gjerësisht për të mos qenë aq e qartë për garancitë e autonomisë, siç kishte qenë Kushtetuta paraprake e vitit 1946. Kjo kushtetutë prezantoi termin "kombësi" për të zëvendësuar termin "pakicë kombëtare" e përdorur më parë.³²¹ Më 1969 Kosova miratoi ligjin e saj kushtetues³²², ndërsa me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974³²³ për herë të parë, republikat dhe krahinat autonome të Kosovës

³¹⁷ Ibid 342- 344.

³¹⁸ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 34.

³¹⁹ Noel Malcolm, *KOSOVA Një Histori e Shkurtër*, 398.

³²⁰ Ibid 399. Me kushtetutën e Jugosllavisë u themelua Republika Popullore Federale e Jugosllavisë përbëhet nga: Republika Popullore e Serbisë, Republika Popullore e Kroacisë, Republika Popullore e Sllovenisë, Republika Popullore e Bosnje-Hercegovinës, Republika Popullore e Maqedonisë dhe Republika Popullore e Malit të Zi. Republika Popullore e Serbisë përbëhet nga njësitë Autonome e Vojvodina dhe Kosova; shih: 'Constitution of the Federative People's Republic of Yugoslavia', January 31, 1946, (Neni 2).

³²¹ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, 160.

³²² 'Ligji kushtetues të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës' ("Fleta zyrtare e KSAK Nr. 6 më 25 Shkurt 1969).

³²³ 'Constitution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia' (1974), (Official Gazette of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia, no. 9/1974 (1974).

dhe Vojvodinës i kishin kushtetutat e tyre³²⁴, kështu që Kosova e miratoi Kushtetutën e vetë si Krahinë Socialiste Autonome në të njëjtin vit.³²⁵ Kushtetuta e vitit 1974 ngushtoi ndjeshëm fuqitë e Federatës, duke shtrirë ato të Republikës dhe Krahinave Autonome. Kjo do të thoshte se Kosova ishte tani një element i plotë konstitutiv i Federatës me përfaqësim të drejtpërdrejtë dhe të drejtë në të gjitha pjesët e saj dhe organet shtetërore. Si një nga tetë njësitë federale të Jugosllavisë, Kosova ishte e përfaqësuar në Dhomën Federale të Asamblesë Jugosllave dhe, ashtu si Republikat Jugosllave, kishte të drejtë të propozonte ligje dhe akte të tjera juridike në kompetencën e Dhomës së Republikave dhe Krahinave. Kjo kushtetutë ndaloi që Republika e Serbisë të ndërhynte në punët krahinore kundër vullnetit të asambleve në Novi Sad (kryeqyteti i Vojvodinës) dhe në Prishtinë.³²⁶ Kushtetuta e re i mundësoi Kosovës të shfaqej si një faktor i pavarur në Federatën Jugosllave, jo më nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë serbe. Krahina e kishte bankën e saj kombëtare, gjykatën supreme dhe administratën e pavarur nën mbikëqyrjen e këshillit ekzekutiv të përkohshëm dhe presidencës së përkohshme. Në fusha të tjera, përfshirë politikën ekonomike, taksimin, arsimin dhe kulturën, Republikës së Serbisë iu dha autoriteti të miratojë legjislacionin e vlefshëm për të gjithë Republikën vetëm me pëlqimin paraprak të Asamblesë së Krahinës. Për shqiptarët siguri i autonomisë nuk shkoi aq larg sa të kënaqte kërkesën e tyre për të pasur një republikë. Shqiptarët përcaktoheshin si kombësi e Jugosllavisë, e jo si komb, dhe për këtë arsye ata nuk mund të kishin një republikë, por vetëm një krahinë autonome.³²⁷ Në këtë mënyrë megjithëse Kushtetuta e vitit 1974 vazhdonte të pohonte se Kosova dhe Vojvodina ishin pjesë të Serbisë, në sajë të shumicës së kriterëve të Ligjit Kushtetues, ato ishin njëherësh organizata të plota federale. Por pse atëherë nuk u ndërmor edhe hapi i fundit për shndërrimin e “krahinave autonome” në republika? Për këtë gjë, sipas Malcolm, kishte dy përgjigje: njëra teorike dhe tjetra praktike. Kundërshtimi teorik ka qenë gjithmonë se i tërë themeli i sistemit federativ Jugosllav, ashtu siç ishte projektuar nga udhëheqja komuniste në mbledhjen e saj më 1943, ishte se republikat ishin entitete për “kombe”, për dallim nga “kombësitë”. Ky dallim, i cili kurrë nuk është përkthyer qartësisht në anglisht, ishte njëfarë doktrine komuniste e zhvilluar

³²⁴ Momčilo Pavlović, ‘Yugoslavia – the constitution of 1974 and some political results’, (Transconflict 2013) <<http://www.transconflict.com/2013/04/yugoslavia-the-constitution-of-1974-and-some-political-results-19/>> qasur: 11.06. 1019.

³²⁵ ‘Krahina Socialiste Autonome e Kosovës’, (“Gazetën Zyrtare të KSAK”, nr. 4 të 27 shkurtit 1974).

³²⁶ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, 178.

³²⁷ Ibid 179.

në Bashkimin Sovjetik. Komb (serbisht *narod*) ishte potencialisht si njësi shtet-formuese ose së paku “njerëzit e saj punues” kishin të drejtë” dhe prandaj një republikë federale kishte edhe të drejtën përfundimtare për shkëputje, kur ishte një republikë si pjesë përbërëse e federatës. Kombësia (serbisht *narodnost*), nga ana tjetër, ishte një pjesë e zhvendosur e një kombi, pjesë kryesore e së cilës jetonte diku tjetër, prandaj nuk mund të bëhej komb kushtetues në federatë dhe as nuk mund të kishte njësinë e vetë federale. Shqiptarët e Kosovës ishin kombësi, sepse “kombi” i shqiptarëve e kishte shtetin e vet në Shqipëri dhe i njëjti parim vlente edhe për Hungarezët e Vojvodinës.³²⁸ Është e vështirë të kuptosh, se pse një parim i këtillë duhej të kishte fuqinë e një norme kushtetuese, kur ai, në të vërtetë, nuk përputhej me realitetin. Pas politikës së mohimit të statusit të Republikës së Kosovës, realisht qëndronin edhe disa arsye praktike dhe politike. Frika e parë ishte se Kosova si Republikë, do të ndahej nga Jugosllavia që të bashkohej me Shqipërinë. Ndërkaq udhëheqja komuniste e Beogradit frikësohej se mos duke i dhënë statusin e republikës, qoftë njëres apo tjetres krahinë autonome do të shkaktonte pakënaqësi të mëdha politike në vetë Serbinë, si dhe ndër serbët që jetonin në Kosovë.³²⁹

Në vitin 1981, kërkesat e shqiptarëve të Kosovës për statusin e plotë republikan mbledhën impuls në protesta masive, por demonstratat u kundërshtuan nga një reagim i ashpër. Ushtria federale u vendos në gjendje e jashtëzakonshme, e cila u shpall në Kosovë.³³⁰ Që nga prilli i vitit 1987 Slobodan Millosheviç në fjalimet e tij kishte provuar të barazonte të drejtat e serbëve individualë me ato të kombit dhe unitetin e tij dhe ta identifikonte veten si mbrojtës të kombit serb kundër armiqve të jashtëm. Megjithëse popullariteti i tij personal po rritej, opinioni publik serb ishte përhapur në mesin e programeve politike konkurruese.³³¹ Kjo nuk ishte vizita e parë e Millosheviçit në Kosovë. Vetëm katër ditë më parë, më 20 Prill, ai kishte qenë atje për të takuar zyrtarët e Partisë Komuniste dhe u pyet nga serbët lokalë për të bërë një vizitë kthimi që do të përqendrohej plotësisht në ankesat e tyre. Gjatë këtyre katër ditëve, ndihmësit e Millosheviçit punuan me zell për të organizuar demonstratat masive, të cilat në

³²⁸ Noel Malcolm, *KOSOVA Një Histori e Shkurtër*, 412.

³²⁹ Ibid 413- 414.

³³⁰ OSCE Kosovo *As Seen, As Told: An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission October 1998 to June 1999*, (Verification Mission October 1998 to June 1999, KOSOVO / KOSOVA) Organization for Security and Co-operation in Europe Office for Democratic Institutions and Human Rights, 27 [tani e tutje: *OSCE Kosovo As Seen, As Told: An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission*].

³³¹ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, 227.

mënyrë të efektshme filluan “kryqëzatën” e tij në Kosovë. Sapo u kthye në Beograd, Millosheviçi, duke kapitalizuar mbështetjen e tij të jashtëzakonshme popullore, për të debatuar për çështjen e Kosovës në mënyrë që t'u tregojë udhëheqjeve të tjera republikane implikimet e vërteta të situatës së serbëve të Kosovës në raport me federatën në tërësi. Tani e tutje, konfliktit midis serbëve dhe shqiptarëve nuk do t'i jepej më veshje ideologjike, por do të trajtohej si një çështje etnike.³³²

Ishte nacionalizmi ai që çoi në ngritjen e Millosheviçit dhe miratimin zyrtar të një axhende ekstreme nacionaliste serbe. Pasi kjo agjendë u bë politikë qeveritare, lufta u bë një mundësi e vërtetë. Në të vërtetë, ndoshta pyetja më e theksuar për të bërë është se pse lufta u shty deri në vitin 1998 dhe nëse bashkësia ndërkombëtare do të mund të kishte bërë ndonjë gjë për të shfrytëzuar këtë kohë të huazuar për të parandaluar atë? Heqja e autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës në v. 1989 ishte një moment kyç në një seri ngjarjesh që çuan në kërkesa për pavarësi nga republikat e tjera, luftërat në Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe përfundimisht edhe në Kosovë.³³³ Heqja e autonomisë së Kosovës filloi me ndryshimet në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë më 28 mars 1989. Ishte një zgjidhje kushtetuese dhe juridike, që minoi pozicionin kushtetues të Kosovës si një nga tetë njësitë federale të Jugosllavisë dhe ekzistenca si një entitet socio-politik dhe ishte privuar nga autoriteti shtetëror. Dhe procesi i ri përcaktimit të statusit kushtetues dhe ligjor të Kosovës u shoqërua me shtypje të fortë policore dhe ligjore nga shteti serb. Më 3 shkurt 1989, Asambleja Kombëtare e Serbisë miratoi ndryshimet, të cilat i dhanë Serbisë më shumë kontroll të drejtpërdrejtë mbi sigurinë, gjyqësorin, financat dhe planifikimin shoqëror të Krahinës Autonome.³³⁴ Pasi Asambleja e Kosovës u shpërbë në qershor 1990, u bë një përpjekje nga 114 nga 180 deputetët e saj më 2 korrik për ta shpallur Kosovën të pavarur nga Serbia dhe një republikë të plotë brenda RSFJ-së. Ky veprim u shpall i paligjshme si nga Serbia ashtu edhe nga RSFJ, kështu që më 7 shtator 111 deputetë, duke u takuar fshehurazi në Kaçanik, e shpallën Republikën e pavarur të Kosovës. Më pas kundër tyre u ngritën kallëzime penale. Atë dhjetor, shqiptarët e Kosovës bojkotuan zgjedhjet në parlamentin serb. Në shtator 1991 deputetët e Kuvendit të Kosovës, duke kundërshtuar ende përpjekjet e Serbisë për t'i shpallur aktivitetet e tyre të paligjshme, organizuan një referendum për sovranitetin në

³³² Ibid 228.

³³³ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 34.

³³⁴ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, 234- 235.

të cilin ata raportuan një pjesëmarrje prej 87% dhe gati 100% të votimit pro. Zgjedhjet e para paralele të organizuara në Kosovë nuk u bënë deri në maj të vitit 1992.³³⁵

Problemet e Kosovës pothuajse duket se kanë qenë një bezdi, duke shtuar komplikime të mëtejshme në negociatat në lidhje me luftërat në Slloveni, Kroaci dhe Bosnje. Kosova duket se është vlerësuar si sekondarja e këtyre konflikteve.³³⁶ Më 27 gusht 1991, Komuniteti European dhe Shtetet Anëtare të tij, në të njëjtën kohë me mbledhjen e një konference paqeje për Jugosllavinë, krijuan një Komitet të Arbitrazhit, i kryesuar nga Robert Badinter (Komisioni i Badinterit).³³⁷ Komisioni përfshiu të drejtën e popujve për vetëvendosje, e drejtë nga e cila deri tani ishin thirrur vetëm popujt kolonial.³³⁸ Pasi vendosi më 16 dhjetor të shtri një njohjen në ato Republika Jugosllave që e kërkojnë atë, mbeti që vendet anëtare të Këshillit të Ministrave të përcaktojnë se cilat Republika tani merituan njohje.³³⁹ Kosova mbeti e fundit, kur shtrohet çështja lidhur me trajtimin diferencial të KE-së ndaj Republikave Jugosllave si kandidat i vetëm për njohje në lidhje me territoret e tjera të ish- Jugosllavisë.³⁴⁰ Megjithëse njësia nën-federale Kosova e bazoi pretendimin e saj për shtetësi nga Jugosllavia në 1991 në të drejtën e popujve për vetëvendosje.³⁴¹ Sidoqoftë Komisioni nuk bëri asnjë referencë në situatën në Kosovë ose për Deklaratën e Pavarësisë të vitit 1991 nga shqiptarët e Kosovës.³⁴²

Në zgjedhjet paralele të majit 1992 Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e themeluar në Shtator 1990 dhe e udhëhequr nga Ibrahim Rugova, fitoi shumicën e vendeve në një "Asamble Themelore Republikane ", me 130 anëtarë, dhe Rugova u shpall Presidenti i Kosovës. Pas kësaj, vëmendja ndërkombëtare u kthye kryesisht në Luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në fillimet e këtij konflikti, roli i Serbisë në përgjithësi shihej nga komuniteti ndërkombëtar si ai i

³³⁵ OSCE Kosovo *As Seen, As Told: An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission*, 29.

³³⁶ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 55.

³³⁷ Alain Pellet, 'The Opinions of the Badinter Arbitration Committee A Second Breath for the Self-Determination of Peoples', (1992) *European Journal of International Law* 1992, 178 [tani e tutje: Alain Pellet, 'The Opinions of the Badinter Arbitration Committee'].

³³⁸ Ibid 179.

³³⁹ Richard Caplan, *Europe and the Recognition of New States in Yugoslavia*, (Cambridge University Press 2005) 35 [tani e tutje: Richard Caplan, *Europe and the Recognition of New States in Yugoslavia*].

³⁴⁰ Ibid 137.

³⁴¹ Peter Radan, *Recognition of States in International Law*, (Routledge Handbook Of State Recognition, First published 2020 by Routledge) 49.

³⁴² Enver Hasani, 'Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo's Self-Determination', (2005) (80)305, *Chicago-Kent Law Review*, 309.

një protagonist, ndërsa Kosova në këtë kohë e konsolidoi shtetin paralel.³⁴³ Deri në fund të vitit 1992, ndikimi i largimeve masive të shqiptarëve nga të gjitha sferat e jetës publike dhe industrisë në shoqërinë kosovare ishte bërë më i theksuar. Rreth 750.000 njerëz tani vlerësohej se ishin pa sigurime shoqërore dhe kështu iu mohuan shërbimet mjekësore falas në institucionet shtetërore. Për ata që nuk mund të përballonin kujdesin mjekësor në klinikat shtetërore ose private, e vetmja alternativë ishte të ndiqnin qendrat shëndetësore paralele.³⁴⁴ Ndërkohë, udhëheqja kosovare vazhdoi politikën e saj të rezistencës paqësore mes një atmosfere gjithnjë e më të tensionuar. Me shumicën e popullsisë shqiptare të paarmatosur, ata ishin të shqetësuar të shmangin me çdo kusht gjakderdhjen që vijonte në Bosnje.³⁴⁵

Ishte kjo periudhë kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) kishte fillimet e saja. Në vitin 1992 dhe 1993, UÇK-ja luajti një rol në krijimin e një grupi gueril në takime të fshehta në Prishtinë dhe Tetovë. Sulmi i parë ishte vrasja e një polici serb në vitin 1995. Por deri në vitin 1996 organizata me qendër në Zvicër me emrin UÇK, mori përgjegjësinë për këto sulme.³⁴⁶ Niveli i ulët i dhunës vdekjeprurëse në Kosovë gjatë viteve të 90-ta ishte keq interpretuar nga bashkësia ndërkombëtare. Kështu, bashkësia ndërkombëtare në vend se të njohë natyrën e përkohshme të paqëndrueshmërisë, përkundrazi u përgjigj në mënyrë të vetëkënaqur duke e shtyrë edhe më tej çështjen e Kosovës në sfond. Vëmendja e vogël drejt Kosovës u pa edhe nga organizatat ndërqeveritare që dukej se ishin përqendruar në periudhën 1992-93 me frikën se lufta në Bosnje dhe Hercegovinë do të përhapej edhe në Kosovë.³⁴⁷

Në verën e vitit 1992 qeveria britanike dhe Kombet e Bashkuara mbajtën një konferencë në Londër në një përpjekje ambicioze për të mbrojtur spastrimin etnik në Bosnje dhe për të rivendosur territorin e marrë me forcë nga shteti i ri i konstruktuar (27 prill 1992), pra një shtet i panjohur Jugosllav, i cili shihej vetëm si Serbia dhe Mali i Zi. Përfaqësuesit nga Kosova megjithëse të ftuar në Londër, ata u klasifikuan si vëzhgues dhe jo si udhëheqës. E gjithë elita e politikanëve kosovarë ishin aty në një dhomë anësore ku duhej të ndiqnin konferencën në një monitor televiziv. Ky ishte një poshtërim i madh për një popull që besonte se vuajtjet e

³⁴³ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, 259.

³⁴⁴ Ibid 262.

³⁴⁵ Ibid 266.

³⁴⁶ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 52.

³⁴⁷ Ibid 56.

tyre ishin të barabarta me atë të myslimanëve boshnjakë. Rezultati i vetëm marginalisht konstruktiv i Konferencës që preku problemin e Kosovës ishte vendimi për të stacionuar vëzhguesit e të drejtave të njeriut në Kosovë.³⁴⁸ Ndërkohë, arrestimi arbitrar dhe dhuna policore drejtuar shqiptarëve u bënë praktika rutinore. Rugova e kundërshtoi këtë politikë të shtypjes së bashkuar me një rezistencë jo të dhunshme, duke inkurajuar zhvillimin e një shoqërie të gjerë paralele të strukturave politike, kulturore, arsimore, shëndetësore dhe të drejtuar nga shqiptarët. Ndërsa bashkësia ndërkombëtare e bëri shumë të qartë se nuk do të mbështeste një Kosovë të pavarur, sepse nuk do të mbështeste shkëputjen dhe ndryshimin e kufijve ndërkombëtarë që mund të zgjojnë pretendime latente ose historike diku tjetër në rajon.³⁴⁹

Në nëntor të vitit 1993, Bashkimi Europian miratoi një propozim për rivendosjen e autonomisë për Kosovën në programin e saj të veprimit Europian për Jugosllavinë. Por politikanët kryesorë, duke përfshirë David Owen, vazhduan të insistojnë në integritetin e Jugosllavisë.³⁵⁰ Deri në dimrin e vitit 1993, kushtet e përgjithshme të jetesës në Kosovë po bëheshin të patolerueshme. Dyqanet ishin thuajse bosh dhe popullsia po i nënshtrohej gjithnjë e më shumë formave të ndryshme të shtypjes së dhunshme, ndërsa intensifikohej prania ushtarake serbe. Aeroporti jashtë Prishtinës tani ishte një bazë ushtarake, tanket e rrethuan vetë qytetin e Prishtinës dhe disa shkolla fillore shqiptare ishin shndërruar në hostele për ushtrinë dhe njësitë e policisë serbe, duke u vendosur më pas në një numër gjithnjë në rritje në të gjithë Kosovën. Pothuajse çdo ditë, aeroplanët fluturonin poshtë nëpër qytete dhe fshatra dhe zjarri me mitraloz mund të dëgjohej në shumicën e netëve.³⁵¹ Gjyqësori në Kosovë kishte ardhur në mënyrë progresive nën kontrollin serb që nga maji 1990, dhe deri më 1993, më shumë se 300 nga 500 gjyqtarë shqiptarë ishin shkarkuar dhe zëvendësuar nga zyrtarë serbë. Parlamenti serb kishte caktuar gjithashtu 168 gjyqtarë për Kosovën nga të cilët vetëm njëzet e pesë ishin me kombësi shqiptare dhe nga këta vetëm gjashtëmbëdhjetë kishin qenë të gatshëm të merrnin detyrën, kurse pjesa tjetër refuzoi. Që nga marrja e kujdesit mjekësor serb, popullata shqiptare kryesisht shmangu institucionet e administruara serbe, veçanërisht në fushat e gjinekologjisë, pediatriisë dhe kirurgjisë. Gratë

³⁴⁸ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, 265- 266.

³⁴⁹ Richard Caplan, *Europe and the Recognition of New States in Yugoslavia*, 141- 142.

³⁵⁰ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 58.

³⁵¹ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, 274.

shqiptare nuk donin që foshnjat e tyre të dorëzoheshin nën mbikëqyrjen e mjekëve serbë dhe kështu rreth 85% vlerësohej të lindnin pa ndonjë kujdes mjekësor profesional.³⁵²

Përkundër këtyre ngjarjeve, në dëshpërimin për të ndaluar luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosova u mënjanua qëllimisht. Kosova nuk u përfshi në negociatat në Dejton. Sidoqoftë procesi i Dejtonit e përkeqësoi problemin e Kosovës. Megjithëse ishte shumë e pamundur që Dejtoni do të kishte mundur të krijonte një zgjidhje për krizën në Kosovë, do të ishte e dobishme, nëse procesi të paktën të përfshinte një diskutim për situatën në Kosovë. Dejtoni mund të ishte përdorur si forum për të inkurajuar prezencën në Kosovë të OJQ-ve etj.³⁵³ Pra, zhgënjimi më i madh erdhi me negociatat e Dejtonit në nëntor 1995, duke arritur kulmin në nënshkrimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kornizë për Paqen në Bosnjë dhe Hercegovinë, (e njohur si “Marrëveshja e Dejtonit”), e cila zyrtarisht përfundoi luftën atje. Sipas Richard Caplan, Kosova kurrë nuk u përfshi në agjendën e Dejtonit për tri arsye. *Së pari*, u ndje se kishte shumë për të negociuar dhe tashmë çështje të tjera të rëndësishme për këtë problem, duke përfshi ndikimin e vazhdueshëm të kriminelëve të akuzuar të luftës, e cila gjë nuk u adresua fare. *Së dyti*, askush nuk donte të tjetërsonte Milosheviçin, 'paqeruajtësin', i cili kishte detyruar serbët boshnjakë të pranojnë kompromiset e nevojshme për Marrëveshjen e Dejtonit dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i së cilës u mendua i domosdoshëm për të siguruar zbatimin e suksesshëm të marrëveshjes. *Në fund*, në mungesë të luftës në Kosovë u mendua se nuk kishte nevojë urgjente për t'u marrë me këtë çështje. Në këtë drejtim, Ibrahim Rugova, udhëheqësi shqiptar i Kosovës, ishte bërë me siguri viktimë e suksesit të tij.³⁵⁴ Që nga mesi i viteve të 90-ta, kur situata filloi të përkeqësohej, shumë shqiptarë të zakonshëm në Kosovë po e humbnin durimin për strategjinë e rezistencës pasive dhe po lodheshin nga lufta për të mbrojtur sistemin paralel në kushte të vështira, dhe pavarësisht kësaj Kosova nuk u përmend fare në Dejton³⁵⁵ dhe përfundimi që shumë shqiptarë nxorën nga Dejtoni, sipas fjalëve të Veton Surroit, kryeredaktor i të përditshmes Koha Ditore, ishte se ‘territoret etnike kanë legjitimitet’ dhe se ‘vëmendja ndërkombëtare mund të merret vetëm përmes luftës’.³⁵⁶

³⁵² Ibid.

³⁵³ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 59- 60.

³⁵⁴ Ibid 140- 141.

³⁵⁵ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 50.

³⁵⁶ Richard Caplan, *Europe and the Recognition of New States in Yugoslavia*, 142.

Ishte ky një zhgënjim i përgjithshëm që ndikoi në rritjen e mbështetjes për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) jo vetëm në Kosovë, por edhe në jug të Serbisë dhe Maqedoni. Ndërsa strategjia e Rugovës dukej se nuk jepte dividendë politikë, UÇK-ja arriti të kryejë një seri sulmesh në stacionet e policisë serbe dhe ushtrisë jugosllave deri në korrik 1998.³⁵⁷ Ndërsa forcat serbe përgjigjeshin brutalisht me dhunë. Viktima e parë e brutalitetit serb ishte një mësues shqiptar i pushkatuar në klasën e tij afër Prishtinës në nëntor 1997. Njëzet mijë shqiptarë morën pjesë në funeralin e tij, me qrast ushtarët e UÇK-së e bënë shfaqjen e tyre të parë publike. Deri në shkurt të vitit 1998, forcat serbe kishin përshkallëzuar fushatën e tyre duke djegur dhjetëra fshatra, pasi u përfshinë në plaçkitje dhe vrasje në të gjithë vendin.³⁵⁸

3.2. Kriza humanitare dhe përgjigjja ndërkombëtare para ndërhyrjes së NATO-s

Më 28 shkurt 1998, forcat serbe të sigurisë filluan një seri veprimesh kundër shqiptarëve të Kosovës të akuzuar si mbështetës të UÇK-së. Këta lanë civilë të vdekur dhe detyruan largimin e të tjerëve.³⁵⁹ Si reagim ndaj përhapjes së luftimeve, duke vepruar nën kapitullin e VII-të të Kartës së OKB-së në mars, KS-ja për situatën në Kosovë miratoi Rezolutën e parë të saj, Rezoluta 1160 (v. 1998).³⁶⁰ Me këtë Rezolutë përcaktohej një propozim për një embargo armësh për Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ), duke përfshirë dhe Kosovën. Kjo Rezolutë dënon përdorimin e forcës së tepruar nga forcat e policisë serbe kundër civilëve dhe demonstruesve paqësorë të Kosovës si dhe të gjitha veprimet e UÇK-së. Gjithashtu, thërret që RFJ të gjejë zgjidhje politike për Kosovën përmes dialogut, duke implementuar veprimet e sugjeruara nga “Grupi i Kontaktit”³⁶¹ (grup jo formal i shteteve që monitoron dhe mbikëqyr politikën ndërkombëtare në Kosovë, i përbërë nga SHBA-ja, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia). Rezoluta themeloi një komitet për monitorimin dhe respektimin e saj. Sipas praktikës standarde, u themelua “komiteti i sanksioneve” i përbërë nga anëtarët

³⁵⁷ Richard Caplan, *Europe and the Recognition of New States in Yugoslavia*, 143.

³⁵⁸ John G. Stoessinger, *Why Nations go to War*, (Eleventh Edition, Wadsworth Cengage Learning 2010) 158.

³⁵⁹ Nicholas Morris, ‘Humanitarian Intervention in the Balkans’, (Edited by Jennifer M. Welsh: Humanitarian Intervention and International Relations, Published in the United States by Oxford University Press 2004) 110 [tani e tutje: Nicholas Morris, ‘Humanitarian Intervention in the Balkans’].

³⁶⁰ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, (botimi i dytë, botuar në shqip: KOHA, 2011) 139 [tani e tutje: Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*].

³⁶¹ UN, S/RES/1160 (1998).

e KS-së.³⁶² Në ditët në vijim, situata u përkeqësua me shpejtësi: luftimet u intensifikuan dhe forcat serbe të sigurisë si dhe ushtria Jugosllave përdorën forcën në mënyrë të tepruar dhe pa dallim, duke shkakuar kështu viktimë të shumta civile, shpërnguljen e qindra mijëra personave të pafajshëm nga shtëpitë e tyre dhe një fluks masiv i refugjatëve në vendet fqinje dhe vendet më të largëta.³⁶³ I ballafaquar me veton ruse, KS-ja nuk ia doli të reagojë me shtimin e sanksioneve ndaj shkeljes së Rezolutës 1160 (1998) dhe shtimit të aksioneve ushtarake nga ana e Jugosllavisë.³⁶⁴

Në ndërkohë qeveria Jugosllave vazhdoi ta karakterizojë situatën si një konflikt të brendshëm që është nën kontroll, ndërsa UÇK-ja për herë të parë mund të pretendojë të jetë një fuqi e rëndësishme politike.³⁶⁵ Pranvera e vitit 1998 solli një valë të gjerë sulmesh të vogla ose jo të koordinuara ndaj instalimeve të policisë serbe, si dhe luftimeve midis fshatrave të armatosura serbe dhe shqiptare në disa zona. UÇK-ja pretendoi se kishte zgjeruar kontrollin e saj mbi fshatra me forcat serbe që kontrollonin qytetet dhe rrugët kryesore.³⁶⁶ Nga pranvera e vitit 1998 njësitë policore e ushtarake të RFJ-së kishin instaluar edhe më shumë postblloqe nëpër rrugë, duke përfshirë edhe zonat rurale, për ta kufizuar lirinë e lëvizjes së luftëtarëve të UÇK-së. Më pas, siç përshkruan Mark Weller, ngjau kopja e ngjarjeve të spastrimit etnik në Kroaci e Bosnjë dhe Hercegovinë. Fshatrat shqiptare, të dyshuara për bashkëpunim me UÇK-në, do të rretoheshin nga forcat e rregullta ushtarake serbe, duke përfshirë artilerinë dhe njësitet e tankeve dhe të garantoheshin.³⁶⁷ Për shkak të konfliktit të vazhdueshëm dhe të dhunshëm në Kosovë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës dëshmon se nga pranvera e vitit 1998, kjo situatë ka çuar në një rritje të numrit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, që deri në shtator 1998 vlerësohej në mes 290.000 dhe 600.000 njerëz.³⁶⁸ Përshkallëzimi dramatik i situatës në Kosovë në qershor 1998 ka rezultuar në lëvizje të papritur në shkallë të gjerë të refugjatëve të luftës. Pjesa më e madhe e refugjatëve kanë ikur

³⁶² Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 139.

³⁶³ Bruno Simma, 'NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects', (1999) *European Journal of International Law*, 6 [tani e tutje: Bruno Simma, 'NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects'].

³⁶⁴ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 140.

³⁶⁵ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 69- 70.

³⁶⁶ Ibid 71.

³⁶⁷ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 130- 131.

³⁶⁸ Council of Europe: *Parliamentary Assembly, Recommendation 1385 (1998) Situation of the Kosovo refugees, asylum seekers and displaced persons*, 24 September (1998), 1385
<<https://www.refworld.org/docid/3ae6b39f20.html> > qasur: 9 Korrik 2020.

në veri të Shqipërisë dhe në Mal të Zi, me një numër edhe më të madh të zhvendosur brenda Kosovës.³⁶⁹

Për ta monitoruar situatën, autoritetet serbe dhe në veçanti Presidenti Millosheviç refuzonte të pranonte çdo mision ndërkombëtar me detyrë monitorimi për të operuar në Kosovë. Por pas një iniciative amerikano-ruse, më 6 Korrik 1998, filloi punën Misioni Vëzhgues Diplomatik i Kosovës (MVDK). “Misioni i tij është të vëzhgojë dhe të raportojë mbi lirinë e përgjithshme të lëvizjes dhe kushtet e sigurisë në të gjithë Kosovën”. Në mënyrë të veçantë, MVDK-ja do të vëzhgojë dhe do të raportojë për Qasjen e Organizatave Joqeveritare (OJQ-ve); kushtet dhe aktivitetet e sigurisë në Kosovë; situatën me personat e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatëve. MVDK-ja punon nën autoritetin e një grupi bashkërendues të përbërë nga Ambasadorët e vendeve të Grupit të Kontaktit në Beograd si dhe Ambasadorët e Austrisë (presidenca e BE-së) dhe Polonia (kryetari i zyrës së OSBE-së).³⁷⁰ Megjithatë vëzhguesve diplomatikë të BE-së dhe KDOM/MVDK iu mohua qasja në zonat ku besohej se forcat e RFJ/Serbisë ishin duke ndërmarrë aksione kundër fshatrave. Edhe pse me ndihma humanitare fillimisht u ishte lejuar njëfarë qasje për të ofruar ndihmë.³⁷¹ Në një fazë të mëvonshme, MVDK-ja amerikane e mori edhe rolin, më pak publik, por të posaçëm për ta verifikuar zbatimin e Marrëveshjes Holbrookut.³⁷² MVDK-ja ia doli ta rriste transparencën në raport me ngjarjet në Kosovë. Sidoqoftë, nga vera e hershme e vitit 1998, situata ishte përkeqësuar aq sa pasojat ishin bërë shumë të dukshme për botën e jashtme.³⁷³ Ndërsa Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (KLKBR) dhe të tjerët po tërhiqnin vëmendjen për pasojat për civilët e abuzimeve masive të pakontrolluara të të drejtave të njeriut.³⁷⁴

Në verën e hershme të vitit 1998, Grupi i kontaktit kërkoi një angazhim të shtuar për të nisur negociatat midis palëve. Angazhimi do të kryesohej nga ambasadori amerikan në

³⁶⁹ Midis Marsit, 1998 dhe 24 Mars 1999, gjithsej 460,000 njerëz ishin zhvendosur. Përafërsisht 260,000 njerëz mbetën brenda Kosovës si njerëz të 'zhvendosur brenda vendit, 100,000 u nisën për në vendet europiane, shih: The UN Refugee Agency, Kosovo Crisis Update, (1999)

<<https://www.unhcr.org/news/updates/1999/3/3ae6b80dc/kosovo-crisis-update.html>> qasur: 9 Korrik 2020.

³⁷⁰ Committee of Ministers of the Council of Europe, *Federal Republic of Yugoslavia and Kosovo, International monitoring of the situation in the Federal Republic of Yugoslavia (FRY) and Kosovo in particular, Document prepared by the Directorate of Political Affairs*, (1998) Restricted CM/Inf(98)35 <<https://rm.coe.int/168051c275>> qasur: 10 Korrik 2010.

³⁷¹ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 131.

³⁷² Ibid 157.

³⁷³ Ibid 158.

³⁷⁴ Nicholas Morris, 'Humanitarian Intervention in the Balkans', 112.

Maqedoni, Chris Hill, i cili kishte pasur një rol gjatë Marrëveshjes së Dejtonit. Në mbledhjen e vet në Bonn, më 8 korrik 1998, Grupi i Kontaktit ishte pajtuar t'ia rekomandonte ekipit të vet negociator elementet themelore për zgjidhjen e çështjes së statusit të Kosovës, duke ritheksuar se nuk përkrahet as *stauts quo* e as pavarësia e Kosovës. Ata kërkuan që të dyja palët të ndalnin dhunën dhe të obligoheshin që t'i hynin dialogut për të arritur një zgjidhje paqësore.³⁷⁵ Deklaratat e grupit të kontaktit tashmë kishin dhënë indicie se KS-ja do të merrte veprime të mëtejme, po që se kërkesat nuk përmbusheshin nga njëra ose pala tjetër. Për më tepër edhe NATO-ja u bë pjesë e procesit. Ndërsa qeveria amerikane, në veçanti, kishte filluar të bënte trysni për aksion të mundshëm ushtarak, për ta ndaluar represionin në Kosovë.³⁷⁶ Mirëpo pavarësisht përpjekjeve për ndalje të dhunës, represioni serb vazhdonte, shifrat e zhvendosjes së KLB-së për gusht 1998 deklarojnë se kishte 260.000 njerëz të zhvendosur brenda vendit dhe 200.000 refugjatë jashtë Kosovës.³⁷⁷

Të shqetësuar për situatën e rëndë për luftën e kohëve të fundit në Kosovë dhe “në veçanti përdorimi i tepërt dhe pa dallim i forcës nga forcat serbe të sigurisë dhe Ushtria Jugosllave të cilat kanë rezultuar në viktima të shumta civile dhe, sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, zhvendosjen e 230.000 personave nga shtëpitë e tyre”,³⁷⁸ KS-ja miratoi një rezolutë tjetër duke vepruar nën kapitullin e VII-të të Kartës së OKB-së, Rezoluta 1199 (1998). Kjo Rezolutë, riafirmon të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpitë e tyre, duke nënvizuar përgjegjësinë e RFJ-së për të krijuar kushtet për kthimin e tyre. Kjo Rezolutë dënon aktet e dhunës, duke shprehur shqetësimin për raportet për shkelje të vazhdueshme të ndalimeve të vendosura me Rezolutën 1160 (1998). Kërkon gjithashtu pushimin e armiqësive dhe hyrjen e menjëhershme në një dialog domethënës pa parakushte, i cili do të mundësojë monitorimin efektiv dhe të vazhdueshëm ndërkombëtar në Kosovë nga Misioni Monitorues Europian.³⁷⁹ Megjithëse u miratua nën kapitullin VII, kjo Rezolutë nuk e autorizoi përdorimin e forcës. Një ditë pas ishte miratuar Rezoluta 1199, NATO-ja lëshoi një lajmërim për një fushatë të kufizuar ajrore fazë-fazë në Kosovë. Kjo do ta çojë NATO-n në një nivel të rritur të gatishmërisë ushtarake dhe ishte një sinjal i rëndësishëm

³⁷⁵ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 159- 160.

³⁷⁶ Ibid 160.

³⁷⁷ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 74.

³⁷⁸ UN, S/RES/1199 (1998).

³⁷⁹ Ibid.

politik i gatishmërisë së saj për të përdorur forcën, nëse do të bëhej e domosdoshme përdorimi i saj.³⁸⁰

Ndërsa forcat qeveritare të sigurisë serbe kryenin sulme në pjesë të ndryshme të Kosovës, duke përfshirë zonat e Likovcit, Gllogovcit dhe Qiqavicës dhe vetëm një javë pas miratimit të Rezolutës 1199 nga KS-ja, forcat serbe intensifikuan sulmet e tyre, duke filluar një sulm tjetër në rajonin e Drenicës dhe në trekëndëshin Suharekë-Shtimje-Ferizaj. Këto operacione thuhet se kanë rezultuar me shpërnguljen e rreth 20.000 personave. Ndërsa dukej se aktivitetet ushtarake pushonin në ditët e fundit të shtatorit dhe me 1 tetor vëzhguesit treguan një ulje të tensioneve të forcave të sigurisë.³⁸¹ Situata megjithatë mbetej dëshpëruese për popullatën civile, të cilët gjithnjë e më shumë ishin bërë shënjestër kryesore në konflikt. Luftimet në Kosovë kanë rezultuar me zhvendosjen masive të popullatës civile, shkatërrime të gjera të fshatrave ku shumë fshatra janë shkatërruar nga granatimet dhe djegia e tyre pas operacioneve të kryera nga forcat qeveritare federale dhe serbe. Niveli i shkatërrimit tregon qartë një përdorim pa dallim dhe joproporcional të forcës ndaj popullatës civile. Nga mesi i shtatorit, rreth 6.000 deri në 7.000 ndërtesa në 269 fshatra ishin dëmtuar ose shkatërruar rëndë. Raportohej për vrasje masive të civilëve në Kosovë, të cilat kujtojnë mizoritë e kryera në Bosnjë dhe Hercegovinë. Megjithatë përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare vazhduan për të sjellë një zgjidhje politike midis autoriteteve serbe dhe ato të Kosovës të mbështetura nga Grupi i Kontaktit dhe veçanërisht Ambasadori Christopher Hill.³⁸²

Gjatë gjithë kohës, kërkesat për negociata nga BE-ja dhe anëtarët e saj, nga Grupi i Kontaktit dhe KS-ja ishin fokusuar në “statusin e ardhshëm” të Kosovës. Megjithatë me kalimin e saj, agjenda aktuale e udhëheqjes nga ambasadori Hill nëpërmjet misionit ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit mori një drejtim tjetër. Pasi Grupi i Kontaktit u prezantoi palëve opsionet e ndryshme të zgjidhjes, u bë e qartë se marrëveshja për statusin aktual të Kosovës u bë e pamundur.³⁸³ Ndërsa i dërguari për Ballkan, amerikanë Christopher Hill (ambasadori Amerikan në Maqedoni), në fillim të shtatorit 1998 raportoi se pas takimeve me qeverinë

³⁸⁰ NATO, Statement by the Secretary General, Press Statement Vilamoura (24 Sept. 1998) <<https://www.nato.int/docu/pr/1998/p980924e.htm>> qasur: 10 Qeroshor 1019.

³⁸¹ Report Of The Secretary-General Prepared Pursuant of Resolutions 1160 (1998) and 1199 (1998) of the Security Council, Security Council, (S/1998/912 3 October 1998).

³⁸² Ibid.

³⁸³ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 163- 165.

serbe dhe me krerët shqiptar të Kosovës, ishte arritur një marrëveshje kornizë e cila shtynte zgjidhjen përfundimtare të statusit juridik të Kosovës për një periudhë tre vjeçare.³⁸⁴ Gjatë verës së vonshme, propozimi i parë zyrtar i Hillit iu paraqit palëve më 1 tetor 1998.³⁸⁵ Përderisa Kosova po e formulonte përgjigjen ndaj projektit fillestar, Marrëveshja Holbrooke ishte përfunduar.³⁸⁶ Më pas më 13 tetor 1998, autoritetet e NATO-s kishin votuar të autorizojnë sulmet ajrore nëse forcat e sigurisë nuk tërhiqeshin nga Kosova brenda 96 orësh. Pas një periudhe bisedimesh intensive me të dërguarin special Richard Holbrooke, që përfaqësonte Grupin e Kontaktit dhe Presidentit serb Slobodan Milosheviç arritën një marrëveshje.³⁸⁷ Më 16 tetor u njoftua e ashtuquajtura marrëveshja Miloseviç-Holbrooke.³⁸⁸ Teksti i saj nuk u botua, por dispozitat e saj kryesore, përveç përfundimit të armiqësive, ishin të trefishta. Sipas saj, të gjithë ata që kishin ikur nga shtëpitë e tyre në Kosovë dhe ishin bërë refugjatë duhej të lejoheshin të ktheheshin. Forcat serbe në Kosovë, përfshirë njësitë e ushtrisë dhe forcat speciale, duhej të zvogëloheshin në nivelet e tyre para vitit 1999. Sipas marrëveshjes Milosheviç-Holbrooke, u arritë edhe një marrëveshje tjetër midis Kryetarit të OSBE-së Bronislaw Geremek (Ministri i Punëve të Jashtme të Polonisë) dhe Ministrit të Jashtëm Jugosllav Zhivadin Jovanoviç, në formën e një misioni vëzhgues 2.000 anëtarësh të OSBE-së, që duhej të lejoheshin në Kosovë për të verifikuar këtë marrëveshje.³⁸⁹ Marrëveshjet e arritura me 15 dhe 16 tetor me NATO-n dhe OSBE-në në Beograd u miratuan me Rezolutën 1203 të 24 tetorit. Në lidhje me verifikimin e pajtueshmërisë nga RFJ me kërkesat e Rezolutës 1199 gjithashtu, edhe kjo Rezolutë është miratuar nën kapitullin VII të Kartës së OKB-së³⁹⁰ me trembëdhjetë vota pro, ndërsa Kina dhe Rusia abstenuan.

Në të njëjtën kohë, sipas marrëveshjes me OSBE-në, do të krijohet një Mision për Verifikim në Kosovë (MVK) për të monitoruar situatën në terren. Dhe nën drejtimin e NATO-s do të krijohet një operacion për të monitoruar situatën nga ajri.³⁹¹ MVK-ja kishte mandatin të

³⁸⁴ Julie Kim, *Kosovo Conflict Chronology*: (1998) - March 1999 April 6, 1999, CRS Report for Congress, Congressional Research Service The Library of Congress, 1999 [tani e tutje: Julie Kim, *Kosovo Conflict Chronology*].

³⁸⁵ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 165.

³⁸⁶ Ibid 167.

³⁸⁷ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 76.

³⁸⁸ OSCE Kosovo *As Seen, As Told: An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission*, 31.

³⁸⁹ Ibid.

³⁹⁰ UN, S/RES/1203 (1998).

³⁹¹ 'Kosovo Verification Mission' (KVM) (Government of Canada October 1998 - March 1999) <<https://www.canada.ca/en/department-national-defence/services/military-history/history-heritage/past->

verifikojë pajtueshmërinë nga të gjitha palët në Kosovë me Rezolutën 1199, të verifikojnë armëpushimin, të monitorojnë lëvizjet e forcave, të kërkojnë dhe të raportojnë blloqet rrugore të paanshme, të monitorojnë aktivitetet e kontrollit kufitar etj.³⁹² Marrëveshja kishte kohëzgjatje një vjeçare me mundësinë e zgjidhjes së njëanshme me kërkesë ose të RFJ-së ose të OSBE-së.³⁹³ OSBE-ja e emëroi ambasadorin amerikan, William Walker, për të udhëhequr KVM-në dhe zyrtarisht e themeloi misionin më 25 tetor. Që nga atëherë, elementet e tjera të Marrëveshjes Holbrooke ishin shndërruar në një sërë aksionesh ushtarake.³⁹⁴

Serbia fillimisht zbatoi marrëveshjen dhe tërhoqi forcat e saj në përputhje me rrethanat. UÇK-ja, përkundrazi, shfrytëzoi situatën e re dhe rinovoi veprimin ushtarak. Në fakt, forcat UÇK-së u zhvendosën për të zënë pozicionet e lira nga forcat serbe të ri dërguara.³⁹⁵ Por në nëntor dhe në fillim të dhjetorit, masat serbe të sigurisë u shtuan, duke përfshirë edhe rivendosjen e postblloqeve dhe një prezencë të madhe sigurie, posaçërisht në fshatrat përgjatë kufirit me Shqipërinë.³⁹⁶ KLKBR dhe MVK nuk ishin në gjendje të informojnë personat e zhvendosur.³⁹⁷ Pra, po bëhej e qartë se, përkundër suksesit fillestar të marrëveshjes Millosheviç-Holbrooke dhe pranisë së MVK-së në mbrojtjen e civilëve, nuk ishte më në gjendje të adresonte çështjet e nevojshme për paqeruajtjen. Nga monitorimi ajror mbi rajonin, NATO-ja ishte në dijeni të shkeljeve të marrëveshjes së armëpushimit gjatë kësaj periudhe.³⁹⁸ Ndërkohë, SHBA-ja dhe diplomatët europianë ndoqën përpjekjet e tyre për të promovuar një zgjidhje të Kosovës, megjithëse ende pa përfshirë UÇK-në në proces.³⁹⁹ Përpjekje tjera për t'u arritur një marrëveshje u paraqitën nga ambasadori Hill në nëntor dhe dhjetor 1998, për një plan të autonomisë për Kosovën. Në fillim të dhjetorit, Ambasadori Hill paraqiti një plan të autonomisë te presidenti serb Millosheviç dhe palës shqiptare në Kosovë, por të dyja palët kundërshtuan planin e përkohshëm të autonomisë së paraqitur nga ambasadori Hill. Zyrtarët serb dhe negociatorët shqiptarë vazhduan të kundërshtojnë

operations/europe/kimono.html> qasur: 20 Qershor 2020, shih gjithashtu: 'OSCE Kosovo Verification Mission/ OSCE Task Force for Kosovo', (OSCE 1999) <<https://www.osce.org/kvm-closed>> qasur: 21 Qershor 2020.

³⁹² Ibid.

³⁹³ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 183.

³⁹⁴ Ibid 184.

³⁹⁵ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 78.

³⁹⁶ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 185.

³⁹⁷ Nicholas Morris, 'Humanitarian Intervention in the Balkans', 113.

³⁹⁸ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 80.

³⁹⁹ OSCE Kosovo *As Seen, As Told: An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission*, 31.

versionin e fundit të marrëveshjes së paqes nga SHBA-ja dhe negociatorët e BE-së. Një ditë më pas, i dërguari amerikan Christopher Hill tregoi se do të përfundonte procesin e diplomacisë midis palëve.⁴⁰⁰

Gjersa mundësitë për një marrëveshje shterreshin, masat shtrënguese dhe ndëshkuese ndaj shqiptarëve të Kosovës ishin tashmë të dëshmuara më 1998 dhe u demonstruan me pamjet tronditëse nga incidentet në janar 1999 që tregonin vrasjen masive të Raçakut dhe përtej saj. Vrasja arbitrare e civilëve është njëkohësisht një taktikë në fushë për dëbuar shqiptarët e Kosovës dhe një objekt në vetvete u bënë gjithnjë e më shumë mjet për zbatimin në shtypjen e të drejtave të civilëve dhe politikanëve të shoqërisë kosovare dhe përdorimin e torturave dhe keqtrajtimin që u aplikuan si një mjet për të frikësuar shoqërinë shqiptare të Kosovës. Dëbimi i detyruar i ushtruar nga forcat jugosllave dhe serbe u bë në një shkallë masive, me planifikim të dukshëm dhe në shkelje të qartë të ligjeve dhe të zakoneve të luftës.⁴⁰¹ Luftimet në Kosovë në 1998 vendosën një precedent për atë që do të ndodhte në vitin 1999. OSBE-ja raportoi se “shumë fshatra janë shkatërruar nga granatimet dhe djegiet pas operacioneve të kryera nga forcat e qeverisë federale dhe serbe. Ekzistonin shqetësime se përdorimi jo proporcional i forcës dhe veprimeve të forcave të sigurisë janë krijuar për të terrorizuar dhe nënshtruar popullatën, një dënim kolektiv për t’i mësuar ata se çmimi i mbështetjes së njësive paraushtarake të Kosovës është shumë i lartë dhe do të jetë edhe më i lartë në të ardhmen”.⁴⁰² Nga 12 janari e deri më 15 janar të vitit 1999, forcat serbe sollën paisje të rënda ushtarake në komunën e Shtimes duke vendosur pozicionet e përhershme. Më 15 janar të vitit 1999, forcat jugosllave sulmuan fshatin Reçak brenda komunës; në këtë proces, ata ekzekutuan 45 shqiptarë etnikë. Më 16 janar të vitit 1999, OSBE-KVM hetoi vendin e masakrës. Ekipi gjeti "prova të ndalimeve arbitrare, vrasjeve jashtë gjyqësore dhe gjymtimit të civilëve të paarmatosur". Shefi i misionit OSCE-MVK, Ambasadori William Walker, u bashkua me ekipin për të vëzhguar provat e dorës së parë. Direkt pas kësaj, ai dënoi publikisht masakrën, i bëri thirrje Tribunalit për Krime të Luftës në Ish-Jugosllavi (TPNJ) të hetojë mizorinë. Më 18 janar të vitit 1998 kryeprokurorit të TPNJ-së iu refuzua hyrja në Kosovë nga

⁴⁰⁰ Julie Kim, *Kosovo Conflict Chronology*, 6.

⁴⁰¹ OSCE Kosovo *As Seen, As Told: An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission*, 11.

⁴⁰² Ibid 58.

kufiri me Maqedoninë. Menjëherë pas kësaj qeveria serbe e shpalli ambasadorin Walker persona *non grata*.⁴⁰³

Nga fundi i janarit të vitit 1999, Ministrat e jashtëm të BE-së vazhduan të diskutojnë për të lehtësuar një zgjidhje politike. Në Prishtinë, i dërguari amerikan Hill u takua me krerët shqiptarë për t'u bërë presion që të bashkohen prapa propozimit të paqes së Grupit të Kontaktit⁴⁰⁴ dhe me gjithë dështimet, ekipi i Hillit vazhdoi punën dhe sajoi edhe një projekt, dy ditë para vendimit të Grupit të Kontaktit për të ftuar palët në bisedime në Rambuje të Francës.⁴⁰⁵

3.3. Konferenca dhe Marrëveshja e Rambujesë

Këto zhvillime të përmendura më sipër çuan në atë që u bë e njohur si bisedimet e Rambujesë (Paris) midis autoriteteve të RFJ/Serbisë dhe palës shqiptare të Kosovës nën kujdesin e 'Grupit të Kontaktit'.⁴⁰⁶ Konferenca u hap në Kështjellën e vjetër të Rambujesë më 6 shkurt 1999⁴⁰⁷ dhe parashihej të përmbyllej me 20 shkurt.⁴⁰⁸ Në konferencë morën pjesë delegacioni serb, në të cilin ishte nuk vet Millosheviç. Delegacioni jugosllav/serb, sipas Mark Weller kishte përbërje të çuditshme. Një numër i përfaqësuesve supozohej se ishin përfaqësues nga Kosova apo përfaqësues të pakicës në Kosovë. Të zgjedhur nga Beogradi, disa prej tyre ishin të lëçitur nga grupet etnike në Kosovë, të cilët pretendonin se i përfaqësonin. Ndërsa edhe delegacioni Kosovar nuk ishte pa polemikë lidhur me përfaqësimin dhe legjitimitetin në konferencë.⁴⁰⁹ Ai përbëhej nga gati një e treta nga Lidhja Demokratike e Kosovës, një e treta nga Lidhja e Bashkimit Demokratik dhe një e treta nga UÇK-ja. Aty ishin edhe dy të pavarur. Veton Surroi dhe Blerim Shala.⁴¹⁰

Pas fillimit të konferencës së Rambujesë, ekipi e tre negociatorëve ndërkombëtarë për Kosovën (Ambasadori Chris Hill i Shteteve të Bashkuara, Ambasadori Wolfgang Petritsch që

⁴⁰³ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 81.

⁴⁰⁴ Julie Kim, *Kosovo Conflict Chronology*, 8.

⁴⁰⁵ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 171.

⁴⁰⁶ Christopher Greenwood, 'Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo', 149.

⁴⁰⁷ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 214.

⁴⁰⁸ Ibid 221.

⁴⁰⁹ Ibid 216- 217.

⁴¹⁰ Ibid 2018.

përfaqësonte BE-në dhe Ambasadori Boris Mayorsky nga Rusia) raportuan se bisedimet "po ecnin përpara, pa u përmendur ndonjë përparim konkret."⁴¹¹ Gjatë kohës së negociatave në Rambuje, më 16 tetor 1999, i dërguari SHBA-së Christopher Hill shkoi në Beograd për t'u takuar me presidentin e Jugosllavisë Millosheviç në një përpjekje për të bërë përparim në çështjen e pranisë paqeruajtëse të NATO-s. Ai vazhdoi të refuzojë të pranojë një vendosje të ardhme të NATO-së në tokat Jugosllave dhe Sekretarja e shtetit të SHBA-së, Albright e quajti këtë pozicion si "ndërprerës të marrëveshjes" dhe paralajmëroi se do të "pasohej me bombardime të NATO-s".⁴¹²

Presioni ishte edhe në palën Kosovare. Në rast se Kosova do të refuzonte t'i nënshtrohej projektit të Rambujesë, shtetet e NATO-s, përfshirë edhe SHBA-në, thjesht do të thoshin se situata do të ishte e pashpresë dhe do të tërhiqeshin nga zgjidhja e krizës. Andaj, duke marr parasysh këtë situatë, e vetmja shpresë për Kosovën që të arrijë diçka në fushën politike ishte nëpërmjet fuqisë ndërkombëtare.⁴¹³ Grupi i kontaktit parashtroi një propozim për një marrëveshje që parashihte armëpushim, zgjidhjen paqësore dhe një masë të madhe të autonomisë dhe praninë e një force ushtarake ndërkombëtare për të garantuar këtë zgjidhje. Raundi i parë i këtyre bisedimeve dukej se po prodhonte një marrëveshje që njihej si 'Marrëveshja e Rambujesë'.⁴¹⁴ Siç u përmend më sipër, konferenca parashihej të përmbyllej me 29 shkurt. Kur u bë e evidente, disa orë para skadimit të afatit të përcaktuar, se as delegacioni i RFJ-së e as delegacioni i Kosovës nuk ishin në pozicion të nënshkruanin marrëveshjen. Grupi i kontaktit vendosi që t'i zgjaste negociatat deri më datën 23 shkurt.⁴¹⁵ Teksti i Marrëveshjes u miratua nga ministrat e Jashtëm të Grupit të Kontaktit në 23 shkurt 1999.⁴¹⁶ Rezultati përfundimtar i Konferencës së Rambujesë, siç përshkruan Weller ishte paksa konfuz. Kosova argumentoi se delegacioni i vet në e kishte pranuar tekstin si rezultat përfundimtar të negociatave dhe se me gjasë do të nënshkruante pas konsultimit në shtëpi.⁴¹⁷ Meqë ishte esenciale që marrëveshja të nënshkruhej në tërësi, Grupi i Kontaktit theksoi se

⁴¹¹ Julie Kim, *Kosovo Conflict Chronology*, 10- 11.

⁴¹² Ibid 11.

⁴¹³ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 211.

⁴¹⁴ Christopher Greenwood, 'Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo', 149.

⁴¹⁵ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 225.

⁴¹⁶ Christopher Greenwood, 'Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo', 149.

⁴¹⁷ Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, 232.

palët kishin premtuar se do të merrnin pjesë në një konferencë pasuese, që do t'i mbulonte të gjitha aspektet e zbatimit, më 15 mars.⁴¹⁸

Në fillim të marsit 1999, në takimin me presidentin Millosheviç, Kryesuesi i OSBE-së raportoi se udhëheqësi serb kishte refuzuar me forcë mundësinë e lejimit të një pranie ndërkombëtare ushtarake në Kosovë.⁴¹⁹ Më 08 mars 1999, pas një takimi të gjatë me të dërguarin amerikan Christopher Hill në Prishtinë, UÇK-ja ra dakord të pranojë marrëveshjen e paqes në Rambuje.⁴²⁰ Një ditë më vonë, më 09 mars, 1999 i dërguari i SHBA-së Richard Holbrooke mbërriti në Beograd për të takuar presidentin Millosheviç. Holbrook tha se ai do të kujtojë Millosheviçin për pasojat e refuzimit të tij të vazhdueshëm për të pranuar marrëveshjen e paqes. Ai paralajmëroi se Jugosllavia dhe Perëndimi ishin në një "rrugë përplasjeje" që mund të çojë në ndërhyrjen e NATO-s.⁴²¹ Pas kthimit nga Kosova në Rambuje, delegacioni Kosovar nënshkroi Marrëveshjen e Rambujesë më 18 mars 1999, ndërsa delegacioni serb jo.⁴²² Marrëveshja e Rambujesë parashihte pushimin e menjëhershëm të forcës, ajo parashihte tërheqjen e trupave serbe dhe kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur.⁴²³ Duke respektuar integritetin territorial të Republikës së ish-Jugosllavisë,⁴²⁴ gjithashtu kërkon që përmes një Kushtetute të krijohen institucionet vetëqeverisëse demokratike në Kosovë.⁴²⁵

Sipas Marrëveshjes, parashihej që palët të ftojnë NATO-n që të udhëhiqte një forcë ushtarake për të ndihmuar sigurinë dhe zbatimin e saj.⁴²⁶ NATO-ja do të krijonte një forcë (KFOR), e cila do të përbëhej nga njësi tokësore, ajrore dhe nga vendet e NATO-s dhe vendet e tjera.⁴²⁷ Gjithashtu parashihej siguri për mbështetjen dhe autorizimin e KFOR-it dhe në veçanti të autorizojë KFOR-in të ndërmarrë veprime të tilla, siç kërkohet, përfshirë edhe përdorimin e forcës së nevojshme, për të siguruar pajtueshmërinë me këtë marrëveshje dhe

⁴¹⁸ Ibid 233.

⁴¹⁹ Julie Kim, *Kosovo Conflict Chronology*, 13.

⁴²⁰ Ibid.

⁴²¹ Ibid.

⁴²² 'The Interim accord of the Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo', (7 June 1999) S/1999/648 <https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf> qasur: 10 Maj 2020 [tani e tutje: . 'The Interim accord of the Rambouillet Accords].

⁴²³ Ibid S/199/648, 5.

⁴²⁴ Ibid S/199/648, 3.

⁴²⁵ Ibid 9.

⁴²⁶ Ibid Article I, 1.a.

⁴²⁷ Ibid Article I, 1.b.

të kontribuojë në një mjedis të sigurt.⁴²⁸ Palët e kuptojnë dhe bien dakord që KFOR-i të ketë të drejtën që të monitorojë dhe të ndihmojë në sigurinë e pajtueshmërisë nga të gjitha palët dhe të përgjigjet menjëherë për çdo shkelje dhe rivendosjen e pajtueshmërisë, duke përdorur forcën ushtarake, nëse kërkohet.⁴²⁹ Personeli i NATO-s do të gëzonte, së bashku me automjetet e tyre, anijet, avionët dhe pajisjet, kalimin e lirë dhe të pakufizuar dhe qasje të pandërprerë në të gjithë RFJ-në, përfshirë hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale.⁴³⁰

Meqenëse Rambouillet ishte thjesht një marrëveshje e përkohshme, çështja se çfarë do të ndiqte më pas atë ishte thelbësore.⁴³¹ Ajo parashihte që “Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, një mbledhje ndërkombëtare do të mbahet për të përcaktuar një mekanizëm për një zgjidhje përfundimtare për Kosovën, mbi bazën e vullnetit të qytetarëve, mendimeve të autoriteteve përkatëse, mundësive të palëve në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe “Aktit Final të Helsinkit”.⁴³²

Pas dështimit të nënshkrimit të marrëveshjes dhe nga pala serbe, një ditë pas nënshkrimit, mikpritësit e konferencës (Franca dhe Mbretëria e Bashkuar) njoftuan që delegacioni i RFJ/Serbisë nuk kishin asnjë qëllim të vazhdonin me bisedime.⁴³³ Ndërsa luftimet vazhduan në Kosovë dhe raportet treguan se 30.000 trupa të tjera jugosllave/serbe ishin duke u vendosur me tankse dhe njësi të parregullta të milicisë, OSBE-KVM u tërhoq më 20 mars. NATO-ja në ndërkohë lëshoi një ultimatum tjetër që kërkonte nënshkrimin e Serbisë, por Parlamenti serb konfirmoi refuzimin e propozimeve të Rambujesë.⁴³⁴ Kështu me rënien e procesit të paqes në Rambuje, OSBE-KVM u tërhoq nga Kosova në 20 mars 1999, përballë një situate të padiskutueshme të përkeqësimit të sigurisë, duke përfshirë vendosjet shtesë të mëdha të forcave ushtarake dhe të sigurisë jugosllave dhe serbe në Kosovë, si dhe ndërkombëtarizimi i afërt i konfliktit.⁴³⁵

⁴²⁸ Ibid Article I, 2b.

⁴²⁹ Ibid Article VIII, 2.a,

⁴³⁰ Ibid Appendix B, 8. 81.

⁴³¹ Eric Herring, *From Rambouillet to the Kosovo accords: NATO'S war against Serbia and its aftermath*, (Routledge, 2014) 226 [tani e tutje: Eric Herring, *From Rambouillet to the Kosovo accords*].

⁴³² ‘The Interim accord of the Rambouillet Accords, Article 1.3.

⁴³³ Christopher Greenwood, ‘Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo’, 150.

⁴³⁴ OSCE Kosovo *As Seen, As Told: An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission*, 32- 33.

⁴³⁵ Ibid 10.

Disa argumentonin se Rambuje ishte një ofertë që presidenti Jugosllav Slobodan Millosheviç nuk do të pranonte,⁴³⁶ me çrast delegacionit Kosovar në Rambuje iu dha garanci se referenca për 'vullnetin e popullit' nënkuptonte vullnetin e popullit të Kosovës (jo të Serbisë apo Jugosllavisë) për tu shprehur në referendum. Dhe nëse Serbia do të refuzonte marrëveshjen, NATO do të bombardonte dhe lufta e pavarësisë do të vazhdonte; ose Serbia do ta pranonte marrëveshjen dhe pavarësia do të vinte përmes një referendumi pas tre vjetësh. Millosheviç tha: 'Ajo që ata u përpoqën të imponojnë në Rambuje nuk ishte autonomi, por pavarësi'.⁴³⁷ Ndërsa, shumë vëzhgues dyshojnë se Serbia mori pjesë në Rambuje me një pritje ose me qëllim të arritjes së marrëveshjes për të ardhmen e Kosovës. Argumentohet se Millosheviç, ishte duke përdorur procesin e bisedimeve për të blerë kohë për t'u përgatitur për raundin tjetër të sulmeve ushtarake serbe në Kosovë. Ai nuk dërgoi një delegacion të nivelit të lartë në Rambouillet dhe ata që ai i dërgoi dukej se ishin të përfshirë me gjysmë zemre në këtë proces. Vetëm në një fazë më të vonshme, Presidenti Serb Milan Milutinoviç u dërgua në Paris për të negociuar direkt.⁴³⁸

Hulumtimi i Komisionit të Pavarur për Kosovën çon në përfundimin se shumica e "grupit perëndimor" (ndoshta me përjashtim të SHBA-së) priste që Millosheviç të pranonte një marrëveshje nën presionin e kërcënimit të bombardimeve. Grupi i UÇK-së nuk duhej të ishte problem; supozohej se ata do të nënshkruanin në fund, nëse mund të merrnin trupa të armatosura tokësore të NATO-s.⁴³⁹ Duke pasur parasysh konfuzionin dhe ndryshimet e mëdha midis shqiptarëve të Kosovës, duhej të ishte e mundur që pala serbe të nënshkruante një marrëveshje që mund të kishte qenë relativisht e mirë nga këndvështrimi i tyre, nëse ata do të kishin qenë mjaft të interesuar për një marrëveshje dhe, mbi të gjitha, ishin përgatitur të pranonin një forcë ndërkombëtare të armatosur në Kosovë. Delegacioni në disa deklarata në fund të negociatave deklaroi se ata ishin të përgatitur për të diskutuar një forcë ndërkombëtare zbatimi në Kosovë, por nëse përfshihet apo jo një forcë e armatosur, është ende e panjohur. Në fund, sipas raportit të Komisionit të pavarur për Kosovën konsideruan se Millosheviçi gaboi llogaritjen e efektit të mosnënshkrimit të marrëveshjes. Si rrjedhojë e kësaj, Serbia ishte shkatërruar pjesërisht dhe ajo humbi pak a shumë të gjithë ndikimin në zhvillimin

⁴³⁶ Eric Herring, *From Rambouillet to the Kosovo accords*, 226.

⁴³⁷ Ibid 226- 227.

⁴³⁸ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 152.

⁴³⁹ Ibid 155.

e ardhshëm të Kosovës ose aftësinë për të mbrojtur serbët në Kosovë (nëse kjo ishte një shqetësim i vërtetë).⁴⁴⁰ Një tipar përcaktues i procesit të Rambujesë sipas raportit të Komisionit të Pavarur për Kosovë ishte afati kohor fiks i kombinuar me ultimatumin e bombardimeve, fatkeqësisht, në Bosnjë dhe në rastin e Kosovës, doli që vetëm kërcënimi me forcë dhe afatet mund të bënin të mundur bisedimet.⁴⁴¹

3.4. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë

Pasi Konferenca e Rambujesë u tregua e pasuksesshme për të arritur një marrëveshje, rrugës diplomatike po i vinte fundi. Më 21 mars 1999, SHBA-ja njoftoi se do të dërgojë Richard Holbrooke në Beograd, në përpjekjen e fundit, për t'i dhënë fund dhunës në Kosovë dhe për të parandaluar sulmet ajrore të NATO-s.⁴⁴² Dy ditë para fillimit të bombardimeve të NATO-s, Holbrooke, pas takimit me Presidentin Millosheviç, e pa se nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm nga udhëheqësi Jugosllavë. Holbrooke zhvilloi një takim të fundit “shansin e fundit” me Millosheviçin, por pa ndonjë marrëveshje ai u largua nga Beogradi, duke e quajtur situatën si më të zbehtë se ndonjëherë.⁴⁴³ Edhe pas përpjekjeve të shumta për arritjen e marrëveshjes paqësore edhe pas kërcënimeve me forcë nga NATO-ja, marrëveshja nuk u arrit.⁴⁴⁴

Pas dështimit të ndonjë marrëveshje dhe pas kërcënimeve të shumta, Javier Solana, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s paralajmëroi fillimin e sulmeve të NATO-s. Ai deklaroi se ky vendim u soll në konsultim me aleatët dhe, pasi u bë e qartë se përpjekja përfundimtare diplomatike e Ambasadorit Holbrooke në Beograd nuk kishte sukses. Ai tha se sulmi do të drejtohej në dobësimin e aftësisë së ushtrisë serbe dhe forcave speciale të policisë dhe dobësimi i aftësisë së tyre për të shkaktuar një katastrofë të mëtejshme humanitare.⁴⁴⁵

Kështu, NATO-ja filloi bombardimet në 24 maj 1999, pa ndonjë autorizim të qartë nga KS-ja.⁴⁴⁶ Arsyeja e mosveprimit të KS-së në bazë të Kapitullit VII të Kartës, ishte paralizimi nga

⁴⁴⁰ Ibid 158.

⁴⁴¹ Ibid. 159.

⁴⁴² Julie Kim, *Kosovo Conflict Chronology*, 15.

⁴⁴³ Ibid.

⁴⁴⁴ Ibid 16.

⁴⁴⁵ Javier Solana, Secretary General of NATO, Press Release (1999)040 23 March 1999.

⁴⁴⁶ Dajena Kumbaro, *The Kosovo Crisis in an International Law Perspective*, 56.

kërcënimi i përdorimit të vetos.⁴⁴⁷ Kërcënimi i përdorimit të vetos nga Rusia dhe Kina bëri që bashkësia ndërkombëtare nuk dëshironte që mosveprimi i KS-së të jetë fundi i ngjarjes. Pavarësisht mungesës së autorizimit të KS-së dhe të shqetësuar për të mos parë një Ruandë dhe Bosnje të re, shtetet e NATO-s vendosën t'i marrin gjërat në duart e tyre. Ato me në krye SHBA-në që e drejtoi operacionin, u munduan të paraqesin një arsyetim ligjor për ndërhyrjen e NATO-s.⁴⁴⁸ Fakti që KS-ja nuk do të vepronte, i lejonte NATO-s të pretendojë me të drejtë se të gjitha mjetet e tjera ishin shteruar.⁴⁴⁹ Kështu në kohën kur NATO-ja vendosi të ndërhyjë, siç përmend John Marriam, ajo posedonte prova thelbësore, që tregonin qartë ekzistencën e një modeli të përhapur të vrasjeve, torturave dhe dëbimeve me forcë dhe një përpjekje që të kujton atë të ndërmarrë nga Nazistët në ditët e mbylljes së Luftës së Dytë Botërore për t'i eliminuar provat e këtyre krimeve.⁴⁵⁰ Një KS i paralizuar nuk ishte në gjendje të vepronte në të dyja rastet për të parandaluar një tragjedi të tmerrshme humanitare. Fuqitë e NATO-s nuk kishin arsye të prisnin asgjë ndryshe në lidhje me Kosovën. NATO-ja me të drejtë kishte frikë se paqëndrueshmëria e shkaktuar nga këto krime universale, dhe përhapja e refugjatëve në Maqedoni dhe Shqipëri, mund të përhapte konfliktin në një luftë tjetër ballkanike. Përballë kësaj situate të papranueshme, NATO-ja zgjodhi të veprojë në mënyrë të njëanshme.⁴⁵¹

Ish-Presidenti i SHBA-së Bill Clinton, duke iu adresuar kombit të vet për ndërhyrjen e NATO-s, deklaroi se:

*Ne veprojmë për të mbrojtur mijëra njerëz të pafajshëm në Kosovë nga një ofensivë ushtarake në rritje. Ne veprojmë për të parandaluar një luftë më të gjerë, për të shpërndarë një fuçi baruti në zemër të Europës, që ka shpërthyer dy herë më parë në këtë shekull me rezultate katastrofale... nëse ne dhe aleatët tanë do të lejonim që kjo luftë të vazhdojë pa përgjigje, Presidenti Millosheviç do të lexonte hezitimin tonë si licencë për të vrarë.*⁴⁵²

⁴⁴⁷ Thomas M. Franck, *Interpretation and change in the law of humanitarian intervention*, 215.

⁴⁴⁸ Rosa Brooks, 'Humanitarian Intervention', 164- 165.

⁴⁴⁹ John J. Merriam, 'Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention', 144.

⁴⁵⁰ Ibid 140.

⁴⁵¹ Ibid 145.

⁴⁵² Bill Clinton, 'Transcript: Clinton addresses nation on Yugoslavia strike', (CNN March 24, 1999) <<http://edition.cnn.com/ALLPOLITICS/stories/1999/03/25/clinton.transcript/>> qasur: 12 Korrik 2019.

Në fillim të bombardimeve sulmet u kryen kundër caqeve ushtarake dhe u përqendrua në rrjetën e mbrojtjes ajrore të RFJ-së. Javier Solana deklaroi se përgjegjësia e krizës aktuale i mbetet Presidentit Millosheviç dhe se varet nga ai që t'i përmbushë kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare. Gjithashtu gjenerali i NATO-s, Wesley Clark, theksoi se operacioni i parë ajror i marrë si përgjigje ndaj tragjedisë thelluese humanitare që po shpalosej në Kosovë, pasi forcat ushtarake dhe të sigurisë Jugosllave vazhdojnë të intensifikojnë sulmet e tyre.⁴⁵³ Menjëherë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s u paraqit një projekt rezolutë në KS të OKB-së nga Rusia, Bjellorusia dhe India, duke kërkuar që veprimet e NATO-s të dënohen si të paligjshme dhe të përcaktonte se përdorimi i forcës nga NATO-ja kundër RFJ-së përbën një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.⁴⁵⁴ Mirëpo KS-ja refuzoi kërkesën për ndërprerje të përdorimit të forcës kundër RFJ-së dhe rifillimin e negociatave, me tre vota për (Kina, Namibia, Federata Ruse) dhe 12 kundër.⁴⁵⁵

Përderisa bombardimet e NATO-s vazhdonin, pas katër javësh, udhëheqja jugosllave ende nuk do t'i përgjigjej propozimit të negociatave. Në një samit të NATO-s në Uashington më 23 prill 1999, udhëheqësit e Aleancës vendosën të intensifikojnë më tej fushatën ajrore, duke zgjeruar objektivin e vendosur për të përfshirë infrastrukturën ushtarake-industriale, mediet dhe synime të tjera në vetë Serbinë.⁴⁵⁶ Deri në fillim të qershorit kur i dërguari i BE-së Martti Ahtisari dhe i dërguari rus Viktor Chernomyrdin sollën një propozim në Beograd që bazohej në parimet e Forumit G8. Këto parime kërkuan përfundim të menjëhershëm të represionit dhe dhunës në Kosovë; tërheqjen e forcave ushtarake, policore dhe paraushtarake; vendosjen e një pranie efektive civile ndërkombëtare; dhe kthimin e refugjatëve. Më 3 qershor, Parlamenti serb miratoi zyrtarisht një plan paqeje të mbështetur në parimet e G8.⁴⁵⁷

Aksionet e NATO-s përfunduan me 10 Qershor me arritjen e marrëveshjes teknike ushtarake midis "KFOR-it" dhe RFJ-së dhe Republikës së Serbisë të arritur një ditë më herët, e njohur si Marrëveshja e Kumanovës. Kjo Marrëveshje parashihte largimin nga Kosova të të

⁴⁵³ Javier Solana and Saceur, Gen. Wesley Clark, Press Conference, (Transcript 25 Mar. 1999) <<https://www.nato.int/kosovo/press/p990325a.htm>> qasur: 12 Korrik 2019.

⁴⁵⁴ UN, S/1999/328 (26 March 1999) Federata Ruse, Bjellorusia dhe India keruan nga KS- ja te nxjerre nje resolute qe do ta konsideronte nderhyrjen e NATO- s si shkelje flagrante te Kartes se OKB- se, nenit 2.4).

⁴⁵⁵ Press Release SC/6659, SC/6659 (26 MARCH 1999).

⁴⁵⁶ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 93.

⁴⁵⁷ Ibid 95- 96.

gjitha forcave të FRJ-së. Ata pajtohen që forca ndërkombëtare e sigurisë ("KFOR-i") të vendosej pas miratimit të Rezolutës së KS-së.⁴⁵⁸ Po atë ditë me përfundimin e sulmeve të NATO-s, KS-ja miratoi Rezolutën 1244, e cila parashihte dhënin fund të dhunës në Kosovë dhe tërheqjen e forcave ushtarake, policore dhe paramilitare nga Kosova dhe vendosjen e pranisë së sigurisë dhe civile ndërkombëtare në Kosovë.⁴⁵⁹

3.4.1. Kritikë e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s

Ndërhyrja e NATO-s kishte dhe kritika. Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën, ndërhyrjen e NATO-s e konsideroi si të suksesshme, sepse ajo detyroi Qeverinë e RFJ-së të tërheqë ushtrinë dhe policinë e saj nga Kosova. Ajo ndaloi shtypjen sistematike të Shqiptarëve të Kosovës. Ndërsa sipas Komisionit, NATO-ja kishte dështuar për të arritur qëllimin e saj të parashikuar për të parandaluar spastrimin masiv etnik, ku më shumë se një milion Kosovarë u bënë refugjatë, rreth 10.000 e humbën jetën; shumë ishin plagosur, idhin përdhunuar ose ishin sulmuar në mënyra të tjera.⁴⁶⁰ NATO-ja kishte filluar fushatën e bombardimeve me shpresën se qeveria Jugosllave të propozojë armëpushim dhe të dëshirojë të rinovojë negociatat pas vetëm disa ditësh. Sipas Komisionit për Kosovën, edhe dy gabime të tjera të supozuara pësuan në mënyrë të pashmangshme nga kjo pikënisje e gabuar, edhe atë: i pari, meqenëse fushata e bombardimeve fillimisht ishte planifikuar të zgjasë vetëm disa ditë dhe të përfshinte një numër të kufizuar objektivash ushtarake, qeveritë e NATO-s nuk i përgatitën zonat e tyre dhe për pasojat e asaj që do të vinte pas 78 ditëve konflikti intensiv, dhe i dyti, NATO-ja gabimisht supozoi se një fushatë e shkurtër bombardimesh nuk do të çonte në përshkallëzimin dramatik të zhvendosjes dhe dëbimit të popullatës shqiptare të Kosovës.⁴⁶¹

Komiteti për Punë të Jashtme në Parlamentin Britanik në raportimin e tij beson se u bë gabim serioz kur u supozua se bombardimi nuk do të çonte në përshkallëzimin dramatik në shpërnguljen dhe dëbimin e popullatës Shqiptare të Kosovës, dhe se liderët politik të NATO-s ishin tepër optimist në lidhje me perspektivën që Millosheviçi të tërhiqej madje para se të

⁴⁵⁸ 'Military Technical Agreement between the International Security Force ("KFOR") and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia', (9 June 1999), <<https://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>> qasur: 12 Korrik 2019.

⁴⁵⁹ UN, S/RES/1244 (1999).

⁴⁶⁰ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 97.

⁴⁶¹ Ibid 92- 93.

fillonte fushata e bombardimeve. Ky optimizëm e dëmtoi fushatën e NATO-s kundër Millosheviçit. Ata gjithashtu konkludojnë se për shkak se sulmi tokësor ishte përjashtuar në një fazë të hershme, NATO-ja nuk ishte në gjendje të niste një sulm tokësor në mars 1999 dhe se duheshin shumë muaj për të krijuar një forcë të mjaftueshme. Andaj, sipas tyre, për shkak të vështirësive ushtarake e logjistike, ka të ngjarë se nëse do të ishte vërtetuar një fillim i një sulmi tokësor, konflikti do të mund të ishte zgjatur dhe mund të kishte përfshirë më shumë viktima.⁴⁶² Pohimi i fundit është i vështirë për t'u vlerësuar. Ne nuk mund ta dimë se çfarë do të ndodhte, nëse NATO nuk do të kishte filluar bombardimet. Sidoqoftë nuk është e vërtetë që NATO-ja provokoi sulme ndaj popullatës civile kosovare, sepse përgjegjësia për këtë fushatë i përket tërësisht qeverisë së Beogradit. Por kjo fushatë ishte gjithashtu gabimi më i rëndësishëm i Millosheviçit. Udhëheqësit e RFJ-së mund të kenë menduar se fluksi i madh i refugjatëve që do të krijonin një krizë politike për vendet fqinje ose që qeveritë europiane do të nervozoheshin përballë qindra mijëra refugjatëve të rinj në pragjet e tyre. Ata gjithashtu mund të kenë menduar se mund të krijojnë një lloj realizimi fati, që një marrëveshje e negociuar më vonë do të lejonte që të paktën një pjesë e popullsisë shqiptare kosovare të qëndronte jashtë Kosovës.⁴⁶³

Gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s prokurori i Tribunalit për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi ka pranuar kërkesa të shumta që ajo të hetojë pretendimet se figura të larta ushtarake të vendeve të NATO-s kryen shkelje serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare gjatë fushatës së tyre. Kritikën e fushatës së bombardimeve përfshinë edhe pretendimet se forcat e NATO-s sulmuan qëllimisht objektiva të infrastrukturës civile (dhe se sulme të tilla ishin të paligjshme), sulmuan me dashje ose pamëshirshëm popullatën civile dhe shkaktuan viktima të tepërta civile. Disa akuza kanë shkuar deri aty sa e akuzojnë NATO-n për krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Në maj 1999 Prokurori themeloi një komitet, i cili do të hetonte akuzat për incidentet e bombardimeve të NATO-s. Komiteti paraqiti raportin e tij Zyrës së Prokurorit të Tribunalit për Krime të Luftës për ish-Jugosllavi. Sipas këtij raporti, NATO-ja ka pranuar se gabimet kanë ndodhur gjatë fushatës së bombardimeve; gabimet në vlerësime gjithashtu kanë ndodhur. Megjithatë, pas informacioneve të shqyrtuara, Komiteti

⁴⁶² Foreign Affairs Committee, *Response of the Secretary of State for Foreign and Commonwealth Affairs*, Fourth Report, from the Session (1999–2000), Presented to Parliament by the Secretary of State for Foreign and Commonwealth Affairs by Command of Her Majesty August 2000, para. 105, 1011, 115 [tani e tutje: *Foreign Affairs Committee, Response of the Secretary of State for Foreign and Commonwealth Affairs*].

⁴⁶³ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 88- 89.

është i mendimit se “asnjë hetim i thellë lidhur me fushatën e bombardimeve në tërësi dhe asnjë hetim në lidhje me incidentet specifike nuk janë të nevojshme”.⁴⁶⁴

Megjithatë, ishte abuzimi i vazhdueshëm i forcave serbe, masakrat dhe granatimet pa dallim ato të cilat përbënin një kërcënim të rëndë për jetën dhe “shokuan ndërgjegjen” e vendeve të NATO-s. Sidoqoftë, ndërhyrja nuk ndodhi deri sa vëzhguesit e BE-së dhe vëzhguesit e OSBE-së u tërhoqën dhe serbët filluan ofensivën e tyre të madhe ku NATO-ja vendosi të ndërhyjë. Kur ushtria serbe filloi shtypjen e saj të fundit, diplomacia kishte dështuar qartë. Siç argumenton John Merriam, kishte kaluar një vijë që e bënte ndërhyrjen një mundësi, ku përdorimi i forcës pasi të gjitha mjetet kishin dështuar. Këtij operacioni nga NATO-ja, i paraprinë 15 muaj përpjekje diplomatike për të zgjidhur problemet e rajonit në mënyrë paqësore.⁴⁶⁵

3.5. Ligjshmëria dhe legjitimiteti i ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë

Çështja nëse dikush ka të drejtë të ndërhyjë me forcë ushtarake për të shpëtuar njerëzit nëse jeta e tyre është në rrezik, është bërë përsëri temë diskutimi në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve politike ndërkombëtare, para dhe pas fillimit të sulmeve 78 ditore të NATO-s në Serbi dhe Kosovë.⁴⁶⁶ Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë kryesisht supozohet se bie në kuadër të doktrinës së ndërhyrjes humanitare, pasi vetë Aleanca deklaroi se kishte ndërhyrë në bazë të qëllimeve mbizotëruese humanitare. Është e qartë se në kohën e ndërhyrjes së NATO-s, është diskutuar dhe diskutohet se nëse Karta ndalon apo lejon ndërhyrjen e njëanshme humanitare.⁴⁶⁷ Pavarësisht ligjshmërisë ose arsyeshmërisë së ndërhyrjes në Kosovë, mungesa e autorizimit nga KS-ja është një pyetje që ka shqetësuar studiuesit. Andaj, ajo çka e bën çështjen e Kosovës të jashtëzakonshme, është shkalla në të cilën kjo çështje ka kapërcyer revistat shkencore dhe bëhet fokusi kryesor i diskutimit

⁴⁶⁴ United Nations, International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, *Final Report to the Prosecutor by the Committee Established to Review the NATO Bombing Campaign Against the Federal Republic of Yugoslavia*, (1999) par. 1- 4, 91 <<https://www.icty.org/en/press/final-report-prosecutor-committee-established-review-nato-bombing-campaign-against-federal>> qasur: 11 Shtator 2019.

⁴⁶⁵ John J. Merriam, ‘Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention’, 141- 142.

⁴⁶⁶ DAJENA KUMBARO, *The Kosovo Crisis in an International Law Perspective*, 49.

⁴⁶⁷ Ibid 53- 55.

diplomatik dhe debatit publik.⁴⁶⁸ Qysh pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s, Kofi Annan në adresimin e tij pranë Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, gjatë raportimit në AP, pas ndërhyrjes në Kosovë, në shtator 1999, vë në pah se konflikti i fundit në Kosovë ka ngjallur pyetje të rëndësishme në lidhje me pasojat e veprimit dhe mungesën e unitetit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Ai ka hedhur dilemën e quajtur ndërhyrje humanitare: nga njëra anë çështje e legjitimitetit të një veprimi të ndërmarrë nga një organizatë rajonale pa një mandat të OKB-së, nga ana tjetër, një imperativ të njohur botërisht për të ndaluar në mënyrë efektive shkeljet mizore e sistematike të të drejtave të njeriut. Dhe pamundësia për tu pajtuar nga bashkësia ndërkombëtare për këto të dyja, është vetëm se një tragjedi.⁴⁶⁹

Shumica e shteteve do të thoshin se KS-ja duke vepruar nën Kapitullin e VII-të të Kartës, mund të autorizojë veprimet ushtarake, por çështja është e vështirë kur KS-ja nuk është në gjendje ose nuk mund të autorizojë veprimin ushtarak në rrethana të tilla. Në këto raste, shtetet mund të përballen përsëri me dilemën që u ngritë në Kosovë. Prandaj, marrë në përgjithësi, lidhur me argumentimin e ndërhyrjes humanitare Jane Stromseth me të drejtë argumenton se duke marrë parasysh situatat në rrethana të tilla edhe në rastin e ndërhyrjes në Kosovë mund të identifikohen disa qëndrime të ndara rreth ndërhyrjes humanitare në mungesë të autorizimit nga KS-ja. Pikëpamja e parë, pohon se ndërhyrja humanitare është e ligjshme vetëm nëse është bërë me autorizim të KS-së ose nëse është kualifikuar si ushtrim i vetëmbrojtjes sipas Nenit 51 të Kartës.⁴⁷⁰ Sipas pikëpamjes së dytë, ndërhyrja humanitare pa mandat të KS-së është teknikisht e paligjshme sipas rregullave të Kartës së OKB-së, por mund të jetë e justifikuar moralisht dhe politikisht në disa raste të jashtëzakonshme. Qasja e tretë, pretendon në një evolucion i së drejtës zakonore të një justifikimi ligjor për ndërhyrje humanitare në raste të rralla. Ndërsa grupi i katërt favorizon kodifikimin e një doktrine të

⁴⁶⁸ Jane Stromseth, 'Rethinking Humanitarian Intervention: The Case For Incremental Change, Humanitarian Intervention Ethical, Legal, And Political Dilemmas' (EDITED BY J. L. Holzgrefe And Robert O. Keohane, Cambridge University Press 2003) 232 [tani e tutje: Jane Stromseth, 'Rethinking Humanitarian Intervention'].

⁴⁶⁹ 'Secretary-General Statements and Messages Secretary-General Presents his Annual Report to General Assembly', (1999) (Press Release SG/SM/7136 GA/9596), <<https://www.un.org/press/en/1999/19990920.sgsm7136.html>> qasur: 12 Shtator 2019 [tani e tutje: 'Secretary-General Statements and Messages Secretary-General Presents his Annual Report to General Assembly'].

⁴⁷⁰ Jane Stromseth, 'Rethinking Humanitarian Intervention', 214.

qartë ose “të drejtën” e ndërhyrjes humanitare përmes disa mënyrave zyrtare të kodifikimit, ose nëpërmjet ndryshimit të Kartës së OKB- së ose një Deklarate të AP-së.⁴⁷¹

Në këtë kapitull do të trajtohen në veçanti qëndrimet dhe argumentet e shteteve dhe autorëve të ndryshëm të së drejtës ndërkombëtare lidhur me ligjshmërinë dhe legjitimitetin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë.

3.5.1. Argumentet për ligjshmërinë dhe legjitimitetin

Duke marrë parasysh atë çka u theksua më sipër, shihet se çështja e ndërhyrjes humanitare nuk ka ndonjë pajtueshmëri të përgjithshme universale. Prandaj, legaliteti i pasigurtë i ndërhyrjes humanitare u bë një barrë shumë e lartë e arsytimit të atyre që do të ndërhyjnë pa autorizim të OKB-së. Kjo pasi që, përdorimi i forcës nga NATO-ja në Kosovë ngriti dilemën ligjore, sepse ajo nuk ishte autorizuar nga KS-ja, as nuk ishte një ushtrim i të drejtës së vetëmbrojtjes individuale dhe kolektive në bazë të Kartës së OKB-së.⁴⁷² Gjatë fushatës ajrore të NATO-s më 1999 në Kosovë, për shumicën e juristëve ndërkombëtarë mbetet e qartë në heshtje ndaj ligjshmërisë së rreptë të ndërhyrjes.⁴⁷³ Në kohën kur NATO-ja ndërhyri në Kosovë, mjetet paqësore të zgjidhjes së konfliktit ishin shteruar. Shumë takime ishin thirrur, KS-ja kishte caktuar embargo, shumë përfaqësues ndërkombëtar kanë shkuar në Beograd dhe shumë takime të tjera janë mbajtur. Negociatat e Rambujesë gjithashtu dështuan pasi Millosheviqi i refuzoi ato. Andaj, për shkak të pamundësisë për të marrë miratimin në KS, NATO-ja si përgjigje, urdhëroi ndërhyrjen humanitare dhe bombardimet.⁴⁷⁴

Qysh në fillim të bombardimeve të NATO-s shtete të ndryshme argumentuan qëndrimet e tyre në mbështetje të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë. Si për shembull, përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë, Francës, Gjermanisë, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës që e mbështetën dhe e konsideronin ndërhyrjen e

⁴⁷¹ Ibid 244- 245.

⁴⁷² Jane Stromseth, ‘Rethinking Humanitarian Intervention’, 233- 234.

⁴⁷³ Michael Byers and Simon Chesterman, ‘Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law’, 177.

⁴⁷⁴ Ibid 190.

NATO-s në Kosovë si një domosdoshmëri për të parandaluar një katastrofë humanitare.⁴⁷⁵ Edhe pse dy ditë pas fillimit të bombardimeve Rusia, Bjellorusia dhe India kishin kërkuar nga KS që veprimet e NATO-s t'i dënonte si të paligjshme⁴⁷⁶, megjithatë KS kishte refuzuar një kërkesë të tillë.⁴⁷⁷ KS-ja nuk e kishte dënuar asnjëherë ndërhyrjen humanitare në asnjë rezolutë të saj që nënkupton një pranim në heshtje të ndërhyrjes së saj.⁴⁷⁸ Edhe pse KS nuk e autorizoi përdorimin e forcës, ajo dha një bekim prapaveprues duke autorizuar trupat e NATO-s për të rivendosur sigurinë në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me Misionin e OKB-së në Kosovë.⁴⁷⁹ Kishte qëndrime se asnjë autorizim as mbështetje nuk ishte paraparë me Rezolutën 1244 të 10 qershorit 1999 dhe as nuk i vërtetoi veprimet e NATO-s në Kosovë⁴⁸⁰ por, as nuk përmbante kritikën për përdorimin e forcës së NATO-s, madje as në një mënyrë implicite.⁴⁸¹ Është thënë se është e vështirë të shihet Rezoluta si autorizim i nënkuptuar i asaj që kishte ndodhur, kur Rusia dhe Kina vazhduan të thoshin se veprimet e NATO-s janë të paligjshme. Por, siç pohon me të drejtë Christopher Greenwood, të thuash se rezolutat e KS-së nuk siguruan vetë një bazë të veçantë për ligjshmërinë e veprimit të NATO-s nuk do të thotë, megjithatë se Rezolutat e KS-së për Kosovën nuk ishin të rëndësishme për çështjen nëse NATO veproi në mënyrë të ligjshme. Në të kundërtën ato formojnë një pjesë të rëndësishme të kornizës ligjore brenda së cilës veproi NATO. Tri rezoluta të miratuara për Kosovën para 24 marsit 1999 u miratuan nën kapitullin VII të Kartës, e konsideruan situatën si kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare të cilat ishin të obliguar për të gjithë. Ato gjithashtu, përbënin një përcaktim autoritar se situata në Kosovë përfshinte shkelje serioze njerëzore nga RFJ dhe se ishte një katastrofë humanitare para se të ndërhynte NATO.⁴⁸² Veprimi i NATO-s meriton mbrojtje më të madhe sesa veprimi thjesht të njëanshëm. Vështirësitë praktike të ndërhyrjes në Kosovë mund të rezultojnë më me ndikim se sa parimi juridik në përcaktimin nëse vendimi i NATO-s do të përqafohet në të ardhmen. Kjo ishte një ndërhyrje e një lloji

⁴⁷⁵ UN, S/PV.3988, (24 March 1999) 4,5,18.

⁴⁷⁶ UN, S/1999/328 (26 March 1999).

⁴⁷⁷ Press Release, UN, SC/6659, SC/6659 (26 March 1999).

⁴⁷⁸ John J. Merriam, 'Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention', 152.

⁴⁷⁹ Rosa Brooks, 'Humanitarian Intervention', 165- 166.

⁴⁸⁰ Michael Byers and Simon Chesterman, 'Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law', 182.

⁴⁸¹ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention', 192.

⁴⁸² Christopher Greenwood, 'Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo', 155- 156.

sfidues sepse nuk kishte për qëllim rrëzimin e një regjimi të veçantë, ose shpëtimin e një grupi të vogël njerëzish.⁴⁸³

Ndërhyrja e NATO-s edhe pse është kundërshtuar nga disa shtete, të cilat flasin hapur kundër ndërhyrjes humanitare, duke përfshi: Kinën, Rusinë, Indinë Meksikën, Bjellorusinë, Ukrainën,⁴⁸⁴ megjithatë ndërhyrja e NATO-s është një shembull i ndërhyrjes humanitare multilaterale, sepse NATO nuk ishte shtet fqinjë, e as aleat i cilësdo pale ndërluftuese, por një aleancë ushtarake shumëpalëshe ku objektivi kryesor i saj ishte parandalimi i tragjedisë humanitare dhe në këtë mënyrë ruajtja e paqes dhe stabilitetit të Europës në tërësi dhe ndërhyrja shumëpalëshe është treguar më efektive dhe më e ligjshme sesa ndërhyrja nga një shtet.⁴⁸⁵ Përballë kërcënimit të veto-s në KS nga Rusia dhe Kina, siç konkludon Komiteti Britanik për Punë të Jashtme se aleatët e NATO-s bënë gjithçka mundën për të bërë ndërhyrjen ndërkombëtare në Kosovë, në përputhje me parimet e të drejtës ndërkombëtare.⁴⁸⁶ AP-ja kurrë nuk e dënoi në mënyrë të qartë luftën e NATO-s në Kosovë, ose ndonjë nga rastet e tjera në veprimet ushtarake të viteve të 90-ta për qëllime humanitare.⁴⁸⁷ Bashkimi Europian gjithashtu dërgoi një komunikim për Sekretarin e Përgjithshëm duke përkrahur ndërhyrjen e NATO-s. Gjithashtu, mbështetje i dhanë edhe Organizata e Shteteve Islamike duke shprehur “keqardhje” se KS-ja nuk arriti të iniciojë përgjegjësinë e saj parësore në bazë të Kartës.⁴⁸⁸

Argumentet e disa shteteve shkuan edhe më tej duke konsideruar për ligjshmëri dhe legjitimitet të ndërhyrjes së NATO-s, si për shembull, argumenti i Sllovenisë në lidhje me ndërhyrjen e NATO-s pa autorizim të KS-së që nuk e sheh si një fenomen të ri, duke konsideruar se “Përgjegjësia e KS-së për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare është një përgjegjësi parësore, por nuk është përgjegjësi ekskluzive”.⁴⁸⁹ Klinton Alexander, e ndan të njëjtin mendim se KS-ja mbetet autoriteti kryesor ndërkombëtar nën kujdesin e të cilit kryhen operacionet e ndërhyrjes humanitare. Të gjitha qeveritë duhet të kërkojnë autorizim së pari

⁴⁸³ Ruth Wedgwood, ‘The American Journal of International Law’ (1999) (93)828, Editorial Comments: Nato’s Kosovo Intervention, 833 [tani e tutje: Ruth Wedgwood, ‘The American Journal of International Law’].

⁴⁸⁴ UN, S/PV.3988 (1999).

⁴⁸⁵ John J. Merriam, ‘Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention’, 150- 151.

⁴⁸⁶ Foreign Affairs Committee, *Response of the Secretary of State for Foreign and Commonwealth Affairs*, para. 134.

⁴⁸⁷ Adam Roberts, ‘The United Nations and Humanitarian Intervention’, 88.

⁴⁸⁸ Matthew C. Cooper, ‘A Note To States Defending Humanitarian Intervention’, 192.

⁴⁸⁹ UN, S/PV.3988, (1999) 19.

në KS përpara se të ndërhyhet në punët e brendshme të një shteti tjetër. Sidoqoftë, ai konsideron se KS-ja nuk është burimi i vetëm autoritar për shtetet për të kërkuar dhe vendosur nëse do të ndërhyhet ose jo në shtetin tjetër për qëllime humanitare.⁴⁹⁰ Ndërsa Holanda argumentoi se “po veprojmë mbi bazën ligjore që kemi në dispozicion, dhe ajo çka kemi në dispozicion është më shumë se adekuate”. Holanda konsideroi se “për shkak të interpretimit të ngurtë të një ose dy anëtarëve të përhershëm të konceptit të juridiksionit të brendshëm, një rezolutë e tillë nuk është e arritshme, por ne nuk mund të rrimë duarkryq dhe thjesht të lejojmë që të ndodhë një katastrofë humanitare”.⁴⁹¹ Për Mbretërinë e Bashkuar “si një masë e jashtëzakonshme për shkak të domosdoshmërisë mbizotëruese humanitare, ndërhyrja ushtarake ishte juridikisht e justifikuar”.⁴⁹² Qeveria Britanike vazhdimisht ka pohuar se “veprimet ushtarake të ndërmarra në fushatën e Kosovës kanë qenë të ligjshme, dhe se NATO nuk do të kishte vepruar jashtë parimeve të së drejtës ndërkombëtare”.⁴⁹³ Belgjika, siç duket, ishte më e bindur se NATO-ja po vepronte në mënyrë të ligjshme. Argumentin e saj në rastin e paraqitur nga Serbia dhe Mali i Zi në GjND kundër Belgjikës gjatë kohës së ndërhyrjes së NATO-s, Belgjika e konsideroi ndërhyrjen si të ligjshme, duke konsideruar se “kjo është një ndërhyrje e armatosur, në përputhje me nenin 2(4) të Kartës së OKB-së. Belgjika e sheh “si një rast të ndërhyrjes së ligjshme humanitare të armatosur për të cilën ekziston një domosdoshmëri imponuese”.⁴⁹⁴ Ndërsa, SHBA-ja dhe NATO ishin të pa sigurtë nëse shtetet e tjera do të praninin ndonjë justifikim ligjor, ata nuk dëshironin të parashtronin ndonjë teori juridike e cila do të mundej të kundërshtojë pastaj nga shtetet e tjera. Ata ndërhyrjen në Kosovë e lanë në sferën jashtë ligjore dhe e lanë historinë ta gjykojë atë dhe historia e gjykojë me mjaft mirësi.⁴⁹⁵

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë u justifikua si legjitime edhe nga Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën. Ky Komision konkludoi se “ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte e kundërligjshme, por legjitime”. Sipas këtij Komisioni, ndërhyrja ishte e kundërligjshme sepse

⁴⁹⁰ Clinton W. Alexander, ‘Nato’s Intervention In Kosovo: The Legal Case for Violating Yugoslavia’s “National Sovereignty” In The Absence of Security Council Approval’, (2000) 40.

⁴⁹¹ UN, S/PV.3988, (24 March 1999)

⁴⁹² Ibid.

⁴⁹³ House of Commons, *Foreign Affairs- Fourth Report, Foreign Affairs Committee Publications*, (Session 1999-2000) <<https://publications.parliament.uk/pa/cm199900/cmselect/cmfaaff/28/2802.htm>> qasur: 10 Shtator 2019 [tani e tutje: House of Commons, *Foreign Affairs- Fourth Report, Foreign Affairs Committee Publications*].

⁴⁹⁴ ICJ, *Legality of Use of Force (Serbia and Montenegro v. Belgium)* 12- 13 <<https://www.icj-cij.org/en/case/105>> qasur: 10 Shtator 2019.

⁴⁹⁵ osa Brooks, ‘Humanitarian Intervention’, 166.

nuk mori aprovimin paraprak nga KS-ja. Sidoqoftë, Komisioni konsideron se ndërhyrja ishte e justifikuar dhe legjitime sepse të gjitha rrugët diplomatike ishin shteruar dhe për shkak se ndërhyrja pati efektin e çlirimit të popullatës shumicë të Kosovës nga një periudhë e gjatë shtypjesh nën sundimin serb.⁴⁹⁶ Komisioni konstaton se duke pasur parasysh katastrofën humanitare të shpërthyer nga modeli serb i kriminalitetit shtypës ndaj popullatës civile shqiptare në Kosovë, përdorimi i forcës nga NATO-ja ishte legjitim, pasi ishte mjeti i vetëm praktik në dispozicion për të mbrojtur Kosovarët shqiptare nga abuzimi i mëtutjeshëm.⁴⁹⁷ Duke folur *de lege lata*, megjithatë, edhe avokatët ndërkombëtarë që mbështesin idenë e ndërhyrjes humanitare të njëanshme do të duhej të mbështeten në qasjen "e paligjshme, por legjitime".⁴⁹⁸

Për Bruno Simma, baza kryesore ligjore për një veprim të tillë ishte "ndërhyrja humanitare", e lidhur sa më shumë që të jetë e mundur me Kartën e OKB-së, në mënyrë që të fitojë sa më tepër legjitimitet.⁴⁹⁹ Edhe për Simman ndërhyrja pa autorizim eksplisit të KS-së ishte e kundërligjshme,⁵⁰⁰ por Aleanca bëri gjithçka që ishte e mundur që të jetë sa më afër ligjshmërisë. Prandaj ai konkludon se "vetëm një vijë e kuqe e hollë e ndan veprimin e NATO-s në Kosovë nga ligjshmëria ndërkombëtare".⁵⁰¹ Antonio Cassese nuk pajtohet me Simman.⁵⁰² Përgjigja e Cassese është se nga pikëpamja etike përdorimi i forcës së armatosur ishte i justifikuar. Sidoqoftë, si ekspert i së drejtës, ai thotë se nuk mund të shmang vërejtjen në të njëjtën frymë se ky veprim moral është në kundërshtim me të drejtën aktuale ndërkombëtare. Mirëpo, shikuar *de lege ferenda*, ai paraqet disa kushte strikte nën të cilat shpresa për përdorimin e forcës së armatosur gradualisht mund të bëhet e justifikuar, madje edhe në mungesë të autorizimit nga KS-ja.⁵⁰³ Për Ruth Wedgwood, lufta në Kosovë mund të shënojë fundin e klasicizmit të KS-së. Ajo mund të shënojë gjithashtu shfaqjen e një të drejte të kufizuar të ndërhyrjes humanitare, duke lejuar përdorimin e forcës për të mbrojtur jetën e

⁴⁹⁶ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 4.

⁴⁹⁷ Ibid 167.

⁴⁹⁸ Petr Valek, 'Is Unilateral Humanitarian Intervention Compatible with the U.N. Charter?', (2005) (26)4, Michigan Journal of International Law, 1255 [tani e tutje: Petr Valek, 'Is Unilateral Humanitarian Intervention Compatible with the U.N. Charter?'].

⁴⁹⁹ Bruno Simma, 'NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects', 7.

⁵⁰⁰ Ibid 11.

⁵⁰¹ Ibid 22.

⁵⁰² Antonio Cassese, 'Ex iniuria oritur: Are We Moving toward International Legitimacy of Forcible Humanitarian Countermeasures in the World Community?' (1999) (10), EJIL 24 [tani e tutje: Antonio Cassese, 'Ex iniuria oritur'].

⁵⁰³ Ibid 27.

një popullate të kërcënuar ku vendimet merren nga shumica e botës që do ta njihte si organizatë shumëpalëshe përgjegjëse dhe KS-ja nuk do të kundërshtonte këtë veprim.⁵⁰⁴

Normalisht, studiuesit arrijnë në përfundime të ndryshme, që tregon se çështjet e së drejtës janë të vështira dhe për të cilat studiuesit me arsye mund të mos pajtohen. Edhe pse në bazë të qasjes tradicionale ndërhyrja në Kosovë duke u bazuar në interpretimin e traktateve ndërkombëtare nga shumë shtete dhe autorë shihet si e paligjshme. Por, debatet për ndërhyrjen në Kosovë mund të shihen në një kontekst më të gjerë të ndryshimeve në natyrën e argumentimit juridik ndërkombëtar në përgjithësi.⁵⁰⁵ Normat që mbështesin ndërhyrjen ushtarake për qëllime humanitare, madje ndërhyrjen e njëanshme, kanë evoluar në mënyrë thelbësore sidomos në dy dekadat e fundit, si rezultat i raportit të KNNSSH-së të vitit 2001 dhe si rezultat i përqafimit të mëvonshëm të PpM nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, sipas Rosa Brooks edhe pse normat që mbështesin ndërhyrjen humanitare janë artikuluar, përpunuar dhe vendosur në një bazë të fortë teorike dhe juridike, konsensusi ndërkombëtar që mbështet ndërhyrjet e tilla humanitare është në rrëmujën më të madhe që nga fundi i Luftës së Ftohtë.⁵⁰⁶ Mungesa e ndonjë burimi të vetëm rregullash ose arbitrit përfundimtar të marrëveshjeve në çështjet ndërkombëtare do të thotë se praktika shtetërore mbetet thelbësore në formimin e një norme juridike. Kur një veprim vlerësohet si urgjent nga shumica e shteteve, madje edhe një veprim që përfshin përdorimin e forcës, ka të ngjarë të krijojë një justifikim ligjor.⁵⁰⁷ Ashtu edhe siç i kemi trajtuar disa raste praktike më sipër ku arsyet humanitare kanë shërbyer si një justifikim i një numri ndërhyrjesh si: Vietnami në Kamboxhia, India në Pakistanin Lindor, Tanzania në Uganda etj., ku të gjitha këto veprime ishin të njëanshme.⁵⁰⁸

⁵⁰⁴ Ruth Wedgwood, 'The American Journal of International Law', 828.

⁵⁰⁵ Michael Byers and Simon Chesterman, 'Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law', 178.

⁵⁰⁶ Rosa Brooks, 'Humanitarian Intervention', 179.

⁵⁰⁷ Ruth Wedgwood, 'The American Journal of International Law', 828.

⁵⁰⁸ Ibid 833.

3.6. Krijimi i një opinio juris pas Kosovës

Nëse nuk ka një justifikim ligjor brenda Kartës së OKB- së për ndërhyrjen në Kosovë, duhet të shikohet nëse një e drejtë e ndërhyrjes ishte zhvilluar në të drejtën zakonore ndërkombëtare.⁵⁰⁹ Sipas botëkuptimeve tradicionale në të drejtën ndërkombëtare, e vetmja mënyrë sipas së cilës ndërhyrja në Kosovë mund të ishte e ligjshme është që e drejta e ndërhyrjes humanitare të ketë arritur statusin e *jus cogens* dhe kështu të tejkalojë dispozitat e traktatit. Nëse kjo gjë kishte ndodhur më 24 Mars 1999 duhet të shikohet praktika e shteteve në dekadat para ndërhyrjes, pra a kishte ndikuar mbizotërimi i praktikës shtetërore dhe shoqërimi i *opinio juris* drejt një ndryshimi i një të drejte të ndërhyrjes humanitare në mungesë të autorizimit nga KS- ja?⁵¹⁰ Për, Byers dhe Chesterman, mbi bazën e të njëjtave kuptime tradicionale të së drejtës ndërkombëtare, ndërhyrja në Kosovë nuk mund të kontribuonte as në zhvillimin e ardhshëm të një të drejte të tillë.⁵¹¹ Ndërsa Einze, argumenton se shumë nga detajet e ndërhyrjes në Kosovë e bëjnë këtë përfundim të pasigurtë. Sipas tij, problemi kryesor është se shtetet ndërhyrëse në Kosovë nuk demonstrojnë një sens të *opinio juris*.⁵¹² Byers dhe Chesterman, konsiderojnë se është tepër ambicioze të thuhet se e drejta zakonore është në zhvillim e sipër. Ata vijnë në përfundim se të paktën, doktrina e ndërhyrjes humanitare ka një bazë të ngushtë në të drejtën aktuale zakonore ndërkombëtare dhe kjo e bën ndërhyrjen e NATO-s juridikisht të diskutueshme.⁵¹³ Duke konsideruar se është jashtëzakonisht e pamundur që kriteret e zbatueshme në të drejtën e ndërhyrjes humanitare pa autorizim të KS-së nuk do të zhvillohen ndonjëherë për të kënaqur një ose më shumë se një grup shtetesh. Por, futjen e Kosovës brenda kategorive të rregullta të së drejtës ndërkombëtare e shohin si të kuptueshme, por të gabuar.⁵¹⁴

NATO-s i mungon karakteri juridik që pritet të kontribuojë në përmirësimin e kërkesës së *opinio juris*.⁵¹⁵ Andaj nuk është e mjaftueshme të karakterizohet ndërhyrja e NATO-s si një

⁵⁰⁹ Michael Byers and Simon Chesterman, 'Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law', 182.

⁵¹⁰ Ibid 184.

⁵¹¹ Ibid.

⁵¹² Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*, 77.

⁵¹³ Michael Byers and Simon Chesterman, 'Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law', 200.

⁵¹⁴ Ibid 203.

⁵¹⁵ Ibid 169.

veprim i drejtuar për krijimin e një norme të re të ndërhyrjes humanitare në konfliktet e brendshme.⁵¹⁶ Për Eric Einze praktika shtetërore dhe *opinio juris* qëndron kundër lejimit të ndërhyrjes si çështje juridike. Nëse Kosova do të lejohej të llogaritej drejtë formimit të së drejtës zakonore, pasi ajo u zhvillua në pjesën më të madhe të këtij aktiviteti dhe pak a shumë është pranuar nga bashkësia ndërkombëtare, mund të jetë tregues që praktika zakonore është duke ndërmarrë me siguri një hap në drejtim të lejimit të ndërhyrjes humanitare. Megjithatë, sipas tij mungesa e një *opinio juris* në rastin e Kosovës e bën atë një kandidat të dobët për të kontribuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare edhe pse ekziston një tolerancë e përgjithshme për normat e ndërhyrjes që dalin nga ndërhyrja në Kosovë. Einze konsideron se është e vështirë të argumentohet për ekzistencën e një modeli të vazhdueshëm të praktikës shtetërore, ku vetëm një ose dy raste të ndërhyrjes humanitare mund të llogariten si dëshmi e së drejtës zakonore ndërkombëtare.⁵¹⁷ Edhe Ian Brownlie konsideron se "ka shumë pak prova për të mbështetur pohimet se një parim i ri i së drejtës zakonore që legjitimon ndërhyrjen humanitare është kristalizuar".⁵¹⁸ Brooks mendon se përgjigjja më e sigurtë është se e drejta zakonore ndërkombëtare mbetet në rrëmujë në këtë temë. Do të shkonte shumë larg, pas debatit të Kosovës e drejta zakonore ndërkombëtare qartazi ndalon ndërhyrjen humanitare pa autorizim të KS-së, por gjithashtu shkon shumë larg, për të pohuar se ndërhyrje të tilla lejohen qartazi me të drejtën zakonore ndërkombëtare. Kjo e drejtë është e pazgjidhur dhe duket se do të mbetet e tillë edhe në të ardhmen.⁵¹⁹

Duke e konsideruar shkallën në të cilën ndërhyrja në Kosovë ka kontribuar në krijimin e një rregulle zakonore që lejon ndërhyrjen humanitare në mungesë të autorizimit nga KS-ja, shumë ekspertë juridikë ndërkombëtarë që e konsiderojnë ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë sipas të drejtës ekzistuese, argumentojnë se është një shembull fillestar i praktikës shtetërore, që përfundimisht do të bëjë të ligjshme ndërhyrjen humanitare.⁵²⁰ Sidoqoftë, Jane Tromseth sugjeron se një ekzaminim i kujdesshëm dhe mosparaqitja e ndërhyrjes në Kosovë sugjeron kontura të një norme të mundshme që shfaqet në të ardhmen. Elementet e zakonshme që pasqyrojnë këtë shfaqje janë se KS-ja nuk ishte në gjendje të veprojë për shkak

⁵¹⁶ Ibid 165.

⁵¹⁷ Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*, 78- 79.

⁵¹⁸ House of Commons, *Foreign Affairs- Fourth Report, Foreign Affairs Committee Publications*.

⁵¹⁹ Rosa Brooks, 'Humanitarian Intervention', 180.

⁵²⁰ Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention*, 76- 78.

se një ose dy anëtarë të OKB-së do të përdornin veton.⁵²¹ Përdorimi i forcës ishte i nevojshëm për të ndaluar shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut. Ndërhyrja ishte e motivuar në një shkallë të konsiderueshme nga shqetësimet humanitare për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut⁵²², ajo ishte kolektive dhe arsyetimi ligjor i ofruar ishte se shtetet ndërhyrëse argumentuan se forca ishte e nevojshme për të ndaluar vrasjen e popullatës civile dhe, se ekzistonte një bazë e fortë ligjore në rrethana të tilla dhe se KS nuk e dënoi ndërhyrjen. Por, është shumë herët për të thënë me besim se po lind një normë juridike pozitive nën të cilën ndërhyrja humanitare, në këto kushte, në mënyrë të qartë mund të konsiderohet e ligjshme.⁵²³ Ajo që konkludon Stromseth në këtë kohë është se KS-ja nuk është e përgatitur të thotë se ndërhyrja humanitare në rrethana të tilla është e paligjshme. Edhe nëse statusi juridik i ndërhyrjes humanitare jo të autorizuar mbetet i paqartë si çështje e përgjithshme, një konsensus normativ megjithatë mund të dalë me kalimin e kohës nga situata konkrete siç është ndërhyrja në Kosovë. Sipas tij, një qasje e së drejtës zakonore është gjithashtu e hapur për shfaqjen e një norme juridike që do t'i lehtësonte shtetet të ndërhyjnë për qëllime humanitare në rrethana të vërteta urgjente, nëse KS-ja nuk është e aftë t'i sfidojë ato.⁵²⁴ Gjithashtu, edhe autorë të tjerë e mbështesin këtë qëndrim, duke folur *de lege ferenda*, e drejta zakonore ndërkombëtare ose interpretimi përmes praktikës mund të mundësojë anashkalimin e KS-së në të ardhmen⁵²⁵ dhe se e drejta e ndërhyrjes humanitare mund të legalizohet në të ardhmen nga e drejta zakonore ndërkombëtare përmes praktikës së shteteve ose procedurës zyrtare sipas nenit 108 dhe 109 të Kartës së OKB- së.⁵²⁶

Ndërsa, përkrahësit e qëndrimit të NATO-s argumentojnë se ndërhyrja humanitare është zhvilluar në të drejtën zakonore ndërkombëtare. Argumenti në favor të ekzistencës së kësaj të drejte është përkrahur nga një numër autorësh.⁵²⁷ Sipas mendimit të Christopher Greenwood, e drejta moderne zakonore ndërkombëtare njeh një të drejtë të ndërhyrjes ushtarake në baza humanitare nga shtetet ose nga një organizatë si NATO. Sidoqoftë, ai e trajton të drejtën e

⁵²¹ Jane Stromseth, 'Rethinking Humanitarian Intervention', 248.

⁵²² Ibid 250.

⁵²³ Ibid 251- 252.

⁵²⁴ Ibid 252- 253.

⁵²⁵ Petr Valek, 'Is Unilateral Humanitarian Intervention Compatible with the U.N. Charter?', 1237.

⁵²⁶ Ibid 1255.

⁵²⁷ House of Commons, *Foreign Affairs- Fourth Report, Foreign Affairs Committee Publications*.

ndërhyrjes humanitare si çështje e zgjidhjes së fundit dhe e kufizon atë në raste ekstreme. Rastet në të cilat është ushtruar ajo e drejtë i sugjerojnë kushtet e mëposhtme:

a) se ekziston një kërcënim i menjëhershëm i urgjencës më serioze humanitare që përfshin humbje të mëdha të jetës;

b) ndërhyrja ushtarake është e domosdoshme, që është e vetmja praktikë e zbatueshme që parandalon ose ndal humbjet e jetës;

c) KS nuk është në gjendje të ndërmarrë një veprim të tillë, për shembull, për shkak të ushtrimit ose ushtrimit të kërcënuar të vetos.⁵²⁸

Greenwood pranon se e drejta e ndërhyrjes humanitare bazohet në praktikën shtetërore, por që kjo është një praktikë shtetërore e cila kishte evoluar në dhjetë vitet e fundit që nga fundi i Luftës së Ftohtë.⁵²⁹ Për Dame Pauline dhe Neville Jones ishte e qartë se veprimi i NATO-s kishte qenë i ligjshëm si dhe profesor Lowe konsideron se veprimi i NATO-s ishte "në përputhje me mënyrën se si po zhvillohet e drejta zakonore ndërkombëtare."⁵³⁰

Nga ajo që u trajtua më sipër për ligjshmërinë dhe legjitimitetin e ndërhyrjes humanitare, trajtimi i një praktike shtetërore është i pashmangshëm. Disa argumentojnë se ndërhyrja në Kosovë është e ligjshme, ndërsa disa të tjerë argumentojnë se ajo ishte e kundërligjshme por, legjitime. Pavarësisht kësaj një *opinio juris* ka qenë gjithmonë në kërkim për juristët ndërkombëtarë që merren me studimin e së drejtës ndërkombëtare. Matthew Cooper, me bindje të fortë argumenton se arsyetimet e shteteve të NATO-s dhe bashkësisë ndërkombëtare demonstrojnë një *opinio juris* të fortë në favor të këtij propozimi: kur KS nuk arrin të mbështesë përgjegjësinë e saj paqësore për të ruajtur paqen dhe sigurinë, shtetet mund të justifikojnë veprimin e ndërhyrjes humanitare "të pavarur".⁵³¹ Ashtu siç u argumentua më sipër me rastin e ndërhyrjeve humanitare në dekadat e fundit, si dhe përkrahjen nga një numër i madh i shteteve dhe një ndërhyrje nga një organizatë siç ishte rasti me NATO-n në Kosovë, mund të konkludojmë se rasti i Kosovës përbën një pikë fillestare dhe të fuqishme për krijimin e të drejtës moderne zakonore ndërkombëtare. Megjithëse, duke marrë parasysh kundërshtimet e shumta nga disa shtete, shtetet dhe studiuesit e së

⁵²⁸ Christopher Greenwood, 'Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo', 170- 171.

⁵²⁹ House of Commons, *Foreign Affairs- Fourth Report, Foreign Affairs Committee Publications*.

⁵³⁰ Ibid.

⁵³¹ Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention', 192- 195.

drejtës ndërkombëtare kanë dyshime nëse ajo përbën një *opinion juris* të fortë e cila do t'i hiqte dilemat e ligjshmërisë së ndërhyrjes humanitare në të ardhmen.

3.7. Propozimet për ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare në të ardhmen

Ndonëse ekzistojnë qëndrime të shumta në lidhje me ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare, një numër i studiuesve të cilët e kontestojnë ligjshmërinë aktuale të ndërhyrjes humanitare sugjerojnë ide të ndryshme se si do të përligjej ajo në të ardhmen. Janë ide të ndryshme lidhur me të ardhmen e ndërhyrjes humanitare dhe krijimin e një baze të fortë ligjore. Ithtarët më të mëdhenj të këtij pozicioni mbrojnë një marrëveshje të qartë, kodifikimin e kriterëve që specifikojnë se kur ndërhyrja humanitare konsiderohet si e gabuar në mungesë të autorizimit të KS-së.⁵³² Adam Roberts shpjegon se, përfshirja e përsëritur e bashkësisë ndërkombëtare në ndërhyrje me një dimension humanitar ka ndikuar thellë në OKB. Ajo ka imponuar detyra dhe pritshmëri të reja dhe ka kërkuar ndryshime në mënyrën se si punon dhe mendon OKB-ja. Gjithashtu, ka përforcuar pikëpamjen se organizata (veçanërisht KS-ja) duhet të reformohet. Ka ndikuar në pikëpamje të kundërt nga shtetet dhe ka ndryshuar dukshëm imazhin e OKB-së.⁵³³ Ish-Sekretari i OKB-së Kofi Annan duke raportuar në AP në vitin 1999 bëri thirrje për mbrojtjen e civilëve dhe deklaroi se “bota nuk mund të qëndrojë mënjane kur ndodhin shkelje të mëdha dhe sistematike të të drejtave të njeriut”. Ai do ta mirëpriste krijimin e një norme të re në favor të ndërhyrjes humanitare për të mbrojtur civilët nga masakrat e mëdha, e që pa dyshim do të vazhdojë të paraqes një sfidë të thellë për komunitetin ndërkombëtar.⁵³⁴ Për më tepër sipas Komisionit të Pavarur për Kosovën, nuk ka ende një sqarim nga GjND-ja ose ndonjë organ tjetër autorizues në lidhje me shkallën e evolucionit të së drejtës në lidhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që gërryen ndalimin e përdorimit jo mbrojtës të forcës. Duke marrë në konsideratë se që nga ekzistenca e OKB-së, statusi i të drejtave të njeriut ka ndryshuar në mënyrë dramatike.⁵³⁵

⁵³² Jane Stromseth, ‘Rethinking Humanitarian Intervention’, 255.

⁵³³ Adam Roberts, ‘The United Nations and Humanitarian Intervention’, 86.

⁵³⁴ ‘Secretary-General Statements and Messages Secretary-General Presents his Annual Report to General Assembly’.

⁵³⁵ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 168.

Antonio Cassese beson se ne te drejtën ndërkombëtare, ne mënyrë graduale mund të arrihet në kristalizimin e një rregulle të përgjithshme ne të drejtën ndërkombëtare duke autorizuar kundërmaset e armatosura për qëllime ekskluzive për dhënien fund të mizorive në shkallë të gjerë që paraqesin krime kundër njerëzimit dhe që përbëjnë një kërcënim për paqen. Një rregull e tillë, eventualisht mund të zhvillohet në komunitetin botëror, e do të përbënte një përjashtim nga sistemi i Kartës së OKB-së për përmbardimin kolektiv të bazuar në autorizimin e KS-së. Me fjalë të tjera, do të ishte një përjashtim i ngjashëm me atë të parashikuar në nenin 51 të Kartës (pra, vetëmbrojtjen)⁵³⁶ Edhe Komiteti për punë të Jashtme i Britanisë së Madhe pas ndërhyrjes në Kosovë, i sugjeron qeverisë Britanike që të shqyrtojë nëse ndonjë instrument i ri ligjor është i nevojshëm për t'i lejuar NATO-s të ndër marrë veprime në të njëjtën mënyrë si ajo në Kosovë.⁵³⁷ Sidoqoftë, studiuesit që mbështesin një kodifikim e hedhin poshtë mundësinë e një zhvillimi të tillë të një norme të re juridike të që të shfrytëzohet si një recetë abuzimi. Sipas mendimit të tyre, miratimi zyrtar i një doktrine ligjore të ndërhyrjes humanitare me kritere specifike do të pamundësojë ndërhyrjet e paarsyeshme, ndërsa inkurajon ndërhyrjet legjitime. Megjithatë, sipas pikëpamjes së Janes Stromseth është e dyshimtë nëse kritere të tilla për ndërhyrjet e ligjshme pa autorizim të KS-së mund të ishin kodifikuar, të paktën jo në një të ardhme të parashikueshme. Por, sipas Stromseth çdo udhëzues i KS-së ka të ngjarë të jetë i përgjithshëm. Si rezultat, është e vështirë të shihet se ato do të ndihmonin në krijimin e një konsensusi në kriza specifike përballë mosmarrëveshjeve të thella politike midis anëtarëve të KS-së. Çdo udhëzues i pranueshëm për të gjithë KS-në ka të ngjarë të jetë aq i përgjithshëm sa që ata nuk do të vezullojnë pak në mënyrën e udhëzimit konkret. Si rrjedhojë, është e vështirë të shihet se si ato do të ndihmonin në krijimin e konsensusit në kriza specifike përballë mosmarrëveshjeve të thella politike midis anëtarëve të KS-së.⁵³⁸ Së paku për një ndërhyrje humanitare duhet një perspektivë e arsyeshme e suksesit në ndalimin e mizorive që shkaktuan ndërhyrjen në radhë të parë. Përndryshe, ndërhyrësit thjesht do t'i ekspozojnë ushtarët e tyre dhe popullsinë e synuar në situata të rrezikshme pa shpresën e suksesit që justifikon rreziqet që duhet të përballen.⁵³⁹

⁵³⁶ Antonio Cassese, 'Ex iniuria oritur', 29.

⁵³⁷ Foreign Affairs Committee, *Response of the Secretary of State for Foreign and Commonwealth Affairs*, para. 135.

⁵³⁸ Ibid 264.

⁵³⁹ Ibid 268.

Komisioni Ndërkombëtar për Kosovën në raportin e tij thekson se ndërhyrja e NATO-s në Kosovë sugjeron nevojën për mbylljen e hendekut midis ligjshmërisë dhe legjitimitetit. Komisioni besonte se është koha e duhur për prezantimin e një kornize parimore për ndërhyrjen humanitare e cila do të përdoret për të udhëhequr përgjigjet e ardhshme ndaj një katastrofe humanitare. Komisioni sugjeronte se AP e OKB-së mund të miratojë një kornizë të tillë në një formë të modifikuar në Deklaratën dhe Kartën e OKB-së që të adaptohet në këtë Deklaratë qoftë me ndryshime përkatëse ose një qasje rast për rast në KS. Kuadri i Komisionit i propozuar përfshinte tre parime të pragut, të cilat duhet të plotësohen për çdo pretendim për ndërhyrje humanitare. Këto parime përfshijnë:

- 1) vuajtjet e civilëve për shkak të shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- 2) angazhimit kryesor për mbrojtjen e popullatës civile dhe
- 3) llogaritjen që ndërhyrja ka një shkak të arsyeshëm për t'i dhënë fund katastrofës humanitare.⁵⁴⁰

Ata e shohin si një nevojë urgjente për të sqaruar kushtet të cilat mund të ndërmerren në një ndërhyrje të arsyeshme humanitare⁵⁴¹ se ajo duhet të jetë mjeti i fundit kur të gjitha mjetet e tjera paqësore për t'iu përgjigjur shkeljeve të drejtave të njeriut janë shteruar, kur të gjitha mjetet e tjera paqësore për t'iu përgjigjur shkeljeve të të drejtave të njeriut janë ezauruar.⁵⁴² Debati mbi ndërhyrjen për të mbrojtur viktimat në rast të emergjencave humanitare ka lëvizur në mënyrë të konsiderueshme në dekadat e fundit. Barrierat e vjetra të veprimit kolektiv janë gërryer në shumë aspekte. Me kalimin e kohës, siç sugjeron rasti i Kosovës, elementet e një konsensusi normativ në lidhje me ndërhyrjen për qëllime humanitare mund të shfaqeshin. Në këtë proces gradual të evolucionit normativ, çdo konflikt midis normës së mosndërhyrjes dhe parimeve të të drejtave të njeriut në zemër të Kartës së OKB-së adresohen më së miri në situata konkrete pasi vlerat dhe esencat e kundërta përballen me gjithë kompleksitetin e tyre. Me pak fjalë, rruga më premtuese për të ardhmen qëndron në shtresën e mesme të teksteve të Kartës së OKB-së dhe përpjekjeve të papjekura për të kodifikuar kriteret për një të drejtë ose doktrinë të ndërhyrjes humanitare.⁵⁴³

⁵⁴⁰ The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report*, 30.

⁵⁴¹ Ibid 291.

⁵⁴² Ibid 298.

⁵⁴³ Jane Stromseth, 'Rethinking Humanitarian Intervention', 271- 272.

Të gjitha këto sugjerime dhe diskutime të shumta të cilat janë sugjeruar për ligjshmëri të ndërhyrjes humanitare gjatë rasteve të ndërhyrjeve humanitare dhe veçanërisht në rastin e Kosovës, kanë bërë që të dalë në dritë një koncept të ri i quajtur “Përgjegjësia për të Mbrojtur” i zhvilluar në OKB, që do të zhvendoste debatin nga doktrina e “Ndërhyrjes Humanitare” e cila për shumë vite ishte pjesë e diskursit të organizatave ndërkombëtare, shteteve dhe studiuesve të së drejtës ndërkombëtare, ndonëse edhe sot e drejta e ndërhyrjes humanitare dhe debati për të nuk është shuar në tërësi. Prandaj, për shkak të zhvillimit të këtij koncepti të ri në të drejtën ndërkombëtare, kapitujt IV dhe V të këtij disertacioni të doktoratës do të trajtojnë në tërësi doktrinën e përgjegjësisë për të mbrojtur.

KAPITULLI IV

4. PËRGJEGJËSIA PËR TË MBROJTUR: NGA NJË IDE NË NJË NORMË NË ZHVILLIM

4.1. Nga ndërhyrja humanitare te përgjegjësia për të mbrojtur – sfondi i lindjes dhe i zhvillimit të saj

Pas mizorive të cilat pasuan në vitet e 90-ta në Ruandë, Bosnjë dhe më pas me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, e cila ishte kritikuar si shkelje e përdorimit të forcës, komuniteti ndërkombëtar u përfshi në një debat serioz, se si duhet të veprohet kur ka shkelje masive të të drejtave të njeriut.⁵⁴⁴ Gjatë tërë viteve të 90-ta Kombet e Bashkuara ishin të ndara midis atyre që këmbëngulnin në një “të drejtë të ndërhyrjes humanitare” dhe atyre që e shohin këtë si shkelje të sovranitetit shtetëror. Sekretari i Përgjithshëm Kofi Annan paralajmëroi në atë kohë se OKB-ja rrezikonte të diskreditonte veten nëse nuk arrinte t’i përgjigjej katastrofave të tilla si rasti në Ruandë.⁵⁴⁵ Dështimi i KS-së që të autorizojë veprimet për të ndaluar “spastrimin etnik” në Kosovë, e nxiti NATO-n që të fillojë bombardimet. Kjo gjë e ndau bashkësinë ndërkombëtare, ndërmjet atyre që e konsideruan ndërhyrjen si të paligjshme dhe të tjerëve që argumentuan se ligjshmëria kishte më pak rëndësi se sa imperativi moral për të shpëtuar jetët e njerëzve. Dhe ky ngërç nënkuptonte një palë zgjedhje të papëlqyeshme: ose shtetet duhet të qëndronin pasiv dhe të linin të ndodhnin vrasjet masive për të ruajtur interpretimin strikt të së drejtës ndërkombëtare, ose ato mund të anashkalonin Kartën e OKB-së dhe në mënyrë të njëanshme të kryenin një akt lufte mbi baza humanitare.⁵⁴⁶ Debatet për të drejtën e ndërhyrjes humanitare ishin shumë intensive dhe të hidhura, ku vitet e 90-ta përfunduan duke mos zgjidhur gjë as në OKB dhe askund tjetër.⁵⁴⁷ Duke adresuar këtë çështje Sekretari i Përgjithshëm në shtator të vitit 1999 në raportin e tij vjetor pranë AP-së, lidhur me “perspektivat dhe sigurinë njerëzore për ndërhyrjet në shekullin e ardhshëm”⁵⁴⁸ është i

⁵⁴⁴ UN Office on Genocide Prevention, and the Responsibility to Protect, ‘Responsibility to Protect’, <<https://www.un.org/en/genocideprevention/about-responsibility-to-protect.shtml>> qasur: 20.11. 2019.

⁵⁴⁵ Global Centre for the Responsibility to protect, The REsponsibility to Protect: A Background briefing’, 1, <<https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/the-responsibility-to-protect-background-briefing.pdf>> qasur: 20.11.2019.

⁵⁴⁶ Ibid.

⁵⁴⁷ Gareth Evans, ‘The Responsibility to Protect- From an Idea to an International Norm, Responsibility to Protect’ (2009) The Global Moral Compact for the 21st Century, (Edited by Richard H. Cooper and Juliette Voinov Kohler, palgrave Macmillan, 2009) 18 [tani e tutje: Gareth Evans, ‘The Responsibility to Protect- From an Idea to an International’].

⁵⁴⁸ Press Release, UN, SG/SM/7136, (20 September 1999).

bindur se shtetet do të gjejnë unitetin shumë më të madh në ndjekjen e vlerave themelore të Kartës si demokracia, pluralizmi, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit, duke kërkuar nga shtetet dhe Kombet e Bashkuara të gjejnë gjuhë të përbashkët për respektimin e parimeve të Kartës dhe veprimin për mbrojtjen e përbashkët të njerëzimit.⁵⁴⁹ Një vit më vonë Kofi Annan në Raportin e Mijëvjeçarit në vitin 2000, duke marrë në konsideratë debatet lidhur me kundërshtimin e ndërhyrjes humanitare dhe mbrojtjen e sovranitetit, mungesën e përkrahjes për ndërhyrje dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e parashtroi pyetjen vijuese:

*Nëse ndërhyrja humanitare është me të vërtetë një sulm i papranueshëm ndaj sovranitetit, si duhet t'i përgjigjemi një Ruande, një Srebrenice, ndaj shkeljeve të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut që ofendojnë çdo rregull të përbashkët të njerëzimit tonë?*⁵⁵⁰

Në përgjigje të kësaj sfide Qeveria e Kanadasë, së bashku me një grup fondacionesh kryesore, njofton AP-në shtator të vitit 2000, për krijimin e “Komisionit Ndërkombëtar për Ndërhyrjen dhe Sovranitetin e Shtetit” (KNNSSH). Nga Komisioni u kërkuar të merrte të gjitha pyetjet juridike, morale, operacionale dhe politike të përfshira në këtë debat, të konsultohet me gamën më të gjerë të mundshme të mendimit në të gjithë botën dhe të sjell një raport që të ndihmonte Sekretarin e Përgjithshëm dhe gjithë të tjerët të gjejnë disa pika të reja të përbashkëta.⁵⁵¹ Ky Komision u udhëhoq nga ish-kryeministri Australian Gareth Evans dhe nga diplomati Algjerian Mohamed Sahnoun dhe përbëhej nga 10-të anëtarë të tjerë.⁵⁵² Anëtarët e Komisionit u zgjodhën me kujdes për të pasqyruar një përfshirje gjeografike, politike dhe profesionale. U mbajtën takime dhe diskutime në kryeqytete të ndryshme të botës me qëllim që të dëgjohen opinionet e ndryshme mbi këtë temë.⁵⁵³ Mandati i Komisionit ishte përgjithësisht të ndërtonin një kuptim më të gjerë të problemit të pajtimit të ndërhyrjes për qëllime të mbrojtjes së njeriut dhe sovranitetit; më konkretisht, ishte për të provuar zhvillimin e një konsensusi politik global për mënyrën e lëvizjes nga polemikat dhe shpesh paralizat drejt

⁵⁴⁹ Ibid.

⁵⁵⁰ Kofi A. Annan Secretary-General of the United Nations, *We the Peoples' The Role of the United Nations in the 21st Century*, (United Nations 2000) 47- 48.

⁵⁵¹ 'Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty'.

⁵⁵² Ibid III.

⁵⁵³ Ramesh Thakur, *The United Nations, Peace And Security- From Collective Security to the Responsibility To Protect* (Cambridge University Press 2006) 247 [Ramesh Thakur, *The United Nations, Peace And Security*].

veprimet brenda sistemit ndërkombëtar, veçanërisht përmes OKB-së.⁵⁵⁴ Siç e përshkruan edhe Ramesh Thakur si anëtar i këtij Komisioni, nuk ishin të interesuar t'i zgjidhnin problemet e botës por t'i qëndrojnë mandatit të tyre të ngushtë. Komisioni, po ashtu, i rezistoi tundimit për të rishikuar raportin në dritën e sulmeve të 11 Shtatorit në SHBA, duke arritur në përfundimin se vetëmbrojtja është konceptualisht dhe operacionalisht e dallueshme nga mbrojtja e popullatave të huaja në rrezik. Gjithashtu, Theker pohon se i rezistuan edhe tundimeve për të nxitur ndryshime të Kartës së OKB-së, p.sh. në lidhje me përbërjen dhe funksionimin e KS-së.⁵⁵⁵

4.1.1. Raporti i KNNSSH- së i vitit 2001

KNNSSH- ja, publikoi raportin e tij në Dhjetor të vitit 2001.⁵⁵⁶ Tema qendrore e raportit, e pasqyruar në titull, është: "Përgjegjësia për të Mbrojtur" (PpM).⁵⁵⁷ Komisioni edhe pse e njeh një histori të gjatë të përdorimit të frazës "ndërhyrje humanitare", por duke marrë parasysh kundërshtimet nga organizatat humanitare se po militarizohet termi "humanitare" dhe kundërshtimet në lidhje me sovranitetin shtetëror, ndërhyrja, sipas Komisionit përtej çështjes së terminologjisë së "ndërhyrjes humanitare", ekziston një ndryshim mjaft më i madh gjuhësor dhe shoqërimi i ri konceptimit të çështjeve, të cilat Komisioni gjithashtu i ka konsideruar të dobishme që të përqafojë konceptin e "përgjegjësisë për të mbrojtur".⁵⁵⁸ Pra, duke konsideruar se shprehja "ndërhyrje humanitare" nuk ndihmoi për të çuar përpara dhe se argumenti pro ose kundër një "të drejte për të ndërhyrje" nga një shtet në territorin e shtetit tjetër, është i vjetërsuar dhe i pa dobishëm. Prandaj, Komisioni preferon të mos flasë për një "të drejtë për të ndërhyrë", por për një "përgjegjësi për të mbrojtur".⁵⁵⁹ Gareth Evans, beson se kjo gjë dha një kontribut të rëndësishëm si një shpikje e re për të folur për "ndërhyrjen humanitare", sipas tij nga një debat të mërzitshëm dhe të shëmtuar të së "drejtës për të ndërhyrë" dhe e karakterizojnë atë jo si një argument të një të "drejte" të shteteve për

⁵⁵⁴ 'Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty', 2.

⁵⁵⁵ Ramesh Thakur, *The United Nations, Peace And Security*, 349.

⁵⁵⁶ 'Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty',

⁵⁵⁷ Ibid VIII.

⁵⁵⁸ Ibid 9.

⁵⁵⁹ Ibid 11.

të bërë gjithçka, por, më tepër në lidhje me “përgjegjësinë” e tyre, në raste të mbrojtjes së popullatës që gjendet në rrezik të lartë.⁵⁶⁰ Sipas Raportit të Komisionit PpM-ja duhet të ketë këto parime themelore:

a) Se sovraniteti i shtetit nënkupton përgjegjësinë mbi vetë shtetin për mbrojtjen e popullit të vet;

b) Kur një popullate i shkaktohen dëme serioze, si rezultat i luftës së brendshme, kryengritjes, shtypjes ose dështimit dhe shteti në fjalë nuk dëshiron ose nuk është në gjendje ta ndalë ose ta parandalojë atë, parimi i mosndërhyrjes i nënshtrohet përgjegjësisë ndërkombëtare për të mbrojtur.⁵⁶¹

PpM-ja pëfaqëson tri përgjegjësi specifike, edhe atë:

1) *Përgjegjësia për të parandaluar*: adresimin e shkaqeve themelore dhe shkaqeve të drejtpërdrejta të konfliktit të brendshëm dhe krizave të tjera të shkaktuara nga njeriu duke vënë popullatën në rrezik.

2) *Përgjegjësia për të reaguar*: për t'iu përgjigjur situatave të nevojës njerëzore me masat e duhura, të cilat mund të përfshijnë masa shtrënguese si sanksione dhe ndjekje penale ndërkombëtare, dhe në raste ekstreme ndërhyrje ushtarake, dhe

3) *Përgjegjësia për të rindërtuar*: të sigurojë, veçanërisht pas një ndërhyrjeje ushtarake, ndihmë të plotë për rimëkëmbjen, rindërtimin dhe pajtimin, duke adresuar shkaqet e dëmit që ndërhyrja ishte krijuar për të ndaluar ose shmangur.⁵⁶²

Së pari, ky Komision beson fuqishëm se PpM-ja nënkupton një përgjegjësi shoqëruese për të parandaluar. Për Komisionin parandalimi nuk është thjeshtë një çështje kombëtare ose lokale. Dështimi i parandalimit mund të ketë pasoja dhe kosto të gjera ndërkombëtare. Që parandalimi të ketë sukses, nevojitet një mbështetje e fortë nga bashkësia ndërkombëtare.⁵⁶³ Gareth Evans thekson se përvoja na ka mësuar se parandalimi efektiv është shumë më pak i

⁵⁶⁰ Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, (Brookings Institution Press, 2008) 39- 40 [tani e tutje: Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*].

⁵⁶¹ ‘Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty’, XI.

⁵⁶² Ibid XI.

⁵⁶³ Ibid 19.

kushtueshëm në gjak dhe thesar se sa të reagosh vetëm kur shumë jetë njerëzish të jenë humbur. Njohja e këtyre realiteteve, që parandalimi është dimension i vetëm më i rëndësishëm i përgjegjësisë për të mbrojtur, është në zemër të konkluzioneve të Samitit Botëror 2005⁵⁶⁴.

Së dyti, PpM-ja nënkupton përgjegjësinë për të reaguar ndaj situatave të nevojshme për mbrojtje të njerëzve. Kur masat parandaluese nuk arrijnë zgjidhje ose kur një shtet nuk është një gjendje ose nuk dëshiron të veprojë për të rregulluar situatën, sipas Komisionit vetëm atëherë mund të kërkohen masa ndërhyrëse nga anëtarët e tjerë të bashkësisë më të gjerë të shteteve. Masat shtrënguese të përshkruara nga KNNSSH përfshijnë masat politike, ekonomike ose gjyqësore dhe në “raste ekstreme por vetëm në raste ekstreme, ato gjithashtu mund të përfshijnë edhe masat ushtarake”, duke plotësuar kushtet e vështira të pragut para se të mendohet ndërhyrja ushtarake.⁵⁶⁵ Por, rastet për të ndërhyrë janë raste të jashtëzakonshme, janë raste të dhunës të cilët vërtetë e “tronditin ndërgjegjen e njerëzimit”, ose paraqesin një rrezik të qartë të sigurisë ndërkombëtare.⁵⁶⁶ Dhe ndërhyrja ushtarake për qëllime humanitare mund të bëhet vetëm duke u plotësuar disa kritere të caktuara, edhe pse Komisioni pranon se nuk ka një listë universale për kriteret e ndërhyrjes. Por, në gjykimin e tij, Komisioni ka përcaktuar këto kritere përkatëse të vendimmarrjes që mund të përmblihen shkurtimisht në gjashtë titujt vijues, edhe atë:

- *Autoriteti i duhur;*
- *Arsyeja e drejtë;*
- *Qëllimi i duhur;*
- *Mundësia e fundit;*
- *Mjetet proporcionale dhe*
- *Perspektivat e arsyeshme.*⁵⁶⁷

Pragu i *arsyes së drejtë*: ndërhyrja ushtarake për mbrojtjen e njerëzve në masa të jashtëzakonshme dhe për tu garantuar, duhet të ketë dëm serioz dhe të pariparueshëm që u ndodh qenieve njerëzore, ose ka të ngjarë të ndodhin llojet e mëposhtme:

1) Humbje jete e një shkalle të gjerë, dhe

⁵⁶⁴ Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, 79.

⁵⁶⁵ ‘Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty’, 29.

⁵⁶⁶ Ibid 31.

⁵⁶⁷ Ibid 32.

2) Spastrimi etnik i një shkalle të gjerë.⁵⁶⁸

Evans kujton se e gjithë kjo terminologji për kriteret e ndërhyrjes tingëllon si e njohur, e cila ka një origjinë në teorinë e “luftës së drejtë” dhe shkon prapa që nga mesjeta e hershme dhe pretendimi ishte të artikulohen vlera të veçanta se sa një grup të veçantë.⁵⁶⁹

Së treti, përgjegjësia për të rindërtuar, nënkupton përgjegjësinë jo vetëm për të parandaluar dhe reaguar, por edhe për të rindërtuar duke bërë një angazhim të mirëfilltë për të ndihmuar në ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme dhe promovimin e qeverisjes së mirë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo gjë sipas sugjerimeve të Komisionit përfshinë kushtet e sigurisë dhe rendit publik që të rindërtohen nga agjentët ndërkombëtar që veprojnë me partnerët e autoriteteve lokale, me qëllim të transferimit progresiv tek ato të autoritetit të përgjegjësisë për rindërtim. Sigurimi i rindërtimit dhe rehabilitimit të qëndrueshëm do të përfshijë angazhimin e fondeve dhe burimeve të mjaftueshme për bashkëpunimin e ngushtë me njerëz lokalë dhe do të nënkuptojë qëndrimin në vend për një periudhë kohe deri sa të jenë përmbushur qëllimet fillestare të ndërhyrjes. Sipas Komisionit ndërse mendohet për ndërhyrje ushtarake, edhe nevoja për një strategji pas ndërhyrjes gjithashtu është e madhe.⁵⁷⁰ Me fokus te siguria dhe zhvillimi i vendit.⁵⁷¹ Evans përgjegjësinë për të rindërtuar një shoqëri, pas luftës, ose krimeve të mizorisë që e kanë copëtuar atë, e parasheh në katër dimensionë të ndërlidhura, por të dallueshme, ato janë: arritja e sigurisë, qeverisja e mirë, drejtësia dhe pajtimi dhe zhvillimi ekonomik dhe shoqëror.⁵⁷²

4.1.2. Çështja e autoritetit

Në lidhje me autoritetin e duhur KNNSSH beson se nuk ka organ më të mirë dhe më të përshtatshëm se KS-ja e OKB-së për të autorizuar ndërhyrjen ushtarake për qëllime të respektimit të të drejtave të njeriut. Komisioni konsideron se “detyra nuk është të gjendet ndonjë alternativë ndaj KS-së si një burim autoriteti, por ta bësh KS-në të funksionojë më mirë”. Autorizimi duhet të kërkohet para çdo ndërhyrje ushtarake. Ata që bëjnë thirrje për

⁵⁶⁸ Ibid.

⁵⁶⁹ Gareth Evans, ‘The Responsibility to Protect: Rethinking Humanitarian Intervention’, (March 31-April 3, 2004) (98) Proceedings of the Annual Meeting (American Society of International Law) 84 [tani e tutje: Gareth Evans, ‘The Responsibility to Protect: Rethinking Humanitarian Intervention’].

⁵⁷⁰ ‘Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty’, 39.

⁵⁷¹ Ibid 40- 42.

⁵⁷² Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, 149.

ndërhyrje duhet të kërkojnë një autorizim të tillë, ose KS-ja me iniciativën e vet, ose Sekretari i Përgjithshëm të kërkojë sipas nenit 99 të Kartës së OKB-së.⁵⁷³ Në këtë rast Komisioni rekomandon që anëtarët e OKB-së të mos zbatojnë fuqinë e tyre të veto-s, në raste kur interesat jetike të shtetit të tyre nuk përfshihen.⁵⁷⁴ Gareth Evans konsideron se bërja e KS-së të funksionojë më mirë do të thotë t'i kushtosh shumë më shumë vëmendje proceseve të tij të vendimmarrjes dhe veçanërisht për të siguruar se vendimet në lidhje me autorizimin dhe mbështetjen e ndërhyrjes ushtarake të merren në baza të forta dëshmuese dhe për arsyet e drejta të moralit ose parimit: me pak fjalë, duke siguruar se ato nuk janë vetëm legale, por edhe legjitime.⁵⁷⁵

Nëse KS-ja refuzon një propozim ose dështon të merret me të një kohë të arsyeshme, opsionet alternative janë si vijon:

(I) Shqyrtimi i çështjes nga AP-ja në Sesionet Speciale të Emergjencës; dhe

(II) Veprimet brenda zonës së juridiksionit të organizatave rajonale ose nën-rajonale sipas kapitullit VIII të Kartës, me kusht që të kërkojnë autorizim të mëvonshëm nga KS-ja.

Në këtë drejtim, Komisioni vazhdon duke përmendur që KS-ja duhet të ketë parasysh të gjitha diskutimet e tij, sepse nëse nuk arrin të përmbush përgjegjësinë e tij për të mbrojtur në situata tronditëse të ndërgjegjes njerëzore, duke lënë të hapur mundësinë se shtetet e interesuara nuk mund të përjashtojnë mjete të tjera për të përmbushur gravitetin e urgjencës së asaj situatë dhe që shteti dhe OKB-ja mund të vuajnë si rrjedhojë e kësaj.⁵⁷⁶

4.1.3. Sovraniteti si përgjegjësi

KNNSSH e koncepton sovranitetin si “përgjegjësi”. Sipas Komisionit, sovraniteti nënkupton përgjegjësi të dyfishtë: e jashtme: të respektojë sovranitetin e shteteve të tjera, dhe e brendshme: të respektojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut. Ky kuptim modern i sovranitetit është i një rëndësie qendrore në qasjen e Komisionit për çështjen e ndërhyrjes për të drejtat e njeriut dhe në veçanti zhvillimin e temës kryesore tek “përgjegjësia

⁵⁷³ ‘Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty’, XII.

⁵⁷⁴ Ibid XIII.

⁵⁷⁵ Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, 139.

⁵⁷⁶ Ibid XIII.

për të mbrojtur”.⁵⁷⁷ Kontributi konceptual i Komisionit këmbëngulte të ishte një mënyrë e re e të folurit për sovranitetin,⁵⁷⁸ duke konsideruar se nuk ka një transferim ose zbehje të sovranitetit shtetëror. Por, ekziston siç thotë Komisioni, një ri-karakterizim i nevojshëm i përfshirë nga sovraniteti si “kontroll” tek sovraniteti si “përgjegjësi”, si në funksion të brendshëm, ashtu edhe në funksion të jashtëm.⁵⁷⁹ Pra, PpM-ja pranon se përgjegjësia kryesore mbetet te shtetet, vetëm nëse shteti nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të përmbushë këtë përgjegjësi, ose është vetë kryerësi i mizorive, atëherë bëhet përgjegjësi e të tjerëve të veprojnë në vend të tij. Një përgjegjësi dytësore për të vepruar bie mbi bashkësinë ndërkombëtare.⁵⁸⁰

Ndryshe nga sovraniteti Westfalian në të cilin dominimi territorial qëndronte në thelb të konceptit, në këtë kuptim, sovraniteti interpretohet në nivel të brendshëm si "autonomi dhe autoritet suprem brenda një territori të caktuar" dhe nga jashtë si ekuivalent me "pavarësi dhe barazi të shteteve".⁵⁸¹ Ose, siç e përmend Evans, se në Traktatin Westfalian të v. 1468, pikëpamja e cila ka mbizotëruar ka qenë se “sovraniteti është një licencë për të vrarë”.⁵⁸² Parimi i barazisë sovrane të shteteve ishte pranuar në Kartën e OKB-së në nenin 2.1 dhe mosndërhyrja në çështjet që hyjnë në juridiksionin e brendshëm të shteteve në nenin 2.7.⁵⁸³ KNNSSH-ja thekson se edhe pse sovraniteti nënkupton aftësinë për të marr vendime autoritative në lidhje me njerëzit dhe burimet brenda territorit të tij, megjithatë, autoriteti i shtetit nuk konsiderohet absolut, “por i kufizuar dhe i rregulluar brenda rregullimit kushtetues të ndarjes së pushtetit”.⁵⁸⁴ Duke punuar kundër këtij standardi ka qenë ndikimi në rritje i viteve të fundit të dokumenteve për të drejtat e njeriut, “duke e zhvendosur kulturën e pa ndëshkueshmërisë sovrane, në atë të përgjegjësisë kombëtare dhe ndërkombëtare”,⁵⁸⁵ dhe

⁵⁷⁷ ‘Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty’, 8; shih gjithashtu: Amy E. Eckert, ‘The Responsibility to Protect in the Anarchical Society: Power, Interest, And The Protection Of Civilians In Libya And Syria’, (2012) 41(1), Denv. J. Int’l. & Pol’y, Andrew Garwood-Gowers, ‘The Responsibility to Protect and The Arab Spring: Libya as The Exception, Syria as the Norm?’, (2013) (36)2, Unsw Law Journal Volume, 596-597.

⁵⁷⁸ Gareth Evans, ‘The Responsibility to Protect- From an Idea to an International’, 19.

⁵⁷⁹ ‘Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty’, 13.

⁵⁸⁰ Ramesh Thakur, *The United Nations, Peace And Security*, 251.

⁵⁸¹ Peter Hilpold, ‘From Humanitarian Intervention to the Responsibility to Protect, Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?’, (2015) Brill Nijhoff, 5 [tani e tutje: Peter Hilpold, ‘From Humanitarian Intervention to the Responsibility to Protect’].

⁵⁸² Gareth Evans, ‘The Responsibility to Protect- From an Idea to an International’, 16.

⁵⁸³ The United Nations Charter 1945; shih gjithashtu: Gareth Evans, ‘The Responsibility to Protect: Rethinking Humanitarian Intervention’, 82.

⁵⁸⁴ ‘Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty’, 12.

⁵⁸⁵ Gareth Erans and Mohamed Sahnoun, ‘The Responsibility to Protect’, (2002), (81)6, Foreign Affairs, 103.

se sovraniteti si përgjegjësi po njihet gjithnjë e më shumë në praktikën shtetërore. Miratimi i standardeve të reja për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut ka qenë një nga arritjet më të mëdha të epokës së pas Luftës së Dytë Botërore, duke u miratuar dokumente të shumta për të drejtat e njeriut, si: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike, Pakti për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore etj.,⁵⁸⁶ dhe shumë dokumente të tjera të cilat i pasuan këto. Këta dokumente të miratuara pas themelimit të OKB-së, sot përbëjnë një pjesë integrale të korpusit të së drejtës ndërkombëtare.⁵⁸⁷

Nga kjo del se ka patur një hendek të madh në rritje midis praktikës më të mirë të kodifikuar të sjelljes ndërkombëtare, siç artikulon Karta e OKB-së, gjuha e qartë e cila thekson respektimin e sovranitetit të shtetit dhe praktikës aktuale të shtetit e cila ka evoluar që nga nënshkrimi i Kartës. Ky hendek demonstroi kufijtë e sovranitetit. Kjo e intrigoi Gareth Evansin dhe komisionin që gjatë takimeve të shumta të shihnin shkallën me të cilin u pranua ky hendek. Dhe Evans vëren se mbrojtja e sovranitetit shtetëror edhe nga mbështetësit e tij më të fortë nuk ngriti asnjë pretendim për fuqinë e pakufizuar të një shteti për të bërë atë që dëshiron me popullin e vet dhe nuk kishin dëgjuar asnjëherë një pretendim të tillë, gjatë përgatitjes së raportit.⁵⁸⁸

Prandaj, futja e përgjegjësisë të secilit shtet të bazuar në sovranitet si përgjegjësi të raportit të KNNSSH, Amneus e sheh si një ndërprerje të rëndësishme të diskursit të ndërhyrjes humanitare pra, si një ndërtues potencial të urës midis veriut dhe jugut global mbi çështjet e mizorive masive dhe nënkupton që parimi i mosndërhyrjes humanitare t'i jepet përgjegjësisë ndërkombëtare kur shteti në fjalë nuk është 'i gatshëm ose është i paafte' të ndalojë vuajtjet e popullatës nga dëmet serioze.⁵⁸⁹ Pra, edhe pse të dyja doktrinat e trajtojnë shkeljen e rëndë

⁵⁸⁶ Gareth Evans, 'The Responsibility to Protect: Rethinking Humanitarian Intervention', 82.

⁵⁸⁷ Hans-Georg Dederer, 'Responsibility to Protect' and 'Functional Sovereignty', 'Responsibility to Protect' and 'Functional Sovereignty', Responsibility to Protect (R2P) (2015) A New Paradigm of International Law?, Brill Nijhoff, 168 [tani e tutje: Hans-Georg Dederer, 'Responsibility to Protect' and 'Functional Sovereignty'].

⁵⁸⁸ Gareth Evans, 'The Responsibility to Protect: Rethinking Humanitarian Intervention',

⁵⁸⁹ Diana Amneus, 'The coining and evolution of responsibility to protect: the protection responsibilities of the State', (2013) *An Institutional Approach to the Responsibility to Protect*, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 7- 8 [tani e tutje: 'Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect']. Alex Bellamy argumenton se Ndërhyrja e NATO-së në Kosovë ndihmoi në përcaktimin e qëndrimeve ndërkombëtare mbi natyrën dhe fushën e sovranitetit si përgjegjësi. Kështu, ky rast zbulon një zonë të gjerë të shteteve të cilët ishin të përgatitur të pranonin se sovraniteti nuk u dha shteteve si një kontroll për t'i trajtuar qytetarët ashtu sic atyre ju pëlqen. Debati për Kosovën nuk vërtetë rreth të drejtës së Jugosllavisë për të abuzuar me qytetarët, ose përshtatshmërisë së angazhimit ndërkombëtar në vetvete, por rreth peshës së abuzimeve të qeverisë ndaj qytetarëve në Kosovë dhe domosdoshmërisë së ndërhyrjes së armatosur. Kështu, njohja e gjerë e përgjegjësisë sovrane që shoqëroi luftën në Kosovë siguroi një katalizator të menduarit të ri në lidhje me përdorimin e forcës së armatosur për qëllime humanitare dhe infuzionin e doktrinës së sovranitetit si përgjegjësi

të tëdrejtave të njeriut, PpM është një tërësi konceptuale që shkon përtej një doktrine që përpiqet thjeshtë të rregullojë zbatimin e ndërhyrjes humanitare, e cila është praktikisht një akt i ndërmarrë për të adresuar një krizë humanitare pas përshkallëzimit ose pasi kriza ta arrijë kulmin e saj. Siç reflektohet në rikonceptimin e sovranitetit shtetëror, PpM nuk ka të bëjë me ndalimin e mizorive masive, por në radhë të parë ka të bëjë me parandalimin e tyre që të ndodhin ose të përshkallëzohen më tej dhe sipas argumentit të Pinar Ercan, kjo është një pikë kryesore e largimit nga të kuptuarit e ndërhyrjes humanitare.⁵⁹⁰ Duke pasur parasysh kritikën e së drejtës për të ndërhyrë, KNNSSH i pari e solli vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare për ata që kishin nevojë për mbështetje, pra subjekteve të vuajtjeve njerëzore sesa të drejtat e ndërhyrësit. KNNSSH u përpoq të transferonte nocionin e sovranitetit shtetëror nga një parim që shtetet konsiderohen si 'të paprekshme' në çështjet e tyre të brendshme, në një nocion që i konsideron shtetet përgjegjëse për mbrojtjen e popujve të tyre nga shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.⁵⁹¹

Në bazë të kushteve të caktuara PpM bën thirrje për ndërhyrje nga jashtë dhe në këtë mënyrë shpërfill parimin e mosndërhyrjes nga jashtë duke qenë një specifikë themelore e sovranitetit shtetëror. Me fjalë të tjera, sovraniteti shihet si ekzistues i natyrshëm por e kufizuar nga PpM. Si pasojë, ndërhyrja e bazuar në PpM nga jashtë nuk mund të konsiderohet një ndërhyrje e padrejtë.⁵⁹² Sidoqoftë, sovraniteti shtetëror i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtme vetëm nëse shteti nuk arrin të përmbushë përgjegjësinë e tij për t'u mbrojtur.⁵⁹³ Ndonëse simpatizuesit e pikëpamjes tradicionale të sovranitetit mund të shprehin rezerva dhe të hezitojnë përballë pranimin të PpM-së në lidhje me sovranitetin si përgjegjësi, sidomos nga vendet të cilët kishin dalur nga procesi i dekolonizimit dhe parimin e mosndërhyrjes e

në debatin e ndërhyrjes humanitare. Në përmbledhje, zhurma për legjitimitetin dhe ligjshmërinë e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë maskoi shfaqjen e një konsensusi më të thellë rreth konceptit të sovranitetit si përgjegjësi të shpallur nga Deng dhe Cohen. Të gjithë në KS me përjashtim të Kinës pranuan se qeveria jugosllave kishte përgjegjësi për mbrojtjen e qytetarëve të Kosovës nga shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, pasi qeveria nuk po përmbushte përgjegjësinë e saj, KS-ja ndërmori disa masa duke synuar t'i jep fund dhunës dhe zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshje, shih: Alex J. Bellamy, 'Kosovo and the Advent of Sovereignty as Responsibility', (2009) (3)2, *Journal of Intervention and Statebuilding*, 164- 176.

⁵⁹⁰ Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect The Evolution of a Moral Norm*, (palgrave macmillan, 2016) 20 [tani e tutje: Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*].

⁵⁹¹ . Ibid 21.

⁵⁹² Hans-Georg Dederer, 'Responsibility to Protect' and 'Functional Sovereignty', 156- 157.

⁵⁹³ Ibid 179.

shohin si një mbrojtje nga kërcënimet ose ndërhyrjet nga jashtë⁵⁹⁴ mirëpo, megjithatë siç theksuam më sipër, ndërhyrja në sovranitetin e një shteti bëhet vetëm atëherë kur shteti nuk dëshiron ose është i pa aftë, të përmbush përgjegjësinë e tij primare për të mbrojtur qytetarët e vetë. Vetëm atëherë bashkësia ndërkombëtare, do të kishte të drejtë për të ndërhyrë. Ramesh Thakur, PpM-në e konsideron si një model të ri konceptual për pajtimin e tensionit në parim midis sovranitetit dhe ndërhyrjes, interesave divergjente dhe perspektivat në praktikën politike.⁵⁹⁵ Dhe me të drejtë Peter Hilpold e përshkruan përgjegjësinë për të mbrojtur si diçka që individët, nuk duhet ta shohin si një antitezë për mbrojtjen e sovranitetit të shtetit, as si një koncept pasardhës të sovranitetit. Por, PpM-ja është më tepër një pjesë integrale e sovranitetit dhe një nga elementet kryesore të tij pra, “sovranitetit si përgjegjësi”.⁵⁹⁶

4.2. Institucionalizimi i PpM-së – OKB-ja dhe përgjegjësia për të mbrojtur

4.2.1. Rezultati i Samitit Botëror 2005

Raporti i Panelit të Nivelit të Lartë të Sekretarit të Përgjithshëm i vitit 2004, i miratuar nga OKB-ja e pranon plotësisht PpM-në, duke pranuar se ka një njohje në rritje se çështja nuk është "e drejta për të ndërhyrë", por "përgjegjësia për të mbrojtur" e çdo shteti kur bëhet fjalë për njerëzit që vuajnë nga një katastrofë e evitueshme, vrasje masive dhe përdhunime, spastrime etnike me dëbim me forcë nga territori, me qëllim urie dhe ekspozim ndaj sëmundjeve. Ekziston një pranim në rritje ndërsa qeveritë sovrane kanë përgjegjësinë kryesore për të mbrojtur qytetarët e tyre nga katastrofa të tilla, kur ata nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë ta bëjnë këtë gjë, që përgjegjësia të merret nga bashkësia ndërkombëtare. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së deklaroi se mbështesin normën që po shfaqet për atë se ekziston një përgjegjësi kolektive ndërkombëtare për të mbrojtur, e ushtrueshme nga KS-ja që autorizon ndërhyrjen ushtarake si një mundësi të fundit, në rast të gjenocidit dhe vrasjeve të tjera në shkallë të gjerë, spastrimit etnik ose shkelje serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare të cilat qeveritë sovrane janë provuar të pafuqishëm ose pa gatishmëri për të

⁵⁹⁴ Gareth Evans, 'The Responsibility to Protect- From an Idea to an International', 17; shih gjithashtu: Maartje Weerdesteijn, 'The Rationality Of Dictators Towards a more effective implementation of the responsibility to protect', (2017) Interesentia United Kingdom, 81- 82.

⁵⁹⁵ Ramesh Thakur, *The United Nations, Peace And Security*, 245.

⁵⁹⁶ Peter Hilpold, 'From Humanitarian Intervention to the Responsibility to Protect', 9.

parandaluar.⁵⁹⁷ Ai me këtë Raport kërkoi, *inter alia*, që AP-ja duhet të përdorë mundësinë e dhënë nga Samiti i Mijëvjeçarit në vitin 2005 për të krijuar një konsensus të ri mbi sigurinë kolektive më të gjerë dhe më efektive.⁵⁹⁸ Njëashtu, edhe në Raportin e vitit 2005 të Sekretarit të Përgjithshëm të emëruar si: “Për liri më të gjerë: Drejt zhvillimit, sigurisë dhe të drejtave të njeriut për të gjithë” të paraqitur pranë AP-së theksoi se duhet të lëvizet drejt përqafimit dhe veprimit të "përgjegjësisë për të mbrojtur" për viktimat e mundshme ose aktuale të mizorive masive. Ka ardhur koha që qeveritë të japin llogari, si ndaj qytetarëve të tyre ashtu edhe ndaj njëri-tjetrit, për respektimin e dinjitetit të individit.⁵⁹⁹

Më 15 shtator 2005, shtetet anëtare të AP-së pranuan PpM-në paragrafët 138-139 të ‘Dokumentit të Rezultatit nga Samiti Botëror’ 2005. Në takimin historik të takimit të nivelit të lartë në AP, udhëheqës të shteteve dhe qeverive, në mënyrë unanime ranë dakord që:

138. “Secili shtet individual ka përgjegjësinë që të mbrojë popullatën e tij nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit. Kjo përgjegjësi përfshin parandalimin e krimeve të tilla, nxitjen e tyre përmes mjeteve të përshtatshme dhe të nevojshme. Ne e pranojmë atë përgjegjësi dhe do të veprojmë në përputhje me të. Komuniteti ndërkombëtar duhet, sipas rastit, të inkurajojë dhe ndihmojë shtetet të ushtrojnë këtë përgjegjësi dhe të mbështesin Kombet e Bashkuara në krijimin e një aftësie paralajmëruese të hershme.”

139. “Komuniteti ndërkombëtar, përmes Kombeve të Bashkuara, ka gjithashtu përgjegjësinë të përdorë mjete të përshtatshme diplomatike, humanitare dhe mjete të tjera paqësore, në përputhje me Kapitujt VI dhe VIII të Kartës, për të ndihmuar në mbrojtjen e popullatës nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimet etnike dhe krimet kundër njerëzimit. Në këtë kontekst, ne jemi të përgatitur për të ndërmarrë veprime kolektive, në një kohë dhe mënyrë vendimtare, përmes Këshillit të Sigurimit, në përputhje me Kartën, përfshi Kapitullin VII, rast pas rasti dhe në bashkëpunim me organizatat përkatëse rajonale si të përshtatshme, nëse mjetet paqësore janë joadekuate dhe autoritetet kombëtare dukshëm nuk arrijnë të mbrojnë popullatën e tyre nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimet etnike dhe krimet kundër njerëzimit. Ne theksojmë nevojën që Asambleja e Përgjithshme të vazhdojë të marrë parasysh

⁵⁹⁷ Report of the Secretary-General's High-Level Panel on Threats, *Challenges and Change on A More Secure World: Our Shared Responsibility*, (2004) (A/59/565) 56- 57 [tani e tutje: A/59/565 (2004)].

⁵⁹⁸ Ibid 87.

⁵⁹⁹ Report of the Secretary- General's on *In Larger Freedom: Towards Development, Security and Human Rights for All*, (2005) (A/59/2005) 34- 35.

përgjegjësinë për të mbrojtur popullatën nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimet etnike dhe krimet kundër njerëzimit dhe pasojat e tij, duke pasur parasysh parimet e Kartës dhe të drejtës ndërkombëtare. Ne gjithashtu synojmë të angazhohemi, kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, për të ndihmuar shtetet të ndërtojnë kapacitete për të mbrojtur popullsinë e tyre nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimet etnike dhe krimet kundër njerëzimit dhe për të ndihmuar ata që janë nën stres para krizave dhe konflikteve”.⁶⁰⁰

Raport i 2005 afirmoi përgjegjësinë e secilit shtet për t’i respektuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e qytetarëve të tyre. Por kjo përgjegjësi e shteteve, për dallim nga rezolutat e mësipërme, në Dokumentin e Samitit Botëror 2005 kufizohet në përgjegjësinë e shteteve për mbrojtjen e popullatës së tyre nga ‘gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit’.⁶⁰¹ Kjo gjë për Michael Doyle zbulon rëndësinë e paragrafëve të Dokumentit të Samitit 2005 (që fituan pëlqimin unanimit të 192 vendeve anëtare). Paragrafët 138-139 pasqyrojnë katër vitet shtesë të lobimit të zellshëm dhe rregullimit doktrinar, duke kapërcyer mosbesimin domethënës të komunitetit ndërkombëtar ndaj çdo ndërhyrjeje pas pushtimit të Irakut në vitin 2003.⁶⁰² Sipas Dokumentit, parandalimi ju përket jo vetëm shteteve por edhe bashkësisë ndërkombëtare në rast të dështimit të shteteve në nivel individual për të për të mbajtur përgjegjësinë e tyre individuale. Sidoqoftë, përgjegjësia e bashkësisë ndërkombëtare u përcaktua në këtë mënyrë pasi që disa shtete anëtare kundërshtuan gjuhën pohuese të propozuar fillimisht. Për shembull, Kina dhe SHBA drejtuan Dokumentin e Rezolutave në hedhjen e kriterëve për legjitimitet dhe në vend të kësaj vendosën të miratojnë një qasje ‘rast pas rasti’. Pra, në lidhje me përgjegjësinë për të reaguar sipas këtij dokumenti, vendimi për të ndërmarrë veprime u bë i varur plotësisht nga KS-ja pa asnjë kufizim në fuqinë e veto-s së pesë anëtarëve, përveç se i nënshtrohen një vlerësimi ‘rast pas rasti’.⁶⁰³ Po kështu, propozimi i SHBA-së, deklarata origjinale ‘se ne njohim përgjegjësinë tonë të përbashkët për të ndërmarrë veprime’, u zëvendësua me atë që tregon se shtetet anëtare janë ‘të përgatitur për të ndërmarrë veprime kolektive’ në rastet e ‘dështimit të dukshëm’ të shteteve individuale. Gjithashtu, shtetet anëtare tregojnë qëllimin e tyre ‘të

⁶⁰⁰ The UN General Assembly, (2005) World Summit Outcome, (A/60/L.1) [tani e tutje: World Summit Outcome, (A/60/L.1)].

⁶⁰¹ Ibid; shih gjithashtu: Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*, 62.

⁶⁰² Michael W. Doyle New Haven, *The Question of Intervention John Stuart Mill and The Responsibility to Protect*, (Yale University Press 2015) 123 [tani e tutje: Michael W. Doyle New Haven, *The Question of Intervention John Stuart Mill and The Responsibility to Protect*].

⁶⁰³ Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*, 63.

angazhohen' për të ndihmuar shtetet në ndërtimin e kapaciteteve të tyre. Në përgjithësi, siç thekson Pinar Ercan, paragrafi miraton një gjuhë shumë të kujdesshme kur përcakton përgjegjësinë e bashkësisë ndërkombëtare dhe lë hapësirë të bollshme për manovrime pa krijuar pasoja të mundshme ligjore dhe detyrime. Padyshim se, gjatë institucionalizimit, ndryshimi më kritik i prezantuar në Dokumentin e Rezultatit të Samitit Botëror 2005 ishte mbase kufizimi i fushës së PpM-së në gjenocid, krime lufte, spastrim etnik dhe krime kundër njerëzimit.⁶⁰⁴

4.2.2. PpM dhe krimet masive

Krimet e lartpërmendura të miratuara me Dokumentin e Samitit 2005 në paragrafët 138 dhe 139 dhe të njohura ndryshe në grupin e “krimeve të mizorisë masive” përdoren për t’iu referuar tani ‘gjenocidit, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe spastrimit etnik’ të cilat nga ana tjetër e përcaktojnë fushën e PpM-së.⁶⁰⁵ Këto krime me të cilat lidhet PpM-ja tashmë janë të ngulitura në të drejtën ndërkombëtare aktuale. Detyrimet për të mbrojtur njerëzit nga gjenocidi, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare dhe sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe shtetet kanë detyrim për t’i parandaluar këto krime; të ndihmojnë shtetet për të përmbushur detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare; dhe të promovojnë pajtueshmërinë me ligjin. Pra, mekanizmat përmes të cilave PpM mund të zbatohet janë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare aktuale.⁶⁰⁶ Gjenocidi, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit gjithashtu kanë arritur statusin e të drejtave të ligjshme dhe detyrimet për të përmbajtur dhe parandaluar kryerjen e tyre, janë detyrime *erga omnes*.⁶⁰⁷

Krimi i “Gjenocidit” ka një përkufizim të qartë me Konventën për Ndalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve të Gjenocidit të vitit 1948,⁶⁰⁸ dhe të përsëritur me Statutin e Gjykatës

⁶⁰⁴ Ibid 64.

⁶⁰⁵ Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, 11.

⁶⁰⁶ Alex J. Bellamy, ‘The Responsibility to Protect A Wide or Narrow Conception?, Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?’, (2015) Brill Nijhoff, 41; shih gjithashtu: ‘Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect’, 15- 16 [tani e tutje: Alex J. Bellamy, ‘The Responsibility to Protect A Wide or Narrow Conception?’].

⁶⁰⁷ ‘Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect’, 16.

⁶⁰⁸ Convention on the Prevention and the Punishment of the Crime of Genocide, (General Assembly resolution 260 A (III) (9 December 1948) neni 2, <https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocity-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of

Penale Ndërkombëtare (GJPN) të vitit 1998.⁶⁰⁹ Detyrimi ligjor për të ‘parandaluar dhe ndëshkuar’ gjenocidin rregullohet me nenin 1 të Konventës, duke e sanksionuar gjenocidin si një krim i së drejtës ndërkombëtare, i kryer qoftë në kohë lufte ose në paqe.⁶¹⁰ Neni 1 nuk ndaloi shprehimisht shtetet nga kryerja e Gjenocidit, por GJND-ja në rastin *Bosnja kundër Serbisë* konfirmoi se një ndalim i tillë rrjedh nga detyrimi për ‘parandalimin dhe ndëshkimin’ dhe nga fakti se gjenocidi është një krim sipas të drejtës ndërkombëtare.⁶¹¹ Gjykata vendosi se Serbia nuk kishte kryer gjenocid në Sebrenicë, megjithatë kishte fajësi për dështim dhe për ta parandaluar atë.⁶¹² Duke kërkuar nga Serbia dhe Mali i zi që të “ndërmarrin hapa efektive për të siguruar pajtueshmëri të plotë me detyrimin e saj për të ndëshkuar akte të gjenocidit sipas Konventës”... dhe “transferimin e individëve të akuzuar për gjenocid apo ndonjë akti tjetër sipas konventës”, në Tribunalin për Krime të Luftës në Ish-Jugosllavi.⁶¹³ Detyra e një shteti për të parandaluar gjenocidin nuk kufizohet vetëm në popullatën e tij, juridiksionin e vetë, por shtrihet edhe përtej kufijve të saj. GJND-ja ka theksuar se për të arritur qëllimin e parandalimit të gjenocidit, shtetet duhet të përdorin të gjitha mjetet e arsyeshme që i kanë në dispozicion në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe në koordinim të ngushtë edhe me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.⁶¹⁴

%20Genocide.pdf> qasur: 20. Mars 2020 [tani e tutje: Convention on the Prevention and the Punishment of the Crime of Genocide].

⁶⁰⁹ Rome Statute of the International Criminal Court, (Published by International Criminal Court, Netherlands 2011) neni 6, <<https://www.icc-cpi.int/resource-library/documents/rs-eng.pdf>> qasur: 20 Mars 2020 [tani e tutje: Rome Statute of the International Criminal Court].

⁶¹⁰ Convention on the Prevention and the Punishment of the Crime of Genocide, neni 1.

⁶¹¹ *Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide* (Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro), Judgment [2007], ICJ 2007, para. 6 [tani e tutje: Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro), Judgment [2007]; shih gjithashtu: ‘Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect’, 17.

⁶¹² Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, 20; shih gjithashtu: Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro), Judgment [2007]. “Që Serbi dhe Mali i Zi ka shkelur dhe po shkel detyrimet e saj sipas Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit për dështimin dhe për mosndëshkimin e akteve të gjenocidit ose ndonjë akt tjetër të ndaluar nga Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe për dështimin dhe për mos transferimin e individëve të akuzuar për gjenocid ose ndonjë akt tjetër të ndaluar nga Konventa në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë dhe për të bashkëpunuar plotësisht me këtë Tribunal”... shih: Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro), Judgment [2007], para. 5.

⁶¹³ Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro), Judgment [2007], para. 6.

⁶¹⁴ Gentian Zyberi, ‘Sharing the responsibility to protect: taking stock and moving forward’, *An Institutional Approach to the Responsibility to Protect*, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 515 [tani e tutje: Gentian Zyberi, ‘Sharing the responsibility to protect: taking stock and moving forward’]. Në vitin 2019, në lidhje me Aplikimin e Konventës së Gjenocidit, Gambia kishte paditur Mianmarin, për veprimet e ndërmarra nga Qeveria e Mianmarit kundër anëtarëve të grupit Rohignya, një grup i vecantë etnik, racor, fetar, që banon kryesisht në shtetin Rokhine të Mianmarit. Gambia konsideronte se këto veprime të cilat përfshijnë vrasjen, shkaktimin e dëmtimit serioz mendor dhe trupor, shkaktimin e kishteve që përfshijnë sjelljet për shkatërrim fizik, vendosja e masave për pengimin e lindjeve dhe transferimin me forcë, janë të karakterit gjenocidal dhe kanë

Ndërsa, “krimet e luftës” mund të gjenden në disa instrumente ndërkombëtare, si në katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, Statutet e Gjykatave të Përkohshme dhe së fundmi të GJPN-së. Krimet e luftës janë shkelje serioze të ‘Konventave të Gjenevës’ dhe të së drejtës zakonore të zbatueshme në konfliktet e armatosura. Detyrimet ligjore për ‘respektimin dhe sigurimin e respektimit’ të konventave në të gjitha rrethanat” përcaktohet në nenin 1 të Konventave dhe të drejtës zakonore ndërkombëtare. Po ashtu edhe neni 1(1) i Protokollit të Konventës përcaktojnë që shtetet palë kanë detyrim ligjor për të respektuar sigurimin e konventës në të gjitha rrethanat.⁶¹⁵ Edhe “krimet kundër njerëzimit” edhe pse të përmendura dhe përkufizimet e ndryshme gjatë historisë, por përkufizimi i Statutit të GJPN-së ka arritur të sigurojë një përkufizim më të rafinuar, të qartë dhe të gjerë, të destinuar për një pranim universal.⁶¹⁶ Përkufizimi i GJPN-së për krimet kundër njerëzimit në Nenin 7 përfaqëson një kodifikim dhe zhvillim progresiv të së drejtës ndërkombëtare dhe ka një strukturë të ngjashme me ato në Statutet e Tribunalit për Krimet të Luftës në Jugosllavi (TPNJ) dhe Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën (TNR). TPNJ dhe TNR kanë riafirmuar karakterin e së drejtës zakonore të 'krimeve kundër njerëzimit', dhe ndalimi i tij gjithashtu konsiderohet të jetë pjesë e *jus cogens*.⁶¹⁷ Gama e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit është shumë e gjerë, edhe në rastin e krimeve të luftës. Gareth Evans argumenton se debati i PpM-së është përqendruar kryesisht, jo në konflikte tradicionale ndërkombëtare, por në luftërat civile, domethënë ato që ndodhin brenda kufijve të shtetit sovran.⁶¹⁸

për qëllim shkatërrimin e plotë ose të pjesshëm të grupit Rohingya. Pretendohet se ato krime janë kryer në shkelje të Konventës kundër Krimeve të Gjenocidit të vitit 1948. Këto Gambia ia atribuon të gjitha Mianmarit, si përgjegjës për kryerjen e gjenocidit. Nga faktet e dokumentuara nga përpjekjet e pavarura hetimore në kuadër të OKB-së, “vërtetojnë se, përkundër sfondit të përndjekjes dhe diskriminimit të gjatë, nga rrethetori 2016 ushtria e Mianmar ("Tatmadaw") dhe forcat e tjera të sigurisë së Mianmar filluan "operacionet e pastrimit" të përhapura dhe sistematike - termi që përdor vetë Mianmar - kundër Rohingya grupi Veprimet gjenocidale të kryera gjatë këtyre operacioneve kishin për qëllim shkatërrimin e Rohingya si një grup, plotësisht ose pjesërisht, duke përdorur vrasje masive, përdhunime dhe forma të tjera të dhunës seksuale, si dhe shkatërrimin sistematik nga zjarri të fshatrave të tyre, shpesh me banorë të mbyllur brenda shtëpive që digje”. Nga gushti i vitit 2017 e tutje, veprime të tilla gjenocidale vazhduan me rifillimin e "operacioneve të pastrimit" nga Mianmar në një shkallë më masive dhe më të gjerë gjeografike... shih: *Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (The Gambia V. Myanmar)*, International Court Of Justice [2019] ICJ 2009 Para. 2, 6.

⁶¹⁵ ICRC, The Geneva Conventions and Their Commentaries, qasur: <<https://www.icrc.org/en/war-and-law/treaties-customary-law/geneva-conventions>> qasur: 21 Mars 2020; shih gjithashtu: 'Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect', 19.

⁶¹⁶ Rome Statute of the International Criminal Court, neni 7; shih gjithashtu: 'Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect', 22.

⁶¹⁷ 'Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect', 22.

⁶¹⁸ Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, 12.

Për dallim nga krimet e lartpërmendura, “spastrimi etnik”, nuk ka një përkufizim të qartë ligjor, por mund të konsiderohet si pjesë e cilitdo nga këto krime ekzistuese.⁶¹⁹ Megjithatë, spastrimi etnik i cili plotëson prapë e gjenocidit, siç thekson profesori Gentian Zyberi, më shumë ka të ngjarë të ngërthehet brenda orbitës së krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, sepse si TPNJ ashtu dhe GJND në vendimet e tyre e kanë interpretuar spastrimin etnik si të dallueshëm nga gjenocidi.⁶²⁰ Akte dhe praktika të ndryshme mund të përbëjnë spastrim etnik, të tilla si: dëbimi, transferimi me forcë, zhvendosja, vrasjet, shkatërrimi i shtëpive etj. Detyrimet për të mbrojtur dhe parandaluar spastrimin etnik rrjedhin nga detyrimet për të parandaluar krimet përkatëse të llogaritura në seksionet e mëparshme.⁶²¹ Që nga mesi i viteve 1980 fenomeni i spastrimit etnik ka përfshirë rajonin kurd të Irakut, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Darfurit dhe zonave të tjera të mizorisë. Një shembull i dobishëm i identifikimit të spastrimit etnik mund të shihet nga Dhomat Gjyqësore të TPNJ-së. Për, David Scheffer, zbulimi i krimit të spastrimit etnik brenda statuteve dhe jurisprudencës së gjykatave penale ndërkombëtare dhe atyre hibride është i rëndësishëm për PpM-së si një parim mbi të cilin qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare mund të veprojnë me besim në legjitimitetin e kauzës së tyre. Meqenëse spastrimi etnik u bë një term i njohur për të përshkruar atë çka po ndodhte në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, në fillim të viteve të 90-ta, përdorimi i tij u rrit vetëm pasi modele të ngjashme të sjelljes diskriminuese janë shpalosur në zona të tjera, si Darfuri, i cili do të ishte një shembull i qartë bashkëkohor i një spastrimi etnik në një shkallë masive.⁶²² Scheffer konsideron se ekziston vullneti politik, që qeveritë, aleancat dhe organizatat ndërkombëtare të mund të përgjigjen me çfarëdo mjeti që të dalë më efektive përmbysja e valës së spastrimit etnik. Sipas tij, spastrimi etnik ka arritur një kornizë ligjore të paraparë deri më tani për persekutimin si një krim kundër njerëzimit, mbi të cilën të justifikojë të gjithë gamën e opsioneve të PpM-së për veprim, në varësi, natyrisht, nga rrethanat precize të fushatës së veçantë të spastrimit etnik.⁶²³ Ndërsa profesori Qerim Qerimi vlerëson se e vetmja iniciativë që njeh vlerën e konsiderueshme dhe të pavarur të spastrimit etnik është PpM-ja. Por ai argumenton se rëndësia e saj mund të rezultojë e kotë

⁶¹⁹ Ibid 12, 31.

⁶²⁰ Gentian Zyberi, ‘Sharing the responsibility to protect: taking stock and moving forward’, 516.

⁶²¹ ‘Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect’, 24.

⁶²² David Scheffer, ‘Atrocity Crimes Framing the Responsibility to Protect, Responsibility to Protect The Global Moral Compact for the 21st Century’, (2009), (Edited by Richard H. Cooper and Juliette Voinov Kohler, palgrave Macmillan, 2009) 90 [tani e tutje: ‘David Scheffer, ‘Atrocity Crimes Framing the Responsibility to Protect’].

⁶²³ Ibid 91.

nëse parimet kryesore të përmbajtjes së saj nuk kanë kuptim të qartë me një status të shëndosh dhe efektiv ligjor.⁶²⁴ Por, dhe përcaktimi i spastrimit etnik në aspektin juridik ose të kodifikimit në një instrumenti ligjor ndërkombëtar nuk duhet të shihet si një zgjidhje magjike. Nuk duhet të shihet si një garanci për t'i dhënë fund spastrimit etnik, ashtu siç Konventa për krimet e Gjenocidit e vitit 1948 nuk e parandaloi gjenocidin në Ruandë dhe Srebrenicë.⁶²⁵

PpM-ja përfaqëson përgjegjësinë e qeverive dhe bashkësisë ndërkombëtare për të mbrojtur popullatën nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit, të gjitha këto janë kategori të krimeve të rëndësishme që duhet të përcaktohen si krime mizore, si për qëllime saktësie kur përshkruajnë krimet përkatëse, ashtu edhe për qëllime thjeshtësie si një mjet për të komunikuar me popullatën globale, me përpjekjet për të aktivizuar parimet e PpM-së në skenën globale.⁶²⁶ Ndonëse katër krimet e përmendura si më sipër, të identifikuara në Samitin Botëror të vitit 2005, janë të sanksionuara tashmë në të drejtën ndërkombëtare, ku disa preferojnë kufizimin e zbatimit të parimit në këto katër krime, ndërsa disa të tjerë kanë sugjeruar që parimi mund të zbatohet edhe për një varg të problemeve të tjera të sigurisë njerëzore, veçanërisht katastrofat natyrore, por edhe abuzimi i përgjithshëm i të drejtave të njeriut, zhvendosja e brendshme, ndihmat dhe ndryshimet klimatike.⁶²⁷ Sipas Scheffer, është e qartë se sipas një interpretimi të ngushtë të PpM-së, kjo doktrinë nuk është krijuar për t'iu përgjigjur abuzimeve të të drejtave të njeriut ose akteve terroriste ndërkombëtare që bien larg krimeve në masë, kërkesat për siguri njerëzore shumë të mëdha, fatkeqësitë natyrore, qeveritë shtypëse dhe jo demokratike, ose kërcënimet ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, nëse nuk ka krime mizore. Konsideroj se, shqetësimi i Scheffer është i drejtë, duke theksuar se zbatimi i përqendruar i OKB-së për PpM-në kundër krimeve të mizorisë në OKB mund të jetë i diskutueshëm pasi mbrojtësit e sinqertë të parimit të zhvillimit të PpM-së kërkojnë të argumentojnë një mandat më të gjerë si çështje e politikës, e të drejtës dhe e moralit.⁶²⁸

⁶²⁴ Qerim Qerimi, 'All You Can Do is Pray': Implications for Human Rights Advocacy of the Lack of Recognition of Ethnic Cleansing as an International Crime on its Own', (2018) (1)18, Journal of Human Rights Practice, 1-18, Policy and Practice Note, (Published by: Oxford university Press).

⁶²⁵ Ibid 11.

⁶²⁶ David Scheffer, 'Atrocity Crimes Framing the Responsibility to Protect', 77.

⁶²⁷ Alex J. Bellamy, 'The Responsibility to Protect A Wide or Narrow Conception?', 38.

⁶²⁸ 'David Scheffer, 'Atrocity Crimes Framing the Responsibility to Protect', 78.

Në vijim të tekstit të OKB-së Sekretari i Përgjithshëm Ban Ki-Moon në një adresim në Berlin në një eveniment, theksoi se PpM nuk është një kod i ri i ndërhyrjes humanitare, por përkundrazi, është ndërtuar mbi një koncept më pozitiv dhe më pohues të sovranitetit si përgjegjësi. Sipas Annan, PpM-ja duhet dalluar gjithashtu nga 'kushëriri i tij' konceptual, pra nga siguria njerëzore.⁶²⁹ Kjo e fundit, është më e gjerë, që nënkupton se politika duhet të marrë parasysh sigurinë njerëzore, jo vetëm të shteteve, por, një gamë të gjerë të kërcënimeve të mundshme. Poashtu, sipas Anan koncepti i PpM-së, "është i ngushtë, por i thellë". Shtrirja e tij është e ngushtë ngase përqendrohet vetëm në katër krime dhe shkelje të rëna dakord nga udhëheqësit botëror në 2005. Ndërsa, zgjerimin e parimit për të mbuluar fatkeqësi të tjera, të tilla si HIV/AIDS, ndryshimi i klimës, reagimi ndaj katastrofave natyrore etj., konsideron se ato do ta minonin konsensusin e vitit 2005 përtej njohjes ose dobisë operative.⁶³⁰ Annan gjithashtu potencon se përgjigja e bashkësisë ndërkombëtare duhet të jetë e thellë, duke përdorur mjete për parandalimin dhe mbrojtjen e sistemit të OKB-së, partnerëve të tij rajonal, nën rajonal, shoqërisë civile dhe shteteve anëtare. Ai bën thirrje në përmirësimin e mekanizmave për paralajmërimin e hershëm të OKB-së dhe forcimin e

⁶²⁹ UN Secretary-General Ban Ki-moon's address at an event on "Responsible Sovereignty: International Cooperation for a Changed World", in Berlin, (2008) <<https://www.globalpolicy.org/component/content/article/154/26074.html>> qasur: 22 Mars 2020; [tani e tutje: 'UN Secretary-General Ban Ki-moon's address at an event on Responsible Sovereignty']. PpM-ja ka të bëjë kryesisht me parandalimin, ndërsa ndërhyrja humanitare ka të bëjë vetëm me reagimin. PpM ka të bëjë me vazhdim të përgjigjeve nga një gamë e tërë aktorësh, jo vetëm ata aktorë të cilët janë të gatshëm dhe të aftë të përdorin forcën ushtarake. Ajo angazhon aktor të ndryshmen në tre 'shtylla' të përgjegjësisë. Përgjegjësia kryesore është që shteti sovran të mos kryejë ose të mos lejojë krimet e mizorisë në territorin e tij. Shtylla e dytë, me përgjegjësinë e bashkësisë ndërkombëtare për të ndihmuar shtetin në kryerjen e përgjegjësisë kryesore. Dhe shtylla e tretë zbatohet vetëm kur parandalimin dështon dhe kjo ka të bëjë me përgjegjësinë e bashkësisë ndërkombëtare të veprojë për të siguruar mbrojtjen me çdo mjet të paraparë me kartën e OKB-së, shih: Gareth Evans 'on 'Responsibility to Protect' after Libya, Interview with Gareth Evans by Alan Philips for The World Today, Chatham House, October 2012) 1, qasje në: <<https://www.chathamhouse.org/publications/the-world-today/2012-10/gareth-evans-responsibility-protect-after-libya>> qasje: 24 Mars 2020.

⁶³⁰ 'UN Secretary-General Ban Ki-moon's address at an event on Responsible Sovereignty'. James Pattison sugjeron se kufizimi i PpM-së nga kriteret e pragut bëhet më i kufizuar në masë me ndërhyrjen humanitare, pasi kjo e fundit 'mund të ndërmirret si përgjigje ndaj një larmie krizash humanitare dhe nuk kërkon autorizim nga KS. Gjendja aktuale e zbatimit të PpM-së i kufizuar vetëm në krimet e gjenocidit, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe spastrimit etnik, e ku nuk ka asnjë kufizim për krimet të cilat duhet të ndërhyet, e bëjnë që fushëveprimi i ndërhyrjes humanitare të interpretohet të jetë më i gjerë se PpM, ndërsa Pettison thekson se PpM-ja është më e gjerë se ndërhyrja humanitare, sepse ajo përfshin tri lloje të përgjegjësisë: përgjegjësia për të parandaluar, përgjegjësia për të reaguar dhe përgjegjësia për të rindërtuar. Ndërsa ndërhyrja humanitare bie vetëm mbi përgjegjësinë për të reaguar, shih: James Pettison, *Humanitarian Intervention and the Responsibility to Protect, Who should Intervene?*, (Oxford university Press 2010) 13, Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*, 27.

kapaciteteve shtetërore për t'i rezistuar veprimeve që kanë të bëjnë me gjenocidin, krimet e luftës, spastrimin etnik dhe krimet kundër njerëzimit.⁶³¹

4.2.3. Zbatimi i PpM-së – Tri shtyllat e Raportit të vitit 2009

Në vitin 2009 Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së lëshoi dokumentin e parë gjithëpërfshirës mbi PpM-në me titull: *"Implementimi i Përgjegjësisë për të Mbrojtur"*.⁶³² Raporti shpjegon se si duhet të zbatohet PpM-ja duke përshkruar masat dhe aktorët që duhet të përfshihen. Ai shpjegon se detyra nuk është të ri-interpretohen dhe të ri-negociohen konkluzionet e Samitit Botëror 2005, por të gjinden mënyra për të zbatuar vendimet e tij në mënyrë plotësisht besnike dhe të qëndrueshme. Sipas këtij Raporti, dispozitat e nenit 138 dhe 139 të Samitit Botëror sugjerojnë që PpM-ja qëndron në tre shtylla vijuese:

- Shtylla e parë: Përgjegjësitë e shteteve për të mbrojtur;
- Shtylla e dytë: Ndihma ndërkombëtare dhe ndërtimi i kapaciteteve;
- Shtylla e tretë: Përgjegjësia me kohë dhe ndërkombëtare.⁶³³

Shtylla e parë, është përgjegjësia e përhershme e shtetit për të mbrojtur popullatën e tij, (qofshin shtetas apo jo), nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit dhe nga nxitja e tyre duke kërkuar nga shtetet respektimin e të drejtave të njeriut si elementi thelbësor i sovranitetit, ku u sugjerohet shteteve se ato mund të japin ndihmë në avancimin e qëllimeve të parandalimit dhe mbrojtjes në lidhje me përgjegjësinë për të mbrojtur, anëtarësimin e shteteve në ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me çrast kërkohet nga shtetet ndëshkimi i atyre që kanë kryer krimet etj.⁶³⁴

Shtylla e dytë është angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare për të ndihmuar shtetet në përmbushjen e këtyre detyrimeve. Ajo kërkon të mbështetet në bashkëpunimin e shteteve anëtare, rregullimet rajonale dhe nën-rajonale, shoqërinë civile dhe sektorin privat, si dhe në pikat e forta institucionale dhe përparësitë krahasuese të sistemit të Kombeve të Bashkuara. Kjo shtyllë e këtij raporti sugjeron se në rastet ku udhëheqja politike e shteteve është e

⁶³¹ 'UN Secretary-General Ban Ki-moon's address at an event on Responsible Sovereignty'.

⁶³² Report of the Secretary-General, *Implementing the responsibility to protect*, (A/63/677, 12 January 2009) [tani e tutje: A/63/677,(12 January 2009).

⁶³³ Ibid.

⁶³⁴ Ibid para. 17- 23.

vendosur të kryejë krime dhe shkelje në lidhje me përgjegjësinë për të mbrojtur, atëherë masat e ndihmës në shtyllën e dytë do të ishin të domosdoshme dhe bashkësia ndërkombëtare do të këshillohej më mirë të fillonte mbledhjen e kapaciteteve dhe vullnetit për një përgjigje "në kohë dhe vendimtare", siç përcaktohet në paragrafin 139 të Rezultatit të Samitit.⁶³⁵ Kjo gjë mund të bëhet përmes inkurajimit të donatorëve, për të financuar programet që kanë të bëjnë me ndihmën e shteteve për parandalimin e krimeve, inkurajimin nëpërmjet dialogut, edukimit dhe trajnimit për të drejtat e njeriut. Duhet të ofrohet ndihma për të ndërtuar kapacitetet civile të organizatave rajonale dhe nën-rajonale për të parandaluar krimet dhe shkeljet në lidhje me Përgjegjësinë për të Mbrojtur gjë që mund të jetë një investim i mençur. Ekzistimi i elementeve të përbashkëta në këto përpjekje të ndryshme për të ndihmuar shtetet varet kryesisht nga ekspertiza civile dhe jo nga prania ushtarake.⁶³⁶

Shtylla e tretë, është përgjegjësia e shteteve anëtare për të reaguar kolektivisht në një kohë dhe në mënyrë vendimtare kur një shtet po dështon të sigurojë një mbrojtje të tillë. Megjithatë diskutohet gjerësisht, se shtylla e tretë përgjithësisht kuptohet shumë ngushtë. Raporti demonstroi përpjekjen e suksesshme dypalëshe, rajonale dhe globale për të shmangur gjakderdhjen e mëtejshme në fillim të vitit 2008 pas zgjedhjeve të diskutueshme në Kenia, se nëse bashkësia ndërkombëtare vepron mjaft herët, zgjedhja nuk ka pse të jetë e zyrtë midis bërjes së asgjëje dhe përdorimit të forcës sepse një zgjidhje e ekuilibruar mirë dhe në kohë mund të përfshijë cilëndo nga gama e gjerë e mjeteve në dispozicion të OKB-së dhe partnerëve të saj. Këtu mund të përfshihen masat nën Kapitullin e VI-të, masat shtrënguese nën Kapitullin e VII-të dhe/ose bashkëpunimi me organizatat rajonale dhe nën-rajonale sipas Kapitullit VIII.⁶³⁷ Duke afirmuar dispozitat e Dokumentit të Samitit 2005, se në rastet kur shtetet dështojnë për të siguruar përgjegjësinë primare për të mbrojtur qytetarët atëherë veprimet mund të merren nën autorizimin e KS-së, mirëpo pragu për zbatimin e shtyllës së tretë do të ishte më lartë se pragu për përgjegjësinë nën shtyllën dy. Kështu, në shtyllën tre, pragu për masat nën Kapitullin e VI-të do të ishte më i ulët se masat e zbatimit sipas Kapitullit të VII-të të Kartës, e cila gjë mund të autorizohet vetëm nën nivelin qeveritar,

⁶³⁵ Ibid para. 29.

⁶³⁶ Ibid para. 32, 33, 39.

⁶³⁷ Ibid 9.

ku “sa më e fortë që të jetë përgjigja, aq më i lartë do të jetë standardi për autorizim”.⁶³⁸ Përveç KS-së edhe AP-ja ka një rol të rëndësishëm, madje edhe nën shtyllën III. AP-ja mund të trajtojë çështjet nën procedurën “të bashkuar për paqe” kur KS nuk arrin të ushtrojë përgjegjësinë e tij primare për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare.⁶³⁹ Raporti rekomandon se tre shtyllat mbështetëse do të kishin një gjatësi të pabarabartë, ndërtesa e përgjegjësisë për të mbrojtur mund të bëhej e paqëndrueshme, duke u mbështetur në mënyrë të pasigurtë në një drejtim ose në tjetër. Përgjashtimisht, nëse tre shtyllat janë të forta, ose ndërtesa mund të mbi ngarkohet ose të shembet. Të tre shtyllat duhet të jenë të gatshme për t’u përdorur në çdo pikë, pasi nuk ka ndonjë rend të caktuar për të lëvizur nga njëra në tjetrën, veçanërisht në një strategji të hershme dhe fleksibile.⁶⁴⁰

Qëllimi i këtij Raporti të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e PpM-së ishte të krijohej një strategji e përbashkët dhe angazhuese ripërtëritëse politike. Përmes tij Ban Ki-Moon inkurajon AP-në të fillojë procesin politik të shqyrtimit të strategjisë së përgjithshme të sugjeruar në raport, duke përfshirë idenë e paralajmërimit të hershëm të OKB-së.⁶⁴¹ Debatimi në AP midis shteteve anëtare konfirmoi një miratim të vazhdueshëm të parimit të PpM-së mbi ‘tre shtyllat dhe katër krimet’, me një qasje ‘të ngushtë por, të thellë’.⁶⁴²

4.2.4. Këshilli i Sigurimit dhe PpM

Që nga fillimi i paraqitjes së idesë së PpM-së, Komisioni i KNNSSH-së, parashihte se nuk kishte organ më të mirë dhe më të përshtatshëm se KS-ja e OKB-së për të autorizuar ndërhyrjen ushtarake me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Komisioni konsideronte se “nuk është detyrë të gjendet një zëvendësim ndaj KS-së si një burim autoriteti, por ta bësh KS-në të funksionoj më mirë. Dhe se autorizimi i KS-së duhet të kërkohet në çdo ndërhyrje ushtarake.”⁶⁴³ Në këto raste Komisioni sugjeronte që anëtarët e përhershëm të KS-së të mos përdornin veto-n në rastet kur nuk prekej interesi i tyre. Por, nëse KS-ja do të refuzonte ose do të dështonte të vepronte në kohë të arsyeshme, atëherë alternativa të tjera do të ishin të

⁶³⁸ Ibid 49- 50.

⁶³⁹ Ibid 63.

⁶⁴⁰ Ibid para. 12.

⁶⁴¹ ‘Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect’, 11.

⁶⁴² Ibid 12.

⁶⁴³ ‘Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty’, XII.

mundshme.⁶⁴⁴ Roli i KS-së u afirmua në Paragrafin 39 të Dokumentit të Samitit Botëror 2005, për të ndërmarrë veprime kolektive, përmes tij, në përputhje me Kartën dhe sipas Kapitullit të VII-të, “rast pas rasti” dhe në bashkëpunim me organizatat e tjera rajonale, në rastet kur mjetet paqësore janë jo adekuate dhe kur autoritetit kombëtarë dukshëm nuk arrin të mbrojnë popullatën nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit.⁶⁴⁵ Menjëherë pas Samitit Botëror 2005, Kofi Anan rekomandoi që Këshilli të mbështesë PpM-në, të riafirmojë të drejtën e ndërhyrjes humanitare, të vazhdojë të sqarojë vendin e mbrojtjes civile në mandatet e paqeruajtjes dhe të zhvillojë sisteme për monitorimin.⁶⁴⁶ Pas disa muajsh të debatit intensiv në KS dhe ngurrimit të disa shteteve,⁶⁴⁷ më 18 Prill 2006 KS miratoi unanimisht Rezolutën 1674 duke ri-konfirmuar dispozitat e paragrafit 138 dhe 139 të Samitit Botëror lidhur me përgjegjësinë për të mbrojtur popullatën nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit.⁶⁴⁸ Kjo Rezolutë kërkon mbrojtjen e civilëve në konflikte të armatosura, duke nxitur bashkësinë ndërkombëtare për t’u ofruar shteteve mbështetje për të përmbushur përgjegjësinë e tyre.⁶⁴⁹ Megjithëse Rezoluta 1674 arriti shumë më pak se sa që kishte kërkuar KNNSSH-ja nga KS-ja, të cilën Alex Bellamy e konsideroi se ishte megjithatë një deklaratë e rëndësishme mbështetjeje.⁶⁵⁰ Mirëpo, debati ndërmjet shteteve si

⁶⁴⁴ Ibid XIII.

⁶⁴⁵ The UN General Assembly, (2005) *World Summit Outcome*, (A/60/L.1).

⁶⁴⁶ UN, S/2005/740, (2005). Më pak se tre muaj pas Samitit botëror propozimi u tregua shumë i diskutueshëm. Rusia, Kina dhe tre anëtarë jo të përhershëm (Algeria, Filipinet dhe Brazili) u tërhoqën pas angazhimit të tyre të mëparshëm dhe argumentuan se Samiti Botëror vetëm kishte angazhuar AP- në për të diskutuar më tej mbi PpM- në, shih: Alex J. Bellamy, ‘Realizing the Responsibility to Protect’, *International Studies Perspectives* (2009) (10) 114 [tani e tutje: Alex J. Bellamy, *Realizing the Responsibility to Protect*]. Vende si Egjipti i cili kërkoj nga Këshilli të kufizohet në mbrojtje të civilëve dhe të mos e zgjerojë autoritetin e tij, duke vendosur politika të përgjithshme për trajtimin e çështjeve humanitare për të drejtat e njeriut. Egjipti u shpreh i shqetësuar për projekt- rezolutën e rolit të mundshëm të KS- së për të ndërmarrë veprime nën “të ashtuquajturën Përgjegjësi për të mbrojtur”. Ata shprehën shqetësimin se AP- ja e cila ishte mandatuar në Samitin Botëror, nuk kishte vazhduar ende shqyrtimin e kësaj çështjeje. Alegjeria, “Kujtojmë që samiti i shtatorit mandatoi AP- në të vazhdojë debatin mbi atë koncept - një koncept për të cilin ende nuk ka unanimitet brenda bashkësisë ndërkombëtare dhe parametrat e të cilit ende duhet të përcaktohen me rigorozitet”, shih: UN Security Council, 5319th meeting Friday, S/PV.5319 (Resumption 1) (9 December 2005).

⁶⁴⁷ William Pace, Nicole Deller, and Sapna Chhatpar, ‘Realizing the Responsibility to Protect in Emerging and Acute Crises- A Civil Society Proposal for the United Nations Responsibility to Protect- The Global Moral Compact for the 21st Century’ (Edited by Richard H. Cooper and Juliette Voinov Kohler, palgrave Macmillan, 2009) 224 [tani e tutje: William Pace, Nicole Deller, and Sapna Chhatpar, ‘Realizing the Responsibility to Protect’].

⁶⁴⁸ S/RES/1674 (2006), (28 April 2006) para 4.

⁶⁴⁹ Ibid para 12- 13.

⁶⁵⁰ Alex J. Bellamy, ‘Realizing the Responsibility to Protect’, 113. Ndryshimet që u bënë te anëtarët e përhershëm në KS, ndryshuan ekuilibrin e debatit në favor të PpM- së. Vende si Algjeria, Brazili, Filipinet...që ishin kundërshtar të rripët të PpM- së u zëvendësuan me vende të rinj ishin Sllovakia, Katari dhe Peru të cilët kishin shprehur mbështetje për PpM- në në debatin e Këshillit të Dhjetorit, Gana i cili nuk kishte marrë pjesë në atë debat por mbështeste PpM- në dhe Kongo i cili në qershor 2006 informoi Këshillin për mbështetjen e tij të fortë " për parimin. Sidoqoftë, Rusia vazhdoi të argumentojë se miratimi i PpM- së ishte i parakohshëm dhe SHBA- ja

dhe zotimi ndaj PpM-së kishte vazhduar mes atyre që e përkrahnin atë dhe atyre që ishin skeptik edhe pas miratimit të Rezolutës 1674.⁶⁵¹ Bellamy konsideron se u provua se sa e vështirë por megjithatë jo e pamundur është për ta bindur KS-në për të përdorur PpM-në për shkak, kryesisht të shqetësimeve humanitare në lidhje me kapacitetin e parimit për t'u abuzuar si justifikim për ndërhyrje të njëanshme humanitare. Temat e përsëritura në debat ishin potenciali për abuzime selektive dhe zgjerimi i shtrirjes së fuqive të mëdha në punët e brendshme të sovranitetit shtetëror. Megjithatë, ndërsa i shprehnin këto shqetësime, shtetet si Kina ishin të përgatitur të pranonin legjitimitetin e angazhimit ndërkombëtar për parandalimin e gjenocidit dhe krimeve masive.⁶⁵² Mes organeve të OKB-së, KS-ja ka një gamë të gjerë të masave për të reaguar ndaj një krize të PpM-së. Mirëpo, procesi i vendimmarrjes në KS është thellësisht politik dhe kështu KS ka qenë shpesh herë i ngadaltë për të reaguar, veçanërisht në një situatë dhune të brendshme në një shtet të caktuar. Sipas Kapitullit të VII-të të Kartës së OKB- së aftësia e KS-së për të ndërmarrë masa varet nga përcaktimi i tij se një situatë përbën kërcënim për paqen. Historikisht KS-ja nuk ka ndërhyrë më shumë për shkak të ngurrimit për ndërhyrje në sovranitetin e shtetit.⁶⁵³ Afirmimi i PpM-së në OKB siç u morr vesh më sipër dhe roli kryesor për të vepruar ndaj situatave të mizorive dhe përgjegjësia kryesore për ndërmarrjen e masave për të parandaluar dhe reaguar, bie mbi KS-në. Pas Konfirmimit të PpM-së në OKB me Rezolutën 1674, KS-ja në po të njëjtin vit pra, më 31 Gusht 2006 ka miratuar Rezolutën 1706 ku kërkohet vendosja e shpejtë e paqeruajtësve në Darfur, me çrast Rezoluta 1706 kujton se "rezolutat e saj të mëparshme përfshi Rezolutën 1674 mbi mbrojtjen e civilëve në konflikt të armatosur, e cila riafirmon ndër të tjera dispozitat e paragrafëve 138 dhe 139 të Dokumentit të Rezultatit të Samitit Botëror të Kombeve të

shqetësohej se riafirmimi i PpM- së mund të krijonte presion mbi Këshillin për të vepruar në më shumë raste. Nga ana e saj, Kina hodhi pozicionin e saj të mëparshëm privat në favor të mbështetjes së vakët për miratimin e Këshillit të PpM me kusht që të përdorë gjuhë identike me atë të miratuar nga Samiti Botëror, shih: Alex J. Bellamy, *Realizing the Responsibility to Protect*, 15; shih gjithashtu: UN Security Council, 5476th meeting Wednesday, (28 June 2006), S/PV.5476.

⁶⁵¹ Alex J. Bellamy, 'Realizing the Responsibility to Protect', 115. Këto shqetësime u morën vesh nga debati i Këshillit në Qershor 2007 mbi mbrojtjen e civilëve. Disa shtete, përfshirë Europianët, Kanada (duke folur në emër të vetvetes, Australi dhe Zelandën e Re), Panama, Peru, Gana dhe Kongo, bënë thirrje për hapa konkretë për të realizuar PpM- në. Të tjerë, të tillë si Katari, Rusia dhe Kina argumentuan për një ngushtim dhe ngadalësim të PpM- së. Katari paralajmëroi kundër "shfrytëzimit" ose "abuzimit" të PpM; Rusia argumentoi që Këshilli duhet t'i përmbahet në mënyrë rigoroze parametrave PpM të përcaktuara në Samitin Botëror dhe të mos zgjerojë fushën e tij; dhe Kina argumentoi se 'still ka ende kuptime dhe interpretime të ndryshme të këtij koncepti midis Shteteve Anëtare.

⁶⁵² Ibid 117.

⁶⁵³ William Pace, Nicole Deller, and Sapna Chhatpar, 'Realizing the Responsibility to Protect', 223.

Bashkuara 2005".⁶⁵⁴ Që nga kjo kohë e deri në v. 2011 KS-ja kishte miratuar një numër shumë të vogël të rezolutave të cilat i referoheshin PpM-së.⁶⁵⁵ Përderisa shtetet kishin diskutuar për PpM-në mirëpo KS nuk ishte thirrur në të në situata specifike, madje, në janar 2007, një veto e dyfishtë e një rezolute të KS-së në lidhje me shkeljet e përhapura të drejtave të njeriut në Mianmar sugjeron që miratimi i PpM-së nuk e ka bërë Këshillin më të gatshëm për të adresuar mizoritë e ndodhura.⁶⁵⁶ Kundërshtimet ndaj veprimit të KS-së përfshinin që situata ishte çështje e një shteti sovran, se situata nuk ishte një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe se si çështje e të drejtave të njeriut. Mund të ndodhë që KS nuk i konsideron krimet që po ndodhin në Mianmar të jenë në shkallën e atyre në Ruandë dhe Darfur. Votimi mbi këtë rezolutë gjithsesi shtroi çështjen nëse KS po tërhiqej nga angazhimi i samitit.⁶⁵⁷

4.2.5. Këshilli i Sigurimit në veprim – ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Libi

Vala e trazirave popullore të njohura si: “Pranvera Arabe” filloi në fund të vitit 2010 në Tuniz dhe ato shumë shpejtë u përhapën në vende të tjera, siç ishte edhe Libia, ku demonstratat anti-qeveritare u intensifikuan në shkurt të vitit 2011, me çrast forcat e sigurimit të regjimit të Gaddafit u përgjigjën me municione, duke përfshirë helikopter dhe aeroplan luftarak. Në fillim trupat e Gaddafit dhe forcat mercenare luftonin për të marrë nën kontroll kryeqytetin Tripoli, ndërsa, për banorët ishte një gjendje “terrori” dhe sulme ndaj civilëve.⁶⁵⁸ Pasi më 15 Shkurt, shpërthyen protestat e para në Bengazi, pas ‘Ditës së Zemërimit’ të 17 shkurtit u rritën përleshjet midis forcave të sigurisë dhe protestuesve. Nga 18 shkurti, grupet kundërshtarë kishin marrë kontrollin e pasurive të rëndësishme në Al-Bayda dhe Benghazi, përfshi bazën ushtarake, rafinerinë e naftës në Brega, stacionin e Radio Bengazit etj. Protesta në pak ditë u përshkallëzua. Deri më 25 shkurt, Jamahirya kishte humbur kontrollin e shumë territoreve në provincat lindore, duke përfshi edhe aeroportin

⁶⁵⁴ UN, S/RES/1706, (31 August 2006); shih gjithashtu: ‘Global Centre for te Responsibility to protect’, Resolution 1706 (Sudan) <<https://www.globalr2p.org/resources/resolution-1706-sudan-s-res-1706/>> qasur 24 Mars 2020.

⁶⁵⁵ Shih: S/RES/1653, (27 January 2006); S/RES/1674, (28 April 2006) S/RES/1706, 31 August 2006; S/RES/1894, 11 November 2009

⁶⁵⁶ William Pace, Nicole Deller, and Sapna Chhatpar, ‘Realizing the Responsibility to Protect’, 224.

⁶⁵⁷ Ibid 225.

⁶⁵⁸ Roland Paris, ‘The ‘Responsibility to Protect’ and the Structural Problems of Preventive Humanitarian Intervention, , (2014) (21)5, International Peacekeeping 569, 580 [tani e tutje: Roland Paris, ‘The ‘Responsibility to Protect’].

ndërkombëtar në Tripoli.⁶⁵⁹ Përgjigja ndërkombëtare për situatën në Libi erdhi shumë shpejtë. KS-ja dhe zyrtarët e lartë të OKB-së me 22 shkurt të v. 2011 i kërkuar qeverisë Libiane të përfundojë shtypjen e dhunshme ndaj protestuesve dhe të përmbushë përgjegjësinë për të mbrojtur popullatën e saj. Edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së u shpreh i “zemëruar” për raportet se autoritetet Libiane kanë qëlluar mbi protestuesit me aeroplanë dhe helikopterë ushtarak. Edhe Komisari i Lartë për të Drejtat e Njeriut kishte kërkuar ndërprerje të menjëhershme të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.⁶⁶⁰ Para trazirave KLBK kishte regjistruar mbi 8.000 refugjatë në Libi, me rreth 3.000 azilkërkues të tjerë që kishin çështje në pritje.⁶⁶¹ Me 23 shkurt Presidenti Francez Sarkozy theksoi se: “bashkësia ndërkombëtare nuk mund të qëndrojë duarkryq përpara këtyre shkeljeve të të drejtave të njeriut.”⁶⁶² Dy ditë më vonë Këshilli i të Drejtave të Njeriut në një sesion të posaçëm për situatën e të drejtave të njeriut në Libi, miratoi Rezolutën S/15-1 duke vendosur që të dërgonte urgjentisht një komision të pavarur ndërkombëtar për të hetuar të gjitha shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut dhe krimet e kryera.⁶⁶³ Por, kur kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare u injoruan,⁶⁶⁴ KS-ja më 26 shkurt të vitit 2011 miratoi Rezolutën 1970 duke shprehur shqetësime të mëdha për situatën në Libi duke dënuar dhunën e përdorur ndaj civilëve dhe shprehur keqardhje për shkeljet e rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut, duke përfshi shtypjen e demonstruesve paqësorë, duke shprehur shqetësime të thella për vdekjen e civilëve si dhe duke iu përkujtuar përgjegjësinë autoriteteve libiane për mbrojtjen e popullatës së saj. Me këtë Rezolutë vendoset të referohet situata në Libi tek Prokurori i GJPN-së; vendoset embargo e armëve; ndalimi i udhëtimeve; ngrirja e aseteve të autoriteteve libiane⁶⁶⁵ etj. Po ashtu AP-ja miratoi Rezolutën 65/265 me të cilën e suspendoi Libinë nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut.⁶⁶⁶ Përkundër paralajmërimeve, forcat e Gaddafit vazhduan

⁶⁵⁹ Debora Valentina Malito, ‘Morality as a Catalyst for Violence: Responsibility to Protect and Regime Change in Libya’, (2019) Politikon, 5 [tani e tutje: ‘Debora Valentina Malito, ‘Morality as a Catalyst for Violence’].

⁶⁶⁰ UN News, Global Perspectives Human Stories, ‘Libya: Security Council, UN officials urge end to use of force against protesters’ (22 February 2011) <<https://news.un.org/en/story/2011/02/367182-libya-security-council-un-officials-urge-end-use-force-against-protesters>> qasur: 30 Mars 2020.

⁶⁶¹ Ibid.

⁶⁶² ‘Debora Valentina Malito, ‘Morality as a Catalyst for Violence’, 5.

⁶⁶³ Human Rights Council, ‘Report of the High Commissioner under Human Rights Council resolution’ S-15/1, Advance Unedited Version, (A/HRC/17/45, 7 June 2011).

⁶⁶⁴ Ramesh Thekur, ‘Libya and the responsibility to protect Between opportunistic humanitarianism and value-free pragmatism’, (2012), Situation Report Institute for Security Studies, 2 [tani e tutje: Ramesh Thekur, ‘Libya and the responsibility to protect’].

⁶⁶⁵ UN S/RES/1970, (26 February 2011), para. 4, 9-10, 15, 17.

⁶⁶⁶ UN, GA A/RES/65/265 (3 March 2011).

ofensivën, duke luftuar rebelët dhe duke qëlluar mbi protestuesit e paarmatosur. Opozita, tani duke formuar një milici të armatosur, humbi territor dhe i bëri thirrje OKB-së të vendosë një zonë ndalim-fluturimi,⁶⁶⁷ ndërsa disa fajësonin edhe grupet e armatosura si nxitës të dhunës.⁶⁶⁸ Më 10 mars 2011, Komisionari i Lartë “e dënoi bombardimin e vazhdueshëm ajror të Qeverisë Libiane ndaj civilëve dhe përdorimin e armëve të klasit ushtarak dhe tankseve në rrugët e qytetit”, për të cilat theksoi se do të duhej të hetoheshin si krime të mundshme kundër njerëzimit.⁶⁶⁹

Shtetet si Britania e Madhe dhe Franca, morën drejtimin për të mobilizuar mbështetjen diplomatike për veprime ushtarake në ndihmë të rebelëve, dhe si pikë mbështetëse për këtë do të ishte edhe SHBA-ja.⁶⁷⁰ Pak kohë pas miratimi të Rezolutës 1970, KS-ja më 17 mars 2011 miratoi Rezolutën 1973.⁶⁷¹ me 10 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime (Brazil, Kina, Gjermania, India dhe Rusia).⁶⁷² Duke vepruar në bazë të kapitullit të VII-të të Kartës së OKB-së, kjo Rezolutë autorizon shtetet anëtare për të marrë “të gjitha masat e nevojshme” për të mbrojtur civilët në zona të populluara nën kërcënimin e sulmit nën Jamahiruya Arabe Libiane, përfshi Bengazin. Poashtu, vendosi edhe zonën e ndalim fluturimit në Libi për mbrojtje të civilëve, ndalimin e fluturimeve nga territori Libian; ngrirjen e aseteve etj.⁶⁷³ Vetëm dy ditë pas miratimit të kësaj Rezolute një koalicion i udhëhequr nga britanikët dhe francezët zbatoi menjëherë dhe në mënyrë agresive Rezolutën 1973, duke sulmuar forcat e Gaddafit. Më 31 mars NATO mori përgjegjësinë e plotë për misionin në Libi dhe zhvilloi mbi 9.000 aksione sulmi në periudhën gjashtë muajshe.⁶⁷⁴

⁶⁶⁷ Roland Paris, ‘The ‘Responsibility to Protect’, 580.

⁶⁶⁸ Alan J. Kuperman, ‘NATO’s Intervention in Libya: A Humanitarian Success?’, “Libya, the Responsibility to Protect and the Future of Humanitarian Intervention”, (2013), Palgrave Macmillan (Edited by Aidan Hehir and Robert Murray 2013) 193 [tani e tutje: Alan J. Kuperman, ‘NATO’s Intervention in Libya: A Humanitarian Success?’].

⁶⁶⁹ A/HRC/17/45, 7 June 2011, para 39.

⁶⁷⁰ Ramesh Thekur, ‘Libya and the responsibility to protect’, 2.

⁶⁷¹ UN, S/RES/1973, (2011).

⁶⁷² UN SC, S/PV.6498 (6498th meeting Thursday, 17 March 2011). Shtetet si Franca, Britania e Madhe dhe SHBA-ja kërkuan të përkrahin rez. 1973 dhe të veprohet ndaj situatës në Libi dhe u bënë thirrje edhe shteteve tjera ta mbështesin këtë rezolutë. Mirëpo, vende të tjera të cilat abstenuan, nuk e kundërshtuan këtë rezolutë mirëpo, ata nuk ishin të gatshëm ta përkrahin një rezolutë të tillë, duke shprehur shqetësimet e tyre dhe të zgjidhjes të krizës aktuale në libi me mjete paqësore”.

⁶⁷³ UN, S/RES/1973, (2011), 4-6, 17- 19.

⁶⁷⁴ Paul R. Williams & Colleen (Betsy) Popken, ‘Security Council Resolution 1973 On Libya: A Moment of Legal & Moral Clarity’, (2011) (44)225, Case W. Res. J. Int’l L., 228 [tani e tutje: Paul R. Williams & Colleen (Betsy) Popken, ‘Security Council Resolution 1973 On Libya’]. Komisioner i Lartë i Këshillit për të drejta të njeriut raportoi se: Në javën e parë të Majit, u raportuan se predhat vazhdonin të binin mbi Mistrata, ku klinikat dhe spitale konfirmuan 530 vdekje. Ky numërim nuk përfshien shumë njerëz që nuk mund të arrinin kujdes mjekësor para se të vdisnin. Nga mesi i majit, më shumë se 800’000 persona kaluan kufijtë në Tunizi, Algjeri, Niger, Çad, Sudan, Egjipt, ishullin

Gjatë kësaj periudhe rebelët morën ndihmë të konsiderueshme nga NATO. Pas rënies së Tripolit, Gaddafi dhe besnikët e tij u tërhoqën drejt jugut, në qytetin e tij të lindjes në Sirte, ku luftimet vazhduan edhe më tutje përfundimisht me ekzekutimin e Gaddafi nga rebelët dhe humbjes së mbetjeve të fundit të regjimit të tij, përfundoi edhe operacioni ndërkombëtar⁶⁷⁵ me Rezolutën 2016 të KS-së të 27 tetorit të v. 2011.⁶⁷⁶ Kështu, Libia shënon rastin e parë ku KS-ja autorizoi një operacion ndërkombëtar të PpM-së.⁶⁷⁷ Në deklaratën e David Cameron më 19 Mars të v. 2011, e arsyetoi përdorimin e PpM-së për të justifikuar legjitimitetin dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjes,⁶⁷⁸ me çrast shihet se me miratimin e Rezolutës 1973, PpM-ja nuk është vetëm një koncept, por edhe një realitet dhe nuk është thjesht vetëm një aspiratë e atyre anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare që mbështesin ndërhyrjen ushtarake. Si rezultat i kësaj, udhëheqësit botërorë, ekspertët ndërkombëtarë dhe të politikës së jashtme si dhe organizatat humanitare kishin një moment për të reflektuar mbi sukseset dhe dështimet e PpM-së.⁶⁷⁹

Gjatë kohës së bombardimeve tri shtetet e përhershme në KS: Britania e Madhe, SHBA dhe Franca, si fajtor për situatën e konsideronin Gaddafi në një deklaratë të përbashkët me të cilën, *inter alia* thanë se qëllimi ishte mbrojtja e civilëve nën mandatin e Rezolutës 1973. Ata deklaruan se: “është e pamundur të imagjinosh të ardhmen në Libi me Gaddafi në pushtet”. Sipas tyre është e paimagjinueshme që dikush që është përpjekur të masakrojë njerëzit të mund të luajë një rol në qeverinë e ardhshme, me një të ardhme pa Gaddafi.⁶⁸⁰ Në debatet e KS-së mbështetësit e ndryshimit të regjimit në Libi shtjelluan idenë se Libia e

Italian të Lampedusa ose Malta. Këto përfshijnë kryesisht shtetas të vendeve të treta që kthehen në vendet e tyre të origjinës, por gjithashtu refugjatë (kryesisht Sudanezë, Eritreanë, Etiopianë dhe Somalitë) të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës dhe duhet të vendosen. Rreth 300'000 Libianë gjithashtu thuhet se kanë ikur nga konflikti dhe më shumë se 50'000 persona të zhvendosur brenda vendit u raportuan në pjesën përfundimtare të vendit, shih: Human Rights Council, Report of the High Commissioner under Human Rights Council resolution S-15/1, Advance Unedited Version, (A/HRC/17/45, 7 June 2011), para. 49, 54.

⁶⁷⁵ Heidarali Teimouri and Surya P. Subedi, ‘Responsibility to Protect and the International Military Intervention in Libya in International Law: What Went Wrong and What Lessons Could Be Learnt from It?’, *Journal of Conflict & Security Law* (2018) (23)1, (Oxford University Press 2018) 7 [tani e tutje: ‘Heidarali Teimouri and Surya P. Subedi, ‘Responsibility to Protect and the International Military Intervention in Libya in International Law’].

⁶⁷⁶ UN, S/RES/2016 (27 October 2011). Në Shtator Këshilli i Sigurimit me Rezolutën S/Res/2009, themeloi Misionin e Mbështetjes së Kombeve të Bashkuara në libi (UNSMIL) dhe i ngriti sanksionet pjesërisht, shih: UN, S/RES/2009, (2011).

⁶⁷⁷ Ramesh Thekur, ‘Libya and the responsibility to protect’, 3.

⁶⁷⁸ ‘Debora Valentina Malito, ‘Morality as a Catalyst for Violence’, 6.

⁶⁷⁹ Sari Bernstein, ‘The Responsibility to Protect After Libya: Humanitarian Prevention as Customary International Law’, (2012) (38)1 *Brooklyn Journal of International Law*, Article 8, 308.

⁶⁸⁰ Barack Obama, David Cameron and Nicolas Sarkozy, ‘Libya’s Pathway to Peace’, *The New York Times*, (April 14, 2011) <<https://www.nytimes.com/2011/04/15/opinion/15iht-edlibya15.html>> qasur: 30 Prill 2020.

unifikuar e kundërshtoi Gaddafin. Besimi për një ndryshim regjimi vinte edhe nga konsensusi arab.⁶⁸¹ Para miratimit të Rezolutës 1973, në mars të v. 2011, Liga Arabe kërkoi nga KS-ja që të vepronte në Libi dhe të caktonte një zonë ndalim fluturimi.⁶⁸² Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së deklaroi se: “KS ka marrë një vendim historik. Rezoluta 1973 e afirmon, në mënyrë të qartë, vendosmërinë e bashkësisë ndërkombëtare për të përmbushur përgjegjësinë e saj për të mbrojtur civilët nga dhuna e kryer mbi ta nga qeveria e tyre”.⁶⁸³ Më vonë, ai konsideroi se operacionet e NATO-s “kanë qenë efektive në mbrojtjen e popullatës civile”.⁶⁸⁴ Marchos Tohorino thekson se pas një dekade debatesh, konstatimesh dhe infiltrimit të ngadaltë të agjendës normative të OKB-së, kishte ardhur koha për zbatimin e padyshimtë të PpM-së. Autorizimi i forcës ushtarake për të imponuar një zonë ndalim-fluturimi në Libi për mbrojtje të civilëve, vetëm dy javë pas sanksioneve ndaj Gaddafit ishte një demonstrim i pazakontë dhe i shpejtë i KS, shpesh të bllokuar.⁶⁸⁵ Williams dhe Popken argumentojnë se Rezoluta 1973 japin një plan për një ndërhyrje efektive humanitare.

Ndërhyrja në Libi u karakterizua me:

- 1) veprimin e shpejtë nga KS për të autorizuar ndërhyrjen ushtarake kur diplomacia dukej e pafrytshme;
- 2) një rezolutë e hartuar mirë që siguronte mandatin e nevojshëm për një ndërhyrje të suksesshme; dhe
- 3) zbatimin agresiv dhe të menjëhershëm nga një koalicion ndërkombëtar.⁶⁸⁶

Rezoluta 1973 është një plan i hartuar mirë, e cila iu siguroi mandatin forcave ndërhyrëse për një ndërhyrje të suksesshme.⁶⁸⁷ Mirëpo, pavarësisht përkrahjes dhe argumentimeve për ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Libi, në përputhje me Rezolutën e KS-së, ajo gjithashtu, nuk mbeti pa kritika. Që nga debati për miratimin e Rezolutës 1973, shtetet anëtare të KS-së

⁶⁸¹ ‘Dobora Valentina Malito, ‘Morality as a Catalyst for Violence’, 8.

⁶⁸² UN Security Council *Report on Libya*, (14 March 2011) <https://www.securitycouncilreport.org/update-report/lookup_c_glkwlmtisg_b_6621881.php> qasur: 30 Prill 2020.

⁶⁸³ United Nations Secretary- General, *Statement on Libya*, (17 March 2011) <<https://www.un.org/sg/>> qasur: 1 Prill 2020.

⁶⁸⁴ United Nations Secretary- General, *Secretary-General's message to Third Meeting of the Contact Group on Libya*, (Statements on 09 June 2011) <<https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2011-06-09/secretary-generals-message-third-meeting-contact-group-libya>> qasur:

⁶⁸⁵ Marcos Tourinho, ‘Oliver Stuenkel & Sarah Brockmeier, “Responsibility while Protecting”: Reforming R2P Implementation’, Global Society, (Routledge 2016) 135- 136 <<https://doi.org/10.1080/13600826.2015.1094452>> qasur: 1 Prill 2020.

⁶⁸⁶ Paul R. Williams & Colleen (Betsy) Popken, ‘Security Council Resolution 1973 On Libya, 226.

⁶⁸⁷ Ibid 227.

kishin diskutuar miratimin e kësaj rezolute, ku shtetet si: Brazili, Gjermania, Kina, Rusia, dhe India, nuk u pajtuan me miratimin e kësaj rezolute dhe abstenuan.⁶⁸⁸ Por, për dikë shihet se frika dhe abstenimi i këtyre shteteve u vërtetua si i pabesuar sepse shumë më pak civilë do të vdisnin nga zbatimi i Rezolutës 1973, se sa bota mos të bënte asgjë dhe frika se kush do ta zbatonte fushatën u shua shpejt pasi francezët, britanikët dhe amerikanët morën menjëherë kryesimin dhe filluan aksionet e NATO-s.⁶⁸⁹ Por, shumë autorë kanë vërejtur se ndërhyrja e NATO-s në Libi ka tejkaluar mandatin e saj të PpM-së dhe u keqpërdor për qëllime të paligjshme dhe të diskutueshme të ndryshimit të regjimit politik.⁶⁹⁰ Në këtë drejtim, Debroda Malito thekson se ndryshimi i regjimit politik nuk ka ardhur vetëm nga llogaritjet e gabuara operative dhe strategjike, por, ai hedh dritë edhe në mënyrën me të cilën morali legjitimon dhunën. Argumenti kryesor i Malito, është se diskursi morale hegjemonike në lidhje me natyrën e konfliktit për zgjidhjen e mundshme të tij, janë përdorur si një sistem për të ndërtuar konsensusin, duke bërë ndryshimin e regjimit politik jo vetëm të mundshëm, por

⁶⁸⁸ UN, SC S/PV.6498 (6498th meeting Thursday, 17 March 2011). Përfaqësuesi i Gjermanisë kërkuan forcimit e sanksioneve kundër regjimit të Gaddafit duke konsideruar se ato “do të jenë një mënyrë efektive për t’i dhënë fund sundimit të Muammar Gaddafit dhe për të filluar një tranzicion të mëtejshëm politik”. Gjermania shprehët e shqetësuar se përdorimin e forcave ushtarake e shihnin “me rreziqe të mëdha” dhe frikën e “humbjen në shkallë të gjerë të jetës” dhe frikën e ndikimit të saj në rajon. Edhe Brazili besonte se përdorimi i forcës që parashihej në paragrafin 4 të rezolutës do të qojë në përfundimin e menjëhershëm të dhunës civile, por se ishin të shqetësuar se “masat e tilla do të kishin efekte të padëshirueshme të përkeqësimit të situatës në terren dhe do të shkaktohej më shumë dëm se sa dobi”. mund të kenë pasoja serioze për situatën në Libi dhe më gjerë. Ndërsa India insistonte në “respekt të plotë të sovranitetit, unitetit dhe integritetit territorial të Libisë”. Rusia besonte se dispozitat e tilla do të “mund të hapnin dyert për ndërhyrje ushtarake në shkallë të gjerë”. Edhe Kina kërkonte respektim të Kartës së OKB- së dhe “respektim të sovranitetit, pavarësisë, unitetit dhe integritetit territorial të Libisë dhe të zgjidhjes të krizës aktuale në Libi me mjete paqësore”.

⁶⁸⁹ Paul R. Williams & Colleen (Betsy) Popken, ‘Security Council Resolution 1973 On Libya’, 231.

⁶⁹⁰ ‘Debora Valentina Malito, ‘Morality as a Catalyst for Violence’, 12; shih gjithashtu: Alan J. Kuperman, ‘NATO’s Intervention in Libya: A Humanitarian Success? 197, 204, Andrea Carati, ‘Responsibility to protect, NATO and the problem of who should intervene: reassessing the intervention in Libya’, (2017) Global Change, Peace & Security 13 [tani e tutje: Andrea Carati, ‘Responsibility to protect, NATO and the problem of who should intervene’] Edward Luck, u përgjigj në pyetjen në lidhje me ndryshimet midis PpM- së dhe ndryshimit të regjimit, duke insistuar se të dyja ishin të ndryshme, duke thënë se “nuk është qëllimi i përgjegjësisë për të mbrojtur ndryshimi i regjimeve”. Në disa raste mënyra e vetme për të mbrojtur popullatën është ndryshimi i regjimeve, por sigurisht nuk është qëllimi i RtoP- së në vetvete. Por, sipas Alex Bellamy, mund të duket se Luck ka të drejtës të argumentojë se në disa situata duhet të bëhet vetëm ndryshimi i regjimit. Mirëpo, Bellamy vëren se për shkak të shqetësimeve të thella nga ana e shumë vendeve anëtare që RtoP mund të shkaktojë një agjendë të ndryshimit të regjimit, po aq i thellë do të jetë kundërshtimi ndërkombëtar ndaj një agjende të tillë, prandaj, ai kërkon që duhet të bëhen më shumë hulumtime një marrëdhënie më të thellë në mënyrë që të konstatojmë nëse ka mënyra për të ruajtur një dallim të qartë midis PpM- së dhe ndryshimit të regjimit pa sakrifikuar mbrojtjen e civilëve, shih: Alex J. Bellamy, ‘The Responsibility to Protect and the Problem of Regime Change, The Responsibility to Protect: challenges & opportunities in light of the Libyan intervention’, (2011), (Edited by Alex Stark, e-International Relations, November 2011) 22 [tani e tutje: : Alex J. Bellamy, ‘The Responsibility to Protect and the Problem of Regime Change’].

edhe të pranueshëm e të lejueshëm.⁶⁹¹ Alan Kuperman argumenton se nëse NATO do të kishte kërkuar thjeshtë mbrojtjen e civilëve, në përputhje me autorizimet e saj, aleanca Trans-Atlantike do të kishte zbatuar zonën e ndalim fluturimeve dhe do të bombardonin forcat që kërcënonin civilët dhe të bënte përpjekje për armëpushim. Mirëpo, sipas tij NATO e bëri të kundërtën, ajo ndihmoi rebelët që refuzuan rrugën paqësore,⁶⁹² ata ndihmuan rebelët edhe pasi ata kishin refuzuar ofertat e qeverisë për armëpushim dhe mund t'i kishte dhënë fund dhunës dhe do të kishte kursyer civilët.⁶⁹³ Andre Carrati, adreson kufizimet në besimin e NATO-s për të kryer misione të ngjashme si ato të PpM-së, veçanërisht problemin e delegimit për shkak të natyrës partikulare dhe ushtarake të një aleance. Prandaj, Carrati konsideron se NATO nuk mund të jetë një zgjidhje për problemin se kush duhet të ndërhyjë, edhe pse ndërhyrjet e saj mund të jenë herë pas here në përputhje me parimet PpM-së. Prandaj, ai thotë se rasti i ndërhyrjes së NATO-s në Libi vë në pah mospërputhjet midis NATO-s dhe PpM-së.⁶⁹⁴ Për më tepër argumentohet se ndërhyrja në Libi bëri pak për të forcuar PpM-në si një normë në zhvillim në të drejtën ndërkombëtare. Prandaj, nga disa autorë argumentohet edhe më tutje se një rishikim i tekstit të Rezolutave të KS-së për Libinë ofron pak prova për të sugjeruar që skepticizmi ndaj PpM-së ishte tejkaluar dhe ndërhyrja Libiane të përbënte një epokë të re të entuziazmit të KS-së për ndërhyrje ushtarake për qëllime humanitare,⁶⁹⁵ dhe përveç “përgjegjësisë së autoriteteve libiane për të mbrojtur popullatën e vet”, asnjë referencë tjetër për PpM nuk mund të gjendet në rezoluta,⁶⁹⁶ me çrast një analizë tekstuale e rezolutave të KS-së që autorizon ndërhyrjen në Libi zbulon se PpM-ja nuk ishte pranuar nga anëtarët e KS-së.⁶⁹⁷

Megjithëse, ndërhyrja në Libi ishte parashikuar për qëllime afatshkurtëra të mbrojtjes së civilëve, vlen të analizohet nëse ndërhyrja prodhoi pasoja afatgjate për Libinë. Lidhur me

⁶⁹¹ 'Debora Valentina Malito, 'Morality as a Catalyst for Violence', 13.

⁶⁹² Alan J. Kuperman, 'NATO's Intervention in Libya: A Humanitarian Success?', "Libya, the Responsibility to Protect and the Future of Humanitarian Intervention", (2013), (Palgrave Macmillan Edited by Aidan Hehir and Robert Murray 2013) 197 [tani e tutje: Alan J. Kuperman, 'NATO's Intervention in Libya: A Humanitarian Success?'].

⁶⁹³ Ibid 204.

⁶⁹⁴ Andrea Carati, 'Responsibility to protect, NATO and the problem of who should intervene', 17.

⁶⁹⁵ David Berman and Christopher Michaelsen, 'Intervention in Libya: Another Nail in the Coffin for the Responsibility-to-Protect?', (2012) (14) International Community Law Review, (Martinus Nijhoff Publishers 2012) 350 [tani e tutje: 'David Berman and Christopher Michaelsen, 'Intervention in Libya'].

⁶⁹⁶ Ibid 352, shih gjithashtu: Aidan Hehir, 'The Permanence of Inconsistency, Libya, the Security Council, and the Responsibility to Protect', (2013) (38)1, International Security, 147.

⁶⁹⁷ 'David Berman and Christopher Michaelsen, 'Intervention in Libya', 358.

këtë çështje, Kuperman si zhvillim më pozitiv pas ndërhyrjes në Libi i konsideron zgjedhjet demokratike të korrikut të vitit 2012, që sollën një pushtet të moderuar, mirëpo, gjërat ndryshuan dhe kryeministri i parë i zgjedhur në mënyrë demokratike në vend, nuk arriti të zgjasë as edhe një muaj në detyrë, më pas edhe zhvillimet e tjera ishin dekurajuese.⁶⁹⁸ Ndryshimi i regjimit politik krijoi një vakum të pushtetit që siguroi terren për rivalitetet fisnore, duke rezultuar në një kaos dhe në një qeveri të dobët qendrore⁶⁹⁹; me çrast në vitin 2016 në Libi kishte tre qendra të pushtetit në skenën politike libiane: e para ishte Këshilli Presidencial i cili ishte i vendosur në Tripoli më 30 mars 2016. Ky organ lindi nga nënshkrimi i Marrëveshjes Politike Libiane të ndërmjetësuar nga OKB-ja më 17 Dhjetor 2015; e dyta, ishte Qeveria e Shpëtimit Kombëtar, përsëri e përqendruar në Tripoli, ku ky autoritet qëndron në udhëheqjen e një grumbulli të Kongresit të Përgjithshëm Kombëtar të Libisë, megjithëse, në vitin 2016, këtij organi i mungonte fuqia e vërtetë për të kontrolluar ndonjë institucion përkatës, dhe e treta është Tobruk-u, i vendosur në Al-Bayda.⁷⁰⁰ Secila nga këto autoritete kishin mbështetje nga disa vende të caktuara, deri sa OKB-ja ftoi në negociata politike libiane për herë të parë edhe besnikët e Gaddafit. Gjithashtu, edhe kriza e refugjatëve e cila ishte përfshirë në të gjithë Europën, përfshinte edhe rastin e komplikuar të Libisë.⁷⁰¹ Sipas të dhënave të KLKBR-së në vitin 2017, rreth 1.3 milion njerëz kishin nevojë për ndihmë humanitare në Libi. Libia gjithashtu pret 43.113 refugjatë dhe azilkërkues, të cilët janë të regjistruar në KLKBR. Refugjatët po udhëtojnë së bashku me migrantët përmes rrugëve të rrezikshme drejt Europës. Deri në 90% e njerëzve që kalojnë Detin Mesdhe për në Europë largohen nga Libia.⁷⁰² Prandaj, për disa autorë mbetet shqetësimi për PpM-në, madje edhe më keq, sepse në këtë fazë, sipas tyre, është e mundur të konkludohet se Libia është në prag të shndërrimit në një shtet të dështuar; në thelb, në një Somali të re.⁷⁰³ Së fundmi për situatën në Libi, Këshilli për të Drejtat të Njeriut i OKB-së ka themeluar Misionin e Pavarur për gjetjen e fakteve në Libi me Rezolutën 43/39 për të hetuar shkeljet dhe abuzimin e të drejtave të

⁶⁹⁸ Alan J. Kuperman, 'NATO's Intervention in Libya: A Humanitarian Success?', 208.

⁶⁹⁹ 'Heidarali Teimouri and Surya P. Subedi, 'Responsibility to Protect and the International Military Intervention in Libya in International Law', 8.

⁷⁰⁰ Ibid.

⁷⁰¹ Ibid 9- 10.

⁷⁰² UNHCR, The UN Refugee Agency, *Lybia*, (2017) <<https://www.unhcr.org/libya.html>> qasur: 4 Prill 2020.

⁷⁰³ 'Heidarali Teimouri and Surya P. Subedi, 'Responsibility to Protect and the International Military Intervention in Libya in International Law', 12.

njeriut që nga viti 2016 me qëllim për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të situatës së të drejtave të njeriut dhe për të siguruar llogaridhënien.⁷⁰⁴

Në bazë të analizës së situatës nga rasti i Libisë mund të konsiderohet si një dështim i zbatimit nga bashkësia ndërkombëtare në mënyrë të duhur të shtyllës së tretë: “Përgjegjësisë për të rindërtuar”, të paraparë që nga Komisioni i KNNSSH- së, se sa dështim i zbatimit të PpM-së në tërësi. Prandaj marrë në përgjithësi, ndërhyrja në Libi është domethënëse për zhvillimin e konceptit të PpM-së, por siç argumenton edhe Brockmeier nuk shënoi asnjë fitore të pakontestueshme dhe as vdekje të PpM-së.⁷⁰⁵ Pavarësisht dështimet e së kaluarës rasti i Libisë zbuloi se bashkësia ndërkombëtare mund të veprojë në kohën e duhur për t’i ndaluar krimet e mizorisë masive kur ekziston vullneti i mjaftueshëm politik dhe operativ.⁷⁰⁶ Dhe në fund, siç argumenton me të drejtë edhe Simon Adams, neve nuk mund të shpërqendrohemi nga ngatërrimi i atyre që argumentojnë se Libia është e vetmja pikë e referimit për të matur PpM-në sepse përkundër ndarjes dhe debatit për kuptimin dhe implikimet e ndërhyrjes libiane, PpM është ende instrumenti më i mirë që kemi për të kapërcyer hendekun midis qëllimeve fisnike të OKB-së dhe botës së papërsosur të diplomacisë globale. PpM-ja mbetet shpresa jonë më e mirë për ta bërë "kurrë më" një parim të gjallë, sesa një klishe për të pëshpëritur ndërsa zhvendosim përkujtimet dhe varret masive të atyre që vdiqën ndërsa bota po rrinte në heshtje.⁷⁰⁷

4.2.6. Iniciativa Braziliene: “Përgjegjësia duke mbrojtur”

Ndërhyrja e NATO-s në Libi në vitin 2011, me miratimin e Rezolutës 1973, nuk u votua nga të gjitha shtetet në KS. Ndër shtetet të cilat nuk e votuan këtë rezolutë ishte edhe Brazili, duke abstenuar në votim krahas Kinës, Gjermanisë dhe Indisë. Në muajt në vijim shqetësimet e shprehura nga Brazili u kthyen në zemërim të dukshëm në mënyrën se si vendet e NATO-s si: Franca, Britania e Madhe dhe SHBA-ja e interpretonin Rezolutën 1973. Sipas Brazilit në vend se të përfundonin aksionet pasi kishin ndalur trupat e Ghaddafit që sulmonin civilët në Bengazi, vendet e NATO-s bënë fluturime të panumërta duke vepruar kundër trupave libiane-

⁷⁰⁴ UN Human Rights Council- ‘Independent Fact-Finding Mission on Libya’

<https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/FFM_Libya/Pages/Index.aspx> qasur: 04. Prill 2020.

⁷⁰⁵ Sarah Brockmeier, Oliver Stuenkel & Marcos Tourinho, ‘The Impact of the Libya Intervention Debates on Norms of Protection’, (2016) (30)1, Global Society, 132.

⁷⁰⁶ Simon Adams, ‘Lybia and the Responsibility to Protect’ (2012), Global Centre for the Responsibility to Protect, 17.

⁷⁰⁷ Ibid 18.

të gjitha në emër të “mbrojtjes së civilëve”. Ambasadori i Indisë në OKB pohoi se veprimet e NATO-s “i kanë dhënë emër të keq” asaj. Arroganca e vendeve të NATO-s dhe lënia mënjanë e kritikave të KS tërhoqën zemërimin e Brazilit, por edhe të Indisë dhe Afrikës së Jugut.⁷⁰⁸ Disa ditë pas ndërhyrjes në Libi, Brazilianët argumentuan se misioni i Libisë demonstroi një nevojë për qartësim mbi PpM-në. Sipas tyre, misioni kishte shkuar përtej mandatit të dhënë nga KS-ja në bazë të PpM-së dhe kishte të bënte më shumë me rrëzimin e Ghaddafit se sa me mbrojtjen e civilëve, një pikëpamje e shprehur edhe nga India dhe Afrika e Jugut.⁷⁰⁹

Dallimi thelbësor i këtij kundërshtimi që kishte Brazili kishte të bënte kryesisht me zbatimin e PpM-së dhe veçanërisht shtyllën e tretë (të Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB- së të vitit 2009), e cila mund të përdoret për të autorizuar forcën ushtarake.⁷¹⁰ Si rezultat i këtij kundërshtimi të zbatimit të PpM-së në rastin e Libisë, Brazili në Nëntor të vitit 2011 inicioi një koncept të ri të quajtur: “Përgjegjësia duke mbrojtur” (PdM). Ambasadorja e Brazilit në OKB, Maria Luiza Ribeiro Viotti në debatin e hapur në KS shprehu pikëpamjen e Brazilit që bashkësia ndërkombëtare “pasi ushtron përgjegjësinë e saj për të mbrojtur, duhet të demonstrojë një nivel të lartë të përgjegjësisë duke mbrojtur”. Duke paraqitur një koncept të zhvilluar nga qeveria Braziliene mbi këtë çështje me titullin: “Përgjegjësia duke Mbrojtur:

⁷⁰⁸ Thorsten Benner, Brazil as a norm entrepreneur: the “Responsibility While Protecting” initiative, (2013) Global Public Policy Institute, (GPPi working paper) 3- 4 [tani e tutje: Thorsten Benner, Brazil as a norm entrepreneur: the “Responsibility While Protecting” initiative].

⁷⁰⁹ Xenia Avezov, 'Responsibility while protecting': are we asking the wrong questions?', (2013) Stockholm International Peace Research Institute, 2013 <<https://www.sipri.org/node/409>> 10 Qershor 2020 [tani e tutje: 'Xenia Avezov, 'Responsibility while protecting': are we asking the wrong questions?']. Ndërhyrja ushtarake në Libi dhe pasojat e saj të komplikuar detyruan një intensifikim të këtij diskutimi dhe një rishikim të shkallës në të cilën aparati i sigurisë kolektive, përfshirë përdorimin e forcës ushtarake, është i përshtatshëm ose i mjaftueshëm për të adresuar këto probleme.

Ndërsa po zhvillohej ky diskutim, diplomatët brazilianë argumentuan për nevojën e mjeteve më të përgjegjshme të mbrojtjes, për një "përgjegjësi duke mbrojtur". Sipas Marcod Tourinho, *së pari*, ai theksoi nevojën për t'u përqëndruar në parandalimin dhe mjetet jo-shtrënguese, duke nënvizuar që strategjitë ushtarake duhet t'i nënshtrohen atyre politike dhe diplomatike. *Së dyti*, ai rishikoi debatin se në çfarë kriteresh dhe për cilat motive, forca duhet të vendoset për të mbrojtur civilët. *Së treti*, ai kërkoi të përmirësojë mekanizmat e monitorimit dhe llogaridhënies së misionit dhe atyre që zbatojnë mandatin në emër të Këshillit të Sigurimit, shih: Marcos Tourinho, Oliver Stuenkel & Sarah Brockmeier, “Responsibility while Protecting”: ‘Reforming R2P Implementation’, (2016) Global Society, (Routledge 2016) 148 <<https://doi.org/10.1080/13600826.2015.1094452>> qasur: 10 Qershor 2020 [tani e tutje: Marcos Tourinho, Oliver Stuenkel & Sarah Brockmeier, “Responsibility while Protecting”].

⁷¹⁰ Kai Michael Kenkel, ‘Brazil and the Responsibility While Protecting Initiative’, (Oxford Research Group, 2016) <<https://www.oxfordresearchgroup.org.uk/blog/brazil-and-the-responsibility-while-protecting-initiative>> qasur 12 Qershor 2020 [tani e tutje: ‘Kai Michael Kenkel, ‘Brazil and the Responsibility While Protecting Initiative’]. Dhe në Shtator të vitit 2011 Presidenja Braziliene Dilma Rousseff në një fjalim të saj pranë AP- së deklaroi se “ndërsa u fol shumë për përgjegjësinë për të mbrojtur, pak u dëgjua për përgjegjësinë duke mbrojtur- dy koncepte që duhet të zhvillohe së bashku”, shih: ‘General Assembly of the United Nations General Debate Brazil H.E. Mrs. Dilma Rousseff’, President (2011) (66th Session), Statement Summary: <<https://gadebate.un.org/en/66/brazil>> qasur 10 Qershor 2020.

elementet për zhvillimin dhe promovimin e një koncepti”. Sipas këtij dokumenti të tri shtyllat e paraqitura të zbatimit të PpM-së nga raporti i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së në Raportin e vitit 2009 të bazuara në paragrafët 139 dhe 139 “duhet të ndjekin një linjë më të rreptë të varësisë politike dhe renditjes kronologjike” shprehur me frikën e keqpërdorimit të PpM-së dhe keqpërdorimit të saj për qëllime të tjera, në vend të mbrojtjes së popullatës civile⁷¹¹. Sipas këtij dokumenti të dy konceptet duhet të evoluojnë së bashku, duke u bazuar në disa parime siç janë: diplomacia parandaluese për të zvogëluar konfliktet e armatosura; përpjekjet rigoroze për të shteruar mjetet e nevojshme për mbrojtjen e popullatës civile; se përdorimi i forcës përfshi edhe ushtrimin e përgjegjësisë për të mbrojtur duhet të autorizohet gjithmonë nga KS-ja në përputhje me kapitullin e VII-të të Kartës, në rrethana të jashtëzakonshme nga AP-ja; operacioni i forcës duhet të jetë i kufizuar në elementet ligjore, operacionale dhe në frymën e mandatit që del nga KS-ja etj.⁷¹²

Një iniciativë e tillë bëri që për herë të parë, Brazili të paraqesë një propozim mbi zhvillimin e një norme kritike globale që i prek bazat e rendit global. Fakti që Brazili zgjodhi debatin mbi PpM-në, nënvizon ambiciet që të bëhet një lojtar global.⁷¹³ Kjo u deklarua edhe nga presidentja Braziliene Dilma Rousseff, e cila bëri thirrje që: “bota ka nevojë për një KS që pasqyron realitetin bashkëkohor”, dhe “duke theksuar se Brazili ishte i gatshëm të mbante përgjegjësinë e tij si një anëtar i përhershëm”⁷¹⁴ dhe veçanërisht pjesëmarrja në formësimin e rregullave të sistemit ndërkombëtar.⁷¹⁵ Reagimet e hershme të Brazilit ndaj PpM-së kishin tendencë t’i shihnin si sfidë kërcënimet për përdorim të forcës, ndërsa theksohet angazhimi i tyre për të drejtat e njeriut dhe shqetësimi për përfaqësimin në KS dhe keqpërdorimin e normave nga fuqitë perëndimore, ata morën një pozicion të qartë të tyre duke argumentuar se këtë të drejtë duhet ta mbajë KS-ja ekskluzivisht dhe jo ndonjë organizatë rajonale siç është NATO dhe këmbëngulte se KS-ja duhet të reflektojë ndryshimet globale.⁷¹⁶ Për, Kai Kenkel rezistenca e Brazilit, duket se është përqendruar më pak në përmbajtjen normative të

⁷¹¹ UN, GA A/66/551-S/2011/701 (11 November 2011) para. 10.

⁷¹² Ibid para 11.

⁷¹³ Thorsten Benner, Brazil as a norm entrepreneur: the “Responsibility While Protecting” initiative, 1.

⁷¹⁴ ‘General Assembly of the United Nations General Debate Brazil H.E. Mrs. Dilma Rousseff’, (President 21 September 2011) (66th Session), Statement Summary < <https://gadebate.un.org/en/66/brazil> > qasur 14 Prill 2020.

⁷¹⁵ ‘Kai Michael Kenkel, ‘Brazil and the Responsibility While Protecting Initiative’.

⁷¹⁶ Ibid 341- 342.

konceptit, me përjashtim të shtyllës së tretë, dhe në vend të kësaj ishte përqendruar në kriteret e zbatimit të saj në terren.⁷¹⁷

Siç shihet “Testi Praktik” i ndërhyrjes në Libi provokoi një debat të fortë politik se si dimensionet shtrënguese të PpM-së duhet të zbatohen më mirë. Por, në atë kohë, veçanërisht në muajt e parë, shumica e shteteve ishin të mendimit se koncepti i PpM-së mbetet i paprekur nga PdM-ja. Përjashtime të rëndësishme, në muajt e parë të debatit të konceptit ishin: Franca, Britania e Madhe dhe një masë më të vogël SHBA-ja. Ata e interpretuan propozimin e Brazilit si një kritikë të drejtpërdrejtë të ndërhyrjes në Libi. Duke dashur të paraqesin ndërhyrjen e NATO-s një sukses, Franca e vlerësoi PdM thjeshtë “si një mjet për ta bërë më të vështirë jetën e pesë anëtarëve të përhershëm të KS- së”.⁷¹⁸ Por, fokusi kryesor i kritikave ishte propozimi fillestar i Brazilit për përkthimin e parimit të “mjetit të fundit” në “një renditje të rreptë dhe kronologjike të tre shtyllave të PpM-së”, një ide që u refuzua gjerësisht.⁷¹⁹ Ndërsa, ideja e Brazilit nga kundërshtarët e PdM-së u pa si një dredhi e qëllimshme nga shtetet e rreshtuara me Kinën dhe Rusinë,⁷²⁰ Thorsten Benner, identifikon edhe tre shtesa kryesore të skepticizmit në Uashington, Berlin, Paris dhe Londër. E para, ka të bëjë me dallimet konceptuale, siç thekson ambasadori Gjerman në debatin zyrtar në OKB për PpM-në, në vitin 2012, se Brazilit i mungon “një koncept nga vetja”. Gjithashtu ai kundërshton edhe përshkrimin e një renditje kronologjike, shterimin e detyrueshëm të mjeteve paqësore.⁷²¹ Shtesa e dytë, është sjellja e Brazilit me rastin e Sirisë. Pasi abstenoj për një rezolutë të paraqitur në KS më 4 tetor 2011 për të dënuar shkeljet e të drejtave të njeriut në Siri dhe kjo lëvizje u pa nga vendet perëndimore se ishte në përputhje me Kinën dhe Rusinë. Në të vërtetë Rusia lloboi më shumë në Brazil, për ta mbështetur pozicionin e tyre për Sirinë. Dhe shtesa e tretë, e reagimeve negative në SHBA dhe Europë ndaj pozicionit të Brazilit shkon më tutje, se si vendet Euro-Atlantike e shohin zhvillimin e normës ndërkombëtare. Elita politike dhe akademike kryesisht argumentonin se “sipërmarrja e normave është domen i perëndimit dhe ka pak vend për vendet jo perëndimore, vendet jo-perëndimore mund të zgjedhin se a dëshirojnë ta zbatojnë atë apo jo”.⁷²²

⁷¹⁷ Ibid 349.

⁷¹⁸ Marcos Tourinho, Oliver Stuenkel & Sarah Brockmeier, “Responsibility while Protecting”, 139- 141.

⁷¹⁹ Ibid.

⁷²⁰ ‘Xenia Avezov, ‘Responsibility while protecting’: are we asking the wrong questions?’.

⁷²¹ Thorsten Benner, Brazil as a norm entrepreneur: the “Responsibility While Protecting” initiative. 4.

⁷²² Ibid 5- 6.

Përkundër kritikave të forta fillestare, nisma formësoi mënyrën se si fuqitë në rritje ndër vepronin në debatet pasuese të OKB-së mbi PpM.⁷²³ Në kulmin e popullaritetit të saj, PdM në mënyrë efektive arriti të zgjeronte debatin rreth PpM-së. Vendet që e kuptuan PdM si një propozim konstruktiv dhe ranë dakord për të adresuar pyetjet lidhur me PpM dhe përdorimit të forcës përfshiu shumë rajone, duke përfshirë: Irlandën, Portugalinë, Luksemburgun, Ganën, Argjentinën, Egjiptin, Meksikën, Malajzinë, Singaporin etj. Ndërsa, disa studiues e interpretuan propozimin si një përpjekje të Brazilit për të marrë udhëheqjen e normës ndërkombëtare, por, shumë autorë në këtë debat pohuan se sqarimi i pyetjes së ngritur nga Brazili ishte thelbësor për të çuar përpara debatin e PpM-së.⁷²⁴ Sipas përkrahësve të PdM, ajo do ta bënte ndërhyrjen ushtarake për mbrojtje të civilëve më të përgjegjshme dhe proporcionale dhe do të frenonte keqpërdorimin e PpM-së.⁷²⁵ Por, gjatë muajve të ardhshëm, pas paraqitjes së doktrinë PdM shumica e kritikëve të hershëm të saj hoqën dorë nga kundërshtimi,⁷²⁶ dhe filluan një angazhim më konstruktiv ndaj saj, si nga Gjermania dhe vende të tjera. Mirëpo, këtij ndryshimi sipas Benner i kanë paraprirë disa lëvizje nga Brazili. Ambasadorja Braziliene në OKB, theksoi se renditja e tri shtyllave duhej të ishte “logjike dhe kronologjike”, duke korrigjuar kështu një defekt nga shënimi origjinal i konceptit, sepse bie ndesh me mësimet e marra nga Libia. Zbatimi i mandatit të Libisë (Rez. 1973) thekson se një renditje e masave në tre shtylla nuk është e nevojshme dhe nuk duhet të jetë rreptësisht kronologjike. Gjithashtu, Brazili votoi Rezolutën A- së 66/253 B e cila dënoi dhunën në Siri.⁷²⁷ Kështu, këto vende dukeshin të vendosura që Brazili të merrte më tej konceptin dhe të tjerë aleatë gjatë hapjes së AP-së në shtator 2012. Mirëpo, kjo gjë nuk ndodhi, pasi në raportin për PpM, Brazili ishte shumë gjenerik në deklaratën e vet dhe nuk kishte asgjë të re nga përpjekja diplomatike Braziliene për ta zgjeruar koalicionin e PdM-së. Thorstern Benner, vëren se Brazili duket se ka qenë i papërgatitur për kritikën dhe kthimet prapa pasi nisi konceptin PdM-së dhe pikërisht kur diskutimi duhej të kishte filluar për të trajtuar pyetjen serioze dhe të hapur, Brazili duket se ka “tërhequr prizën”.⁷²⁸ Edhe pse vendet perëndimore, megjithatë, filluan ta shohin konceptin PdM-së si një mjet për ta ringjallur PpM-në, Brazili duke mos pasur përvojë

⁷²³ ‘Kai Michael Kenkel, ‘Brazil and the Responsibility While Protecting Initiative’.

⁷²⁴ Marcos Tourinho, Oliver Stuenkel & Sarah Brockmeier, “Responsibility while Protecting”, 142.

⁷²⁵ ‘Xenia Avezov, ‘Responsibility while protecting’: are we asking the wrong questions?’.

⁷²⁶ .Marcos Tourinho, Oliver Stuenkel & Sarah Brockmeier, “Responsibility while Protecting”, 141.

⁷²⁷ Thorsten Benner, Brazil as a norm entrepreneur: the “Responsibility While Protecting” initiative, 7.

⁷²⁸ Ibid 8- 9.

në rolin e sipërmarrësit të normës ndërkombëtare, ishte zbrapsur nga iniciativa e vet.⁷²⁹ Kai Michel Kenkel, vë në pah se ndryshimet e brendshme në Brazil dhe ministria e saj e punëve të jashtme i kishin bërë avokatin e vazhdueshëm politikës së paqëndrueshme. Varësisht përpjekjeve, në vitin 2016, masat shtrënguese fiskale dhe kriza politike paralizuese e cila filloi në Prill 2016 kanë kufizuar në mënyrë të rreptë Brazilin për të avancuar në mënyrë aktive iniciativën e vetë normative.⁷³⁰ Përkundër kritikave të Brazilit në rolin e tij si sipërmarrës norme, ai konsideron se shënimi i Brazilit ka vazhduar të strukturojë debate globale mbi ndërhyrjen, veçanërisht mbi mbizotërimin perëndimor përmes udhëzimeve të rrepta në prag të krizës së legjitimitetit të PpM-së në Libi. Kenkel argumenton se iniciativa Braziliene këtë e ka bërë në tre fusha kryesore: avancimin e rëndësisë së një renditje operationale të shtyllave të PpM; rritjen e kufizimeve për përdorim të forcës; dhe monitorimin më pro aktiv nga KS-ja i udhëzimeve vijuese në misionet e vazhdueshme.⁷³¹

Sipas Thorsten Benner, BE-ja dhe vendet e tjera duhet të marrin elementet kryesore të konceptit dhe të ringjallin debatin me ide të reja. Ai konsideron se kjo është urgjente në dritën e performancës katastrofale të bashkësisë ndërkombëtare në Siri. Andaj si perëndimi ashtu edhe Brazili duhet të nxjerrin disa mësimet të gjera për evoluimin e normës globale nga saga e PdM-së: kryeqytetet perëndimore (dhe OJQ- të) duhet të mësohen me faktin se nuk mbajnë monopolin për ndërmarrjen e një norme ndërkombëtare dhe duhet të kenë një angazhim më konstruktiv me propozimet mbi normat që dalin nga vendet jo perëndimore, ndërsa në Brazil duhet të bëhet një rishikim i brendshëm.⁷³² Rasti i Sirisë, vë në pah paralizimin e KS-së. Thëksimi i PdM, kërkon një koordinim të vazhdueshëm me KS gjatë tërë operationit për autorizimin e çdo hapi për ndërhyrje, që mund të jetë një pengesë për veprimin kolektiv. Njëashtu, edhe Siria ishte një provë e dobishme për PdM. Xenia Avezov, thekson se disa komentues sugjerojnë se PdM vetëm sa do të ndihmonte mungesën për ndërhyrje.⁷³³

Debatet në lidhje me zbatimin e kësaj doktrine janë zhytur në dinamikën politike dhe mungesa e rregullimit të mëtejshëm nga KS-ja është mbase çështja kryesore që bashkon pesë anëtarët e përhershëm të KS-së kur bëhet fjalë për PpM-në dhe PdM-në. Nisma e Brazilit artikuloi me sukses nevojën për mjete të përgjithshme të mbrojtjes, veçanërisht kur përdoret

⁷²⁹ 'Kai Michael Kenkel, 'Brazil and the Responsibility While Protecting Initiative'.

⁷³⁰ Ibid.

⁷³¹ Ibid.

⁷³² Thorsten Benner, Brazil as a norm entrepreneur: the "Responsibility While Protecting" initiative, 9.

⁷³³ 'Xenia Avezov, 'Responsibility while protecting': are we asking the wrong questions?'

forca ushtarake në emër të sigurisë kolektive dhe humanizmit. Por, ideja e PdM-së mbeti kryesisht abstrakte dhe nuk u adresua sa duhet për tu materializuar e që mund të adresonte problemin e sigurisë kolektive për mbrojtjen e njerëzve në praktikë. Tourinho dhe Stuenkel konsiderojnë se me të drejtë nuk ishte një proces i lehtë: kriza siriane e bëri diskutimin toksik në qarqet e politikanëve dhe kishte oreks të kufizuar në pjesën më të madhe të globit jugor për të mbështetur propozimin në mënyrë efektive. Ndërsa, në Europë ishin pak të gatshëm të sfidonin në mënyrë të qartë pozicionet franceze dhe britanike për të mbështetur një fuqi jugore në zhvillim.⁷³⁴

Megjithatë, deri sa shfaqen kriza të reja, studiuesit vazhdojnë të kërkojnë mënyra të reja për të adresuar problemet e vështira të identifikuara në propozimin e PdM-së. Ndërsa, këto përpjekje, të cilat ndodhin si në komunitetin shkencor ashtu edhe në atë të politikave, janë ende në vazhdim dhe për këtë arsye janë të hapura, deri më tani kanë treguar bazë politike të krijuar nga PdM dhe kanë ndihmuar fillimin e debateve rreth asaj se çfarë reformash potenciale mund të kryhen për të përmirësuar zbatimin praktik të PpM-së.⁷³⁵

4.2.7. Këshilli i Sigurimit dhe PpM pas Libisë

Menjëherë pas miratimit të Rezolutës 1973 dhe ndërhyrjes së NATO-s në Libi, KS-ja miratoi Rezolutën 1975 për Bregun e Fildishtë,⁷³⁶ duke potencuar përgjegjësinë primare të shteteve për mbrojtjen e civilëve, me çrast Këshilli theksoi mbështetjen e tij të plotë dhënë Misionit të Kombeve të Bashkuara në Bregun e Fildishtë "për të përdorur të gjitha mjetet e nevojshme për të kryer mandatin e tij për të mbrojtur civilët nën kërcënimin e afërt të dhunës fizike".⁷³⁷ As aktivitetet i këtij misioni (Operacioni i OKB-së) në Bregun e Fildishtë dhe as NATO në Libi nuk kundërshtuan këtë konsensus të arritur, por vepruan sipas rezolutave të Kapitullit të VII-të që autorizonin përdorimin e forcës për të mbrojtur civilët.⁷³⁸ Libia shënoi herën e parë që KS-ja autorizoi një operacion ndërkombëtar sipas PpM-së.

⁷³⁴ Marcos Tourinho, Oliver Stuenkel & Sarah Brockmeier, "Responsibility while Protecting", 149.

⁷³⁵ Ibid.

⁷³⁶ UN, S/RES/1975 (2011).

⁷³⁷ Ibid para 4- 6.

⁷³⁸ Alex J. Bellamy, 'The Responsibility to Protect and the Problem of Regime Change, 22.

Bregu i Fildishtë ishte hera e parë që autorizoi përdorimin e forcës ushtarake nga fuqitë e jashtme vetëm për mbrojtjen e civilëve. Duke justifikuar autorizimin e të gjitha masave të nevojshme nga operacioni i paqes i OKB-së në Bregun e Fildishtë, Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1975 riafirmoi 'përgjegjësinë kryesore të secilit shtet për të mbrojtur civilët' dhe, në të njëjtën fjali, përsëriti që 'palët në konflikt të armatosur mbajnë përgjegjësi kryesore për të ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm për të siguruar mbrojtjen e civilëve'.⁷³⁹

KS duhet të luajë rolin kryesor në zbatimin e parimit të PpM-së, veçanërisht të shtyllës së II-të dhe III të parimit, si organi kryesor që ka përgjegjësinë për të vepruar në parandalimin e krimeve të mizorisë. Veprimi kolektiv mund të marrë një formë shtrënguese ose jo-shtrënguese, në përputhje me mjetet e disponueshme në Kapitujt VI, VII dhe VIII të Kartës së OKB-së.⁷⁴⁰ Në këtë drejtim, që nga Miratimi i PpM-së në KS deri në vitin 2019, KS-ja ka miratuar mesatarisht një rezolutë në muaj që i referohet PpM-së.

Tabela 1:
Rezolutat e KS- së të cilat i referohen PpM-së për periudhën e viteve 2006-2019

Viti	Nr. i Rezolutave
2006	3
2007	0
2008	0
2009	1
2010	0
2011	6
2012	2
2013	7
2014	10
2015	14
2016	12
2017	12
2018	11
2019	5

Gjithsej 83

⁷³⁹ Ramesh Thekur, 'Libya and the responsibility to protect Between opportunistic humanitarianism and value-free pragmatism' (2012) Situation Report, Institute for Security Studies, 3.

⁷⁴⁰ 'The UN Office on Genocide and the Responsibility to Protect, Security Council', qasur: <<https://www.un.org/en/genocideprevention/security-council.shtml>> qasur: 20 Qershor 2020.

Sipas Tabelës së mësipërme, marrë në tërësi në periudhën e viteve 2006-2019, KS ka miratuar gjithsej një numër prej 83 Rezolutash, të cilat i referohen PpM-së⁷⁴¹ ku mbështetja për këtë parim si dhe Këshilltarët Specialë për Parandalimin dhe Gjenocidin dhe Përgjegjësinë për të Mbrojtur është shprehur gjithashtu në terma më të fortë dhe me frekuencë në rritje në vitet e fundit në KS, si: /RES/2250 (2015), S/RES/2150 (2014); S/RES/2171 (2014). Përveç kësaj, disa rezoluta që autorizojnë operacionet e paqes të Kombeve të Bashkuara kanë theksuar posaçërisht nevojën për të mbështetur autoritetet kombëtare në mbajtjen e përgjegjësisë së tyre për të mbrojtur. Aty përfshihen: S /RES/ 1975 (2011); S/RES/1996 (2011); S/RES/2085 (2012); S/RES/2121 (2013).⁷⁴²

Siç shihet në Tabelën 1 të mësipërme, vitet e fundit KS-ja ka miratuar një numër dukshëm më të madh të rezolutave se sa në vitet e para të miratimit të PpM-së. Në periudhën 8-të vjeçare ishin miratuar 19 rezoluta me referencë PpM-në. Ndërsa, në 6 vitet e fundit deri në vitin 2019, KS-ja ka qenë shumë më aktive, duke u thirrur në PpM. Më 14 dhjetor 2015 Spanja dhe Kili thirrën takimin e parë kushtuar PpM-së. Fokusuar në “Përgjegjësinë për të mbrojtur dhe akterët jo-shtetëror”, duke diskutuar se si KS-ja mund t’i përshtasë mjetet e tij ekzistuese për t’iu përgjigjur sfidave të paraqitura nga grupet e armatosura jo-shtetërore të cilët kanë përfaqësuar krimet si: gjenocidi, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe spastrimi etnik si një strategji për përdorimin e objektivave të tyre politike.⁷⁴³ Nga 83 Rezolutat e miratuara nga KS-ja për PpM-në, 69 prej tyre i referohen situatave në shtete të ndryshme.

Tabela 2:
Referimi për shtete nga Rezolutat e miratuara nga KS të cilat e përmendin PpM-në për periudhën e viteve 2006-2019

Republika e Afrikës Qendrore	12
Sudani Jugor	10
Republika Demokratike e Kongos	8
Mali	7

⁷⁴¹ Global Centre for the Responsibility to protect, *UN Security Council Resolutions and Presidential Statements Referencing R2P*, (2019) <<https://www.globalr2p.org/wp-content/uploads/2020/01/UNSC-Resolutions-and-Statements-with-R2P-Table-as-of-14-January-2020.pdf>> qashur: 21 Qershor 2020.

⁷⁴² ‘The UN Office on Genocide and the Responsibility to Protect, Security Council’, <<https://www.un.org/en/genocideprevention/security-council.shtml>> 20 Qershor 2020.

⁷⁴³ Ibid.

Siria	6
Sudani dhe Sudani Jugor	6
Somalia	6
Libia	5
Sudani (Darfur)	3
Liberia	2
Burundi dhe Republika Demokratike e Kongos	1
Qadi	1
Bregu i Fildishtë	1
Jemeni	1

Rezolutat nga Tabela 2 e mësipërme, i referohen situatave në kriza nga 14-të shtete të ndryshme të botës. Pjesa më e madhe e këtyre rezolutave i përfshijnë vendet nga kontinenti Afrikan. Ndërsa për krizën në vendet e Lindjes së Mesme një numër më i vogël i rezolutave që i referohen PpM-së. Libia dhe Siria kanë një numër pothuajse të barabartë të rezolutave të miratuara në KS, ndërsa kriza në Siri ishte shumë më e rëndë. Gati se gjysma e këtyre rezolutave janë të miratuara vetëm për tre shtete, edhe atë: Republika e Afrikës Qendrore, Sudani Jugor dhe Republika Demokratike e Kongos.

Përveç këtij suksesi të PpM-së në KS, e cila për përkrahësit e PpM-së paraqet një argument shumë cilësor për zhvillimin e kësaj norme ndërkombëtare juridike, duke marrë parasysh edhe aktivitetin e KS-së në rritjen e numrit të rezolutave të miratuara, gjithsesi se, një qasje kritike në lidhje me veprimet e KS-së në raport me PpM-në është e rëndësishme që të trajtohet në këtë pjesë. Në këtë drejtim, që nga Komisioni i KKNSSH i cili konsideronte se përgjegjësinë kryesore për të reaguar e ka KS dhe qëllimi nuk ishte që të gjendet ndonjë organ tjetër, por, të KS të bëhet të funksionojë më mirë. Përderisa ky komision në rastet e mosveprimit të KS-së në rastet e mizorisë në ndonjë shtet, ekziston mundësia të vepohet nga AP e OKB-së, por edhe nga shtetet e caktuara jashtë KS-së. Ndërsa, Raporti i 2005 i cili e miratoi PpM-në dhe Raporti i Sekretarit të OKB-së, nuk e miratojnë në tërësi raportin e KKNSSH, duke mos lejuar që veprimet të ndërmerren jashtë OKB-së. Përgjegjësia kryesore e KS-së dhe suksesi i tij duhet të shihet veçanërisht në shtyllën III. Aidan Hehir, një ndër kritikuesit më të mëdhenj të PpM-së i sheh me mjaft skepticizëm këto veprime dhe sukses të KS-së për PpM-në. Ai këtë sukses e sheh si një lexim sipërfaqësor të mënyrës me të cilën KS-

ja ka përdorur PpM-në.⁷⁴⁴ Aiden paraqet shqetësimet se dokumenti i PpM-së nuk arriti të adresojë çështjet se çka ndodh më tutje në rastet kur KS-ja nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të autorizojë përdorimin e forcës për të parandaluar një tragjedi. Sipas tij, në vend se Dokumenti i 2005 të përbënte diçka të re ose “revolucionare”, në fakt ai njohu sistemin ekzistues dhe bashkë me të edhe të dhënat historike; mënyra me të cilën PpM u trajtua në vitin 2005 ishte në përputhje me vendosmërinë e pesë anëtarëve të përhershëm të KS-së që nga viti 1945 për të mbrojtur pozicionet e tyre brenda arkitekturës së OKB-së për të ruajtur monopolin e tyre mbi autorizimin e përdorimit të forcës dhe lirinë për të zgjedhur se si të veprojnë. Hehir pretendon se PpM nuk ndryshoi të drejtën ndërkombëtare dhe nuk përbën ndonjë gjë që bënë ndonjë ndryshim të anëtarëve të përhershëm në KS.⁷⁴⁵ Prandaj Hehir pavarësisht lavdeve për numrin aq të madh të rezolutave të miratuara nga KS-ja për PpM-në, atë e konsideron se nuk jep asnjë pasqyrë reale për të cilën PpM ishte aktualisht i përdorur në rezoluta.⁷⁴⁶ Për të demonstruar këtë gjë një analizë e rezolutave të miratuara nga KS-ja për një periudhë 10-të vjeçare nga miratimi i PpM, shumica dërmuese e rezolutave janë përqendruar në shtyllën e I-rë duke potencuar përgjegjësinë e shtetit për të mbrojtur qytetarët, dhe deri në vitin 2017 nga gjithsej 67 rezoluta të miratuara 55 prej tyre i referohen shtyllës së parë, ndërsa 12 i referohen paragrafit 139 të Samitit Botëror. Ndërsa, Hehir pretendon se asnjë rezolutë nga këto nuk i referohet shtyllës III. Kështu nga ky trend Hehir thekson se është shumë e qartë se KS e ka përdorur gjuhën e PpM-së në shumicën dërmuese për të theksuar se shteti pritës, dhe jo KS-ja e ka përgjegjësinë kryesore për të mbrojtur popullatën nga krimet e mizorisë.⁷⁴⁷

Duke i analizuar rezolutat e miratuara nga KS për shtetet e caktuara, Hehir kritikon se fokusi i KS-së në kriza të caktuara ishte përdorur në mënyrë selektive. Duke potencuar se pak autorë mohojnë se situata në Sudan, Sudanin Jugor dhe Republikën e Afrikës Qendrore dhe pjesë të tjera të Afrikës ka qenë e tmerrshme dhe ajo meriton vëmendje, por shkalla e këtij fokusi është i pajustificueshëm. Ndërsa, Këshilli nuk ka miratuar një rezolutë të vetme që përmend PpM-në për situatat si në: Bahrein, Ukrainë, Birmani, Izrael ose Kore të Veriut, me gjithë rëndësinë e tij të dukshme në këto vitet e fundit.⁷⁴⁸ Dhe nga kjo analizë e referimeve të

⁷⁴⁴ Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*, (palgrave macmillan, 2019) 117.

⁷⁴⁵ Ibid 124.

⁷⁴⁶ Ibid 127.

⁷⁴⁷ Ibid 135.

⁷⁴⁸ Ibid 136.

PpM-së në rezolutat e KS-së, Aiden evidenton dy tendenca, edhe atë: e para, që KS ka përdorur në mënyrë shumë të kufizuar me një theks të shtuar në shtyllën e I-rë dhe e dyta, që KS ka përdorur atë në mënyrë selektive, duke rezervuar përdorimin e PpM-së në rastet kur i përshtatet interesave të pesë anëtarëve të përhershëm pëe vendet e ndryshme në krizë. Nga këto dy tendenca, Aiden konstaton se PpM nuk është në zhvillim pozitiv, por mund të ketë madje një zhvillim negativ. Mënyra se si KS-ja e ka përdorur PpM-në deri më sot i mundëson pesë anëtarëve të përhershëm të KS-së të mohojnë përgjegjësinë dhe kështu të legjitimojnë mosveprimin. Prandaj, KS e ka përdorur PpM-në si një mjet për të hequr përgjegjësinë.⁷⁴⁹ Madje dy anëtarë si: Kina dhe Rusia kanë treguar përbuzje për idenë, pasi në shtatë projekt-rezoluta kanë vënë veto vetëm në Rastin e Sirisë nga këto dy vende. Gjithashtu, edhe me rastin e përkeqësimit të situatës në Mianmar në vitin 2016, KS-ja ishte dënuar gjerësisht për mos përgjigje të situatës në mënyrë efektive. Edhe për Hehir këto vende mund të jenë moralisht detyruese, ato nuk kanë shkelur asnjë të drejtë, për sa kohë që këto pesë shtete kanë të drejtë të zgjedhin nëse do të veprojnë dhe si do të veprojnë në përgjigje të krimeve të mizorisë, interesat politike do të kenë ndikim më të madh se sa shqetësimet humanitare.⁷⁵⁰

Nga shumë autorë theksohet se PpM nuk ka krijuar një detyrim ligjor për OKB-në për të ndërhyrë si dhe të anëtarëve të KS-së për të vepruar pozitivisht.⁷⁵¹ Pra, nëse PpM-ja do të ishte një normë ligjore, një veto ose mosveprim nga KS do të ishte e kundërligjshme, por një detyrim i tillë nuk është miratuar në të drejtën ndërkombëtare. Dhe një ngurrim i pranimit të PpM-së si normë në të drejtën ndërkombëtare nga detyrimet e KS, është se KS varet

⁷⁴⁹ Ibid 137.

⁷⁵⁰ Ibid 141. Nga Komisioni Ndërkombëtar i OKB- së për gjetjen e Fakteve në Mianmar në vitin 2018, kishte gjetur se në Mianmar kishte shkelje të rënda të drejtave të njeriut dhe shkelje serioze të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare që nga viti 2021 dhe shumë prej këtyre shkeljeve pa dyshim se përbëjnë krime shumë të rënda të drjetës ndërkombëtare, shih: UN, A/HRC/39/CRP.2, (17 September 2018 (para 1671) para. 1671. Edhe në vitin 2019 sipas këtij Komisioni përndjekja e ashpër e komunitetit Rohignya vazhdon pandërprerë nëkundëshrtim me thirrjet e komunitetit ndërkombëtar. Trajtimi i rreth 600.000 anëtar të komunitetet Rohygnia të cilët kishin mbetur në vend ishte e pandryshuar. Ata ballafaqoheshin me një situatë të përkeqësuar, ku i nënshtroheshin diskriminimit, ndarjes, kufizimit të lëvizjes, pa qasje në mjete të jetesës, tokë, shërbime themelore, përfshirë arsimin dhe kujdesin shëndetësor, ose drejtësi për krimet e kryera nga Tatmadaw, shih: 'UN Independent International Fact-Finding Mission on Myanmar calls on UN Member States to remain vigilant in the face of the continued threat of gjenocide', New York (23 October 2019) <<https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25197&LangID=E>> qasur: 20 Qershor 2020.

⁷⁵¹ Anne Peters, 'The Security Council's Responsibility to Protect', (2011), International Organizations Law Review 8 (Martinus Nijhoff Publishers) 36 [tani e tutje: Anne Peters, 'The Security Council's Responsibility to Protect'].

përfundimisht vetëm nga vullneti politik i këtyre shteteve.⁷⁵² Anne Peters konsideron se PpM ka të bëjë me skepticizëm për legjitimitetin e KS-së dhe për debatin nëse ai duhet të reformohet. Por, insistimi për monopolin e autorizimit të përdorimit të forcës nga KS, ende duket zgjidhje më e mirë dhe ky monopol është në përputhje me pozicionin ligjor të Këshillit si institucion që mban përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë dhe në aspektin politik të justifikueshëm si mburojë kundër ndërhyrjeve të njëanshme si mundësi për abuzim.⁷⁵³ Dhe kështu detyrimi bie jo vetëm mbi KS-në si një organ i OKB-së, por edhe mbi shtetet. Megjithatë sipas nenit 24 të Kartës së OKB-së KS-ja ka “përgjegjësinë kryesore” për ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare dhe përgjigjen ndaj mizorive masive, nuk është përgjegjësia e tij ekskluzive, sepse përgjegjësia dytësore është e të gjitha shteteve të OKB-së.⁷⁵⁴ Ndërsa, Chelsea Koester argumenton se dy kontrole të veto-s janë vendosur tashmë. Së pari, abstenimi i detyrueshëm i vendosur brenda Kartës së OKB-së, i cili e kufizon aftësinë e një anëtarit të KS-së për të ushtruar fuqinë e veto-s kur është palë në mosmarrëveshje që adresohet nga KS-ja. Ndërsa, së dyti, është Rezoluta të Bashkuar për Paqe, e cila siguron mundësinë e vetme të anulimit të një veto nga KS-ja përmes veprimit të AP-së. Koester konsideron se këto dy opsione janë të denja, madje superiore, dhe alternativa me të cilën trajtohet kjo çështje nuk mund të neglizhohet. Të paktën, ata paraqesin një mjet të dobishëm për të shërbyer për të legjitimuar veprimet e ndërmarra në përputhje me Doktrinën e Përgjegjësisë për të Mbrojtur.⁷⁵⁵

Për fund, nëse kthehemi te shumë formulime, veçanërisht si ai i KNNSSH- së, do të shihet se akoma përqendrimi është në KS si autoriteti kryesor për të vepruar në rastin e abuzimeve të veprimeve ushtarake, me çrast Komisioni thoshte se nuk është qëllimi që të gjendet një alternativë ndaj KS-së por të bësh atë të funksionojë më mirë. Si zgjidhje nga përdorimi i veto-s, KNNSSH sugjeronte që ajo të mos përdorej nga pesë anëtarët në rast se interesat e tyre nuk cenoheshin. Miratimi i PpM-së në OKB më pas vetëm sa e fuqizoi rolin e KS-së në këtë drejtim. Prandaj, nga ajo që u argumentua më sipër, edhe nëse kritikën e Hehir ndaj PpM-së, mund të duken cinike, marrë parasysh edhe rritjen e aktivitetit të KS-së për PpM, veprimet e KS-së veçanërisht në shtyllën III si dhe dështimi për të vepruar në disa raste

⁷⁵² Ibid 38.

⁷⁵³ Ibid 14- 15.

⁷⁵⁴ Ibid 21.

⁷⁵⁵ Chelsea Koester, ‘Looking Beyond R2p for an Answer to Inaction In The Security Council’, (2015) (27), Florida Journal Of International Law, 378.

pikërisht nga përdorimi i veto-s, tregon se qëllimi fillestar i Komisionit KNNSSH “që ta bëjë KS-në të funksionojë më mirë”, nuk ka treguar shumë sukses dhe fati i shumë vendeve me situata në rrezik të PpM-së, varet përsëri nga interesat politike të pesë anëtarëve të përhershëm të KS-së.

4.2.8. Roli i Asamblesë së Përgjithshme në zhvillimin e PpM-së

Kur KS-ja dështon të veprojë, atëherë AP-ja është një alternativë e mundshme e cila edhe sipas Komisionit të KNNSSH-së kishte gjetur mbështetje të madhe gjë që ka të bëjë me kërkimet për një mbështetje për veprimet ushtarake nga mbledhjet e AP-së në një: “Sesion Special të Emergjencës” në procedurat e vendosura: “Të Bashkuar për Paqe”. KNNSSH theksonte se megjithatë, AP-së i mungon fuqia për të drejtuar atë veprim, por, mbështetja nga një fuqi dërmuese e shteteve anëtare, do të siguronte një shkallë të lartë të legjitimitetit për një ndërhyrje e cila do ta siguronte një shkallë të lartë të legjitimitetit për një ndërhyrje e cila do të inkurajonte vet KS-në të ri-mendonte pozicionin e tij. Sipas Komisionit, mundësia e thjeshtë që ky veprim të ndërmerret do të jetë një formë e rëndësishme shtesë për KS-në të inkurajojë atë të veprojë me vendosmëri.⁷⁵⁶ Në vitin 2004 Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në Raportin e tij të paraqitur në AP, theksoi se AP-ja si një organ universal, që përfaqëson çdo shtet në botë dhe legjitimiteti i tij unik duhet të përdoret për të na çuar drejt një konsensusi global për çështjet e politikave botërore, duke kërkuar që në Samitin e Mijëvjeçarit në vitin 2005 të krijohet një konsensus i ri mbi sigurinë kolektive më të gjerë dhe më efektive.⁷⁵⁷ Asambleja e Përgjithshme në vitin 2005 kishte miratuar PpM-në Samitin Botëror. Në Paragrafin 139 nga ky dokument kërkohet që AP-ja të vazhdojë të marrë parasysh përgjegjësinë për të mbrojtur popullatën nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit dhe pasojat e tij, duke mbajtur parasysh parimet e Kartës dhe të së drejtës ndërkombëtare.⁷⁵⁸ Angazhimi i AP-së u kërkua edhe nga Raporti tre shtyllësh i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në vitin 2009 për veprimet nga shtylla e tretë që AP-ja mund të konsiderojë masat e tilla të Rezolutës 377 (V), të “Bashkuar për Paqe”, megjithëse, veprimet e tilla nuk janë ligjërisht të detyrueshme. Në bazë të këtyre përgjegjësi nëse AP-

⁷⁵⁶ Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty, 53.

⁷⁵⁷ A/59/565 (2004) 85.

⁷⁵⁸ World Summit Outcome, (A/60/L.1).

ja do të luajë një rol udhëheqës në formimin e një përgjegjësie të Kombeve të Bashkuara, atëherë të gjitha shtetet anëtare në AP do të duhej ta shpërndajnë përgjegjësinë për të bërë atë një instrument efektiv në përparimin e përgjegjësisë për të mbrojtur. Raporti thekson se AP-ja mund të luajë një rol të rëndësishëm madje në bazë të shtyllës III dhe të ndërmarrë veprime nën Rezolutën “Të Bashkuar Për Paqe” në rastet kur KS-ja nuk arrin të ushtrojë përgjegjësinë e tij për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare për shkak të mungesës së unanimitetit të anëtarëve të tij të përhershëm. Mirëpo, përsëri ky Raport potencon se edhe në raste të tilla, vendimet e AP-së nuk janë juridikisht të detyrueshme për palët.⁷⁵⁹

Edhe pas miratimit të mëhershëm të Rezolutës ajo shumë vështirë është thirrur në të. Megjithatë, vlen të përmendet se disa anëtarë të NATO-s e veçanërisht Britania e Madhe dhe Kanadaja e zhvilluan idenë e tyre për t’u thirrur në këtë Rezolutë për të autorizuar ndërhyrjen humanitare në Kosovë (v. 1999). Mirëpo, shqetësimet politike dhe ligjore mbi këtë Rezolutë në krizën e Kosovës, sipas Ryngeart dhe Cuycker mund të shfaqen edhe në kontekste të PpM-së dhe kështu mund të shuajë shpresat për një aplikim të saj.⁷⁶⁰ Edhe pse në një analizë të saj, rezulton se Karta e OKB-së i jep autorizime të mjaftueshme AP-së për të rekomanduar situata për PpM-në, mirëpo shumë dokumente të fundit të OKB-së e kanë mohuar një mundësi për një bazë ligjore. Në dritën e këtyre deklaratave, siç theksojnë dhe Ryngaert dhe Cuyckens nuk ka gjasa që AP-ja të autorizojë ndonjëherë, përdorimin e forcës, qoftë edhe vetëm mbi bazën e një rekomandimi, edhe nëse parashihet nga Rezoluta: “Të Bashkuar për Paqe.”⁷⁶¹

Megjithatë, përballur me epërsinë e KS-së për të vepruar në situata të ruajtjes së paqes dhe sigurisë në bazë të Kapitullit të VII-të të Kartës së OKB-së, AP-ja është përqendruar në dimensionet tjera të PpM-së, përveç përdorimit të forcës dhe vendosjes së sanksioneve. Ajo i kushton vëmendje vlerësimit të hershëm të kërcënimeve të parandalimit të konflikteve në përgjithësi. Ky interesim i përfshirjes së AP-së në çështjet e PpM-së për të përcaktuar një agjendë drejt zbatimit të kapaciteteve të nevojshme në mënyrë që të krijohet një konsensus i gjerë.⁷⁶² AP-ja ka një rol të rëndësishëm në avancimin e parimit të PpM-së duke vazhduar

⁷⁵⁹ A/63/677, 12 January 2009, para 63.

⁷⁶⁰ Cedric Ryngaert and Hanne Cuyckens, ‘The General Assembly’, (2013), *An Institutional Approach to the Responsibility to Protect*, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 112.

⁷⁶¹ Ibid 118.

⁷⁶² Ibid 127.

debatet për çështjet relevante në zbatimin e tij.⁷⁶³ AP-ja që nga miratimi i PpM-së në vitin 2005 deri në vitin 2019 ka miratuar gjithsej 17-të rezoluta të cilat i referohen PpM-së.⁷⁶⁴

Tabela 3:
Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të cilat i referohen PpM-së për shtete, për periudhën e viteve 2005-2019

Siria	8
Republika Popullore Demokratike e Koresë	6

Nga paraqitja e Tabelës 3 të mësipërme, shihet se nga 17 rezoluta sa janë miratuar gjithsej nga AP-ja e të cilat i referohen PpM-së, 14 sish janë të përqendruara për situatat vetëm në dy shtete. Ndërkaq, në krahasim me numrin e Rezolutave nga KS-ja, AP-ja është përqendruar në një numër shumë të vogël të situatave të vendeve në krizë. Sigurisht se mund ta zgjerojë aktivitetin e saj për t’iu referuar situatave në shtete të ndryshme, ku për miratimin e këtyre rezolutave nuk kërkohet një votim siç kërkohet në KS.

Por, AP ka qenë aktive në PpM gjithashtu, nga viti 2009 çdo vit ka mbajtur diskutime formale dhe jo formale për Raportet e Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me PpM-në.⁷⁶⁵ Përveç miratimit të rezolutave për shtete të caktuara, AP-ja në vitin 2015 kishte miratuar Rezolutën A/RES/69/323, e cila përcaktoi ditën ndërkombëtare komemorative dhe të dinjitetit të viktimave të gjenocidit dhe parandalimit të tij.⁷⁶⁶ Nga kjo që u tha më sipër, pavarësisht fuqisë ligjore së AP-së për të vepruar sipas Shtyllës III, ajo ka luajtur dhe mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm që nga miratimi i parë i PpM-së në OKB nga ana e këtij

⁷⁶³ UN Office on Genocide and the Responsibility to Protect, ‘General Assembly’, qasur: <<https://www.un.org/en/genocideprevention/general-assembly.shtml>> qasur: 25 Qershor 2020 [tani e tutje: UN Office on Genocide and the Responsibility to Protect, ‘General Assembly’].

⁷⁶⁴ Global Centre for the Responsibility to Protect, ‘UN General Assembly Resolutions Referencing R2P’, qasur në: <<https://www.globalr2p.org/resources/un-general-assembly-resolutions-referencing-r2p-2/>> qasur: 26 Qershor 2020.

⁷⁶⁵ UN Office on Genocide and the Responsibility to Protect, ‘General Assembly’.

⁷⁶⁶ Ibid.

organi në vitin 2005. Sidomos, AP mund të ketë një rol kyç në zhvillimin e PpM-së në të ardhmen në forcimin e parimit sidomos në fushën e parandalimit, duke pasur parasysh se ky organ përbëhet nga përfaqësues të të gjitha shteteve të cilët janë anëtarë të OKB-së dhe rrjedhimisht do të krijonte një konsensus më të gjerë.

4.2.9. Roli i Sekretarit të Përgjithshëm në PpM

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së që nga fillimi, ashtu edhe siç u përmend edhe më sipër, ka një rol të rëndësishëm dhe të vazhdueshëm për zhvillimin e PpM-së. PpM u formulua në përgjigje të sfidës së Kofi Annan ndaj shteteve anëtare në OKB për konsensus se si t'u përgjigjen situatave të krimeve masive. Vetë Annan ishte i angazhuar në përkrahjen e konceptit dhe promovimin dhe kristalizimin e zhvillimeve normative në lidhje me mbrojtjen e popujve të pambrojtur të cilat arritën kulmin në Marrëveshjen e Samitit Botëror 2005.⁷⁶⁷ Që nga thirrjet e tij për të vepruar nga OKB-ja për situatat në rrezik, Sekretari i Përgjithshëm në vitin 2004 në Raportin e tij në AP, e pranoi PpM-në, ku koncepti i sigurisë kolektive dhe përgjegjësisë së përbashkët ishte në qendër të këtij raporti. Duke kërkuar nga AP-ja që në vitin 2005 të përdorte mundësinë në Samitin Botëror të krijonte një konsensus të ri për sigurinë kolektive dhe më gjerë,⁷⁶⁸ duke luajtur një rol të rëndësishëm në konsensusin dhe zhvillimin e PpM-së dhe më e rëndësishmja ndër to është Raporti i v. 2009 i cili përbëhet nga tre shtylla, duke sqaruar se si të kuptohet PpM dhe përshkruan masat dhe aktorët e përfshirë në aspektet operative.⁷⁶⁹

Që nga viti 2009, KS-ja ka avancuar zhvillimin konceptual dhe praktik të PpM-së përmes raporteve vjetore për AP-në dhe KS-në.⁷⁷⁰ KS ka ndërmarrë një sërë hapash për të përpunuar PpM-në për mbrojtjen e parimit dhe zbatimin e tij praktik.⁷⁷¹ Kështu, ishte themeluar Këshilltari Special për Parandalimin e Gjenocidit dhe Këshilltari Special për Përgjegjësinë për të Mbrojtur. Në mënyrë që të maksimalizohet efikasiteti dhe burimet, Sekretari i

⁷⁶⁷ Nicholas Turner, 'The Secretary-General', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 130 [tani e tutje: Nicholas Turner, 'The Secretary-General'].

⁷⁶⁸ A/59/565 (2004).

⁷⁶⁹ A/63/677, (12 January 2009).

⁷⁷⁰ The UN Office of Genocide Prevention and the Responsibility to protect, 'Secretary- General', <<https://www.un.org/en/genocideprevention/secretary-general.shtml>> qasur: 27 Qershor 2020.

⁷⁷¹ Ibid.

Përgjithshëm vendosi të institucionalizojë bashkëpunimin midis Këshilltarëve Specialë përmes krijimit të një Zyre të përbashkët: Zyra për Parandalimin e Gjenocidit dhe Përgjegjësisë për të Mbrojtur. Ata punojnë së bashku për të avancuar përpjekjet kombëtare dhe ndërkombëtare për të mbrojtur popullatën nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimet etnike dhe krimet kundër njerëzimit (krime mizorie), si dhe nxitjen e tyre. Në mbështetje të mandateve të tyre, mbledhjen e informacioneve, kryerjen e vlerësimeve në të gjithë botën dhe për këtë e njofton Sekretarin e Përgjithshëm etj.⁷⁷²

Për pikëpamjen e Nicholas Truner, përkundër përgjegjësisë së saj të gjera, kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm siç i përcakton Karta e OKB-së janë çuditërisht të kufizuara. Autoriteti i tij buron nga neni 97, nën të cilin ai është zyrtari kryesor administrativ i Sekretariatit. Neni 98 parashikon se Sekretari i Përgjithshëm ngarkohet me funksione të ndryshme nga AP-ja, KS-ja ose nga Këshilli Ekonomik dhe Social. Me këto organe kryesore që gradualisht marrin një gamë të gjerë detyrimesh, kjo dispozitë ka rezultuar në delegimin e përgjegjësisë progresive me të mëdha të KS-së, duke përfshirë autoritetin komandues në operacionet e paqes. Pastaj, neni 99 i Kartës e fuqizon Sekretarin e Përgjithshëm që të sjell vëmendjen e KS-së për çdo mendim dhe çështje që për mendimin e tij mund të kërcënojnë ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.⁷⁷³

Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm mund të ushtrojë një shkallë të caktuar të ndikimit në shqyrtimin e KS-së në kriza specifike, si drejtpërdrejtë përmes raporteve dhe fjalimeve në takimet e Këshillit dhe indirekt duke ua kujtuar pesë anëtarëve përgjegjësinë e tyre në shtyllën e tretë të PpM-së. Deklaratat publike, paralajmërimet e hershme dhe rekomandimet mund të kontribuojnë në vendosjen e parametrave të debatit brenda Këshillit; Në të vërtetë, siç vëren Truner, përdorimi i vazhdueshëm i gjuhës së PpM-së nga Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarët e Sekretariatit në lidhje me krizat e fundit ka qenë domethënëse në udhëheqjen e KS-së për të konsideruar këto kriza në drejtim të mbrojtjes civile,⁷⁷⁴ ku aftësitë unike të zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm do të vazhdojnë të jenë kritike në gjetjen e mënyrave për të përkthyer angazhimin retorik të shteteve anëtare në veprim efektiv për të parandaluar dhe

⁷⁷² 'Un Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect'

<<https://www.un.org/en/genocideprevention/office-man>> qasur: 26 Qershor 2020., shih gjithashtu:

<<https://www.un.org/en/genocideprevention/office-mandate.shtml>> qasur: 27 Qershor 2020.

⁷⁷³ Nicholas Turner, 'The Secretary-General', 131.

⁷⁷⁴ Ibid 149.

nëse është e nevojshme, t'i përgjigjen Kamboxhias, Ruandës ose Darfurit të ardhshëm.⁷⁷⁵ Dhe këtë KS-ja mund ta bëjë ashtu siç kontribuon në mënyrë aktive me zbatimin e parimit të PpM-së. Njoftimet e tij për organet ndërqeveritare të OKB-së dhe punës së ndryshme me Sekretariatet përmes paralajmërimit të hershëm, parandalimit të konfliktit, të drejtat e njeriut, bashkëpunimit me organizatat regjionale, angazhimit politik me vendet anëtare etj.⁷⁷⁶

4.2.10. Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe PpM

Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe mekanizmat e tij, kanë kontribuar në zbatimin e PpM-së në mënyra të ndryshme, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Kjo gjë është bërë duke adresuar shqetësimet e shteteve anëtare në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut dhe faktorët e rrezikut të krimeve të mizorisë, duke bërë rekomandime që inkurajojnë pajtueshmërinë me standardet dhe detyrimet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, përfshirë ato që janë bazë për parimin e përgjegjësisë për të mbrojtur, si dhe përmes rezolutave të këtij Këshilli mbi situatat me çështje tematike, përfshi edhe lidhjen e drejtpërdrejtë me rrezikun ose kryerjen e drejtpërdrejtë të krimeve të mizorisë. Të gjitha këto veprime kontribuojnë në zbatimin e shtyllave I dhe II të PpM-së duke promovuar një unitet më të madh midis anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare për mbrojtjen e popullatës nga krimet e mizerisë.⁷⁷⁷ Që nga viti 2008 ky Këshill ka miratuar një numër të konsiderueshëm të rezolutave të cilat i referohen PpM- së.

Tabela 4:
Referimi për shtete nga Rezolutat e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të cilat e përmendin PpM-në, për periudhën e viteve 2008-2019

Guinea	2
Libia	2
Siria	25

⁷⁷⁵ Ibid 155.

⁷⁷⁶ The UN Office of Genocide Prevention and the Responsibility to protect, 'Secretary- General', <<https://www.un.org/en/genocideprevention/secretary-general.shtml>> qasur: 27 Qershor 2020.

⁷⁷⁷The UN Office of Genocide and the Responsibility to Protect, 'Human Rights Council', <<https://www.un.org/en/genocidepreventio>> qasur: 28 Qershor 2020.

Republika Popullore Demokratike e Koresë	3
Sudani Jugor	3
Republika Demokratike e Kongos	3
Republika e Afrikës Qendrore	2

Siç shihet nga Tabela 4 e mësipërme, ky Këshill i është referuar PpM-së 40-të herë, nga viti 2008-2019,⁷⁷⁸ ku pothuajse gjysma e rezolutave të miratuara janë miratuar për Sirinë, me çrast siç shihet kriza dhe situata në Siri ishte shumë më e nevojshme për zbatimin e PpM-së, për dallim prej shteteve të tjera në krizë, ku numri i rezolutave të miratuara është dukshëm më i vogël. Sidomos nëse kjo krahasohet me rezolutat e KS-së dhe AP-së, aktiviteti dhe fokusi i këtij Këshilli ishte me fokus kryesor për Sirinë.

Ky Këshill mban sesione të veçanta për të adresuar situatat urgjente që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe krimeve të mizorisë. Që nga viti 2006 këto sesione të veçanta kanë konsideruar situata të ndryshme në: Burundi, Republika e Afrikës Qendrore, Bregu i Fildishtë, Darfuri, Republika Demokratike e Kongos, Iraku, Libani, Libia, Mianmari, Territori i Pushtuar Palestinez, Sudani i Jugut, Shri Lanka dhe Siria. Sesione të veçanta janë mbledhur gjithashtu për të shqyrtuar kërcënimin e paraqitur nga Boko Haram, Shteti Islamik në Irak dhe Levant dhe grupet e shoqëruara. Përveç kësaj, ky Këshill kishte krijuar disa komisione hetimore që adresojnë rrezikun ose kryerjen e vazhdueshme të gjenocidit, krimeve të luftës, spastrimit etnik ose krimeve kundër njerëzimit, si dhe përgjegjësinë për krimet e kryera, duke përfshi si vijon: Burundi, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Eritrea, Gaza, Libani, Libia, Shri Lanka dhe Siria.⁷⁷⁹

Nga ajo që u trajtua më sipër, në lidhje me zhvillimin e PpM-së në OKB, shohim se që nga viti 2005 kur ishte miratuar për herë të parë në AP dhe deri me sot, janë përfshirë disa institucione kryesore të OKB-së, me një sërë operacionesh të ndryshme në luftimin dhe

⁷⁷⁸ Global Centre for the Responsibility to Protect, 'UN Human Rights Council Resolutions Referencing R2P' <<https://www.globalr2p.org/resources/un-human-rights-council-resolutions-referencing-r2p/>> qasur: 30 Qershor 2020.

⁷⁷⁹ The UN Office of Genocide and the Responsibility to Protect, 'Human Rights Council', <<https://www.un.org/en/genocidepreventio>> qasur: 28 Qershor 2020.

parandalimin e krimeve të mizorisë. Nga kjo rrjedh se këto organe dhe institucione të OKB-së kanë bërë një punë mjaft të madhe në avancimin e parimit të PpM-së, mirëpo, kjo nuk do të thotë se këto veprime janë të mjaftueshme, duke konsideruar situatat e veprimeve të pa mjaftueshme ose jo adekuate në shtete të caktuara.

Përkundër literaturës së konsiderueshme mbi aspektet e ndryshme të PpM-së, profesori Gentian Zyberi vëren se pak vëmendje i është kushtuar rolit të një institucioni të rëndësishëm gjyqësor siç është GjND-ja e cila mund të luajë një rol të rëndësishëm në interpretimin dhe zhvillimin e fushës së detyrimeve të aktorëve shtetëror dhe joshtetëror nën përgjegjësinë për të mbrojtur.⁷⁸⁰ Dhe si një komponent i rëndësishëm juridik ndërkombëtar GjND-ja mund të sigurojë udhëzime të nevojshme në sqarimin e fushës ligjore të PpM-së dhe detyrimeve që u ngarkohen shteteve dhe aktorëve të tjerë.⁷⁸¹ Pra, ashtu dhe siç argumenton profesori Zyberi me të drejtë, me siguri se një mendim këshillëdhënës nga GjND mund t'i ndihmojë AP-së në diskutimet e veta në lidhje me karakterin e tij dhe obligimet e shteteve, organizatave përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare dhe mekanizmave të sigurisë. Gjithashtu, edhe KS-ja do të përfitonte nga një interpretim i tillë në rastet e veprimit të tij në bazë të Kapitullit të VII-të të Kartës dhe çështje të ndjeshme të përdorimit të veto-s nga anëtarët e përhershëm të KS-së në situata të PpM-së.⁷⁸² Një interpretim nga GjND mund të jetë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të konceptit ligjor të PpM-së.⁷⁸³

4.3. Kontributi i organizatave regjionale

Në rastin e PpM-së te përgjegjësia për të reaguar, Komisioni i KNNSSH-së parashihte një mundësi të mëtejme për ndërhyrje kolektive që të ndiqet nga organizatat regjionale dhe nën-regjionale që të veprojnë brenda kufijve të tyre të autorizimit. Shumë katastrofa humanitare do të kenë efekt të dukshëm në vendet fqinje përmes tejkalimit të kufijve kombëtar të fluksit të refugjatëve, ku edhe shtetet fqinje do të kenë interes për veprim të fortë kolektiv dhe në mënyrë efektive për katastrofën. Sipas vlerësimeve të Komisionit të KNNSSH është dëshmuar

⁷⁸⁰ Gentian Zyberi, 'The International Court of Justice', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 365.

⁷⁸¹ Ibid 367.

⁷⁸² Ibid 368.

⁷⁸³ Ibid 385.

se shtetet fqinje që veprojnë brenda kornizave të organizatave regjionale dhe nën-regjionale shpesh (por jo çdoherë) janë në gjendje për të vepruar se sa OKB-ja dhe neni 52 i Kartës së OKB-së u jep atyre mjaft fleksibilitet të konsiderueshëm në këtë drejtim.⁷⁸⁴ Ky legjitimitet për organizatat regjionale njihet në Kapitullin VIII të Kartës së OKB-së, por siç kërkon Karta, veprimeve paraprake të organizatave regjionale duhet të paraprihen nga autorizimi i KS-së. Por, siç kemi parë në disa raste, kur aprovimi është kërkuar *ex post facto*, ose pas ngjarjes në Liberi dhe Sierra Leone dhe mund të ketë mundësi të caktuara për veprime të tilla në të ardhmen.⁷⁸⁵ Edhe Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm i vitit 2004 i cili së pari përqafton PpM-në, thekson se aftësia e KS-së për t'u bërë më pro-aktive në përgjigjen ndaj kërcënimeve do të forcohet duke përdorur më shumë dhe në mënyrë më pro-aktive dispozitat e kapitullit VIII të Kartës së OKB-së. Sipas këtij raporti çelësi është që të organizohet aksioni regjional brenda kornizave të Kartës së OKB-së dhe të sigurohet që OKB dhe organizatat regjionale ta bëjnë punën në mënyrë më të integruar se që është bërë deri më tani.⁷⁸⁶ Në lidhje me veprimet ushtarake të organizatave regjionale Sekretari i Përgjithshëm, veprimet e NATO-s të cilat janë ndërmarrë në disa vende të caktuara, (ose edhe që nuk janë konsideruar organizata regjionale sipas kuptimit të Kapitullit të VII-të të Kartës, por që kanë disa karakteristika të ngjashme) kanë marrë operacione përtej mandatit të tyre. Më tutje ai thekson se veprimet të tilla janë të pranueshme për sa kohë ato janë të autorizuar dhe të përgjegjshme pranë KS-së.⁷⁸⁷ Raporti tre shtyllash i Sekretarit të Përgjithshëm i vitit 2009 thekson rëndësinë e veprimit gjithashtu dhe të organizatave rajonale dhe nën rajonale nën shtyllën e II-të si ndihmë ndaj organizatave të tilla dhe për të ndërtuar kapacitetet civile të tyre me qëllim për të parandaluar krimet dhe shkeljet e tjera në mënyrë që PpM të jetë një investim shumë i mençur. Po ashtu, në shtyllën III raporti përmend rëndësinë e veprimeve për PpM, duke vepruar nën kapitullin VIII të Kartës së OKB-së duke përfshi edhe ndërmarrjen e masave diplomatike, humanitare dhe paqësore.⁷⁸⁸

Që nga fundi i Luftës së Ftohtë organizatat regjionale kanë luajtur një rol shumë më thelbësor se sa më parë në paqe dhe në zbatimin e paqes, me çrast dobia e tyre e mundshme si në lidhje me zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve u pranuan nga OKB që nga fillimi,

⁷⁸⁴ Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty, 53.

⁷⁸⁵ Ibid 54.

⁷⁸⁶ A/59/565 (2004).

⁷⁸⁷ Ibid para. 273.

⁷⁸⁸ A/63/677, (12 January 2009), para 49.

duke e rregulluar këtë me Kapitullin VIII që përcakton rolin dhe fushëveprimin e këtyre organizatave. Sigurisht që këto përfshijnë lojtarët⁷⁸⁹ më aktivë dhe më të njohur në çështjet e paqes dhe të sigurisë, si: BE, Unioni Afrikan (UA) dhe partnerët e tij nën regionalë dhe OSBE-në. Përballë kësaj, ato gjithashtu përfshijnë edhe NATO-n, megjithëse kjo e fundit gjithmonë ka preferuar të përshkruajë vetveten, për arsye jo veçanërisht bindëse, si një "pakt kolektiv i vetëmbrojtjes" se sa një rregullim rajonal i Kapitullit VIII. Gjithashtu, një rol dhe kontribut të rëndësishëm në pranimin dhe zhvillimin e PpM-së kanë edhe organizata të tjera regjionale siç janë: Liga Araba (LA), Organizata e Shteteve të Amerikës (OSHA) dhe organizata të tjera.

Pas Samitit Botëror në vitin 2005, miratimi i PpM-së u mirëprit dhe u përkrah nga organizatat regjionale. BE-ja menjëherë në nëntor të po këtij viti kishte mbështetur fuqishëm PpM-në. Në deklaratën e BE-së theksohet se: "ne nuk mund të qëndrojmë pranë, pasi janë kryer krime lufte, gjenocid, spastrim etnik ose shkelje të tjera të rënda të së Drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtave të njeriut", duke garantuar mbështetje për një rol të forcuar të organizatave regjionale dhe nën-regjionale për procesin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.⁷⁹⁰ Mbështetja e BE-së ndaj PpM-së është e dokumentuar mirë. Në Raportin vijues të vitit 2008 mbi strategjinë Europiane të sigurisë ekziston njohja e PpM-së. Për më tepër Parlamenti Europian në një numër rezolutash jo-detyruese ka treguar këtë angazhim për PpM-në⁷⁹¹ duke u thirrur në PpM-në dhe duke i bërë thirrje BE-së për t'i dhënë fund mizorive në vende të ndryshme, si në Darfur, Sudan etj.,⁷⁹² siç është rasti poashtu edhe me iniciativën e Parlamentit Europian të vitit 2013, ndër më të mëdhatë ku BE për të konsoliduar dhe funksionalizuar mbështetjen e saj për PpM-në dhe për të krijuar një konsensus ndëreuropian në këtë çështje.⁷⁹³ Ajo gjithashtu, në vitin 2016 caktoi një "Pikë Fokale" të PpM-së për të koordinuar aktivitetet e saj në këtë fushë, duke u bërë kështu organizata e parë regjionale duke u bërë pjesë e rrjetit global, si një përpjekje globale ndërqeveritare për

⁷⁸⁹ Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, 181.

⁷⁹⁰ 'Council Of the European Union', (14820/05), (22 November 2005) 13

<<https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST%2014820%202005%20INIT/EN/pdf>> qasur: 2 Korri 2020.

⁷⁹¹ Daniel Fiott and Marie Vincent, 'The European Union, An Institutional Approach to the Responsibility to Protect' (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 202 [tani e tutje: Daniel Fiott and Marie Vincent, 'The European Union, An Institutional Approach to the Responsibility to Protect'].

⁷⁹² Ibid 2013.

⁷⁹³ European Parliament recommendation to the Council of 18 April 2013 on the UN principle of the 'Responsibility to Protect' ('R2P') (2012/2143(INI), qasur:

<https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-7-2013-0180_EN.html> qasur: 6 Korrik 2020.

luftimin e mizorive, pesë e të cilës janë edhe 61 shtete.⁷⁹⁴ Shërbimi European i Veprimit të Jashtëm, Komisioni European dhe Qendra Globale e Përgjegjësisë për të mbrojtur, organizuan një takim në vitin 2019 në Bruksel. Ky ishte takimi i parë i Rrjetit Global i pritur nga një Organizatë Regjionale.⁷⁹⁵ Për më tepër, delegacioni i BE-së në OKB ka marrë pjesë aktive në aktivitetet dhe takimet e 'Grupit të Miqve të PpM' në New York, një grup mbështetësish shtetërorë të PpM, bashkëkryetari i të cilit ka qenë gjithmonë një vend europian. E gjithë kjo ka ndihmuar në promovimin e PpM-së në qarqet diplomatike dhe forcimin e saj normativ.⁷⁹⁶ Gjithashtu, BE-ja dhe shtetet anëtare të saj kanë reaguar në situata të ndryshme të krizës. Liderët e shteteve më të fuqishme europiane, si: Franca, Britania e Madhe dhe vende të tjera u treguan ndër përkrahësit më të mëdhenj të PpM-së, duke vepruar në situata të ndryshme siç është edhe Rasti i Libisë.⁷⁹⁷ Një skenar i mundshëm sipas Smith dhe Marolly është edhe përfshirja e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke interpretuar Konventën Europiane, për veprimet ushtarake të shteteve anëtare lidhur me vazhden e përgjegjësisë së tyre për të mbrojtur si në sistemet tjera rajonale për të drejtat e njeriut po ashtu edhe Gjykata

⁷⁹⁴ The JCMS Blog Insight from the Journal of Common Market Studies, 'The European Union and the Responsibility to Protect' <<http://jcms.ideasononeurope.eu/2020/05/13/the-european-union-and-the-responsibility-to-protect/>> qasur 6 Korrik 2020, [tani e tutje: The JCMS Blog Insight from the Journal of Common Market Studies'], shih gjithashtu: Global Centre for the Responsibility to Protect, Global Network Of R2p Focal Points <<HTTPS://WWW.GLOBALR2P.ORG/THE-GLOBAL-NETWORK-OF-R2P-FOCAL-POINTS/>> QASUR: 6 KORRIK 2020, Global Centre for the Responsibility to Protect, 'Members of the Global Network of R2P Focal Points' <<https://www.globalr2p.org/resources/members-of-the-global-network-of-r2p-focal-points/>> qasur: 7 Korrik 2020. Emërimi i një "Pike Fokale" është një hap i rëndësishëm ndërqeveritar për ndalimin e mizorive. Një "Pikë Fokale" është një zyrtar i lartë brenda një qeverie për të lehtësuar mekanizmat ndërkombëtar për parandalimin e mizorive dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar duke marrur pjesë në rrjetin global. Emërimi i një Pike Fokale PpM është një hap që mund të zbatohet nga qeveritë për të demonstruar angazhimin e tyre për parandalimin e mizorisë masive, pavarësisht nga aftësia e tyre. Anëtarësimi i këtij rrjeti global tani përbëhet prej mbi 60 shteteve dhe dy organiztave rajonale: BE-ja dhe OSHA të cilët kanë caktuar një "Pikë Fokale" të PpM- së. Anëtar të këtij rrjeti global tani janë edhe shtete të cilat nuk kanë përjetuar kurrë mizori brenda vendit të tyre. Vendorsja e një "Pike Fokale" brenda një sistemi shtetëror është vendim i secilës qeveri individuale. Që nga viti 2011 Rrejtja Global përveç takimeve vjetore ka mbajtur edhe takime rajonale. Dhe për të ndihmuar punën e këtij rrjeti Global, në vitin 2019 është formuar edhe "Grupi Drejtues i Rrjetit Global" për "Pikave Fokale" të PpM- së për të ndërmarrë aktivitete përkatëse dhe në mes të takimeve vjetore. Ai udhëhiqet nga disa "Pika Fokale" dhe Sekretariati... shih: Global Centre for the Responsibility to Protect, Global Network Of R2p Focal Points <<HTTPS://WWW.GLOBALR2P.ORG/THE-GLOBAL-NETWORK-OF-R2P-FOCAL-POINTS/>> QASUR: 9 KORRIK 2020.

⁷⁹⁵ UN Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect, 'Regional Organizations', <<https://www.un.org/en/genocideprevention/regional-organisations.shtml>> qasur: 08 Korrik 2020.

⁷⁹⁶ The JCMS Blog Insight from the Journal of Common Market Studies'.

⁷⁹⁷ Matthias Dembinski and Berenike Schott, 'Regional security arrangements as a filter for norm diffusion: the African Union, the European Union and the responsibility to protect' (2014) (27)2, Cambridge Review of International Affairs, 368- 370 [tani e tutje: Matthias Dembinski and Berenike Schott, 'Regional security arrangements as a filter for norm diffusion: the African Union] shih gjithashtu: Daniel Fiott and Marie Vincent, 'The European Union, An Institutional Approach to the Responsibility to Protect', 204- 213.

Europiane e Drejtësisë dhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut mund të urdhërojnë edhe masa të përkohshme.⁷⁹⁸

Përveç Bashkimit European ndër organizatat tjera regjionale që kanë pranuar dhe kontribuar për PpM-në është edhe organizata e Unionit Afrikan (UA). UA është organizata e parë regjionale në botë e cila e ka kodifikuar PpM-në dokumentin e saj themelues.⁷⁹⁹ Ajo është miratuar në Aktin Kushtetues të UA-së në vitin 2000 dhe protokollit të tij në lidhje me themelimin e Këshillit të Paqes dhe Sigurisë të vitit 2005. Specifikisht, e drejta për të ndërhyrë gjendet në Nenin 4(h) të saj.⁸⁰⁰ E drejta për të ndërhyrë sipas këtij neni dhe shtyllës së tretë të PpM-së parashikon mundësinë e përdorimit të forcës ushtarake për të mbrojtur civilët nga krimet e mizorisë masive si: krimet e luftës, gjenocidit dhe krimet kundër njerëzimit, me gjithë se kritikohet se ajo nuk e përshkruan mënyrën se si ushtria duhet të përdorë forcën për mbrojtjen e civilëve.⁸⁰¹ UA ka treguar rolin e të qenit organi kryesor për të vepruar në situatën në Darfur nga viti 2004, duke lëshuar komunikata të ndryshme, duke negociuar marrëveshje për situatën në Darfur etj. Pra, Darfuri ishte rasti i parë për të provuar zbatimin normativ të PpM-së nga UA, me çrast në vitin 2004 u vendos të dërgohet një mision në Darfur. Hapi i parë ishte vendosja e vëzhguesve ushtarakë për monitorimin, verifikimin, hetimin dhe raportimin e shkeljeve të marrëveshjes së armëpushimit, të njohur si Misioni i Bashkimit Afrikan në Sudan (AMIS). Më pas, UA vendosi një pranim të plotë në Darfur, i njohur si “AMIS II”.⁸⁰² Përveç veprimeve në kriza të ndryshme në Kontinentin e Afrikës nga ana e kësaj organizate, sugjerohet edhe mundësia e përfshirjes së Komisionit dhe Gjykatës Afrikane, që të reagojnë në një numër mënyrash për të parandaluar përkeqësimin e rrethanave në kushte që potencialisht justifikojnë ndërhyrjen e detyruar ndërkombëtare⁸⁰³ veçanërisht në zbatimin aktual të Nenit 4(h) të Aktit Kushtetues. Edhe pse as Komisioni e as gjykata nuk mund të shtyjnë në funksion në mënyrën më të mirë zbatimin e PpM-së, Komisioni mund të bëjë

⁷⁹⁸ Rhona Smith And Conall Mallory, ‘The European system of human rights’, An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 455.

⁷⁹⁹ Matthias Dembinski and Berenike Schott, ‘Regional security arrangements as a filter for norm diffusion: the African Union’, 372.

⁸⁰⁰ Jeremy Sarkin, ‘The Responsibility to Protect and Humanitarian Intervention in Africa, Global Responsibility to Protect’ 2 (2010), Martinus Nijhoff Publishers, 378.

⁸⁰¹ Dan Kuwali, ‘Humanitarian Rights’: ‘Bridging the Doctrinal Gap between the Protection of Civilians and the Responsibility to Protect’, (2013), Journal of International Humanitarian Legal Studies 4 (Brill Nijhoff) 5.

⁸⁰² Solomon A. Dersso, ‘The African Union’, An Institutional Approach to the Responsibility to Protect (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 232- 234.

⁸⁰³ Frans Viljoen, ‘The African system of human rights’, An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 484.

rekomandime për shtetet dhe mund të raportojë për shkeljet masive në kuptim të nenit 58 të Kartës së UA-së.⁸⁰⁴

Një ndër organizatat regjionale, shtetet e së cilës janë ballafaquar me probleme dhe kriza të mëdha gjatë viteve të fundit është edhe Liga Arabe (LA). Duke u nisur nga krizat dhe situatat e PpM-së në Libi dhe Siri, LA ishte aktive në veprimet e saj që nga fillimi. Në vitin 2011 kur filloi përkeqësimi i situatës në Libi, LA kërkoi menjëherë nga autoritet Libiane të ndalojnë dhunën. Dhe nga shtetet e kësaj organizate u propozua pezullimi i Libisë nga LA. Si LA ashtu edhe KS-ja iu referuan detyrimeve të PpM-së nga ana e shtetit në rastin e Libisë. Është e pamohueshme që LA, si një organizatë regjionale, luajti një rol kritik në sigurimin e KS-së të informacionit të saktë dhe të duhur nga perspektiva regjionale.⁸⁰⁵ LA pezulloi anëtarësimin e Libisë dhe Sirisë nga kjo organizatë.⁸⁰⁶ Prej këtui shihet se bashkëpunimi i LA-së me OKB-në ishte i vazhdueshëm, gjithashtu edhe në përpjekjet e të dërguarit të OKB-së dhe LA-së për t'i dhënë fund dhunës në Siri. Poashtu, ndërhyrja në Libi në çështjet e marrëdhënies ndërmjet LA-së dhe KS-së në lidhje me rolin e duhur të organizatave regjionale në rolin e zbatimit të duhur të PpM-së.⁸⁰⁷ Kjo organizatë i kërkonte KS-së që të ndërmernte veprime të menjëhershme në Libi për shkak të situatës së PpM-së.⁸⁰⁸

Edhe Organizata e Shteteve të Amerikës (OSHA) dhe shtetet anëtare të kësaj organizate e mbështetën në përgjithësi parimin e PpM-së në Samitin Botëror të vitit 2005. Pavarësisht dyshimeve të PpM-së nga disa vende të kësaj organizate siç ishte kundërshtimi i Rezolutës 1973 për Libinë nga Brazili dhe Kolumbia, atë kohë anëtarë jo të përhershëm në KS, mund të thuhet se një numër i vogël i shteteve në OSHA e kundërshtojnë parimin e PpM-së. Megjithëse disa vende të tjera demonstrojnë skepticizëm mbi çështjen e PpM, ato kohën e fundit kanë demonstruar më shumë fleksibilitet dhe kanë sjellë elementë të rinj në diskutim.⁸⁰⁹ Për më

⁸⁰⁴ Ibid 49.

⁸⁰⁵ Mahasen M. Aljaghoub, Ibrahim M. Aljazy And Maysa S. Bydoon, 'The Arab League', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 296 [tani e tutje: Mahasen M. Aljaghoub, Ibrahim M. Aljazy And Maysa S. Bydoon, 'The Arab League'].

⁸⁰⁶ Reuters Staff, 'Arab League suspends Libya delegation', Reuters (February 22, 2011) <<https://www.reuters.com/article/libya-protests-league-idUSLDE71L2GK20110222>> qasur: 21 Korrik 2020; shih gjithashtu: David Batty and Jack Shenker, 'Syria suspended from Arab League Sat' *The Guardian*, (12 Nov 2011) <<https://www.theguardian.com/world/2011/nov/12/syria-suspended-arab-league>> qasur 26 Korrik 2020.

⁸⁰⁷ Mahasen M. Aljaghoub, Ibrahim M. Aljazy And Maysa S. Bydoon, 'The Arab League', 297- 298.

⁸⁰⁸ Ibid 299.

⁸⁰⁹ Paulo De Tarso Lugon Arantes, 'The Organization of American States', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 280- 282.

shumë kjo organizatë së bashku me BE-në janë të vetmet organizata të cilat kanë përfshirë “Pikat Fokale” të PpM-së. Gjithashtu, kjo organizatë nënshkruajti një marrëveshje bashkëpunimi me GJPN-në, dhe në vitin 2018 ajo mbështeti edhe vendimin e Argjentinës, Kilit, Kolumbisë, Paraguit, Perusë dhe Kanadasë për t’iu referuar GJPN-së situatën në Venezuelë, duke shënuar referimin e grupit të parë në gjykatë.⁸¹⁰

Funksionalisht, organizatat ndërkombëtare regjionale janë aktorë si në përbërësit civilë ashtu edhe në ato ushtarakë të konceptit të PpM-së.⁸¹¹ Këto janë në pozicion për të ndihmuar dhe përgjigjur në nivel regjional dhe lokal ndaj situatave shqetësuese nga perspektiva e parimit të PpM-së. Kontributi i tyre mund të përfshijë të tri shtyllat e PpM-së. Nën shtyllën e parë, organizatat regjionale dhe nën-regjionale mund të inkurajojnë qeveritë që të njohin detyrimet ndërkombëtare sipas konventave ndërkombëtare dhe të adresojnë burimet e krizave brenda shoqërive të tyre para se kjo të çojë në dhunë dhe krizë të mizorisë. Nën shtyllën e dytë, organizatat regjionale dhe nën-regjionale janë thelbësore në forcimin e përpjekjeve për parandalimin strukturor meqë luajnë një rol kryesor në zhvillimin e normave, standardeve dhe institucioneve për promovimin e tolerancës, llogaridhënien dhe menaxhimin konstruktiv të diversiteteve të ndryshme etj. Ndërsa nën shtyllën e tretë, kur shtetet nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të mbrojnë popullatën nga krimet masive, mjetet e reagimit, si hetimi, gjetja e fakteve, ndërmjetësimi, bindja personale dhe zgjidhja e konfliktit të paraqitura në kapitujt VI dhe VIII të Kartës së OKB-së, shpesh ndërmerren nga marrëveshjet regjionale dhe nën-regjionale. Marrëveshjet regjionale dhe nën-regjionale gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm edhe në nivelin global, si për shembull, për shkak se ato janë më afër situatave në të cilat ekziston rreziku i kryerjes së krimeve, ata mund të jenë kritikë për të ndihmuar në sigurimin e rrjedhës së saktë dhe në kohë të informacionit dhe analizës nga niveli i vendit tek vendimmarrësit global, dhe zvogëlimin e rrezikut të keqinterpretimit, keqinformimit dhe shtrembërimit të qëllimshëm.⁸¹²

⁸¹⁰ UN Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect, ‘Regional Organizations’, <<https://www.un.org/en/genocideprevention/regional-organisations.shtml>> qasur: 26 Korrik 2020.

⁸¹¹ Stefan Kadelbach, ‘The European Union’s Responsibility to Protect, Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?’, (2015) Brill Nijhoff, 244.

⁸¹² UN Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect, ‘Regional Organizations’, <<https://www.un.org/en/genocideprevention/regional-organisations.shtml>> qasur 26 Korrik 2020.

4.4. Aktorët e tjerë dhe shoqëria civile

Viteve të fundit janë krijuar grupe të ndryshme të përbërë nga shtete, organizata jo-qeveritare dhe organizata të tjera me fokus PpM-në. Një ndër organizimet është edhe: “Grupi i Miqve për Përgjegjësinë për të Mbrojtur”.⁸¹³ Ky Grup shërben si platformë ndër-qeveritare informale me mision të përhershëm në OKB, i vendosur në New York dhe Gjenevë. Grupi përbëhet nga 53 shtete të të gjitha regjioneve dhe BE-ja, synon të promovojë dialogun dhe të inkurajojë vendet anëtare të OKB-së që të përparojnë në parandalimin efektiv të gjenocidit, krimeve të luftës, spastrimit etnik dhe krimeve kundër njerëzimit. Grupi ka për qëllim të identifikojë mundësitë ku vendet anëtare mund të lehtësojnë diskutimin efektiv mbi çështjet e lidhura me PpM-në, përfshi edhe parandalimin e konfliktit, të drejtat e njeriut dhe drejtësinë ndërkombëtare. Grupi gjithashtu jep deklarata të përbashkëta gjatë debateve të AP-së së OKB-së, në debate të hapura në KS dhe gjatë seancave në Këshillin e të Drejtave të Njeriut.⁸¹⁴ Gjithashtu, janë krijuar qendra të ndryshme të cilat merren me avokimin dhe promovimin dhe përfshirjen e tyre në avancimin e PpM-së përmes hulumtimeve shkencore. Këto qendra që kryesisht veprojnë në kuadër të universiteteve të caktuara janë: “Qendra Europiane për Përgjegjësinë për të Mbrojtur”,⁸¹⁵ “Qendra Aziatike-Paqësore për Përgjegjësinë për të Mbrojtur”⁸¹⁶ dhe “Qendra Kanadeze për Përgjegjësinë për të Mbrojtur”.⁸¹⁷

Një koalicion i shoqërisë civile i përbërë nga 80-të OJQ- është themeluar në vitin 2009, i quajtur: “Koalicioni Ndërkombëtar për Përgjegjësinë për të Mbrojtur”. Koalicioni bashkon OJQ-të nga të gjitha rajonet e botës për të forcuar konsensusin normativ për PpM, për të kuptuar më tej normën, për të nxitur kapacitetet e forcuara për të parandaluar dhe ndaluar mizoritë dhe për të mobilizuar OJQ-të për të avokuar për veprim për të shpëtuar jetën në situatat specifike të PpM-së.⁸¹⁸

⁸¹³ Global Centre for the Responsibility to Protect, ‘Group of Friends of the Responsibility to protect’, <<https://www.globalr2p.org/group-of-friends-of-the-responsibility-to-protect/>> qasur: 10 Gusht 2020.

⁸¹⁴ . Ibid.

⁸¹⁵ ‘European Centre for the Responsibility to Protect’, (University of Leeds) <<https://ecr2p.leeds.ac.uk/about-2/about/>> qasur: 10 Gusht 2020.

⁸¹⁶ ‘Asia- Pasific for the Responsibility to Protect’, (The University of Queensland Australia) <<https://r2pasiapacific.org/team/our-staff>> qasur: 10 Gusht 2020.

⁸¹⁷ . ‘Canadian Centre for the Responsibility to Protect’ <<http://ccr2p.org/>> qasur 10 Gusht 2020.

⁸¹⁸ ‘International Coalition for the Responsibility to Protect’ <<https://www.devex.com/organizations/international-coalition-for-the-responsibility-to-protect-59778>> qasur 10 Gusht 2020.

Parandalimi i kryerjes së krimeve të mizorisë është përgjegjësi e shteteve, por, përmbushja e kësaj përgjegjësie kërkon partneritet me shoqërinë civile. Organizata kombëtare dhe ndërkombëtare nga shoqëria civile janë të rëndësishme për mbështetjen e parimit të PpM-së. Kështu, në këtë kontekst, ato mund të jenë të dobishme në shndërrimin e angazhimeve, në veprim në terren. Kështu, ata kanë në dorë një sërë mjetesh për të parandaluar krimet dhe shkeljet e parimit të PpM-së. Këto mund të punojnë me qeveritë për të thelluar mirëkuptimin dhe ndërgjegjësimin e PpM-së, për të ndërtuar kapacitetet në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar dhe për të mbrojtur popullatën nën kërcënim. Shoqëria civile mund të mbështet zhvillimin e strategjive afatgjate kombëtare dhe lokale për ndalimin e mizorive. Për më tepër, ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm për paralajmërimin e hershëm, veçanërisht pasi teknologjitë e reja mundësojnë sigurimin e informacionit të drejtpërdrejtë, ku informacionet e tilla mund të nxisin shtetet dhe organizatat ndërkombëtare të veprojnë. Organizata e shoqërisë civile kanë synuar fushata të ndërgjegjësimit për akterë të veçantë, të tilla si media, udhëheqja fetare, udhëheqësit lokal në lidhje me rolin e tyre në minimizimin e rreziqeve të mizorisë etj.⁸¹⁹

4.5. Statusi ligjor i PpM-së – A është vërtet një normë e re?

Për sa i përket statusit ligjor të PpM-së ekzistojnë qëndrime të ndryshme. Shumica e autorëve argumentojnë se PpM-ja akoma nuk është bërë një normë detyruese në të drejtën ndërkombëtare.⁸²⁰ Mirëpo, një pjesë e madhe e tyre pavarësisht se e mohojnë që PpM ta ketë arritur statusin ligjor në të drejtën ndërkombëtare, e konsiderojnë atë më shumë si një normë ndërkombëtare shoqërore, politike dhe morale.⁸²¹

Ndërsa nga autorët e tjerë konsiderohet se tani PpM-ja është një normë në zhvillim, madje një numër i vogël i tyre besojnë se ajo tani e ka arritur statusin ligjor të një normë të re

⁸¹⁹ The UN Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect, 'Civile Society', qasur: <<https://www.un.org/en/genocideprevention/civil-society.shtml>> qasur 10 Gusht 2020.

⁸²⁰ Peter-Tobias Stoll, 'The Responsibility to Protect, One-time Incentive or Lasting Advancement for International law? Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?' (2015) Brill Nijhoff 147; shih gjithashtu: Michael W. Doyle New Haven, *The Question of Intervention John Stuart Mill and The Responsibility to Protect*, 114- 115, Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*, (palgrave macmillan, 2019),

⁸²¹ 'Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect', 13; shih gjithashtu: Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*, 81.

ndërkombëtare.⁸²² Ndonëse PpM-ja nuk mund të nënvlerësohet në raport me zhvillimin e saj, megjithatë argumentohet se ajo bazohet në mekanizmat tanimë ekzistues në të drejtën ndërkombëtare, prandaj konsiderohet se PpM-ja nga Samiti Botëror 2005 nuk ofron detyrime ligjore shtesë për dallim prej atyre normave ekzistuese.⁸²³ Detyrimet e shteteve për të mbrojtur qytetarët brenda territorit të tyre nga mizoritë janë tashmë të reflektuara nga Konventa për Prandalimin dhe Ndëshkrimin e Krimeve të Gjenocidit, traktatet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut etj. Siç përshkruan Anne Orford, as nuk duket se shpallja e një përgjegjësie ndërkombëtare për të mbrojtur t'u ketë imponuar një detyrim ligjor shteteve për t'u përfshirë në një ndërhyrje të njëanshme ose kolektive në situata të krizave humanitare. Orford, vëren se koncepti i PpM-së është hartuar me kujdes në mënyrë që të mos vendosen detyra ligjore ndaj shteteve ose organizatave ndërkombëtare për të ndërmarrë veprime të veçanta në rrethana specifike. Ideja që PpM të krijojë detyrime të asaj natyre për shtetet ka hasur në rezistencë nga shtetet.⁸²⁴ Gjithashtu edhe në diskutimet e AP-së në vitin 2009 për “Zbatimin e PpM-së”, ishte kundërshtuar çdo lidhje e PpM-së me ndërhyrjen e njëanshme. Megjithëse, siç thotë Orford edhe nëse PpM-ja nuk imponon detyrime ligjore mbi OKB-në dhe shtetet për të ndërmarrë veprime në situata të krizave humanitare, ajo megjithatë ngre pyetje thelbësore të rëndësishme ligjore. Orford argumenton se koncepti i PpM-së nuk është një formë e ligjit që imponon detyrime për subjektet, por, përkundrazi mund të kuptohet si një formë e ligjit që jep kompetenca “të një natyre publike ose zyrtare” dhe që ndan juridiksionin. PpM-ja duhet të kuptohet si diç normative në sensin e formës së dikurshme të autorizimit ligjor dhe llojeve të caktuara të veprimtarive.⁸²⁵

Kundërshtimet në lidhje me ekzistimin e PpM-së si një normë në të drejtën ndërkombëtare argumentohen nga komentuesit në kuptimin e asaj se ajo nuk është në

⁸²² Peter Hilpold, ‘From Humanitarian Intervention to the Responsibility to Protect’, 29; shih gjithashtu: Gareth Evans, ‘The Responsibility to Protect- From an Idea to an International’, 21, Evans, Gareth, ‘The Responsibility to Protect in Environmental Emergencies’, (2009) International Crisis Group, Presentation by Gareth Evans, President, International Crisis Group, to American Society of International Law (ASIL) 103rd Annual Meeting, <<https://www.crisisgroup.org/global/responsibility-protect-environmental-emergencies>> qasur: 2 Shtator 2020.

⁸²³ Raphaël van Steenberghe, ‘The Notions of the Responsibility to Protect and the Protection of Civilians in Armed Conflict: Detecting Their Association and Its Impact Upon International Law’, (2014) (6)1, Goettingen Journal of International Law, 112 [tani e tutje: Raphaël van Steenberghe, ‘The Notions of the Responsibility to Protect and the Protection of Civilians in Armed Conflict’]; shih gjithashtu: ‘Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect’, 14.

⁸²⁴ Anne Orford, ‘International Authority and the Responsibility to Protect’, (Cambridge University Press 2011) 23- 24.

⁸²⁵ Ibid 25.

përputhje me burimet aktuale të së drejtës ndërkombëtare. Nuk është pjesë e ndonjë traktati ndërkombëtar, nuk e ka arritur statusin e një të drejte zakonore ndërkombëtare apo *opinio juris* dhe nuk njihet si parim i përgjithshëm i së drejtës.⁸²⁶ Një ndër kundërshtarët më të mëdhenj të zhvillimit të normës së PpM-së është Aidan Hehir, që PpM-në e përshkruan si një “normë të zbrastë”. Statusin e PpM-së si një normë e zbrastë Hehir e konsideron se është një funksion i evolucionit të përmbajtjes së tij normative; PpM është e orientuar gjithnjë e më shumë drejtë konstituimit të interpretimit të kufizuar të shtyllave I dhe II, elementet më të lakueshme të PpM- së dhe më pak transformuese. Ndërsa theksi në shtyllën II është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme sa që sot nuk paraqitet në debatet politike të PpM-së. Hehir argumenton se arritja e konsensusit rreth këtij versionit të shkurtër të PpM-së nuk është as domethënëse në vetvete, as nuk është provë se do të ketë rritje të rëndësishme. Efikasiteti i PpM-së varet nga tre shtyllat nëse punojnë së bashku.⁸²⁷ Në fakt, nëse konsensusi për PpM është një funksion i shteteve që veçojnë shtyllën III, atëherë ky konsensus është në fakt dëshmi se evolucioni i normës është karakterizuar nga degradimi. Siç argumenton ai, në këtë mënyrë siç është PpM, një lloj i veçantë i normës që komprometon efikasitetin e saj dhe ndikimin pozitiv, prandaj, Hehir konsideron se PpM është një bërë një normë e zbrastë, e orientuar në mënyrë thelbësore drejt shtyllave I dhe II, dhe është një funksion i procesit të kontestimit gjatë të cilit kuptimi i PpM-së është ndryshuar ndjeshëm.⁸²⁸

Edhe nëse PpM-ja nuk e ka arritur statusin ligjor të një norme dhe ende nuk ka arritur një praktikë të kristalizuar, nga disa studiues argumentohet se ajo të paktën duhet të konsiderohet si një normë morale dhe politike e cila përfshin rregulla të ndryshme ligjore.⁸²⁹ Si një koncept politik, ajo ende është e diskutueshme dhe duhet të trajtohet në OKB.⁸³⁰ Përderisa rregullat juridike kanë kompetenca ligjore të detyrueshme dhe kanë pasoja të drejtpërdrejta juridike në rastin e shkeljes së tyre, normave morale ju mungon një autoritet i tillë. Pinar Ercan, përshkruan se karakterizimi i PpM- së si një normë morale kufizon fuqitë e PpM-së në drejtim të shtrëngimit të shteteve dhe bashkësisë ndërkombëtare për të vepruar

⁸²⁶ Andrew Garwood-Gowers, ‘The Responsibility To Protect And The Arab Spring: Libya As The Exception, Syria As The Norm?’, (2013) (36)2, UNSW Law Journal Volume, 600; shih gjithashtu: Michael W. Doyle New Haven, *The Question of Intervention John Stuart Mill and The Responsibility to Protect*, 115.

⁸²⁷ Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*, (palgrave macmillan, 2019) 9- 10 [tani e tutje: Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*].

⁸²⁸ Ibid 77.

⁸²⁹ ‘Diana Amneus, The coining and evolution of responsibility to protect’, 13.

⁸³⁰ Raphaël van Steenberghe, ‘The Notions of the Responsibility to Protect and the Protection of Civilians in Armed Conflict’, 112.

në mënyrë të caktuar. Prandaj, ndërsa PpM-ja përcakton sjelljen e duhur për shtetet si dhe bashkësinë ndërkombëtare dhe natyrisht krijon një prirje të konformitetit, ai nuk mund të sigurojë pajtueshmëri dhe të sanksionojë ligjërisht këtë mospërputhje. Ai thekson se bazuar në një analizë kontekstuale të dokumenteve të miratuara brenda kornizës së OKB-së dhe deklaratave të Sekretarit të Përgjithshëm, mund të argumentohet se paragrafët 138 dhe 139 vendosën PpM-në kryesisht në një standard moral të sjelljes së përshtatshme të shteteve që duhet të ndjekin dhe transmetojnë për bashkësinë ndërkombëtare në sjelljen e tyre.⁸³¹ Nuk ka dyshim që PpM-ja si koncept ka gjetur një jehonë të jashtëzakonshme midis shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe regjionale si dhe aktorëve joshtetëror dhe ka vendosur një status moral dhe një koncept politik, por për kundërshtarët e saj dokumentet kryesore të PpM-së kanë krijuar një legjitimitet të ndërhyrjes, mirëpo ato heshtin në lidhje me ligjshmërinë e saj dhe kështu si një koncept i ri shihet thjesht si: *de lege ferenda*, pas ende nuk e ka fituar statusin *lex lata*.⁸³² Mirëpo, pavarësisht qëndrimeve të tilla është e domosdoshme që bashkësia ndërkombëtare të përqafojë thirrjet morale dhe ligjore të PpM-së brenda sistemit të sigurisë kolektive që të adresojë vuajtjet e miliona njerëzve gjatë katastrofave të ndryshme humanitare. Përndryshe siç thotë Astha Pandey PpM do të fajësohet për justifikimin e “ndërhyrjeve neo-imperialiste”. Pavarësisht se reagimet ndërkombëtare gjatë krizave kanë qenë zhgënjyese dhe jo adekuate, kjo gjë nuk duhet ti pengojë studiuesit të pranojnë shfaqjen graduale, por të pamohueshme të miratimit ndërkombëtar të PpM-së për mbrojtjen e popullatave nga krimet e mizorisë dhe se normat konkrete ndërkombëtare të ndalimit të përdorimit të forcës të pësojnë një ndryshim të rëndësishëm në dritën e njohjes dhe pranimit në rritje të PpM-së.⁸³³ Monika Hakimi, argumenton se PpM nuk duhet të paraqesë një detyrim ligjor gjithëpërfshirës, që bie menjëherë mbi të gjithë bashkësinë ndërkombëtare por përkundrazi duhet të paraqitet një pako detyrash diskrete dhe përgjegjësia për secilën prej këtyre detyrave duhet t’u përgjigjet shteteve në situata specifike të jashtme në të njëjtën kohë. Duke konsideruar që ky version i PpM-së është më i preferueshëm se ai aktual, pasi bazohet në detyrimet ekzistuese ndërkombëtare sepse e drejta ndërkombëtare tanimë është duke caktuar detyra ndaj shteteve për të vepruar në

⁸³¹ Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*, 81.

⁸³² Astha Pandey, ‘The Responsibility To Protect (“R2P”) In International Law: Protection of Human Rights or Destruction of State Sovereignty?’, (2013) 115, *NLUJ Law Review*, 125.

⁸³³ *Ibid* 126.

situata ndaj popullatave të huaja dhe trajektorja është duke vazhduar të rritet zgjerimi i këtyre detyrimeve.⁸³⁴ Hakimi, konsideron se PpM-ja nuk ofron shumë udhëzime konkrete se si duhet të veprojnë shtetet e huaja ndaj situatave në rrezik, prandaj konsideron se kjo doktrinë nuk ka nevojë të jetë ekskluzivisht e ligjshme sipas formës së saj. Vetëm propozimet e politikave mund të shtynë disa shtete të jashtme të veprojnë; vetë shtetet mund të mbështesin propozimet ose t'i përgjigjen zgjedhësve që i mbështesin. Por, caktimi i detyrave operative ligjore të shteteve të jashtme do të nënkuptojë krijimin e pritshmërisë që të ndihmohet popullatat në rrezik nuk është gjithmonë diskrecionale, dhe mos ndihma mund të shkaktojë në mënyrë legjitime përgjegjësinë e një shteti të jashtëm.⁸³⁵

Ndërsa, nga ana tjetër, mbështetësit e PpM-së, argumentojnë se ajo ka arritur statusin e një norme në të drejtën ndërkombëtare në Samitin Botëror në vitin 2005, ku me miratimin unanimit të PpM-së nga 150 krerë të shteteve dhe qeverive të pranishme në AP u pranuan edhe rekomandimet kryesore dhe e miratuan PpM-në. Gjithashtu, edhe miratimi i një rezolute të KS-së në vitin 2006 për PpM-në si dhe i shumë rezolutave për situatat specifike të PpM-së flet për miratimin e saj si një normë ndërkombëtare. Vetëm katër vite nga miratimi i PpM-së në OKB, Gareth Evans argumentonte se PpM-në tek ajo që tani ka origjinën për t'u përshkruar si një normë ndërkombëtare të pranuar gjerësisht (me një potencial për të evoluuar në një rregull të ri të së drejtës ndërkombëtare zakonore) me një histori jashtëzakonisht inkurajuese dhe ne duhet të inkurajohemi prej saj.⁸³⁶ Pra, ai konsideron se PpM është më shumë se një normë në zhvillim, pra një normë e re. Më shumë punë duhet të bëhet dhe Evans është i bindur se PpM-ja ka një të ardhme të sigurtë.⁸³⁷

Si përfundim, duke pasur parasysh atë që u trajtua më sipër në lidhje me qëndrimet e ndryshme për statusin ligjor të PpM-së, nuk mund të argumentohet se PpM tashmë ka arritur statusin ligjor në të drejtën ndërkombëtare, pavarësisht miratimit dhe afirmimit të deritanishëm të saj në OKB. Megjithatë, miratimi i treguar për PpM dëshmon se ky koncept plotëson një boshllëk në rendin juridik ndërkombëtar, ku miratimi dhe veprimet në situata të

⁸³⁴ Monica Hakimi, 'Toward a Legal Theory on The Responsibility to Protect', (2014) (39)247, The Yale Journal of International Law, 250.

⁸³⁵ Ibid 253.

⁸³⁶ Gareth Evans, 'The Responsibility to Protect- From an Idea to an International', 20- 21.

⁸³⁷ European Centre for the Responsibility to Protect (ECR2P) Annual Lecture (Online), 'Leeds University', (26 November 2020) by Professor the Hon Gareth Evans, 2020 Annual Lecture – Professor Gareth Evans, <<https://ecr2p.leeds.ac.uk/ecr2p-annual-lectures/2020-annual-lecture-professor-gareth-evans/>> qasur: 02 Shtator 2020 [tani e tutje: Gareth Evans, European Centre for the Responsibility to Protect (ECR2P) Annual Lecture (Online), 'Leeds University'].

PpM-së nuk mund të mohohet një zhvillim i një faze të caktuar i saj. Mirëpo, nuk duket se këto veprime janë të mjaftueshme për të konsideruar PpM-në si një normë të plotë ekzistuese. Ashtu siç argumenton me të drejtë edhe Peter Hilpold, procesi i legalizimit të PpM-së ka arritur në gjysmë të rrugës. Prandaj, përkufizimi i saj gjysmë koncept ligjor dhe gjysmë politik është i pakënaqshëm dhe me të vërtetë nuk i jep drejtësi përmbajtjes së PpM-së.⁸³⁸

4.6. PpM midis suksesit dhe kritikës

Përgjatë viteve PpM ka pasur një avancim si nga përkrahja e saj ndërkombëtare, ashtu edhe krijimi i mekanizmave dhe ndërmarrja e veprimeve të caktuara në situata të PpM-së. Ndërsa në të njëjtën periudhë koncepti i PpM-së është ballafaquar me kritika të shumta dhe dështime në veprim, ajo nga viti 2005 është miratuar nga më shumë se 150 vende anëtare në AP, dhe ishte një fillim mjaft i mbarë për konceptin. Siç e konsideron Gareth Evans, Samiti Botëror 2005 na ofroi më shumë se sa kishim qenë më parë për ta bërë ëndrrën “kurrë më” më shumë se një moto. Të bësh që krerët e shteteve dhe qeverive të pranojnë njëzëri se këto krime përbënin shqetësim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare edhe kur këto kryheshin brenda një shteti sovran, ishte në çdo pikëpamje një triumf diplomatik.⁸³⁹ Nga viti 2005 janë miratuar një sërë rezolutash të cilat janë përmendur më sipër në këtë kapitull, siç janë ato nga KS-ja, AP-ja, Këshilli për të Drejtat e Njeriut, aktivitetet dhe raportet vjetore të Sekretarit të Përgjithshëm duke iu referuar PpM-së.

Organizatat regjionale dhe nën-regjionale janë angazhuar në shumë situata të PpM-së. Për ithtarët e PpM-së, për më shumë se një dekadë ky koncept është pritur mjaft mirë. Kështu, PpM bazohet në një sistem shumë shtresor të mbrojtjes së sigurisë njerëzore, duke përfshi shtetet, organizatat regjionale, organizatat nën-regjionale dhe organizatat ndërkombëtare.⁸⁴⁰ Midis progresit të rëndësishëm institucional të PpM-së, përfshi këtu Zyrën

⁸³⁸ Peter Hilpold, ‘From Humanitarian Intervention to the Responsibility to Protect’, 29- 30.

⁸³⁹ Gareth Evans, European Centre for the Responsibility to Protect (ECR2P) Annual Lecture (Online), ‘Leeds University’.

⁸⁴⁰ Gentian Zyberi, ‘Sharing the responsibility to protect: taking stock and moving forward’, 520; shih gjithashtu: Peter Hilpold, ‘From Humanitarian Intervention to the Responsibility to Protect’, 25, Simon Adams, ‘Statement of the Global Centre for the Responsibility to Protect at the 2016 UN General Assembly Informal Interactive Dialogue on the Responsibility to Protect’ (2016) Global Centre of the Responsibility to Protect <<http://s156658.gridserver.com/media/files/2016-september-gcr2p-r2p-interactive-dialogue-statement-2.pdf>> qasur: 15 Shtator 2020.

e OKB-së për Parandalimin e Gjenocidit dhe Përgjegjësinë për të Mbrojtur, Rritjen e Grupit të Miqve të PpM-së në grupin më të madh të shteteve brenda OKB- së dhe emërimin e 61 “Pikave Fokale” nga shtetet dhe organizatat regjionale, mund të thuhet se PpM-ja ka arritur të rrisë ndërgjegjen kolektive për situata të mizorisë. Gjatë 15-të viteve të fundit, suktesi i PpM-së mund të dëshmohet me vetë faktin se është dëshmuar gjithnjë e më shumë në situata të mizorisë.⁸⁴¹ Në mënyrë parandaluese strategjitë e drejtuara nga PpM kanë pasur një numër suksesesh, veçanërisht në ndalimin e përsëritjes së dhunës në: Kenia, Sierra Leone, Liberia, Guinea, Bregu i Fildishtë, Gambia etj. Por pavarësisht këtyre suksesëve edhe vetë përkrahësit më të mëdhenj siç është Gareth Evans pajtohen se nuk ka hapësirë për vetëkënaqësi. Mirëpo, sipas tij atë se çka ka arritur PpM gjatë këtyre 15-të viteve të fundit ka shumë për të festuar dhe për të qenë optimist. Prova të tilla janë debatuar në AP që nga viti 2009 që treguan mbështetje të qëndrueshme, dhe një artikulum të qartë se PpM tani pranohet si një normë politike (nëse jo ligjore) dhe janë nxjerrë më shumë se 80-të rezoluta dhe Deklarata Presidenciale nga KS-ja.⁸⁴²

Nga një numër suksesesh PpM gjithashtu përballet edhe me kritika dhe vështirësi në zbatim. Vet Evans si një nga “etërit” e PpM-së e pranon se lajm jo i mirë është rekordi i PpM-së që ka qenë zhgënjyes në çdo pikëpamje, të paktën vitet e fundit. Duke përmendur dështimet e fundit si në Shri Lanka, Sudan, Mianmar, Jemen dhe mbi të gjitha në Siri.⁸⁴³ Periudha midis 2010 dhe 2015 dëshmoi se është një rrugë e vështirë përpara për zbatimin e PpM-së, sa i përket parandalimit dhe ndëshkimit. Megjithëse kishte rrallë histori suktesi, si rastet e Guineas dhe Kenias, shumicën e kohës bashkësia ndërkombëtare përballej me dështime për të parandaluar situatat në fazat e tyre të hershme dhe me ngurrim e zbatuan PpM-në. Shpesh duke u sfiduar nga situata të rënda dhe dështimi për të parandaluar situatat në fazat e tyre të hershme, si në rastin e Darfurit, bashkësia ndërkombëtare nuk e vendosi opsionin e ndërhyrjes ushtarake në diskutim.⁸⁴⁴ Edhe rastet e ndërhyrjes në Libi dhe në Bregun e Fildishtë në vitin 2011, nga shumë kritikohen se gjuha e përdorur në këto rezoluta, nuk u thirrën në paragrafin 139 për të ftuar veprime e mbetura të bashkësisë

⁸⁴¹ Savita Pawnday, ‘Jaclyn Streifeld-Hall, The Practitioner’s Perspective: R2P at 15, global responsibility to protect’ (2020) (12) Brill Nijhoff 366, 367.

⁸⁴² Gareth Evans, European Centre for the Responsibility to Protect (ECR2P) Annual Lecture (Online), ‘Leeds University’.

⁸⁴³ Ibid.

⁸⁴⁴ Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*, 2; shih gjithashtu:

ndërkombëtare.⁸⁴⁵ Pengesë e cila e ndalon zhvillimin e PpM- së në shumë raste, janë edhe dështimet e KS-së ku në shumicën dërmuese të rezolutave përdorë zakonisht vetëm shtyllën I dhe shtyllën II, duke hequr përgjegjësinë e mbetur për bashkësinë ndërkombëtare në bazë të shtyllës III.⁸⁴⁶

Që nga viti 2015 edhe pse kishte një rritje të rezolutave të miratuar nga KS, mirëpo, të gjitha këto i referoheshin shtyllës së parë dhe të dytë.⁸⁴⁷ Në këtë periudhë spiralja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka filluar të ulet. Shumë organizata ndërkombëtare dhe mekanizma të tjerë, u ankuan për dështimin e bashkësisë ndërkombëtare për të reaguar.⁸⁴⁸ Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së gjithashtu, në vitin 2017 alarmoi se bota jonë është bërë më e rrezikshme, më pak e parashikueshme, më kaotike dhe konfliktet e reja po shtohen.⁸⁴⁹ Veçanërisht, përkeqësimi i situatave në Siri dhe në Myanmar që nga 2012 nga Hehir konsiderohen se ato kanë shërbyer si një ilustrim i tmerrshëm se mbështetja e shtetit për PpM dhe angazhimet e bëra nga shtetet për dekada janë provuar kryesisht si të pavlefshme.⁸⁵⁰ Hehir, këtë periudhë e konsideron si rënie dhe degjenerim të të drejtave të njeriut. Prandaj ai konsideron se duke pasur parasysh peshën e provave që tregojnë një degjenerim të shpejtë dhe të përshpejtuar të të drejtave të njeriut në nivel global, me siguri pyetja e duhur, nëse jo më thelbësore për t'u bërë nuk është se: "A ka qenë PpM një sukses?", por përkundrazi: "Përse PpM dështoi?".⁸⁵¹ Hehir argumenton se fakti i progresit të jashtëzakonshëm të PpM-së pas takimit të AP në vitin 2009, se PpM ka bërë përparim në bazë

⁸⁴⁵ Ibid 102; shih gjithashtu: Simon Chesterman, 'R2P and humanitarian Intervention: From Apology to Utopia and Back Again', [Written for Robin Geiß & Nils Melzer (eds.), The Oxford Handbook on the International Law of Global Security (Oxford University Press, Forthcoming 2018), 10 qasur: <https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3224116> qasur: 18 Shtator 2020.

⁸⁴⁶ Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*, 11- 12; shih gjithashtu: Aidan Hehir, 'The Illusion of Progress: Libya and the Future of R2P', The Responsibility to Protect: challenges & opportunities in light of the Libyan intervention', (Edited by Alex Stark, e-International Relations, November 2011), Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*, 103.

⁸⁴⁷ Simon Chesterman, 'R2P and humanitarian Intervention: From Apology to Utopia and Back Again', [Written for Robin Geiß & Nils Melzer (eds.), The Oxford Handbook on the International Law of Global Security (Oxford University Press, Forthcoming 2018) <https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3224116> qasur: 18 Shtator 2020.

⁸⁴⁸ Salil Shetty, Secretary General at Amnesty International, *Amnesty International Annual Report (2014/2015)* <<https://www.amnesty.org/en/latest/research/2015/02/annual-report-201415/>> qasur: 20 Shtator 2020; shih gjithashtu: Kenneth Roth, *Raporti botëror i Human Rights Watch (2017)* 1, <https://www.hrw.org/sites/default/files/world_report_download/wr2017-web.pdf> qasur: 20 Shtator 2020.

⁸⁴⁹ António Guterres, United Nations Secretary-General, *Remarks to the Human Rights Council*, (27 February 2017).

⁸⁵⁰ Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*, 3.

⁸⁵¹ Ibid 30.

të një numri faktorësh të pakontestueshëm në raport me mbështetjen e shteteve dhe thirrjet zyrtare, megjithëse me këto fakte, nuk mund të supozohet se ato “provojnë” se PpM funksionon. Sipas tij këto fakte duhet të shikohen në dritën e degjenerimit global të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur paraprakisht me ngritjen e PpM-së. Logjikisht nuk mund të thuhet se PpM ka qenë një “sukses i jashtëzakonshëm” nëse vetë problemi që u krijua për të adresuar u përkeqësua ndjeshëm. Në fund të fundit, nuk është se respekti global për të drejtat e njeriut thjesht është përmirësuar që kur PpM-ja u njoh në Samitin Botëror 2005, përkundrazi, është ulur ndjeshëm.⁸⁵² Sidoqoftë, Hehir konsideron se nuk janë skeptikët dhe kritikët ata që duhet të provojnë se këto konkluzione janë të pasakta; barra e provës u takon atyre që bëjnë pretendime për PpM-në. Sfidë nuk duhet të jetë pra “të provojë se shtetet nuk kujdesen vërtet për PpM-në”, por përkundrazi, të provojnë se: “shtetet kujdesen vërtet për PpM-në”.⁸⁵³ Pra, suksesi i PpM-së siç mbrohet nga mbështetësit e tij premtohet me përshëndetjen e një numri të shteteve që kanë shprehur mbështetjen e tyre për normën, siç ishte rasti i krijimit të një numri të “pikave fokale” nga shtetet. Megjithatë, iniciativa sigurisht nuk është mjeti i vetëm me të cilin PpM zbatohet, dhe efikasiteti i normës nuk parashikohet veçmas mbi aktivitetet e Rrjetit të Pikave Fokale të PpM- së.⁸⁵⁴ Në fund Hehir thekson se duke reflektuar në dështimet e PpM- së na takon të gjithëve të identifikojmë të paktën pse ajo ka dështuar. Nëse mësimet për dështimet e PpM-së mund të identifikohen me të vërtetë, atëherë të paktën, mund të mendojmë për hartimin e qasjeve që mund të prodhojnë rezultate më të mira. Për mendimin e Hehir PpM ka dështuar dhe ky dështim mund të jetë i dobishëm në atë masë sa të paktën të kanalizojë diç të mirë. Dhe kështu në vend se të festojmë për suksesin e PpM-së, duhet të shqyrtohet me siguri pse PpM nuk është kthyer në praktikë. Kjo mund të shpjegohet sipas argumentimit të Hehir, se PpM është në thelb i paqartë, i lakueshëm dhe një normë, sesa një përshkrim inovativ dhe i zbatueshëm ligjërisht.⁸⁵⁵

Ndërsa, përkrahësit e PpM-së, lidhur me ngecjet për moszbatim dhe zbatim jo efektiv të saj nuk e pranojnë që vet norma është e paefektshme, ose e parëndësishme, por, më shumë përgjegjësinë ia apostrofojnë veprimeve të shteteve dhe bashkësisë ndërkombëtare që duhet

⁸⁵² Ibid 48- 49.

⁸⁵³ Ibid 201.

⁸⁵⁴ Ibid 204.

⁸⁵⁵ Ibid 2016.

të veprohet më shumë në të ardhmen.⁸⁵⁶ Dispozitat e paragrafëve 138 dhe 139 të Samitit Botëror 2005 nuk sqarojnë se si aktorë të ndryshëm të bashkësisë ndërkombëtare do të bartin barrën e PpM-së. As nuk ka udhëzime se cila organizatë ose cili organ se çfarë duhet të bëjë. Profesori Gentian Zyberi konsideron se këto pasiguri kërkojnë më shumë udhëzime nga AP-ja. Për fat të keq, rastet e dështimit të zbatimit të PpM-së demonstrojnë hendekun ekzistues dhe hendekun e hasur kur bëhet fjalë për dhënien e përgjegjësisë në kohën vendimtare ndaj mizorisë. Andaj, këto raste tregojnë dështimin e bashkësisë ndërkombëtare për të mbrojtur qytetarët në raste të PpM-së. Prandaj, prof. Zyberi argumenton se ndarja e përgjegjësisë në nivel ndërkombëtar duket se shkaktoi apati institucionale, konfuzion dhe zhvendosje të barrës kur bëhet fjalë për zbatimin e PpM-së. Dhe problemet politike më shumë mund të shkaktojnë vonesë në vend se të çojnë përpara një përgjigje me kohë dhe vendimtare nga ana e mekanizmave përkatëse dhe rajonale.⁸⁵⁷

Por pavarësisht pretendimeve të bëra për statusin e saj ligjor, siç u tha edhe më sipër koncepti ka një bazë të fortë në traktate dhe në të drejtën zakonore ndërkombëtare, përkatësisht në detyrimet e të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare, disa prej të cilave sic është gjenocidi që tashmë e kanë arritur statusin ligjor të *jus cogens*. Prandaj edhe pse PpM nuk ka krijuar një normë të re, ajo thjesht ofron një platformë politike gjithëpërfshirëse, që bazohet në Kartën e OKB-së, traktatet ndërkombëtare të vendosura, të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore.⁸⁵⁸ Dështimi në zbatim nuk nënkupton edhe dështimin e normës. Më tepër tregon dobësitë që duhet të adresohen për të siguruar efektivitetin, si dhe për brendësinë e normës. Dhe në formën e tij aktuale si një normë morale, siç argumenton dhe Pinar Ercan, PpM nuk mund të kontribuojë më shumë pasi është lidhur me proceset ekzistuese burokratike nga mekanizmat e OKB-së. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të shikohet se çfarë mund të bëhet për të përmirësuar dhe për të rritur atë në një mjet efektiv për t'iu përgjigjur krimeve të mizorisë.⁸⁵⁹ Ndonëse, pranohet pothuajse nga të gjithë se PpM-ja ka dështuar për të vepruar në disa situata të krizave të mizorisë, kjo nuk nënkupton se PpM-ja ka dështuar, ashtu siç argumenton Hehier, sepse mos zbatimi i një norme të caktuar për shkak të mosveprimit nga shtetet dhe bashkësia ndërkombëtare, nuk

⁸⁵⁶ Gareth Evans, 'Interview: The R2P Balance Sheet After Libya, The Responsibility to Protect: challenges & opportunities in light of the Libyan intervention, (Edited by Alex Stark, 2011) e-International Relations, 42.

⁸⁵⁷ Gentian Zyberi, 'Sharing the responsibility to protect: taking stock and moving forward', 527.

⁸⁵⁸ Ibid 528.

⁸⁵⁹ Pinar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect*, 104.

nënkupton në vetvete dështimin e PpM-së. Duke marruar parasysh edhe përkrahjen aq të madhe nga shtetet, OKB-ja dhe organizata të tjera regjionale dhe nën-regjionale, flet për atë siç thekson edhe Ivan Šimonović, se nuk ka asnjë ide më të mirë se PpM-ja për të mbrojtur parandalimin e krimeve të mizorisë dhe nuk ka ndonjë ide tjetër që mund të gjejë një konsensus botëror dhe kjo ide ekuilibron sovranitetin dhe të drejtat e njeriut.⁸⁶⁰

⁸⁶⁰ Ivan Šimonović, 'R2P: Operationalisation or Marginalisation?', (2017) Annual Lecture- European Centre for the Responsibility to Protect, <<https://ecr2p.leeds.ac.uk/ecr2p-annual-lectures/2017-annual-lecture/>> qasur: 25 Shtator 2020.

KAPITULLI V

5. SIRIA DHE PËRGJEGJËSIA PËR TË MBROJTUR

5.1. Sfondi i konfliktit në Siri

Në vazhden e Pranverës Arabe, përveç Libisë edhe në Siri në pranverën e vitit 2011, filluan protestat kundër qeverisë së Bashar el-Assadit. Konflikti filloi kur forcat siriane të sigurisë iu përgjigjën me dhunë protestave paqësore pro-demokratike në qytetin Dar'a. Protestat u përhapën në të gjithë Sirinë, ashtu edhe reagimi i dhunshëm nga regjimi i Presidentit Assad. Ai foli kundër protestave, duke u atribuar atyre si forca imperialiste, komplotiste të brendshme dhe "banda të armatosura dhe terroriste" të vendosur për ta shkatërruar qeverinë e tij.⁸⁶¹ Ashtu si në Libi, protestuesve për rrëzimin e Assadit nga pushteti, qeveria ishte përgjigjur ashpër duke hapur zjarr ndaj tyre.⁸⁶² Lëvizja masive u zhvillua shpejtë në të gjithë vendin, megjithëse ajo ishte lëvizje e popullarizuar në vend me shumicë arabe sunite, ku më pas erdhën demonstruesit nga e gjithë Siria,⁸⁶³ dhe pavarësisht premtimeve të presidentit Assad për reforma demokratike në vend, ai u mbështet në forcat e sigurisë për të qëlluar protestuesit në mënyrë sistematike dhe për të ndaluar kundërshtarët politik. Faza tjetër, e cila ishte e dukshme nga gjysma e dytë e vitit 2011, kishte një numër të rritjes së civilëve kundër qeverisë si dhe dezertuesve nga forcat e sigurisë, duke i'u bashkuar "Ushtrisë së Sirisë së Lirë", e formuar zyrtarisht në korrik të v. 2011. Në shtator të vitit 2011 kjo ushtri luftoi një betejë të madhe kundër forcave të regjimit në Ar-Rastan dhe vazhduan në vende të tjera.⁸⁶⁴ Brenda disa muajve nga fillimi i protestave në Siri ishin raportuar se forcat Siriane kishin vrarë 3.100 protestues. Ata kanë gjymtuar dhe plagosur shumë më tepër dhe kishin arrestuar në mënyrë arbitrare mijëra qytetarë në të gjithë vendin, duke iu nënshtruar shumë prej tyre torturave në paraburgim, ndërsa numri i të vdekurve vetëm sa rritej.⁸⁶⁵ Rrethimi dhe

⁸⁶¹ E. Tendayi Achiume, 'Syria, Cost-sharing, and the Responsibility to Protect Refugees', (2015) (100)687, Minnesota Law Review, 695 [tani e tutje: E. Tendayi Achiume, 'Syria, Cost-sharing, and the Responsibility to Protect Refugees'].

⁸⁶² Amy E. Eckert, 'The Responsibility to Protect in the Anarchical Society: Power, Interest, And The Protection Of Civilians In Libya And Syria', (2012) 41(1), Denv. J. Int'l'l. & Pol'y, 89.

⁸⁶³ Simon Adams, 'Failure to Protect: Syria and the Security Council, (2015), Global Centre for the Responsibility to Protect, 6 [tani e tutje: Simon Adams, 'Failure to Protect: Syria and the Security Council'].

⁸⁶⁴ Ibid.

⁸⁶⁵ Human Rights Watch, "We Live as in War", *Crackdown on Protesters in the Governorate of Homs, Syria*, (November 2011); shih gjithashtu: Amnesty International, Annual Reprt 2012- Syria, (2012) < <https://www.refworld.org/docid/4fbc390a3e.html>> qasur: 16 Tetor 2020.

sulmet e fillim vitit 2012 mbi qytetin e Homsit përbën një fazë të re të konfliktit. Qeveria u përpoq ushtarakisht të merrte qendrat e rezistencës opozitare, e cila kontrollonte pjesën më të madhe të Homsit. Gjatë shkurtit forcat e Assadit nisën një ofensivë të madhe që përfshinte rrethimin e qytetit me bombardime të parreshtura në pjesë që konsideroheshin fortesë e rebelëve. Gjatë muajve Prill dhe maj të vitit 2012 u përdorën helikopterë për të sulmuar kundërshtarët, dhe numri i këtyre sulmeve u rrit gjatë korrikut. Po ashtu, në korrik filluan të përdoren edhe avionët luftarak. Gjatë muajit gusht regjimi i Assadit kreu më shumë se 110 sulme ajrore kundër caqeve të opozitës. Miratimi i një politike të ndëshkimit kolektiv dhe sulmeve me helikopterë dhe avionë luftarak në zona ku banonin civilët, bëri të ishin shumë të ekspozuar ndaj rrezikut edhe shkollat, spitalet etj.⁸⁶⁶ Ndërsa grupet e tjera të armatosura opozitare u sofistikun gjithnjë e më shumë në ushtrimet e tyre operacionale. Nga mesi i vitit 2012 një pjesë e fshatrave në veri dhe jug-lindje të Sirisë kishin rënë në duart e rebelëve. Rebelët kundërshtuan kontrollin qeveritar edhe në rrethinat e Damaskut dhe Alepos. Vendi tani ishte përfshirë në një luftë civile në një shkallë të gjerë.⁸⁶⁷ Siç raportonte edhe Human Rights Watch, kryengritja Siriane u kthye gjithnjë e më e përgjakshme në vitin 2012, ndërsa goditja e qeverisë ndaj protestuesve anti-qeveritar u zhvillua në një konflikt të armatosur. Forcat qeveritare dhe milicia pro-qeveritare e njohur si “Shabeeha” vazhduan të torturojnë të arrestuarit dhe të kryenin vrasje në zona të kontrollit të tyre. Gjithashtu, raportohet se edhe disa forca opozitare kanë kryer abuzime serioze, si rrëmbime, tortura dhe ekzekutime pa gjyq. Sipas burimeve të opozitës, në këtë periudhë ishin vrarë mbi 34.000 civilë. Përhapja dhe intensifikimi i luftimeve kanë çuar në një situatë të tmerrshme humanitare ku me qindra dhe mijëra civilë u zhvendosën si refugjatë në vendet fqinje.⁸⁶⁸ Vendet fqinje si: Iraku, Jordania, Libani dhe Turqia kishin hapur kufijtë për më shumë se 341.000 refugjatë sirianë.⁸⁶⁹ Konflikti i armatosur në Siri u përshkallëzua edhe më tej në vitin 2013 ndërsa qeveria intensifikoi sulmet e saj dhe filloi të përdorte armë gjithnjë e më vdekjeprurëse dhe pa kritere duke arritur në një sulm me armë kimike me 21 gusht 2013 në afërsi të Damaskut. Forcat e

⁸⁶⁶ Simon Adams, ‘Failure to Protect: Syria and the Security Council, 6; shih gjithashtu: Human Rights Whatch, (World Report 2013) *Syria*, (Events of 2012) <<https://www.hrw.org/world-report/2013/country-chapters/syria#>> qasur: 20 Tetor 2020.

⁸⁶⁷ Ibid.

⁸⁶⁸ Human Rights Whatch, (World Report 2013) *Syria*, (Events of 2012) <<https://www.hrw.org/world-report/2013/country-chapters/syria#>> qasur: 20 Tetor 2020 [tani e tutje: Human Rights Whatch, (World Report 2013)].

⁸⁶⁹ Ibid.

armatosura të opozitës, duke përfshirë një numër në rritje të luftëtarëve të huaj pro-opozitar kanë kryer abuzime serioze ndaj civilëve. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Ban Ki-Mun, deri në korrik 2013 më shumë se 100.000 njerëz ishin vrarë në këtë konflikt. Përhapja dhe intensifikimi i luftimeve kanë çuar në një krizë të tmerrshme humanitare me miliona të zhvendosur brenda vendit ose duke kërkuar strehim në vendet fqinje.⁸⁷⁰ Zyra e OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare vlerëson se 4.25 milionë Sirianë janë zhvendosur brenda vendit. Luftimet në Siri e vështirësuan edhe punën e organizatave humanitare për t'iu dalur në ndihmë të zhvendosurve, madje qeveria refuzonte vazhdimisht ndihmat të cilat vinin jashtë kufirit të shtetit. Ndërsa, 2.3 milionë ishin në pritje të regjistrimit si refugjatë nga Agjencia e OKB-së për Refugjatë.⁸⁷¹ Që nga fundi i v. 2013 Siria ka pushuar të jetë një konflikt politik, ku bëhet një luftë civile sektare e zhvilluar me pjesëmarrjen e disa luftëtarëve laikë të kërcënuar drejtpërdrejtë me selefistët në rritje midis opozitës së armatosur, ndërsa minoritetet si të krishterët dhe alevitë kryesisht iu bashkuan regjimit. Qeveria ka organizuar në mënyrë aktive një milici nga këto komunitete dhe i vendosi ata për të sulmuar komunitete fqinje sunite. Lufta civile e ktheu vendin në një copë toke e paqëndrueshme ushtarake, ku në këtë kohë askush nuk kishte sovranitet mbi Sirinë në përgjithësi. Në perëndim nga bregu i Latakisë deri në kufi me Libanin dhe në jug me Damaskun, qeveria mbante nën kontroll një të tretën e vendit. Në verilindje, kurdët etnik kanë përdorur luftën civile për të themeluar një shtet të pavarur për veten e tyre. Ndërkohë lugina e Eufratit nga veriu në jug-lindje të vendit kontrollohej nga forcat e ndryshme opozitare që shpesh e gjejnë veten e tyre duke konkurruar me njëra-tjetrën, si dhe luftimet e "Shtetit Islamik të Irakut dhe Al-Sham", (ISIL më vonë i njohur si ISIS ose IS) që deklaroi shtetin e vet që shtrihej nga kryeqyteti i tyre Al-Raqqa drejt lindjes e deri në Mosul në Irak.⁸⁷² Ky fragmentim politik kushte zhytur miliona njerëz në mjerim. Në luftën e Sirisë ishin të përfshirë edhe forca të ndryshme dhe disa shtete. Disa forca Iraniane dhe një numër i luftëtarëve të Hesbullahut nga Libani kanë luajtur një rol të rëndësishëm në pushtimin e Al-Qusayr, një qytet afër kufirit libanez, gjatë qershorit të vitit 2013. Ndërkohë Turqia, Katari dhe Arabia Saudite

⁸⁷⁰ Human Rights Watch, (World Report 2014) (Events of 2013) <<https://www.hrw.org/world-report/2014>> qasur: 26 Tetor 2020 [tani e tutje: Human Rights Watch, (World Report 2014)].

⁸⁷¹ Ibid 611- 612.

⁸⁷² Simon Adams, 'Failure to Protect: Syria and the Security Council', 6. Lidhur me termin "ISIS" dhe "ISIL", shih: Jonathan Hogeback, 'Is it ISIS or ISIL', Encyclopaedia Britannica, <<https://www.britannica.com/story/is-it-isis-or-isil>> qasur 27 Tetor 2020.

dhe prapa tyre disa demokraci të mëdha perëndimore vazhdonin të mbështesnin komponente të ndryshme të opozitës së armatosur, përfshi: “Ushtrinë e Lirë Siriane”. Megjithëse fitorja e plotë mbetej e porealizueshme, gjatë gjithë qeverisë siriane 2013 dhe 2014 forcat vazhduan të rimarrin ngadalë fshatrat e shumtë përgjatë kufiri libanez si dhe zonat përreth Alepos dhe Damaskut i kontrolluar më parë nga rebelët.⁸⁷³ Lufta civile në Siri tani kërcënonte të gjithë rajonin e Lindjes së Mesme. Në Liban, Hesbullahu dhe mbështetësit e rebelëve Sirianë kanë kryer atentate dhe kanë vendosur makina bombë kundër njëri-tjetrit. Me më shumë se një milionë refugjatë Sirianë, Libani rrezikonte të bëhej zgjerimi i fushëbetejës së Sirisë. Beteja me luftëtarë të huaj që u bashkuan së pari në radhët e saj në Siri, ISIL pushtoi qytetin e Mosulit, qytetit të dytë më të madh të Irakut, ku përparimi i madh ushtarak i ISIL në mes të vitit 2014 ishte aq i shpejtë sa që në korrik, grupi u ndje mjaft i sigurtë për të deklaruar një kalifat që përfshiu Irakun dhe Sirinë.⁸⁷⁴ ISIL vazhdonte të rrezikonte ekzistencën e Irakut. Turqia në ndërkohë ka luftuar për të parandaluar krizën siriane nga kontaminimi i politikës së vetë të brendshme. Edhe Izraeli në anën tjetër kishte shkëmbyer zjarr me forcat siriane. Kriza e Sirisë rëndoi edhe Jordanin, pasi kishte mbi gjysmë milioni refugjatë Sirian etj.⁸⁷⁵ Ky vit ishte mjaft i përgjakshëm ku milicitë qeveritare dhe pro-qeveritare intensifikuan sulmet e tyre ndaj civilëve dhe përdorën armët pa kritere. Grupet të tjera si: Shteti Islamik (ISIS, IS) dhe bashkëpunëtorët e Al-Kaidës në Siri “Jabhat Al-Nusra” ishin gjithashtu përgjegjëse për shkelje sistematike dhe të përhapur, duke përfshirë shenjëstrimin e civilëve, rrëmbimet dhe ekzekutimet. Sulme dhe bombardime ndaj popullatës civile në zona të kontrolluara nga qeveria kryheshin edhe nga grupet e tjera të armatosura jo-qeveritare. Sipas Komisionarit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut të atëhershëm, Navi Pillay, që nga gushti 2014 numri i të vdekurve ishte më shumë se 191.000 njerëz. OKB-ja vlerëson se 7.6 milionë Sirianë janë të zhvendosur brenda vendit dhe se 12.2 milionë kanë nevojë për ndihmë humanitare. Poashtu, ishin mbi 3 milionë sirianë të regjistruar ose ishin në pritje të regjistrimit si refugjatë në Agjencinë e OKB-së për Refugjatë në Liban, Jordani, Turqi, Irak dhe Egjipt. Ndërsa, një numër i refugjatëve përpiqeshin të arrijnë në Europë, përfshi përmes rrugëve të rrezikshme të kontrabandës, poashtu është rritur. Disa shtete europiane i mirëpritën ata, ndërsa disa të tjera si Greqia dhe Bullgaria, i kanë shtyrë azilkërkuesit nganjëherë me dhunë

⁸⁷³ Simon Adams, ‘Failure to Protect: Syria and the Security Council’, 6.

⁸⁷⁴ Ibid 7.

⁸⁷⁵ Ibid 8.

drejt kufijve të tyre pa i lejuar ata të paraqesin kërkesa për azil.⁸⁷⁶ Edhe në vitet në vijim dhuna vazhdoi të përshkallëzohej në Siri mes mungesës së përpjekjeve kuptimplote për t'i dhënë fund luftës dhe për të zvogëluar abuzimet. Ashtu siç qeveria Siriane dhe aleatët e saj kryenin sulme pa kritere dhe të qëllimshme dhe pa kritere ndaj civilëve, poashtu edhe grupet e armatosura jo-qeveritare vazhdonin të kryenin krime duke përfshirë sulme ndaj civilëve dhe duke rritur numrin e vdekjeve, të zhvendosurve dhe rritjen e numrit të refugjatëve sirianë.⁸⁷⁷

Në vitin 2018 qeveria Siriane përsëri kishte përdorur armët kimike ndaj civilëve. Sipas Human Rights Watch dhe organizatave të tjera të pavarura midis viteve 2013-2018 janë përdorur të paktën 85 sulme me armë kimike, shumica e kryer nga forcat e qeverisë Siriane.⁸⁷⁸ Pas sulmeve kimike në Douma dhe Ghouta Lindore, u bënë përpjekje të reja ndërkombëtare

⁸⁷⁶ Human Rights Watch, (World Report 2015) *Syria*, (Events of 2014) qasur në: <https://www.hrw.org/world-report/2015/country-chapters/syria> qasur: 30 Tetor 2020 [tani e tutje: Human Rights Watch, (World Report 2015) *Syria*]. I ashtu- quajtur shteti Islamik (IS) kishte përfituar nga kaosi dhe ka marrë nën kontrollin e zonave të mëdha të Sirisë dhe Irakut, ku shpalli krijimin e një "kalifati" në qershor 2014. Shumë luftëtarë të huaj janë përfshirë "në luftë brenda një lufte" në Siri, duke luftuar rebelët dhe xhihadistët rivalë nga fronti Nusra e lidhur me Al- Kaidën, si dhe me forcat qeveritare dhe kurdë. Në shtator të vitit 2014, një koalicion i udhëhequr nga SHBA filloi sulmet ajrore brenda Sirisë në një përpjekje për "të degraduar dhe shkatërruar përfundimisht" Shtetin Islamik, duke shmangur sulmet që mund të përfitojnë forcat e Asadit. Gjithashtu, edhe Rusia kishte filluar një fushatë ajrore që synonte "terroristët" në Siri një vit më vonë, të cilët nga aktivistët e opozitistë u konsideruan si sulme të cilat kryesisht kishin grarë rebelë dhe civilë të mbështetur nga perëndimi. Në arenën politike grupet opozitare ishin gjithashtu të ndara thellë, me aleanca rivale që luftonin për epërsi. Më i spikatur është Koalicioni Kombëtar për Forcat Revolucionare dhe të Forcave Opozitare, mbështetur nga disa shtete perendimore dhe shtete arabe të gjirit, shih: BBC, 'Syria the Story of the Conflict,' (BBC 11 March 2016) <<https://www.bbc.com/news/world-middle-east-26116868>> qasur: 31 Tetor 2020.

⁸⁷⁷ Human Rights Watch (Report 2016) *Syria* (Events of 2015) <<https://www.hrw.org/world-report/2016/country-chapters/syria>> qasur: 2 Nëntor 2020 [tani e tutje: Human Rights Watch (Report 2016) *Syria*]. Konflikti në Siri kishte hyrë në vitin e tij të pestë duke përfaqësuar një sfidë gjithnjë e më komplekse globale me shvendosje të paparë në rajon dhe rritje të nevojave të refugjatëve. Mbi 3.9 milion refugjatë kanë kërkuar strehë në vendet fqinje dhe Afrikën Veriore. Përveq kësaj, më shumë se 200,000 sirianë kanë kërkuar azil të Europë. Më shumë se 1.19 milion refugjatë Sirian ishin të vendosur në Liban. Një numër i madhe ishin i vendosur në Turqi dhe vende tjera, shih: UN High Commissioner for Refugees (UNHCR), *Inter-Agency Regional Update-Syrian Refugees*, (6 April 2015) <<https://www.refworld.org/docid/5566e97c4.html>> qasur: - 03 Nëntor 2020. Një numër i madhe i refugjatëve kalonin nga Greqia në Europë, ku fluksi i emigrantëve kishte mbingarkuar autoritetet veriore dhe Europën Veriore ku ishin të vendosur shumica e azilkërkuesve. Udhëheqësit e Bashkimit Europian në Bruksel ranë dakord të krijojnë qendra pritjeje në Greqi dhe përgjatë rrugës së ashtuquajtur Ballkanike në Europë për të përpunuar dhe mbajtur deri në 100,000 azilkërkues, shih: Kareem Fahim and Maher Samaan, 'Violence in Syria Spurs a Huge Surge in Civilian Flight', (Oct. 26, 2015), UN Migration IOM, 'Greece Records Highest Weekly Migration Inflows in 2015 So Far' (2015). Deri në vitin 2017 sipas raportimeve të OKB- së lufta ka shtyer që afër pesë milion njerëz të largohen nga vendi, shumë prej të cilëve kanë rrezikuar jetën e tyre duke kërkuar një vend të sigurtë në Europë, ndërsa qindra e mijra të tjerë qëndronin të pasigurtë në qadra dhe strehimore në vende fqinje të Sirisë. Ndërsa brenda Sirisë, infrastruktura themelore, si rrjeti elektrik, linjat e ujit dhe rrugët ishin nën rrënoja, shih: Dylan Collins 'Worst man-made disaster since World War II' *Aljazeera*, Syria wae (5 Mar 2017). Ndërsa mbi 400.000 mijë njerëz kishin vdekur, shih: Human Rights Watch (Report 2018) *Syria* (Events of 2017) <<https://www.hrw.org/world-report/2018/country-chapters/syria>> qasur: 04 Nëntor 2020 [tani e tutje: Human Rights Watch (Report 2018) *Syria*].

⁸⁷⁸ Human Rights Watch Report 2019: Syria, Events of 2018, qasur në: <<https://www.hrw.org/world-report/2019/country-chapters/syria>> qasur: 25 Nëntor 2020 [tani e tutje: 'Human Rights Watch Report 2019: Syria, Events of 2018'].

për të parandaluar përdorimin e armëve kimike, edhe pse ishte mohuar nga qeveria Siriane dhe aleati i saj Rusia.⁸⁷⁹ Qeveria e Assadit e ndihmuar nga Rusia dhe Irani rimorrën zonat në Ghouta Lindore dhe afër Damaskut. Qeveria këtu përdori taktika të paligjshme dhe armë të ndaluara, sulme pa kritere, madje edhe ndalimin e ndihmave humanitare me qëllim që t'i detyrojë grupet anti-qeveritare të dorëzoheshin në këto zona, duke rezultuar me zhvendosje masive. Edhe grupet e armatosura anti-qeveritare sulmuan në zonat e kontrolluara nga qeveria të cilat pamundësuan aftësinë e civilëve për t'u larguar nga lufta. Në zonat e marra nga IS numri i lartë i viktimave civile u bë i qartë. Minat e vendosura nga IS para se të arratiseshin, vazhduan të vrisnin dhe gjymtonin civilë. Partnerët e IS dhe Al-Kaidas vazhdonin të kryenin abuzime, duke filluar nga ekzekutimet, rrëmbimet deri të ndërhyrjet në shpërndarjen e ndihmave. Observatori Sirian për të Drejtat e Njeriut, një grup vëzhgimi me qendër në Mbretëri të Bashkuar, vlerësoi se numri i të vdekurve që nga fillimi ishte 511.000. Vitet e luftës së pamëshirshme lanë 6.6 milionë të zhvendosur dhe 5.6 milionë refugjatë në të gjithë botën, sipas KLKBR-së.⁸⁸⁰ Ndërsa në vitin 2019 ngjarjet në Siri sipas Human Rights Watch, përforcuan konstatimin se mizoritë dhe shkeljet e të drejtave të njeriut që karakterizuan konfliktin vazhdojnë të jenë rregull, e jo përjashtim. Aleanca ushtarake siriano-ruse në prill rifilluan operacionet ushtarake në Iblid, vendi i fundit anti-qeveritar, duke përdorur armë pa kritere dhe armë të ndaluara. Ata ndërmorrën me qindra sulme ditore për t'i rikthyer zonat të cilat ishin në kontroll të grupeve kundër-qeveritare, duke përdorur armë të ndaluara, duke sulmuar shkolla dhe spitale dhe me qindra e mijëra civilë të vdekur. Mbi 11 milionë njerëz kishin nevojë për ndihmë humanitare dhe mbrojtje. Ndërsa në veri-lindje të Sirisë, një numër i civilëve mbeti i vrarë si rezultat i koalicionit të SHBA-së dhe aleatit lokal Forcat Demokratike të Sirisë, si dhe gjithashtu një shkallë e shkatërrimit dhe humbjes së jetës së personave civilë në zonat e kontrolluara nga IS, që tregon dështimin për të ndërmarrë masa për mbrojtjen e civilëve. Fati i mijëra personave të rrëmbyer nga IS mbeti i panjohur. Sulmet intensive ajrore të aleatëve me në krye me SHBA sollën shkatërrimin territorial të IS. Ndërsa edhe Turqia në nëntor ndërmorri një operacion ushtarak në veri-lindje të Sirisë. Së bashku me forcat opozitare, përfshi Ushtrinë Kombëtare Siriane, mbështetën operacionin e quajtur

⁸⁷⁹ News Wires, 'Syria May have used chemical weapons in 2018, says watchdog', *France 24* (2021) <<https://www.france24.com/en/middle-east/20210412-syria-may-have-used-chemical-weapons-on-town-in-2018-says-watchdog>> qasur: 27 Nëntor 2020.

⁸⁸⁰ 'Human Rights Watch Report 2019: Syria, Events of 2018'.

“Operacioni Pranvera e Paqes”. Këto operacione kishin zhvendosur një numër të madh të personave në zona më të sigurta. Ndonëse numri i refugjatëve sirianë ishte shumë i madh, një numër prej 40.000 personash janë kthyer në vend nga mesi i vitit 2019.⁸⁸¹

Edhe në vitin pasues forcat e koalicionit Ruso-Sirian vazhduan sulmet ku për objektiv kishin civilët, sulmet kryheshin në shkolla, spitale, shtëpi etj. Krime po ashtu u kryen edhe nga grupet anti-qeveritare në vend. Në vend ishin ende 6.1 milionë të zhvendosur.⁸⁸² Kriza e refugjatëve Sirianë konsiderohet si më e madhja pas Luftës së Dytë Botërore.⁸⁸³ Edhe në kohën kur po e shkruajmë këtë disertacion të doktoratës, sipas të dhënave të KLKBR-së janë rreth 3.4 milionë persona të cilët kanë nevojë për ndihmë humanitare, 6.7 milionë të zhvendosur dhe 6.6 milionë refugjatë sirianë në të gjithë botën, nga të cilët 5.6 milionë janë të vendosur në shtetet fqinje të Sirisë.⁸⁸⁴

5.2. Përgjegjësia ndërkombëtare në krizën e Sirisë

Në përgjigje të situatës në Siri që nga fillimi i konfliktit kishin filluar edhe reagimet ndërkombëtare nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare. SHBA-ja dhe BE-ja kanë vendosur sanksione kundër civilëve dhe ndërmarrjeve, duke përfshirë ngrirjen e aseteve kundër zyrtarëve të lartë të qeverisë dhe atyre ushtarak, zyrtarë dhe biznese që ndihmonin qeverinë.⁸⁸⁵ Po ashtu Parlamenti Europian kishte miratuar një rezolutë e cila dënonte ashpër përdorimin e tepruar të forcës ndaj protestuesve paqësor.⁸⁸⁶ Një numër shtetesh Arabe u bashkuan në dënimin dhe shtypjen në Siri. Në gusht të vitit 2011 Arabia Saudite, Bahrejni, Kuvajti dhe Tunizia tërhoqën ambasadorët nga Damasku për konsultime. Turqia si një partner

⁸⁸¹ Human Rights Watch (Report 2020) *Syria* (Events of 2019) <<https://www.hrw.org/world-report/2020/country-chapters/syria>> qasur: 30 Nëntor 2020 [tani e tutje: Human Rights Watch (Report 2020) *Syria*].

⁸⁸² Human Rights Watch (Report 2021) *Syria* (Events of 2020) qasur në: <<https://www.hrw.org/world-report/2021/country-chapters/syria>> qasur: 2 Shkur 2021 [tani e tutje: Human Rights Watch (Report 2021) *Syria*].

⁸⁸³ E. Tendayi Achiume, ‘Syria, Cost-sharing, and the Responsibility to Protect Refugees’, 688.

⁸⁸⁴ The UN Refugee Agency, ‘Syria emergency’, (2021) <<https://www.unhcr.org/syria-emergency.html>> 3 Mars 2021.

⁸⁸⁵ Human Rights Watch, (World Report 2012) (Events of 2011) <<https://www.hrw.org/world-report/2012/country-chapters/syria>> qasur: 30 Tetor 2020 [tani e tutje: ‘Human Rights Watch, World Report 2012’].

⁸⁸⁶ European Parliament, P7_TA(2011)0333, (7 July 2011) shih gjithashtu: European Parliament, P7_TA(2011)0387, (15 September 2011).

tregtar, dënoi vazhdimisht sulmet Siriane.⁸⁸⁷ Në gusht KS-ja miratoi unanimisht një Deklaratë Presidenciale me të cilën “dënonte përhapjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut për përdorimin e forcës kundër civilëve nga autoritetet Siriane”.⁸⁸⁸ Ndërsa Këshilli për të Drejtat e Njeriut dënoi dhunën “kundër protestuesve paqësor” nga qeveria Siriane, duke kërkuar përfundimin e “dhunës dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, të mbrojtë popullatën e vet dhe të mbrojtë plotësisht të drejtat dhe liritë themelore”.⁸⁸⁹ Këshilli kështu themeloi Komisionin Ndërkombëtar për Hetime në Siri, me mandat për të hetuar të gjitha shkeljet e pretenduara të së drejtës ndërkombëtare dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.⁸⁹⁰ Ndërsa AP-ja në dhjetor të vitit 2011, me një rezolutë dënoi dhunën e autoriteteve Siriane ndaj popullatës civile dhe përkrahu zbatimin e një iniciative për një plan të veprimit të miratuar nga Liga Arabe në Nëntor.⁸⁹¹

Kështu, Liga Arabe e suspendoi Sirinë nga anëtarësia e kësaj Lige dhe e akuzoi presidentin Bashar Assad për sfidimin e një marrëveshje të paqes dhe për të ndaluar shtypjen e dhunshme ndaj protestuesve.⁸⁹² Liga Arabe kishte kërkuar që KS-ja të miratojë një rezolutë për situatën në Siri⁸⁹³ dhe më 4 shkurt 2012 një draft-rezolutë e paraqitur në KS që do të dënonte dhunën në Siri dhe një tranzicion politik në vend, nuk kaloi pasi u përdor veto nga Kina dhe Rusia.⁸⁹⁴ Që nga fillimi edhe AP shprehu keqardhje pas dështimit të KS-së për të vepruar në situatën

⁸⁸⁷ ‘Human Rights Watch, World Report 2012’.

⁸⁸⁸ UN Security Council 6598th meeting, S/PV.6598, (3 August 2011).

⁸⁸⁹ The Human Rights Council, ‘Situation of human rights in the Syrian Arab Republic’, Resolution adopted by the Human Rights Council at its seventeenth special session, S-17/1, (2011), para. 1.

⁸⁹⁰ Ibid, para. 13; shih gjithashtu: UN, A/HRC/S-17/2 (18 October 2011). Komisioni me 23 Nëntor 2011, kishte paraqitur raportin e parë, duke gjetur se “shkelje të rënda të drejtave të njeriut ishin kryer nga qeveria Siriane nga fillimi i protestave në Mars të vitit 2011”, shih: UN, A/HRC/S-17/2/Add.1, (23 November 2011). Që nga ky raport deri në vitin 2020 ishin miratuar gjithsej, 21 raporte të këtij komisioni për hetimet dhe të gjeturat nga shkeljet e kryara gjat gjithë këtyre viteve në Siri, shih: United Nations Human Rights Council, ‘Independent International Commission of Inquiry on the Syrian Arab Republic’, <<https://ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/IICISyria/Pages/Documentation.aspx>> qasur: 2 Mars 2021.

⁸⁹¹ UN, A/RES/66/176, (19 December 2011).

⁸⁹² Neil MacFarquhar, ‘Arab League Voted to Suspend Syria Over Crackdown’, The New York Times, (Nov. 12, 2011) <<https://www.nytimes.com/2011/11/13/world/middleeast/arab-league-votes-to-suspend-syria-over-its-crackdown-on-protesters.html>> qasur: 10 Mars 2021, shih gjithashtu: Neil MacFarquhar & Nada Bakri, ‘Arab League Says Syria Accepts Its Plan for Talks; Protesters Are Skeptical’, N.Y. TIMES, (Nov. 2, 2011) <<https://www.nytimes.com/2011/11/03/world/middleeast/arab-league-says-syria-accepts-plan-for-talks.html>> qasur: 11 Mars 2021. Edhe Organizata për Bashkëpunim Islamik, e suspendoi Sirinë nga anëtarësimi në gusht 2012. Sipas Sekretarit Ekmeleddin Ihsanoglu “Lëvizja e organizatës i dërgon një mesazh Presidentit Sirian Bashar al-Asad se anëtarët e saj nuk do të pranojnë që regjimi të vrasë njerëzit e saj”, shih: Salma Abdelaziz, Nick Paton-Walsh and Joe Sterling, ‘Organization of Islamic Cooperation suspends Syria’, CNN (August 16, 2012) <<https://www.nytimes.com/2011/11/03/world/middleeast/arab-league-says-syria-accepts-plan-for-talks.html>> qasur: 10 Mars 2021.

⁸⁹³ UN Security Council, 6710th meeting Tuesday, S/PV.6710, (31 January 2012).

⁸⁹⁴ UN Security Council 6711th meeting Saturday, S/PV.6711 (4 February 2012).

në Siri.⁸⁹⁵ Ndërkaq, për shkak të situatës që përkeqësohej në Siri, Liga Arabe së bashku me OKB-në caktuan të Dërguarin e tyre të përbashkët Kofi Annan. Ndërsa, KS-ja me një deklaratë presidenciale kishte bërë të ditur se Qeveria Siriane ishte e vendosur të respektonte një propozim gjashtë-pikësh të të Dërguarit special Annan.⁸⁹⁶

Sidoqoftë, disa ditë para armëpushimit që parashihej me propozimin e Annan, forcat Siriane intensifikuan sulmet e tyre dhe për këtë gjë KS lëshoi një deklaratë tjetër presidenciale me të cilën shpreh shqetësimin për përkeqësimin e situatës në Siri.⁸⁹⁷ Më 12 prill, dhuna u zvogëlua përkohësisht në të gjithë Sirinë ndërsa forcat qeveritare dhe rebelët e armatosur vazhduan armëpushimin.⁸⁹⁸ Vetëm dy ditë më vonë KS-ja miratoi Rezolutën e parë që nga fillimi i konfliktit në Siri me të cilën caktoi një mision prej 30 vëzhguesve.⁸⁹⁹ KS më pas, më 21 prill kishte themeluar Misionin e OKB-së për Mbikëqyrje në Siri (MMOKBS) me mision 90 ditor i përbërë nga 300 vëzhgues të paarmatosur, të cilët do të mbikëqyrnin planin e Armëpushimit të Annan.⁹⁰⁰ Masat e ndërmarra nga MMOKBS dukej se në fillim kishin një efekt zbutës ndaj dhunës në zonat vëzhguese të misionit. Sidoqoftë, dhuna e ndërprerë u mbajt vetëm shkurtimisht. Kjo pasi që java e dytë e majit kishte një armiqësi të papërmbajtur në rritje. Niveli i dhunës i bënte aktivitetet e zbatimit të mandatit të MMOKBS-së të paqëndrueshme dhe më 15 qershor, misioni pezulloi operacionet e tij vëzhguese, ku vëzhguesit e misionit kishin një angazhim shumë të kufizuar.⁹⁰¹ Më 20 korrik KS-ja ia vazhdoi mandatin MMOKBS për një periudhë shtesë 30 ditore, duke marrë parasysh rekomandimet e Sekretarit të Përgjithshëm, për të rikonfiguruar misionin dhe marrjen parasysh implikimet operationale të situatës gjithnjë e më të rrezikshme të situatës në Siri.⁹⁰² Ndonëse kërkesat e KS nuk ishin plotësuar, misioni MMOKBS e kishte përfunduar mandatin me 19 gusht 2012,⁹⁰³ kur edhe Annan dha

⁸⁹⁵ UN, A/RES/66/253 B, (7 August 2012).

⁸⁹⁶ UN Security Council, S/PRST/2012/10, (5 April 2012). Armëpushimi ishte pjesa qendrore e këtij plani të paqes së dërguarit special Kofi Annan, i cili i'u paraqit Presidentit Assad, në 10 Mars dhe u pranua nga ai me 27 Mars, shih: Reuters, Text of Annan's six-point peace plan for Syria, APRIL 4, 2012, qasur në: <<https://www.reuters.com/article/us-syria-ceasefire-idUSBRE8330HJ20120404>> qasur: 13 Mars 2020.

⁸⁹⁷ UN Security Council, S/PRST/2012/6*, (21 March 2012).

⁸⁹⁸ Simon Adams, 'Failure to Protect: Syria and the Security Council', 12.

⁸⁹⁹ UN, S/RES/2042 2012, (14 April 2012).

⁹⁰⁰ UN, S/RES/2043 2012, (21 April 2012) para. 5- 6.

⁹⁰¹ United Nations Supervision Mission in Syria, 'UNAMIS Background' (2012), qasur në: <<https://peacekeeping.un.org/en/mission/past/unsmis/background.shtml>> qasur 15 Mars 2020 [tani e tutje: United Nations Supervision Mission in Syria].

⁹⁰² UN, S/RES/2059 2012, (20 July 2012) para. 1; shih gjithashtu: Report of the Secretary-General on the implementation of Security Council resolution 2043 (2012), UN Security Council, S/2012/523, (6 July 2012).

⁹⁰³ United Nations Supervision Mission in Syria.

dorëheqje si i Dërguar special. Ndërsa, në shtator diplomati Lakhdar Brahimi mori detyrën nga Annan si i Dërguar special. Përpjekje u bënë gjithashtu, edhe jashtë OKB-së për të kërkuar një zgjidhje të negociuar të konfliktit dhe për të bërë presion shtesë mbi qeverinë Siriane përfshi përmes krijimit të një grupi të kontaktit: “Miq të Sirisë”.⁹⁰⁴ Kofi Annan në kohën sa ishte i Dërguar special, u takua në Gjenevë me ministrat e punëve të jashtme, përfshi edhe pesë shtetet e përhershme anëtare në KS, për të diskutuar lidhur me procesin politik dhe tranzicionin në Siri, por, pa e bërë të qartë nëse Assad do të përjashtohej. Në vend të kësaj, ata së bashku bënë presion mbi qeverinë dhe grupet opozitare të caktojnë përfaqësuesit për diskutime.⁹⁰⁵

Shtetet ishin të ndara në lidhje me situatën në Siri. Kanadaja, Bashkimi Europian, Zvicra, Turqia, dhe Shtetet e Bashkuara zbatuan sanksione ndaj individëve dhe kompanive të përfshira në abuzime të të drejtave të njeriut dhe zyrtarëve të lartë. Importet Siriane të naftës dhe armëve ishin gjithashtu të ndaluara. Ndërsa, qeveria Kineze, Iraniane dhe Ruse vazhduan të mbështesnin qeverinë Siriane në mënyrë diplomatike ose përmes mbështetjes financiare dhe ushtarake. Ndërsa, sipas opozitës siriane dhe raportimeve të ndryshme, grupet e armatosura të opozitës në Siri, gjithashtu morën mbështetje financiare dhe ushtarake nga Katari, Arabia Saudite, Turqia, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA.⁹⁰⁶

Situata në Siri ishte mjaft e rëndë, kur më 21 gusht 2013 Qeveria Siriane kishte përdorur armët kimike në Ghouta. Sulmi vrau qindra civilë përfshi edhe një numër të madh të fëmijëve.⁹⁰⁷ Pas përdorimit të armëve kimike, në takimin e Gjenevës në shtator përfaqësuesit e SHBA-së dhe Rusisë arritën një marrëveshje për çarmatimin e armëve kimike të Sirisë.⁹⁰⁸ SHBA-ja dhe Britania e Madhe kërcënuan Sirinë me “përgjigje serioze” në rast se do të dilte që në Siri janë përdorur armët kimike.⁹⁰⁹ Edhe pse qëllimi i tyre ishte fillimi i sulmeve ajrore në Siri pas situatës së krijuar, qeveria britanike nuk arriti ta merrte pëlqimin e Parlamentit

⁹⁰⁴ Human Rights Watch, (World Report 2013).

⁹⁰⁵ Karen DeYoung, ‘Syria Conference fails to specify plan for Assad’, *The Washington Post*, (June 30, 2012) <https://www.washingtonpost.com/world/national-security/syria-conference-fails-to-specify-plan-for-assad/2012/06/30/gJQAsPfeEW_story.html> qasur: 15 Prill 2021.

⁹⁰⁶ Human Rights Watch, (World Report 2013).

⁹⁰⁷ Human Rights Watch, ‘Attacks on Ghouta’, Analysis of A llegend Use of Chimical Wapons in Syria, (September 10 2013) <<https://www.hrw.org/report/2013/09/10/attacks-ghouta/analysis-alleged-use-chemical-weapons-syria>> qasur: 20 Mars 2021.

⁹⁰⁸ James Robbins, ‘US and Russia agree Syria chemical weapons deal in Geneva’, *BBC* (14 September 2013) <<https://www.bbc.com/news/av/world-middle-east-24090056>> qasur: 20 Mars 2021.

⁹⁰⁹ ‘Syria: Cameron and Obama threaten ‘serious response’, *BBC* (25 August 2013) qasur: <<https://www.bbc.com/news/uk-23830590>> qasur: 22 Mars 2020.

Britanik për veprime ushtarake kundër regjimit të Assad-it për të parandaluar përdorimin e armëve kimike.⁹¹⁰ Qeveria e Britanisë gjithashtu, kishte kërkuar edhe nga KS-ja të miratojë një rezolutë në bazë të kapitullit të VII-të e cila do ta ndalonte përdorimin e armëve kimike nga autoritetet siriane; që autoritetet siriane të respektojnë me përpikmëri të drejtën ndërkombëtare dhe rezolutat e mëparshme të KS-së; dhe të autorizojnë vendet anëtare të marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e armëve kimike në të ardhmen. Madje qeveria britanike konsideronte se nëse KS-ja bllokohet, Britania e Madhe do të lejë të veprohet që të ndërmerren masat e jashtëzakonshme në mënyrë që të lehtësojnë shkallën e krizës Siriane, nën doktrinën e ndërhyrjes humanitare.⁹¹¹ Edhe Presidenti i SHBA-së Barak Husein Obama ishte i vendosur se duhej të ndërhyhet në Siri, por se duhej të merrej pëlqimi paraprak nga Kongresi Amerikan⁹¹², mirëpo, kjo gjë nuk u arrit. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së bëri thirrje që sa më shpejtë KS të miratojë një rezolutë për armët kimike në Siri.⁹¹³ Në lidhje me përdorimin e armëve kimike KS në shtator ra dakord që të miratojë unanimisht Rezolutën 2118 me të cilën kërkoi verifikimin dhe shkatërrimin e rezervave të armëve kimike në Siri dhe bëri thirrje për bisedime të paqes në Gjeneva II, ku e obligoi Sirinë të bashkëpunojë me Organizatën për Parandalimin e Armëve Kimike.⁹¹⁴

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, kundërshtimi rus dhe kinez përjashtoi KS-në që t'i referonte situatën GJNP-së duke penguar dhënien e përgjegjësisë për shkeljet në konflikt.⁹¹⁵ Ndërsa AP-ja përsëri miratoi një rezolutë që dënonte dhunën në Siri dhe e nxiti KS-në të ndërmerren masa dhe të përfundojë dhuna në Siri.⁹¹⁶ Vazhdimisht kërkohet referimi i situatës Siriane në GJPN. Rreth 64 shtete kërkuar nga KS-ja përfshi edhe disa shtete anëtare të KS-së, gjithashtu Franca paraqiti një draft-rezolutë në KS, për referimin e situatës Siriane në GJNP për shkak të përdorimit të armëve kimike në Siri, por një referencë e tillë ishte larguar gjatë

⁹¹⁰ 'Syria crisis: Cameron loses Commons vote on Syria action', *BBC News* B30 August 2013, <<https://www.bbc.com/news/uk-politics-23892783>> qasur: 24 Mars 2021.

⁹¹¹ UK Government, 'Chemical Wapons use by Syrian Regime', (UK Government Legal position, 2013) para. 3- 4, <<https://www.gov.uk/government/publications/chemical-weapon-use-by-syrian-regime-uk-government-legal-position/chemical-weapon-use-by-syrian-regime-uk-government-legal-position-html-version>> qasur: 6 Mars 2021.

⁹¹² Paul Lewis, 'US attack on Syria delayed after surprise U-turn from Obama', *The Guardian* (31 August 2013) <<https://www.theguardian.com/world/2013/aug/31/syrian-air-strikes-obama-congress>> qasur: 24 Mars 2021.

⁹¹³ Paul Kawika Martin, 'Un General Secretary Ban Ki-Moon: 9/24/13 General Assembly Speech', (September 24, 2013).

⁹¹⁴ UN, S/RES/2118 2013, (27 September 2013) para. 3- 13, 17.

⁹¹⁵ Human Rights Whatch, (World Report 2014).

⁹¹⁶ UN, A/RES/68/182, (2014) para 3- 4, 12.

diskutimit të tekstit, pasi as Kina dhe as SHBA nuk shprehën mbështetje për një referim në GJNP. Ndërsa, Rusia konsideroi se referimi i rastit në GJNP është në kohë të keqe dhe kundër produktive.⁹¹⁷ Opozita Siriane nën ombrellën e Koalicionit Kombëtar të forcave Revolucionare vazhdonte të fitojë mbështetje dhe njohje si përfaqësues legjitim të popullit Sirian, mirëpo pavarësisht kësaj, koalicioni nuk arriti të krijojë një opozitë të unifikuar politike dhe ushtarake. Grupet e armatosura të opozitës siriane merrnin mbështetje nga: Arabia Saudite, Katari, SHBA, Britania, Franca, ndërsa qeveria siriane vazhdonte të mbështetej nga Rusia dhe Kina. BE-ja ishte donatori i dytë më i madh, pas SHBA-së, për krizën humanitare në Siri. Por, përkundër angazhimeve të BE-së për GJNP dhe krimet e rënda që kryheshin në Siri, përfaqësuesi i lartë i BE-së dështoi për të siguruar një zë dhe strategji të fortë të BE-së që do të çonte përpara shanset që të sjellë krimet e kryera në Siri para GJNP-së.⁹¹⁸

Në Janar të vitit 2014 ishte mbajtur: “Gjeneva II”, për të gjetur një zgjidhje për situatën në Siri,⁹¹⁹ por e cila nuk rezultoi të ishte e suksesshme për zgjidhjen e krizës.⁹²⁰ Edhe përpjekjet ndërkombëtare për të çuar para drejtësinë për krimet e kryera në Siri, gjithashtu nuk ishin të suksesshme. Kështu, në maj të vitit 2014 Kina dhe Rusia përdorën veto ndaj një Rezolute të KS-së, e cila do ta referonte Sirinë në GJNP.⁹²¹ Mirëpo, në shkurt KS-ja kishte arritur të miratojë një rezolutë e cila kërkonte nga të gjitha palët, veçanërisht nga autoritetet siriane, që të lejojnë ndërhyrjen e ndihmave humanitare në Siri, përtej vijave të konfliktit.⁹²² Përsëri në Korrik, KS-ja miraton një rezolutë tjetër e cila e autorizoi ndërhyrjen ndërkufitare për OKB-në dhe partnerët e saj për të ofruar ndihmën humanitare në Siri pa miratimin e shtetit dhe krijoi një mekanizëm monitorimi për 180 ditë.⁹²³ Në shtator KS-ja zgjeroi luftën kundër terrorizmit dhe obligoi shtetet të ndërmerrnin masa që t’i përgjigjeshin kërcënimeve ndaj luftëtarëve të huaj.⁹²⁴ Për t’iu përgjigjur dhunës dhe kërcënimit të organizatave terroriste në Siri, SHBA dhe pesë shtetet aleate arabe, jashtë autorizimit të KS-së, filluan disa sulme ndaj IS

⁹¹⁷ Human Rights Watch, (World Report 2014). Ndërsa në fillim të vitit 2014 edhe Këshilli për të Drejtat e Njeriut, nga Raporti i Komisionit Hetimor për Sirinë, rekomandoi KS- në që të referojë raste në GJNP, shih: UN, A/HRC/25/65, (12 February 2014) para. 163.

⁹¹⁸ Ibid.

⁹¹⁹ ‘What is the Geneva II conference on Syria?’, BBC (22 January 2014) <<https://www.bbc.com/news/world-middle-east-24628442>> qasur 27 Mars 2021.

⁹²⁰ Human Rights Watch, (World Report 2015).

⁹²¹ UN Security Council, 7180th meeting, S/PV.7180, (22 May 2014).

⁹²² UN, S/RES/2139 2014, (22 February 2014) para. 7.

⁹²³ UN, S/RES/2165 2014, (14 July 2014), para. 2- 5.

⁹²⁴ UN, S/RES/2170 2014, (15 August 2014); shih gjithashtu: UN, S/RES/2178 2014, (24 September 2014).

në Siri dhe në Irak. Ata gjithashtu sulmuan edhe disa veteranë të Al-Kaidas të quajtur si: “Khorasan”.⁹²⁵ Shtetet si: Kuvajti, Katari, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë ndërmarrë masa për të ndaluar individët të cilët financonin IS dhe Jabhat Al-Nusra dhe ndaj personave që shkojnë për të luftuar për këto organizata terroriste.⁹²⁶

Në vitin 2015 dhuna vazhdoi të përshkallëzohej brenda Sirisë mes mungesës së përpjekjeve kuptimplota për t’i dhënë fund krizës ose për të zvogëluar abuzimet në vend.⁹²⁷ Gjatë këtyre viteve ishin miratuar rezoluta të ndryshme në OKB⁹²⁸ ndërsa, përsëri disa përpjekje serioze për miratimin e Rezolutave në KS, si më parë u bllokuan me veto nga KS-ja,⁹²⁹ deri sa situata humanitare ishte e përkeqësuar, dhe u bënë përpjekje nga Rusia, SHBA-ja dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë për të arritur një zgjidhje politike gjatë takimeve në Vjenë, por që nuk arritën të ndalnin në mënyrë të konsiderueshme shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.⁹³⁰ Përveç bllokimit të vazhdueshëm në KS për të frenuar shkeljet nga qeveria Siriane, Rusia së bashku me qeverinë Iraniane, vazhduan t’i sigurojnë qeverisë siriane ndihmë ushtarake, madje duke filluar sulme të përbashkëta ajrore me forcat qeveritare Siriane me qëllimin se po targetonin vetëm vendet e IS, por në fakt ata po godisnin edhe

⁹²⁵ ‘Syria: US begins air strikes on Islamic State targets’, *BBC* (23 September 2014) <<https://www.bbc.com/news/world-middle-east-29321136>> qasur: 2 Prill 2021. Qeveria Britanike gjithashtu, kishte arritur ta mirrte miratimin në Parlament, për të sulmuar në Siri dhe në Irak kundër IS. Sidoqoftë, zëdhënësi zyrtar i kryeministrit theksoi që trupat nuk do të ishin në një rol luftarak por do të përdoren për të drejtuar sulmet ajrore nga luftëtarët RAF dhe, ndoshta, për të trajnuar forcat Irakiane dhe Kurde të peshmergeve, megjithëse kjo mund të ndodhë në vendet fqinje, shih: ‘Cameron: IS threat may require Syria intervention’, *BBC News* (26 September 2014) <<https://www.bbc.com/news/uk-politics-29366007>> qasur: 2 Prill 2021.

⁹²⁶ Human Rights Watch, (World Report 2015) *Syria*.

⁹²⁷ Human Rights Watch (Report 2016) *Syria*.

⁹²⁸ UN, S/RES/2199, (12 February 2015); shih gjithashtu: S/Res/2209, 6 March 2015, S/Res/2235, 7 August 2015, S/Res/2249, 20 November 2015, S/Res/2258, 22 December 2015, S/Res/2268, 26 February 2016, S/Res/2314, 31 October 2016, S/Res/2319, 17 November 2016, S/Res/2328, 19 December 2016; A/Res/71/130, 9 December 2016. Ap- ja me Rezolutën A/Res/71/248, Në Dhjetor 2016 e themeloi “Mekanizmin e Pavarur dhe të pa anshëm” për të ndihmuar në hetimin dhe ndjekjen penale të atyre që janë përgjegjës për krime të rënda të kryera në Siri, shih: UN, General Assembly, A/Res/71/248, 21 December 2016, Para. 4, A/HRC/Res/28/20, 27 March 2015, A/HRC/Res/29/16, 2 July 2015, A/HRC/Res/30/10, 1 October 2015.

⁹²⁹ UN Security Council S/PV.7825, (5 December 2016).

⁹³⁰ OHCA, reliefweb, ‘Statement of the International Syria Support Group’ (November 14, 2015), News and Press Release 14 Nov 2015; shih gjithashtu: Human Rights Watch (Report 2016) *Syria*, Ian Black, ‘Syria: Vienna meeting agrees aid airdrops but fails to set date for talks’, *The Guardian* (17 May 2016) <<https://www.theguardian.com/world/2016/may/17/syria-vienna-meeting-agrees-aid-airdrops-but-fails-to-set-date-for-talks>> qasur: 20 Mars 2021.

grupet e tjera të armatosura në Homs dhe Idlib. Ndërsa SHBA-ja vazhdoi koalicionin për të bombarduar IS në Irak dhe Siri.⁹³¹

Bisedat e paqes të mbajtura nga OKB-ja në Gjenevë nuk kanë mundur të arrijnë momentumin. Në janar 2017, Rusia, Irani dhe Turqia u takuan në Astana të Kazakistanit së bashku me përfaqësuesit e palëve në konflikt për të arritur një ulje të përshkallëzimit të konfliktit. Ndërsa, takimet e njëpasnjëshme kanë rezultuar në ulje të dhunës pas një marrëveshje në maj, ato nuk kanë arritur të ndalojnë atë plotësisht. Qeveria Siriane, Rusia dhe aktorët e tjerë kanë shkelur vazhdimisht këtë armëpushim. Më vonë Turqia vendosi trupat e veta ushtarake brenda provincës Idlib.⁹³² Ndërsa, qeveria siriane vazhdoi të përdorë armët kimike edhe në vitin 2017⁹³³ duke shkelur rezolutat e KS-së që kërkonin kryerje të sigurtë dhe të papenguar të ndërhyrjeve humanitare; ndërprerjen e përdorimit pa kritere të armëve në zona të populluara, përfshi edhe sulmet ajrore.⁹³⁴ Kjo e ndihmuar edhe nga aleatët e tyre si: Rusia dhe Kina të cilët vazhduan të përdornin veton e tyre në KS të cilët kishin për qëllim të sanksionin regjimin sirian për përdorimin e armëve kimike.⁹³⁵ Përveç, dekurajimit ose refuzimit të vazhdueshëm për veprim kuptimplotë nga KS-ja për të frenuar shkeljet nga qeveria Siriane, Rusia së bashku me qeverinë Iraniane, vazhdonte t'i siguronte qeverisë siriane ndihmë ushtarake edhe në vitin 2017. Ndërsa SHBA-ja së bashku me koalicionin sulmonin caqet e IS në Siri dhe Irak dhe duke mbështetur Forcat Demokratike të Sirisë.⁹³⁶ Në përgjigje të përdorimit të armëve kimike nga qeveria Siriane, SHBA në prill kishte kryer një sulm raketor ndaj një baze ushtarake të qeverisë siriane, me çrast 59-të raketa Tomahavk u qëlluan nga dy anije të Marinës Amerikane të vendosura në Mesdhe. Ky ishte veprimi i parë i SHBA-së i drejtuar drejtpërdrejtë kundër forcave të regjimit të Assadit.⁹³⁷

⁹³¹ Human Rights Watch (Report 2016) *Syria*.

⁹³² Human Rights Watch (Report 2018) *Syria*.

⁹³³ Human Rights Watch, *Death by Chemicals, The Syrian Government's Widespread and Systematic Use of Chemical Weapons*, (May 1, 2017) <<https://www.hrw.org/report/2017/05/01/death-chemicals/syrian-governments-widespread-and-systematic-use-chemical-weapons>> qasur: 10 Prill 2020.

⁹³⁴ Human Rights Watch (Report 2018) *Syria*.

⁹³⁵ UN Security Council, S/PV.7893, (28 February 2017); shih gjithashtu: UN Security Council, S/Pv.7922; (12 April 2017).

⁹³⁶ Human Rights Watch (Report 2018) *Syria*.

⁹³⁷ 'Syria war: US launches missile strikes in response to 'chemical attack', *BBC*, (7 April 2017) <<https://www.bbc.com/news/world-us-canada-39523654>> qasur: 12 Prill 2021. Këshilli i BE-së kishte miratuar një strategji në vitin 2017 e cila kërkon përfundimin e luftës në Siri dhe një tranzicion politik; dhe adresimin e ndihmave humanitare për Sirinë; promovimi i demokracisë dhe të drejtave të njeriut; llogaridhënie për krimet e kryera në Siri, shih: Council of the EU, *Council adopts EU strategy on Syria*, (3 April 2017) <<https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2017/04/03/fac-conclusions-syria/>> qasur: 12 Prill

Ndonëse, negociatat politike të drejtuara nga OKB mbetën në ngërç, Rusia bëri përpjekje për të legjitimuar politikisht fitimet e ushtrisë së qeverisë Siriane. Në janar Rusia priti një Kongres të Popullit Sirian në Soçi për të rënë dakord mbi një Kushtetutë të re. Megjithëse, nuk arriti objektivin e tij të deklaruar, Kongresi mandatoi të Dërguarin special të OKB-së për krijimin e një komiteti kushtetues.⁹³⁸ Rusia, Turqia dhe Irani vazhduan takimet e tyre trepalëshe për Sirinë, duke mbajtur tre takime të nivelit të samitit në v. 2018 dhe tre raunde bisedimesh në procesin e Astanas, ku negociatat për depërkallëzimin e situatës në Siri ishin mbajtur rregullisht në Astana që nga v. 2017. Ndërsa Rusia ende mbetej furnizuesja kryesore e qeverisë Siriane.⁹³⁹

Edhe pse përpjekjet për një zgjidhje politike dhe ndërprerjen e dhunës në Siri, ishin të vazhdueshme edhe jashtë OKB-së, megjithatë qeveria Siriane vazhdonte me përdorimin e armëve kimike ndaj popullatës civile. Në muajin shkurt⁹⁴⁰ dhe më pas sulmet kimike në Douma, e shtynë SHBA-në, Francën dhe Britaninë e Madhe që më 14 prill të kryenin sulme ajrore në struktura të armëve kimike në Siri.⁹⁴¹ Presidenti i SHBA-së Donald J. Trump deklaroi se qëllimi i koalicionit ishte “të vendoste një parandalim të fortë kundër prodhimit, përhapjes dhe përdorimit të armëve kimike”. Trumpi theksoi se vendosja e “këtij parandalimi ishte jetik për sigurinë Kombëtare të SHBA-së”.⁹⁴² Ndërkaq, Kryeministrja Britanike Theresa May tha se “ishte e ligjshme të ndërmarrim veprime ushtarake së bashku me aleatët tanë më të ngushtë, për të lehtësuar vuajtjet e mëtejshme humanitare duke degraduar aftësinë e armëve kimike të regjimit Sirian dhe duke parandaluar përdorimin e tyre. May tha se kjo nuk kishte të bënte

2021. Strategji e cila u mirëprit nga Parlamenti Europian, përfshirë qëllimet dhe objektivat e BE- së për Sirinë, shih: European Parliament, P8_TA(2017)0227, (18 May 2017) para. 1.

⁹³⁸ ‘Human Rights Watch Report 2019: Syria, Events of 2018’.

⁹³⁹ Ibid.

⁹⁴⁰ ‘Syria used chemical weapons on civilians in 2018: OPCW’, DW (12.04.2021) <<https://www.dw.com/en/syria-used-chemical-weapons-on-civilians-in-2018-opcw/a-57168683>> 14 Prill 2021.

⁹⁴¹ Julia Masterson and Leanne Quinn, ‘Arms Control Association’, May 2021, qasur në: <<https://www.armscontrol.org/factsheets/Timeline-of-Syrian-Chemical-Weapons-Activity>> qasur: 14 Prill 2021. KS- ja ishte takuar me 10 prill qëllim që të dakordoheshin për një përgjigje konkrete për shkak të përdorimit të armëve kimike. Ishin paraqitur tri draft- rezoluta kishin dështuar të miratohen. Duke përfshirë një për të cilën Rusia kishte përdorur Veto, shih: UN Security Council, S/PV.8228, (10 April 2018). Deri tani Rusia kishte përdorur 12 herë Veto për të bllokuar veprimet kundër qeverisë së Assadi- it, shih: Sam Meredith, ‘Syria war explained: Here’s what you need to know’, April 12 2018, <<https://www.cnbc.com/2018/04/11/syrian-war-explained-heres-everything-you-need-to-know.html>> qasur: 14 Prill 2021.

⁹⁴² Amanda Macias, ‘Trump orders targeted strikes in Syria to retaliate for suspected chemical weapons attack’, CNBC, April 13 2018, <<https://www.cnbc.com/2018/04/13/trump-to-address-the-nation-about-syria-nbc-news.html>> qasur: 14 Prill 2021.

me ndërhyrje në luftë civile dhe as me ndryshim regjimi, “ishte një sulm i kufizuar, i shënjestruar dhe efektiv me kufinj të qartë që kërkonte shprehimisht të shmangte përshkallëzimin dhe bëri gjithçka të mundur për të parandaluar viktimat civile.⁹⁴³ Për sulmin në Siri qeveria Britanike e përmendi ndërhyrjen humanitare si një bazë ligjore për përdorimin e forcës, e cila drejtohej ekskluzivisht "për të shmangur një katastrofë humanitare të shkaktuar nga përdorimi i armëve kimike nga regjimi Sirian". Ndërsa, qeveria franceze dhe amerikane ndonëse iu referuan pasojave humanitare të përdorimit të armëve kimike, nuk përmendën ndërhyrjen e qartë humanitare si bazë ligjore për sulmet ajrore, por për më tepër u përqendruan në parandalimin e përhapjes së armëve kimike.⁹⁴⁴ Britania e Madhe e përmendi parandalimin si një mundësi për zbatimin e PpM-së. Mirëpo, lidhur me bllokimin në KS, e pranojnë se KS-ja është autoriteti i duhur për përdorim të forcës, por e drejta e përdorimit të veto-s “ka përgjegjësi për të siguruar se interesat e ngushta të dikujt, nuk qëndrojnë në rrugën e mbrojtës së shumicës”. Këtë Britania e Madhe e konsideron si një abuzim të përgjegjësisë morale që u është besuar anëtarëve të përhershëm të KS-së për të bllokuar veprimet e kërkuara, për të parandaluar ose lehtësuar vuajtjet e mizorive masive.⁹⁴⁵

Ndonëse dhuna vazhonte në Siri, në prill të vitin 2018 u mbajtë Konferenca e Organizuar nga BE e bashkëkryesuar me OKB, e quajtur si: “Brukseli II”, për të ndihmuar të ardhmen e Sirisë dhe të rajonit.⁹⁴⁶ Ndërsa, në mars të vitit 2019 ishte mbajtur Konferenca: “Brukseli III”, në të cilën morën pjesë 57 shtete, më shumë se 20 organizata ndërkombëtare dhe agjenci të OKB-së, me të njëjtin qëllim për ndihmë ndaj Sirisë dhe të regjionit.⁹⁴⁷ Mirëpo, pavarësisht përpjekjeve për një zgjidhje të situatës në Siri edhe më 2019 siç raportonte Human Rights Watch: “mizoritë dhe shkelja e të drejtave që kanë karakterizuar konfliktin vazhduan të jenë

⁹⁴³ The UK Government, ‘PM's press conference statement on Syria’ (14 April 2018), The Prime Minister addressed the press with the following statement in Downing Street this morning, qasur në: <<https://www.gov.uk/government/speeches/pms-press-conference-statement-on-syria-14-april-2018>> qasur: 14 Prill 2021.

⁹⁴⁴ House of Commons Foreign Affairs Committee, ‘Global Britain: The Responsibility to Protect and Humanitarian Intervention’, Twelfth Report of Session 2017–19, (Published on 10 September 2018 by authority of the House of Commons) 7.

⁹⁴⁵ Ibid para 30.

⁹⁴⁶ Council of the EU, Brussels II Conference on 'Supporting the future of Syria and the region': co-chairs declaration, (25 April 2018) para 1 <<https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2018/04/25/brussels-ii-conference-on-supporting-the-future-of-syria-and-the-region-co-chairs-declaration/>> qasur: 15 Prill 2021.

⁹⁴⁷ Council of the EU, ‘Supporting the future of Syria and the region’ - Brussels III conference, (12-14 March 2019) <<https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-ministerial-meetings/2019/03/12-14/>> qasur: 16 Prill 2021.

rregull dhe jo përjashtim". Aleanca Siri-Rusi rifilloi operacionet ushtarake në Iblid, vendi i fundit në duart e anti-qeveritarëve.⁹⁴⁸ Në përgjigje të sulmeve Siriane dhe Ruse mbi objektet shëndetësore dhe objekte të tjera humanitare në Iblid dhe Homa Veriore, dy e treta e anëtarëve të OKB-së e kanë shtyrë Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së Antonio Guterres të fillojë një hetim dhe t'i dërgohej një mesazh i qartë Rosisë dhe Sirisë dhe palëve të tjera në konflikt se shenjëstrimi i spitaleve është një krim lufte dhe për këtë gjë duhet të mbahet përgjegjësi.⁹⁴⁹

Në shtator Rusia bllokoi një rezolutë të KS-së, e që ishte rezoluta e 13-të ndaj të cilës Rusia vuri veto lidhur me konfliktin në Siri, duke bllokuar kështu kërkesën për një armëpushim në Veri-Perëndim të Sirisë, sepse nuk përfshinte një përjashtim për ofensivë ushtarake kundër një grupi militant në listën e zezë të OKB-së. Rusia dhe Kina përdorën veton edhe ndaj draft-rezolutave të tjera. Kina nga fillimi i konfliktit kishte përdorur veton shtatë herë.⁹⁵⁰ Gjithashtu, edhe emërimi i një të Dërguari të ri të posaçëm të OKB-së në Siri, Gier Pederson, për negociata politike të drejtuara nga OKB mbeti e bllokuar. Jashtë OKB-së, shtetet si: Turqia dhe Irani vazhdojnë të kenë ndikim në Siri, me përpjekjet kryesore të Rosisë për të legjitimuar politikisht qeverinë Siriane të Bashar Al-Assadit dhe për të inkurajuar kthimin e refugjatëve dhe sigurimin e fondeve për rindërtim. Ndërsa, koalicioni i udhëhequr nga SHBA zhvilloi sulme ajrore kundër IS. Gjithashtu, SHBA dhe BE i zgjeruan sanksionet kundër Sirisë.⁹⁵¹

Edhe më tutje në vitin 2020 në Siri kishte konfrontime dhe abuzime të të drejtave të njeriut. Mekanizmat ndërkombëtarë të OKB-së për ndjekjen e krimeve të luftës dhe ndalimin e armëve kimike vazhduan punën e tyre. Shtetet si: Rusia, Turqia dhe Irani vazhdojnë përpjekjet për të legjitimuar qeverinë Siriane, SHBA mbështet koalicionin kundër IS dhe siguron mbështetje logjistike dhe financiare për Forcat Demokratike të Sirisë.⁹⁵² BE së bashku me OKB kishin ftuar Konferencën: "Brukseli IV", për të ardhmen e Sirisë dhe të rajonit në fillim

⁹⁴⁸ Human Rights Watch (Report 2020) *Syria*.

⁹⁴⁹ Louis Charbonneau, 'UN Chief Should Order Inquiry into Syria Hospital Attacks' Human Rights Watch, (31 July 2019) <<https://www.hrw.org/news/2019/07/31/un-chief-should-order-inquiry-syria-hospital-attacks>> qasur: 16 Prill 2021.

⁹⁵⁰ Michelle Nichols, Russia casts 13th veto of U.N. Security Council action during Syrian war, Reuters, (September 19, 2019) <<https://www.reuters.com/article/us-syria-security-un-iduskbn1w42cj>> qasur: 19 Prill 2021.

⁹⁵¹ Human Rights Watch (Report 2020) *Syria*.

⁹⁵² Human Rights Watch (Report 2021) *Syria*.

të vitit 2020.⁹⁵³ Ndërsa në KS, SHBA dhe disa anëtarë të Këshillit European kanë bërë përpjekje për rivendosjen e mekanizmit ndërkufitar humanitar dhe kanë mbështetur përgjegjësinë për shkeljet në Siri. Rusia ka vazhduar të përdorë fuqinë e veto-s për të shmangur mandatin e ndihmës ndërkufitare.⁹⁵⁴

5.3. Këshilli i Sigurimit dhe PpM në Siri

Për dallim nga Libia ku KS ishte shumë i shpejtë për të reaguar, rasti i Sirisë e tregon të kundërtën. Edhe pse KS kishte miratuar mbi 20-të rezoluta për situatën në Siri,⁹⁵⁵ rreth 6-të prej tyre i referohen PpM-së⁹⁵⁶ duke kërkuar përgjegjësinë e qeverisë për të mbrojtur popullatën e vet, por asnjëra prej tyre nuk është zbatuar.⁹⁵⁷ Mirëpo pavarësisht kësaj, anëtarët e përhershëm të KS-së që mbajnë të drejtën e veto-s, vazhdojnë të mos bien dakord për shumë çështje në politikat ndërkombëtare, përfshi edhe përgjigjet ndaj krizave humanitare. Edhe pse në disa raste sot, marrëveshja shpesh shprehet duke abstenuar, se sa duke hedhur veto për të bllokuar një vendim, në disa raste përfshi krizën aktuale në Siri, anëtarët e përhershëm të KS-së kanë përdorur veton për të bllokuar veprimet që bien ndesh me interesat e tyre përkatëse.⁹⁵⁸ Dështimi i ndërmarrjes së veprimeve, ashtu siç argumenton Martin Binder, përgjigja e KS-së ka mbetur selektive,⁹⁵⁹ me çrast përdorimi i veto-s nga ana e Rusisë dhe Kinës në më shumë se 10-të projekt-rezoluta⁹⁶⁰ e ka pamundësuar veprimin e KS-

⁹⁵³ Council of the EU, 'Supporting the future of Syria and the region' Brussels IV Conference, (30 June 2020) <<https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-ministerial-meetings/2020/06/30/>> qasur: 10 Prill 2020.

⁹⁵⁴ Human Rights Watch (Report 2021) *Syria*.

⁹⁵⁵ Security Council Report, 'UN Documents for Syria: Security Council Resolutions' <https://www.securitycouncilreport.org/un_documents_type/security-council-resolutions/page/2?ctype=Syria&cbtype=syria#038;cbtype=syria> qasur: 25 Prill 2021.

⁹⁵⁶ Global Centre for the Responsibility to protect, 'UN Security Council Resolutions and Presidential Statements Referencing R2P', <<https://www.globalr2p.org/wp-content/uploads/2020/01/UNSC-Resolutions-and-Statements-with-R2P-Table-as-of-14-January-2020.pdf>> qasur: 2 Maj 2021.

⁹⁵⁷ Global Centre for the Responsibility to Protect, 'Syria' (2021) <<https://www.globalr2p.org/countries/syria/>> qasur: 2. Qershor.2021 [tani e tutje: Global Centre for the Responsibility to Protect, 'Syria'].

⁹⁵⁸ Martin Binder, *The United Nations and the Politics of Selective Humanitarian Intervention*, (Palgrave Macmillan, 2017) 7.

⁹⁵⁹ Ibid 30.

⁹⁶⁰ Global Centre for the Responsibility to Protect, 'Syria'; shih gjithashtu: Security Council Report, UN Documents for Syria: Security Council Resolutions, qasur në: <https://www.securitycouncilreport.org/un_documents_type/security-council-resolutions/page/2?ctype=Syria&cbtype=syria#038;cbtype=syria> 20 Mars 2021.

së, si një autoritet ekskluziv për të urdhëruar veprimet shtrënguese nën shtyllën III. Gjatë luftës civile tetë vjeçare në Siri, KS-ja nuk ka qenë në gjendje të bie dakord për ndonjë veprim kuptimplotë, të penguar nga bllokimi politik, në ndërkohë qindra e mijëra sirianë kanë humbur jetën, e miliona të tjerë janë refugjatë dhe persona të zhvendosur.⁹⁶¹

Interesat politike të Ruisë në raport me Sirinë kanë qenë të mëdha. Rusia ishte e vendosur të mbrojtë qeverinë siriane të Bashar Al-Assadit. Lidhja e Ruisë me Sirinë shtrihet në epokën Sovjetike dhe më shumë se katër dekada ku Bashkimi i Republikave Socialiste-Sovjetike (BRSS) bënte përpjekje për të shtrirë ndikimin e tij në Lindjen e Mesme. Që nga viti 1980 Rusia ka pasur një strukturë detare dhe një personel ushtarak në qytetin Sirian Turtus për të siguruar praninë e Ruisë në rajon, si ndër bazat e vetme të mbetura jashtë territorit të BRSS-së dhe kështu e rëndësishme për qëndrimin gjeopolitik të Ruisë. Edhe industria e armëve ruse kishte përfituar mjaft shumë nga shitja e tyre Sirisë për një kohë të gjatë. Kështu, edhe në luftën civile, që nga v. 2011 Rusia kishte ndihmuar qeverinë e Assadit gjatë gjithë kohës me armatim, gjithashtu raportohet se e ndihmoi Sirinë edhe në aspektin financiar me qëllim të mbrojtjes së vendit nga falimentimi.⁹⁶²

Ndryshe nga Rusia, Kina ka më pak interes ekonomik dhe politik në Siri dhe ka qenë me qëndrime më të barabarta në raport me qeverinë Siriane dhe opozitën. Por, siç duket, qëndrimi i Kinës në rastin e vetove ndaj ndërmarrjes së veprimeve në Siri pasqyron parimet tradicionale të diplomacisë Kineze përkatësisht “mosndërhyrjet në punët e brendshme të shteteve të tjera”. Sidoqoftë qëndrimi negativ i Kinës ndaj një përfshirje në punët e brendshme të një shteti tjetër u forcua për shkak të pakënaqësisë së saj me ndërhyrjen e udhëhequr nga Perëndimi në Libi në v. 2011 e cila kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në veprimet e saj në lidhje me Sirinë sot.⁹⁶³ Duke vepruar kështu, Kina demonstroi përkushtimin ndaj parimeve tradicionale të diplomacisë së vet dhe pavarësisë nga shtetet perëndimore, por edhe bashkëpunimin diplomatik Kinezo-Rus.⁹⁶⁴ Ndërkaq, edhe SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar si dhe Franca janë kritikuar gjerësisht për dërgimin e mesazheve të përziera kundër atyre që janë kundër Assadit. Aidan Hehir argumenton se burimi kryesor i ndarjes midis pesë

⁹⁶¹ Jenna B. Russo, ‘R2P in Syria and Myanmar: Norm Violation and Advancement, global responsibility to protect’ (2020) (12) Brill Nijhoff, 212 [tani e tutje: Jenna B. Russo, ‘R2P in Syria and Myanmar’].

⁹⁶² Simon Adams, ‘Failure to Protect: Syria and the Security Council’, 15.

⁹⁶³ Ibid 47.

⁹⁶⁴ Ibid 48.

shteteve të përhershme të KS-së dhe kështu faktori kryesor shpjegues prapa përgjigjes ndërkombëtare josistematike ka qenë interesi i tyre nacional reciprokisht përjashtues. Në veçanti, përqendrimi i ngushtë i Rusisë dhe Kinës në mbështetje të regjimit të Assadit ka bërë që ata të kenë qenë të gatshëm të bllokojnë përpjekjet ndërkombëtare për të ndaluar represionin e qeverisë.⁹⁶⁵ Ndërsa, interesat e Kinës me veprime të caktuara në Siri ishin të lidhura me qëndrimin e tyre më të gjerë në marrëdhëniet midis sovranitetit dhe të drejtave të njeriut, në veçanti neveritetet e tyre ndaj ndërhyrjeve të jashtme në punët e brendshme të shteteve. Ndërkaq, interesat e Rusisë me Sirinë janë më të ngushta sepse Rusia e shihte qartë situatën në Siri si një mundësi e mirë për ambiciet e saj gjeopolitike në rajon.⁹⁶⁶

Marrë në përgjithësi, Siria ka sjellë në pah realitetin e thellë të OKB-së të shekullit XXI, që lufton për t'iu përgjigjur sfidave të këtij shekulli. Simon Adams konsideron se, përdorimi i veto-s në një situatë të mizorisë masive është në kundërshtim me aspiratat e AP-së, që nuk beson më se sovraniteti duhet të jetë një “licencë e pakufizuar” për të vrarë dhe as nuk pranon të drejtën e pesë fitimtarëve nga v. 1945 për të mbajtur privilegje dhe benefite, nëse këto rezultojnë jo miqësore me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Në veçanti, ka një presion në rritje për të mbështetur angazhimin e OKB-së nga viti 2005 dhe PpM-ja nënkupton në këtë rast që anëtarët e KS-së kanë përgjegjësi të mos e përdorin veton kur bota përballet me krimet më të urryera.⁹⁶⁷ Prandaj, ashtu siç argumenton Adams, me ose pa reformën, KS-ja është e detyruar të ndihmojnë në përfundimin e krimeve të luftës dhe krimet kundër njerëzimit në Siri.⁹⁶⁸

5.4. Dështimi për të vepruar në Siri dhe e ardhmja e PpM-së

Në Siri, KS ka dështuar në vazhdimësi dhe ka qenë i paaftë për të ndërmarrë veprimet e duhura për të parandaluar sulmet ushtarake të regjimit sirian ndaj popullatës civile të pafajshme për shkak të bllokimit me veto nga ana e Kinës dhe Rusisë.⁹⁶⁹ Nga disa autorë

⁹⁶⁵ Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*, 169.

⁹⁶⁶ Ibid 170.

⁹⁶⁷ Simon Adams, ‘Failure to Protect: Syria and the Security Council’, 21.

⁹⁶⁸ Ibid.

⁹⁶⁹ Terry D. Gill, “The Security Council”, *An Institutional Approach to the Responsibility to Protect*, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013) 104- 105 [tani e tutje: Terry D. Gill, “The Security Council”]; shih gjithashtu: Luke Glanville, ‘Syria Teaches Us Little about Questions of Military Intervention, Into the Eleventh Hour: R2P, Syria and Humanitarianism in Crisis’, (2014) (Edited by Robert W Murray, & Alsdair Mckey) *E-International Relations United Kingdom*, 47, Jenna B. Russo, R2P in Syria and Myanmar: Norm Violation and Advancement, *global responsibility to protect* 12 (2020), Brill Nijhoff, 213.

dështimi për të vepruar në Siri u pa nga mënyra se si fushata e ndërhyrjes në Libi ka përforcuar pozicionin e disa shteteve që e kanë kundërshtuar atë ndërhyrje brenda dhe jashtë KS-së të cilët hezitojnë të zbatojnë masat kolektive në përgjigje të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe ka thelluar ndoshta ndarjen brenda bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me një veprim të tillë për përdorimin e PpM-së për ta legjitimuar atë⁹⁷⁰ dhe mosveprimi në Siri dhe në vende të tjera gjerësisht shihet edhe si dështim i PpM-së, bazuar në mungesën e veprimeve.⁹⁷¹

Pra, mungesa e veprimit të KS-së kishte ndezur një debat për legjitimitimin e PpM-së, ku një numër i autorëve dështimin e veprimit në Siri e shohin si dështim ose zbehje të parimit të PpM-së. Megjithatë, siç vëren Jenna Russo dështimet e veprimeve të PpM-së kanë bërë që edhe përkrahësit e PpM-së të vënë në dyshim shkëlqimin e tij të vazhdueshëm.⁹⁷² Por, fakti i mos autorizimit të KS-së për ndërhyrje ushtarake në Siri dhe kundërshtimi ndaj zbatimit të normës, nuk nënkupton se ajo nuk ka ndikim në shoqëri. Ndonjëherë, normat turpërohen nga interesat e shteteve të fuqishme, kjo nuk do të thotë se norma nuk do të ketë ndikim të fuqishëm në raste të tjera.⁹⁷³ Sidoqoftë Russo konsideron se forca e PpM-së dhe zhvillimi i saj si një normë, ashtu siç është tani ku organi i vetëm për të autorizuar forcën ushtarake në situatat e mizorisë është KS-ja, gjë që do të varet pikërisht nga sjellja e anëtarëve të përhershëm të KS-së se si do të veprojnë në rastet e tjera aktuale të PpM-së dhe ato të cilat do të paraqiten në të ardhmen.

Megjithatë, me të drejtë Russo thekson faktin se edhe pse KS-ja ka dështuar në mënyrë të përsëritur në përgjegjësinë e tij për të vepruar në kohë dhe në mënyrë vendimtare, nuk mund të mohohet fakti se deri më tani pavarësisht këtij dështimi të këtyre grupe aktorësh, shtetet anëtare kanë vazhduar të mbështesin PpM-në jo vetëm në retorikë por, edhe në krijimin e mekanizmave inovues për të anashkaluar bllokimin e KS-së. Aktorët e PpM-së kështu janë përgjigjur duke krijuar rrugë alternative për funksionalizmin të cilat në fund të fundit kanë shërbyer për të avancuar më tej PpM-në.⁹⁷⁴

⁹⁷⁰ Karin Oellers-Frahm, 'Responsibility to Protect Any New Obligations for the Security Council and Its Members?', *Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?* (2015) Brill Nijhoff, 204; shih gjithashtu: Terry D. Gill, "The Security Council", 105.

⁹⁷¹ Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*, 214.

⁹⁷² Ibid 213.

⁹⁷³ Luke Glanville, 'Syria Teaches Us Little about Questions of Military Intervention, Into the Eleventh Hour: R2P, Syria and Humanitarianism in Crisis', (2014) (Edited by Robert W Murray, & Alsdair Mckey) E- International Relations United Kingdom, 46.

⁹⁷⁴ Jenna B. Russo, 'R2P in Syria and Myanmar: Norm Violation and Advancement, global responsibility to protect' (2020 (12), Brill Nijhoff, 213.

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Në këtë disertacion të doktoratës janë trajtuar: zhvillimin historik, argumentimi ligjor dhe argumentimi moral si dhe praktika e organizatave ndërkombëtare dhe shtetërore, lidhur me: “Ndërhyrjen humanitare” dhe “Përgjegjësinë për të mbrojtur”.

Në këtë hulumtim u konstatua se, ndërhyrja humanitare e paraqitur gjashtëqind vite më parë në diskursin e doktrinave fetare, të luftërave të drejta dhe të padrejta, duke argumentuar një të drejtë të ndërhyrjes nga jashtë në rast të persekutimit ndaj popullatës civile, kishte një përkrahje si nga studiues të së drejtës dhe praktikës shtetërore, deri në shek. XX, me çrast e drejta e ndërhyrjes humanitare kishte një përkrahje të përgjithshme. Mirëpo, miratimi i dokumenteve ndërkombëtare, veçanërisht të Kartës së OKB-së në vitin 1945, neni 2(4) dhe 2(7) dhe ndalimi i përdorimit të forcës në përgjithësi ka bërë që edhe ndërhyrja humanitare nga një pjesë e madhe e shteteve dhe studiuesve të së drejtës ndërkombëtare, sipas interpretimit të Kartës së OKB-së, të konsiderohet e kundërligjshme dhe se cenon sovranitetin shtetëror.

Periudha pas vitit 1945, që nga miratimi i Kartës së OKB-së, e rriti debatin për ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare. Mbrojtja e sovranitetit shtetëror në njërën anë dhe zhvillimi dhe mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut me Kartën e OKB-së nga ana tjetër, ishin mjaft tensionuese. Nuk mund të mohohet fakti se një numër i shteteve dhe shumë studiues të së drejtës ndërkombëtare, konsiderojnë se Karta e OKB-së e ndalon rreptësisht ndërhyrjen humanitare dhe se në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si e ligjshme. Por, megjithatë, pavarësisht kësaj, Karta e OKB-së nuk e ndalon shprehimisht ndërhyrjen humanitare dhe kështu, një numër i shteteve kryesisht perëndimore dhe disa studiues, filluan që ta shohin rritjen e mbrojtjes ndërkombëtare të drejtave të njeriut si një mundësi për një të drejtë të ndërhyrjes humanitare në raste kur një shtet bën shkelje masive të të drejtave të njeriut, sepse qëllimi i ndërhyrjes humanitare nuk është shkelja e integritetit territorial dhe pavarësisë politike të një shteti, por, vetëm mbrojtja e qytetarëve të atij shteti nga mizoritë. Kështu, praktika e shteteve pas themelimit të OKB-së ka treguar një rritje të rasteve të ndërhyrjeve humanitare dhe atë jashtë KS-së të cilat u konsideruan si ndërhyrje për qëllime humanitare, si ndërhyrja e Indisë në Pakistan, ajo e Tanzanisë në Ugandë, ajo e Vietnamit në Kamboxhia

etj. Edhe pse në këto raste të ndërhyrjeve individuale dhe rasteve të tjera të ndërhyrjeve në dekadat e para pas miratimit të Kartës së OKB-së, shtetet ndërhyrëse nuk deklaruan se po ndërhynin për qëllime humanitare. Për shumë arsye, në këtë periudhë u rritë numri i shteteve dhe studiuesve të cilët bënë thirrje për ndërhyrje në ndonjë shtet tjetër në rast të emergjencave humanitare dhe nëse veprohet jashtë OKB-së, kur KS-ja bllokohet me veto. Megjithatë, në këtë periudhë nuk mund të thuhet se kishte një pranueshmëri se ndërhyrja humanitare është e ligjshme në të drejtën ndërkombëtare sipas Kartës së OKB-së, madje edhe praktika e shteteve u pa si e pamjaftueshme për krijimin e një norme zakonore ndërkombëtare.

Edhe Këshilli i Sigurimit i OKB-së i cili e kishte detyrën kryesore sipas Kartës, ta ruajë paqen dhe sigurinë në botë, ishte i bllokuar në shumicën e kohës nga e drejta e veto-s kryesisht nga Kina dhe Rusia të cilat ishin kundër çdo ndërhyrje ndaj sovranitetit të shteteve. Ndonëse, nuk mund të mohohet zhblokimi i KS-së, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, dështimi për të vepruar me kohë në vitet e 90-ta në Bosnjë, ku nga shumica dërmuese u pa si i vonshëm dështimi edhe i ndërhyrjes në Ruandë, kanë bërë që gjatë gjithë kohës shtetet dhe studiuesit e së drejtës ndërkombëtare gjithmonë ta shohin mundësinë që të ndërhyhet ushtarakisht në një shtet, jashtë veprimit nga OKB-ja.

Marrë në përgjithësi argumentet kryesore lidhur me (jo) ligjshmërinë e ndërhyrjes humanitare mund të grupohen në tri grupe. Së pari, argumentimi i një grupi të shteteve të cilat thirrin në sovranitetin absolut të shteteve dhe një grupi studiuesish se ndërhyrja humanitare përveç vetëmbrojtjes dhe autorizimit nga KS-ja është e kundërligjshme në të drejtën ndërkombëtare. Grupi i dytë, beson se pavarësisht nëse ndërhyrja humanitare mund të konsiderohet e kundërligjshme sipas Kartës së OKB-së, ajo është krejtësisht legjitime, (për arsye morale dhe politike) në raste të caktuara kur ka shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe OKB-ja dështon të veprojë, atëherë është detyrë e shteteve dhe e bashkësisë ndërkombëtare të veprojnë për ndalimin e krimeve mizore. Ndërsa në fund, sipas grupit të tretë, duke u bazuar në ndërhyrjet e mëparshme humanitare dhe ato pas themelimit të OKB-së, tashmë mund të thirremi në një normë zakonore të së drejtës ndërkombëtare për një të drejtë të ndërhyrjes humanitare.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë vetëm sa e rriti këtë diskurs juridik ndërkombëtar, nga qarqe të ndryshme diplomatike, politike etj. Prandaj në këtë hulumtim është trajtuar më në

detaje si rast i ndërhyrjes humanitare. Pra, ajo që ishte më e rëndësishme për qëllime të këtij hulumtimi është diskutimi juridik nëse ndërhyrja e NATO-s në Kosovë është e ligjshme apo paraqet shkelje të së drejtës ndërkombëtare. Rasti i ndërhyrjes humanitare në Kosovë, u përçoll ndoshta me diskutime gati universale për ligjshmërinë e saj. Natyrisht, studiuesit klasik dhe disa shtete si: Kina, Rusia, India dhe vende të tjera i mbetën besnik parimit të mosndërhyrjes dhe e argumentuan atë edhe pas ndërhyrjes ushtarake në Kosovë dhe e konsideruan atë si të kundërligjshme sipas të drejtës ndërkombëtare. Mirëpo, ndërhyrja e NATO-s në Kosovë e bindi një numër të madh të shteteve perëndimore dhe studiues të shumtë për ndërhyrjen humanitare në favor të kësaj ndërhyrje. Madje, edhe disa studiues të cilët janë kundër ndërhyrjes humanitare siç është për shembull, Bruno Simma dhe të tjerë, e pranojnë se së paku ndërhyrja ushtarake në Kosovë ishte legjitime. Duhet të pranohet se legjitimiteti i ndërhyrjes në Kosovë është pranuar gjerësisht, nga një pjesë shumë e madhe e bashkësisë ndërkombëtare. Argumentime të shumta tregojnë se para ndërhyrjes së NATO-s, përpjekjet e shumta diplomatike për ndërprerje të luftës dhe arritje të një marrëveshjeje dështuan, ndërkaq krimet në masë të kryera ndaj popullit në Kosovë, moszbatimi i detyrimeve ndërkombëtare nga ana e Millosheviçit, dështimi i KS-së për të autorizuar forcën, për shkak të kërcënimit me veto nga Kina dhe Rusia, e shtynë një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare, që të ndërhyjë ushtarakisht në Kosovë për ndaljen e krimeve serbe në Kosovë.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë edhe pse ishte bërë jashtë autorizimit nga KS, ishte bërë nga një organizatë regjionale, e përbërë nga një numër i madh i shteteve, ku madje disa prej këtyre shteteve, argumentuan në OKB se ndërhyrja në Kosovë ishte e ligjshme sipas të drejtës ndërkombëtare. Por, edhe pse kjo ndërhyrje ishte bërë pa autorizim të KS-së, KS kurrë nuk e dënoi një ndërhyrje të tillë. Kjo nuk nënkupton në vetëvete një miratim të ndërhyrjes, mirëpo, mund të merret si një miratim në heshtje. Prandaj, nëse shikohen ndërhyrjet paraprake humanitare, por në veçanti ndërhyrja e fundit humanitare, ajo e Kosovës, për studiuesit të cilët kanë qenë gjithmonë në kërkim të kristalizimit të një norme zakonore ndërkombëtare e cila e lejon ndërhyrjen humanitare në rastin e Kosovës e shohin pranueshmërinë ndërkombëtare të kësaj ndërhyrjeje gjë që tregon se një normë zakonore tashmë është krijuar. Nga kjo, edhe pjesa tjetër veçanërisht nga disa shtete të mëdha ende haptazi e kundërshtojnë ndërhyrjen humanitare, dhe u japin legjitimitet kundërshtuesve të ligjshmërisë së ndërhyrjes humanitare. Megjithatë, ndërhyrja e NATO-s është shumë e rëndësishme për

zhvillimin e një *jus cogens* për të drejtën e ndërhyrjes humanitare, sepse një numër i madh i shteteve e mbështetën atë, edhe nëse tërësisht nuk është kristalizuar si një normë e tillë zakonore në të drejtën ndërkombëtare.

Ishte pikërisht debati për ndërhyrjen ushtarake në Kosovë, midis përkrahësve të sovranitetit dhe atyre për të drejtat e njeriut, dhe dështimin e OKB-së për të vepruar si në Bosnje, Ruandë dhe në fund në Kosovë, të cilët e shtynë Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së të nxisë debatin në OKB dhe të paralajmëroje diskreditimin e OKB-së, nëse ajo nuk vepron në situata të katastrofave humanitare. Dhe, ashtu siç u morr vesh gjatë trajtimit të ndërhyrjes humanitare në këtë hulumtim, kundërshtimet ishin të shumta për ndërhyrjen ushtarake pa mandat të OKB-së. Si rezultat i këtyre ngjarjeve del në dritë koncepti i PpM-së. Ky koncept i lindur që nga viti 2001 kishte për qëllim të zhvendoste debatin e ndërhyrjes humanitare, i cili u konsiderua si jo adekuat dhe i vjetërsuar. Ashtu siç u konstatua PpM-ja nuk ka qëllim kryesor ndërhyrjen ushtarake, por parandalimin, ndërsa ndërhyrja ushtarake mund të vijë vetëm atëherë kur shteti dështon të veprojë. Ndërsa koncepti i sovranitetit nuk konsiderohet më si një e drejtë, por si përgjegjësi e shteteve, dhe në aspektin e jashtëm nënkupton respektimin e sovranitetit të shteteve të tjera, ndërsa në aspektin e brendshëm respektimin e të drejtave të njeriut. Mirëpo, edhe këtu sovraniteti nuk është i paprekur, në raste kur shteti dështon ose nuk dëshiron ti mbrojë qytetarët e vet nga krimet masive, atëherë sovraniteti i shtetit i nënshtrohet ndërhyrjes nga jashtë.

Për dallim nga ndërhyrja humanitare e cila kishte për qëllim vetëm ndërhyrjen ushtarake në raste të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, PpM-ja u konceptua së pari në përgjegjësinë për të parandaluar, përgjegjësinë për të reaguar dhe përgjegjësinë për të rindërtuar. Por, përgjegjësia kryesore për të reaguar këtu bie mbi KS-në, pra ideja e Komisionit që e konceptoi PpM-në nuk kishte për qëllim që të gjente ndonjë alternativë ndaj KS-së, por të bëjë që KS të funksionojë më mirë.

Shumë shpejtë nga lindja e kësaj ideje nga një Komision i pavarur, në vitin 2005 PpM-ja u pranua në OKB së pari nga AP-ja e pastaj edhe nga KS-ja dhe nga institucionet e tjera të OKB-së. Ky pranim i këtij koncepti nga organizata më e madhe në botë pra, OKB-ja është i rëndësishëm për të shpresuar se PpM-ja do të ketë një të ardhme të ndritshme. Dokumenti i Samitit Botëror nga AP-ja në vitin 2005 dhe Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për implementimin e PpM-së tri-shtyllësh i vitit 2009 edhe sot qëndrojnë si dy udhërrëfyes dhe

dokumente kryesore mbi PpM-në. Fokusi dhe kufizimi i konceptit për përgjegjësi të shteteve dhe atë ndërkombëtare vetëm në katër krime, që janë: gjenocidi, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe spastrimi etnik tregon se PpM-ja mbështetet në krimet që tashmë shumica e tyre janë norma të ngulitura thellë në të drejtën ndërkombëtare dhe njëherit, mos sugjerimi edhe në krime të tjera është shumë i rëndësishëm për të mos e vështirësuar dhe deformuar idenë fillestare të konceptit dhe mundësisht ndalon edhe interpretimin e konceptit për t'u keqpërdorur nga ana e shteteve për veprime të ndryshme e që nuk janë në grupin e këtyre katër krimeve. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm i vitit 2009 ishte shumë i rëndësishëm për zbatimin e PpM-së. Shtylla I dhe II përfshijnë përgjegjësinë e shteteve dhe ndihmën nga bashkësia ndërkombëtare për ndalimin e krimeve në masë. Ndërsa shtylla III, e cila ka një prag më të lartë të zbatimit pasi ajo përfshin masat shtrënguese nga deri te ndërhyrja ushtarake, e cila edhe nga ky raport përgjegjësia për të reaguar bie mbi autorizimin e KS-së. Por, të trija shtyllat duhet të funksionojnë së bashku, sepse në të kundërtën mos-zbatimi i njërës e rrezikon zbatimin e shtyllave të tjera dhe konceptin e PpM-së në tërësi.

Ndonëse KS e kishte miratuar PpM-në një vit pas pranimi në AP, pra në vitin 2006, dukej se KS do të ishte e gatshme për të reaguar në situata të PpM-së, pasi ajo në po të njëjtin vit miratoi rezoluta të menjëhershme për vendosjen e paqeruajtësve në Sudan dhe Darfur. Mirëpo, KS në vitet e para të pranimi të PpM-së e deri në v. 2011 kishte vepruar shumë pak, dhe se historiku i KS nuk kishte ndryshuar historikun e veprimit edhe më pas, për shkak të mos ndërhyrjes në sovranitetin shtetëror. Tek në vitin 2011 ndërhyrja e NATO-s në Libi me autorizimin e KS-së, u lavdërua dhe u pa si një mundësi e mirë se PpM-ja është duke pasur sukses dhe se KS-ja do të veprojë në situata të mizorive. Mirëpo, dhe autorizimi i ndërhyrjes në Libi, nuk u përkrah nga vetë disa shtete brenda KS-së dhe nga dy anëtarët e përhershëm si Kina dhe Rusia dhe më vonë edhe në shkrimet e shumë studiuesve të cilët argumentojnë si një rast jo të mirë të zbatimit të PpM-së dhe se nuk mund të merret se kjo ndërhyrje të ketë ndikuar shumë në zhvillimin e PpM-së. Në këtë periudhë, i rëndësishëm ishte edhe propozimi i Brazilit për PdM-në, që kundërshton mënyrën se si u ndërhy në Libi dhe kërkon që tre shtyllat e PpM-së të kenë një zbatim të rreptë politik dhe kronologjik dhe të përdoren mjete të tjera para ndërhyrjes së shpejtë ushtarake. Mirëpo, ideja e Brazilit nuk zgjati shumë vite, pasi vetë Brazili nuk arriti ta zhvillojë konceptin e vet, dhe u zbraps nga kjo iniciativë.

Për të parë suksesin e KS-së në zbatimin e PpM-së që nga viti 2006 kur ishte pranuar ky koncept në Këshill, e deri në vitin 2019, për qëllimet e këtij hulumtimi kemi analizuar numrin e rezolutave për vite dhe për shtete ku kishte shkelje masive të të drejtave të njeriut. Kjo është me rëndësi pasi KS ka përgjegjësi kryesore për të reaguar ndaj krimeve mizore. Edhe pse numri i përgjithshëm i rezolutave të miratuara nga KS-ja ishte mjaft i lartë, mbi 83 sish, ku shumica e tyre i referohen thirrjeve nga KS ndaj shteteve për përgjegjësinë e këtyre shteteve ndaj situatave të mizorive, megjithatë nëse i shikojmë rezolutat e miratuara nga ky organ për përgjegjësinë e vet ndaj këtyre situatave, numri i tyre ka qenë shumë i papërfillshëm, madje numri më i madh i tyre ishte në shtyllën I dhe i kufizuar me mbi gjysmën e tyre vetëm në tri shtete në Afrikë. Mirëpo, dështimi i KS-së për të vepruar në Siri, Myanmar dhe në disa vende të tjera, për shkak të përdorimit të veto-s, tregon se Këshilli mbetet ende selektiv, dhe dështimi për të vepruar në bazë të shtyllës III, tregon se edhe pas zhvillimit dhe pranimin të PpM-së, KS ende nuk ka ndryshuar nga qasja e vet e autorizimit për përdorimin e forcës ushtarake. Bllokimi i KS në të ardhmen dhe mosveprimi në situata të mizorive, padyshim se e zbehin PpM-në dhe janë një sfidë për këtë koncept. Edhe pse sugjerimi është që KS të mos e përdor veton nëse nuk preken interesat e tyre dhe të gjejë mënyra për tu zhbllokuar në situata të tilla, deri më tani kjo gjë nuk u dëshmuar nga ky organ.

Nga ana tjetër, edhe dokumentet e PpM-së në mungesë të autorizimit të KS-së në situata të krimeve masive, e parashohin veprimin e AP-së që në bazë të shtyllës II dhe duke u bazuar në rezolutën të bashkuar për paqe të autorizojnë përdorimin e forcës, mirëpo, kjo rezolutë ishte përmendur të thirret edhe në situata të ndërhyrjeve humanitare siç ishte rasti i Kosovës dhe raste të tjera, tani edhe nga PpM-ja sugjerohet një gjë e tillë. Mirëpo, është e ditur dhe e pranuar gjerësisht se veprimet e AP-së dhe autorizimi nga ky organ nuk është juridikisht i detyrueshëm, prandaj e bën të vështirë që ligjërisht të veprohet jashtë KS-së. Edhe pse roli i AP-së është shumë i rëndësishëm, që nga miratimi për herë të parë i konceptit në këtë organ, dhe rezoluta e diskutime të shumta, të mbajtura në AP, bëjnë që ky organ të kontribuojë mjaft shumë në forcimin e konceptit dhe fakti i prezencës së 193 vendeve anëtare në këtë organ, mund të ndikojë në krijimin e një konsensusi mjaft të gjerë.

PpM-ja si koncept edhe pse është miratuar dhe zhvilluar nga institucionet e OKB-së që nga viti 2005, është pranuar gjerësisht se ajo ende nuk e ka fituar statusin ligjor të një norme detyruese në të drejtën ndërkombëtare, pasi nuk është e sanksionuar në ndonjë marrëveshje

ndërkombëtare dhe as nuk e ka fituar statusin e një norme obligative. Ajo më shumë ende është një normë politike, apo një normë e cila është në zhvillim e sipër.

Në këtë hulumtim shkencor u konstatua se, edhe pse PpM-ja është kritikuar mjaft për shkak se ka dështuar në situata të krimeve në masë, dhe se ende nuk e ka arritur statusin ligjor për tu bërë obligative për shtetet, ajo ka pasur sukses në disa shtete, ku shumë rezoluta janë miratuar dhe ka hasur në një pranueshmëri universale, pasi për dallim nga ndërhyrja humanitare, PpM është miratuar dhe është duke u zhvilluar nga OKB, ku përfshihen institucionet kryesore të kësaj organizate, siç janë: AP, KS, Sekretari i Përgjithshëm, mekanizma të tjerë të krijuar në OKB; por jo vetëm, janë edhe organizatat regjionale dhe organizatat jo-qeveritare të cilat po luajnë një rol shumë të rëndësishëm për PpM-në. Veçanërisht shtylla I dhe II e PpM-së kanë një avancim më të madh universal, sepse kontributi i shumicës së këtyre mekanizmave është parandalimi i krimeve mizore.

Lidhur me krizën siriane si njëra nga krizat më të rënda humanitare të shekullit XXI, si rast studimi në këtë hulumtim shkencor u konstatua se PpM-ja akoma ka disa çështje të hapura që dalin nga analiza e praktikës shtetërore gjatë kësaj krize lidhur me çështjen nëse Siria kishte përmbushur përgjegjësinë e saj për të mbrojtur popullatën e vetë civile, me çrast edhe pse shkeljet masive të të drejtave të njeriut kundër civilëve i krijuan parakushtet për zbatimin e PpM-së në Siri, megjithatë shtetet si: Rusia dhe Kina e mbajtën qëndrimin se kriza siriane paraqet një çështje të brendshme ndërkaq, shtetet si: Brazili, India dhe Afrika Jugore nuk ishin të bindur lidhur me PpM-në në Siri duke i dhënë përparësi mbrojtjes së sovranitetit shtetëror të këtij shteti. Ndërkaq, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Franca ishin për përdorimin e forcës ushtarake në Siri (edhe pa autorizimin e KS-së), por jo mbi bazën e PpM-së por mbi bazën e përdorimit të armëve kimike në Siri gjë që i riktheu sërish polemikat e vjetra lidhur me përdorimin e forcës ushtarake pa autorizimin e KS-së për qëllime humanitare, gjë që praktikisht flet për dështimin e PpM-së në rastin e krizës humanitare në Siri.

Në këtë drejtim, nga hulumtimi i praktikës shtetërore dhe i përgjigjes së bashkësisë ndërkombëtare gjatë krizave të rënda humanitare si “raste testimi” të PpM-së mund të konstatohet dhe të konkludohet se nuk ekziston një praktikë shtetërore e përgjithshme që do të ishte juridikisht e detyrueshme për shtetet sepse në këtë hulumtim u konstatuan disa kundërthënie identike të konceptit të PpM-së me ndërhyrjen ndërkombëtare para pranimit

të tij, gjë që na shpie në konkluzionin se koncepti i PpM-së megjithatë nuk ka sjellur ndryshime në të drejtën ndërkombëtare, me çrast rastet si: Gaza, Burma etj., flasin se koncepti i PpM-së shumë lehtë mund edhe të keqpërdoret.

Në këtë hulumtim u konstatua edhe dështimi i bashkësisë ndërkombëtare për të reaguar ndaj krizës humanitare në Siri, ngjashëm si në rastin e krizës humanitare në Ruandë. Nëse këtij konstatimi i shtohen edhe divergjencat mbi përdorimin e forcës pa autorizimin e KS-së lidhur me rastin e krizës humanitare në Kosovë atëherë do të bëhet e qartë se gjërat shumë pak kanë ndryshuar në të drejtën ndërkombëtare.

Siç u morr vesh në këtë hulumtim, sfida kryesore qëndron, dhe siç duket do të vazhdojë të mbetet, tek shtylla III e PpM-së në rastin e reagimit me veprime ushtarake për të cilën KS-ja, ashtu edhe siç argumentuam në këtë hulumtim, është organ politik, selektiv dhe i bllokuar në shumë situata të krimeve mizore, dhe nuk ka vepruar. Nga këto bllokada për shkak të veto-s në KS, shtetet e caktuara dhe argumentimet e studiuesve ende do të thirren në të drejtën e ndërhyrjes humanitare, ashtu siç ka ndodhur në të kaluarën. PpM-ja ende nuk e ka “bërë KS-në të funksionojë më mirë”, prandaj është e vështirë që të largohet diskursi i ndërhyrjes humanitare nga shtetet dhe shkrimet e studiuesve. Këto pretendime do të ishin legjitime nëse kemi një Këshill gjithmonë të bllokuar. Kështu, edhe përpjekjet për reformim të OKB-së dhe KS-së dhe miratimi i ndonjë marrëveshje ndërkombëtare për ndërhyrje ushtarake, deri më sot janë treguar gati të pamundshme për tu arritur.

PpM-ja është një koncept i hartuar mirë, dhe vetë fakti i pranueshmërisë universale flet për zhvillimin e saj në qarqet e ndryshme në botë, pavarësisht dështimeve në disa situata. PpM do të jetë alternativa më e mirë për situatat e ardhshme të krizave në shtete të ndryshme të botës, me një përgjegjësi më të madhe dhe serioze institucionale në mekanizmat e OKB-së. Në rrethana të tilla, një rregullim më i gjerë ligjor i përgjegjësisë së shtetit për të mbrojtur popullsinë e vet duket sot të jetë një detyrë jashtëzakonisht e rëndësishme e të drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, por edhe një lloj sprove e qëllimit dhe besueshmërisë së konceptit të PpM-së.

Me qëllim të funksionimit të përgjegjësisë parandaluese për të mbrojtur, të shteteve dhe bashkësisë ndërkombëtare, duke u bazuar në gjetjet kryesore të këtij hulumtimi, do të veçohen tri *rekomandime* kryesore si në vijim:

- Zbatimi i paragrafit 38-të të Dokumentit të Samitit Botëror dhe shtyllës I të PpM-së nga shtetet përmes zbatimit kushtetues të të drejtave të njeriut, krijimit të mekanizmave të mbrojtjes së tyre, duke përfshi dhe forcat e sigurisë dhe reformimin e tyre, të mos kryejnë çfarëdo krime në masë. Autoritetet shtetërore janë të obliguara gjithashtu edhe nga ndalimi ndërkombëtar i gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, të cilat rrjedhin nga normat *jus cogens*. Gjithashtu, i rëndësishëm është ratifikimi i instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për shtetet të cilat ende nuk janë palë në këto konventa. Sidomos pranimi i statutit të gjykatave penale ndërkombëtare;
- Ndalimi i krimeve të mizorisë mund të kontribuojë në zbatimin e ligjit sidomos në fushën e të drejtave të njeriut, zbatimi i të drejtave të pakicave kombëtare dhe barazia para ligjit (mos diskriminimi). Kjo mund të arrihet përmes institucioneve nga ato legislative në miratimin e ligjeve, institucioneve të pavarura gjyqësore, e deri te mekanizmat profesionale në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në fushën e të drejtave të njeriut si dhe kontributi i shoqërisë civile, do të ndihmonte në forcimin e kapaciteteve shoqërore në atë drejtim, me qëllim të shmangies së kryerjes së krimeve të ndryshme mizore. Një rol të rëndësishëm mund të luajë edhe krijimi i mekanizmave për paralajmërim të hershëm, krijimi i “pikave fokale” në shtetet të cilat ende nuk i kanë krijuar këto mekanizma përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, krijimi i strategjive dhe planeve shtetërore për bashkëpunim ndër-institucional do të ndihmonte poashtu në përmbushjen e përgjegjësisë shtetërore për të mbrojtur nga krimet mizore; dhe
- Zbatimi i shtyllës II të Dokumentit të Samitit Botëror të PpM-së nga bashkësia ndërkombëtare, me çrast OKB dhe organizatat regjionale duhet të kenë koordinim dhe bashkëpunim me qëllim të intensifikimit të raporteve me shtetet me qëllim të ofrimit të ndihmës institucionale, financiare dhe profesionale në ndihmë të shteteve për ndërtimin e kapaciteteve të tyre për ndalimin e krimeve të mizorisë. Pastaj, bashkëpunimi i shteteve nëpërmjet organizatave ndërkombëtare, bashkëpunimit regjional, në funksion të dialogut, trajnimit për të drejtat e njeriut dhe ofrimit të kapaciteteve të organizatave regjionale për shtetet nëpërmjet programeve të ndryshme të ndihmës.

BIBLIOGRAFIA

I. Libra

1. H. Lauterpacht, *The Grotian Tradition in International Law*, (1946) The British Year Book of International Law, (Oxford University Press 1946) 46.
2. L. Oppenheim, *International Law A Treaties*, (I) (Longmans, Green and Co. 1905) 186.
3. Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, (Seventh Edition, Oxford University Press, 2008).
4. Encyclopedia of Public International Law, *Use of Force War and Neutrality Peace Treaties*, (North-Holland Publishing Company, 1982) 2012.
5. Bruno Simma, *Charter of the United Nations: A Commentary*, (Volume I, 3rd edn., Oxford University Press, Volume I 2012).
6. Martin Dixon, *E Drejta Ndërkombëtare* (Botuar në gjuhën shqipe nga: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2011).
7. Christine Gray, *The Use of Force and the International Legal Order*, (3rd ed., Oxford University Press: 2003) 591-592.
8. Peter Malanczuk, *Akehurst's Modern Introduction to International Law*, (7th revised ed., Taylor & Francis e-Library, 2002).
9. Christine Gray, *International Law and the Use of Force*, (3rd ed., Oxford University Press, 2008).
10. Jannifer M. Welsh, *Humanitarian Intervention, and International Relations*, (Oxford University Press, 2004).
11. J. L. Holzgrefe, *The humanitarian intervention debate, Humanitarian Intervention, Ethical, Legal and Political Dilemmas*, (1st ed., Cambridge University Press 2003).
12. Jennifer M. Welsh, *Taking Consequences Seriously: Objections to Humanitarian Intervention, Humanitarian Intervention and International Relations*, (Oxford University Press, 2006).
13. James Pattison, *Humanitarian Intervention & The Responsibility to Protect, Who Should Intervene?*, (Oxford University Press, 2010).
14. Aidan Heir, *Humanitarian Intervention And Introduction*, (Pelgrave Macmillan, 2010).
15. Taylor B. Seybolt, *Humanitarian Military Intervention The Conditions for Success and Failure*, (Stockholm International Peace Research Institute, Edited by: Oxford University Press, 2008).
16. Karina Z. Butler, *A Critical Humanitarian Intervention Approach*, (Palgrave Macmillan, 2011).
17. Aidan Hehir, *Humanitarian Intervention after Kosovo Iraq, Darfur and the Record of Global Civil Society* (1st ed. PALGRAVE MACMILLAN, 2008).
18. Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, (botimi i plotësuar dhe i ndryshuar, Furkan ISM-Shkup, Prishtinë, 2009).
19. Michael Walzer, *Arguing About War*, (Yale University Press, 2004).
20. Professor H. Lauterpacht, *The Grotian Tradition in International Law*, (The British Year Book of International Law, Oxford University Press, 1946).
21. Anne Orford, 'Moral Internationalism and the Responsibility to Protect', (2013) (24)1, *The European Journal of International Law*, (Published by Oxford University Press 2013).
22. Michael Walzer, *Just And Unjust Wars, A Moral Argument with Historical Illustrations*, (Fourth Edition, Basic Books New York 2006).

23. Rajan Menon, *The Concept of Humanitarian Intervention*, (Oxford University Press 2016).
24. SIMON CHESTERMAN, 'Legality Versus Legitimacy: Humanitarian Intervention, the Security Council, and the Rule of Law', (2002) (33)3, *International Peace Academy*, (SAGE Publications), 297.
25. Eric A. Einze, *Waging Humanitarian War, The Ethics, Law, and Politics of humanitarian Intervention. Humanitarian Intervention in International Law*, (State University of New York Press, Albany, 2009).
26. Malcolm N. Shaw, *International Law*, (Sixth Edition, Cambridge University Press, 2008).
27. Christopher Greenwood, 'Humanitarian Intervention: The Case of Kosovo', (1999) (X) *Finnish Yearbook of International Law*.
28. Noam Chomsky, *Rouge States: The Rule of Force in the World Affairs*, (South End Press 2000).
29. Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian, A History of Kosovo*, (Columbia University Press New York, 1998).
30. Oliver Jens Schmitt, *KOSOVA Histori e Shkurtër e një Treve Qendrore Ballkanike*, (Botuar në shqip: KOHA 2012).
31. Noel Malcolm, *KOSOVA Një Histori e Shkurtër*, (botuar në shqip: KOHA 2011).
32. Richard Caplan, *Europe and the Recognition of New States in Yugoslavia*, (Cambridge University Press 2005).
33. Peter Radan, *Recognition of States in International Law*, (Routledge Handbook Of State Recognition, First published 2020 by Routledge).
34. John G. Stoessinger, *Whay Nations go to War*, (Eleventh Edition, Wadsworth Cengage Learning 2010).
35. Mark Weller, *Shtetësia e Kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, (botimi i dytë, botuar në shqip: KOHA, 2011).
36. Eric Herring, *From Rambouillet to the Kosovo accords: NATO'S war against Serbia and its aftermath*, (Routledge, 2014).
37. Ramesh Thakur, *The United Nations, Peace And Security- From Collective Security to the Responsibility To Protect* (Cambridge University Press 2006).
38. Gareth Evans, *The Responsibility to Protect, Ending Mass Atrocity Crimes Once And For All*, (Brookings Institution Press, 2008).
39. Pınar Gözen Ercan, *Debating the Future of the Responsibility to Protect The Evolution of a Moral Norm*, (palgrave macmillan, 2016).
40. Anne Orford, 'International Authority and the Responsibility to Protect', (Cambridge University Press 2011).
41. Aidan Hehir, *Hollow Norms and the Responsibility to Protect*, (palgrave macmillan, 2019).
42. Martin Binder, *The United Nations and the Politics of Selective Humanitarian Intervention*, (Palgrave Macmillan, 2017).
43. Sabrina Hoeling, 'Can R2P practice what it promises? A Case Study on the Syrian Civil War', (Hamburg, Anchor Academic Publishing, 2015).

II. Publikime shkencore

1. Las Cuevas, 'Exceptional Measures Call For Exceptional Times: The Permissibility Under International Law of Humanitarian Intervention to Protect a People's Right to Self-Determination' (2007), 37(2) *Houston Journal of International Law*.
2. Barry M. Benjamin, 'Unilateral Humanitarian Intervention: Legalizing the Use of Force to Prevent human Right Atrocities', (1992), (16)1 *article 4 Fordham International Law Journal* 127;
3. Chelsea O'Donnell, 'The Development of the Responsibility to protect: An Examination of the Debate Over the Legality of Humanitarian Intervention', (2014). (24)557, *Duke Journal of Comparative & International Law*.
4. Tania Von, 'Closing the gap between Legitimacy and legality of Humanitarian Intervention: Lessons from East Timor and Kosovo', (2012) *UCLA J. INT'L L. and & for AFF*.
5. Milena Sterio, 'Humanitarian Intervention, Post-Syria: Legitimate and Legal?', (2014) (40) 1, *Article 3, Brooklyn Journal of Internaitonal Law*, 119-120.
6. Randall Lesaffer, *Kellogg-Briand Pact (1928)*, Max Planck Encyclopedia of Public International Law, (Oxford University Press, 2011).
7. Christine Gray, 'The Use of Force and the International Legal Order', (Book Charter),
8. René Värk, 'The use of force in the modern World: Recent Developments and Legal Regulation of the Use of Force', (2003) (2)10 *Baltic Defence Review*, 29.
9. Mügr Kinancioğlu, 'The Principles of the Non-Intervention at the United Nations. The Charter Framework and the legal debate', (2005), *European Institute and Visiting Fellow, Centre for International Studies*,
10. Matthew C. Cooper, 'A Note To States Defending Humanitarian Intervention: Examining Viable Arguments Before The International Court Of Justice', (2012) (40)1-3, *DENV. J. INT'L L. & POL'Y*.
11. James A. Green and Francis Grimal, 'The Threat of Force as an Action in Self-Defense Under International Law', (2011) (44)285, *Vanderbilt Journal of Transnational law*, 295.
12. Adam Roberts, 'The So-Called 'Right' of Humanitarian Intervention', *Yearbook of International Humanitarian Law* (3)2000, (Oxford University Press 2000) 5.
13. Juan Carlos De Las Cuevas, 'Exceptional Measures Call for Exceptional Times: The Permissibility Under International Law of Humanitarian Intervention to Protect a People's Right to Self-Determination', (2015) (37)2 *Houston Journal of International Law*, 495.
14. Anne Ryniker, 'The ICRC's position on "humanitarian intervention"', (2001) (83)842, *RICR Juin IRRC*.
15. Nicholas J Wheeler, 'Legitimizing Humanitarian Intervention: Principles and Procedures', (2001) (2) *Melbourne Journal of International Law*.
16. Watanabe Koji, 'The Debate on Humanitarian Intervention, Humanitarian Intervention: The Evolving Asian Debate' (2003) (ed. Watanabe Koji), Tokyo: Japan Center for International Exchange.
17. David M. Mednicoff, 'Humane wars? International law, Just War theory and contemporary armed humanitarian intervention' (2006) (2) *Law, Culture and the Humanities*.
18. Terry Nardin, 'From Right to Intervene to Duty to Protect: Michael Walzer on Humanitarian Intervention', (2013) (24)1 *The European Journal of International Law*, (Published by Oxford University Press 2013).
19. Michael Walzer, 'Coda: Can the Good Guys Win?', (2013) (24)1, *The European Journal of International Law* (Published by Oxford University Press 2013).

20. Steve G. Simon, 'The Contemporary Legality Of Unilateral Humanitarian Intervention', (1993), California Western International Law Journal.
21. Nigel S. Rodley and Basak Cali, 'Kosovo Revisited: Humanitarian Intervention on the Fault Lines of International Law', (2007) (7)2, Human Rights Law Review (Published by Oxford University Press).
22. Ian Hurd, 'Is Humanitarian Intervention Legal? The Rule of Law in an Incoherent World', (2011) (25)33 Ethics & International Affairs, 25, no. 3 (2011), (Carnegie Council for Ethics in International Affairs).
23. John J. Merriam, 'Kosovo and the Law of Humanitarian Intervention', (2001) (33)1, Case Western Reserve Journal of International Law.
24. Adam Roberts, The united Nations and Humanitarian Intervention, (Edited by Jennifer M. Welsh: Humanitarian Intervention and International Relations'), (Published in the United States by Oxford University Press 2004).
25. Richemond, Daphné 'Normativity in International Law: The Case of Unilateral Humanitarian Intervention', (2003) (6)1, Article 2.
26. Michael Byers and Simon Chesterman, 'Changing the rules about rules? Unilateral humanitarian intervention and the future of international law, (HUMANITARIAN INTERVENTION Ethical, Legal, and Political Dilemmas E d i t e d b y J . L . HOLZGREFE AND ROBERT O. KEOHANE, Cambridge University Press 2003).
27. Thomas M. Franck, *Interpretation and change in the law of humanitarian intervention, HUMANITARIAN INTERVENTION* (Ethical, Legal, and Political Dilemmas E d i t e d b y J . L . HOLZGREFE AND ROBERT O. KEOHANE, Cambridge University Press 2003).
28. 'ECOWAS and the Subregional Peacekeeping in Liberia', (The Journal of Humanitarian Assistance, SEPTEMBER 25, 1995).
29. Peter A. Jenkins, 'The Economic Community of West African States and the Regional Use of Force, (2007) (35)2, DENV. J. INT'L L. & POL'Y.
30. Christian Tomuschat, 'Uniting for Peace General Assembly resolution 377 (V)', (Introductory Note, Audio Visual Library of International Law, 2008).
31. Alain Pellet, 'The Opinions of the Badinter Arbitration Committee A Second Breath for the Self-Determination of Peoples', (1992) European Journal of Internatinal Law 1992.
32. Enver Hasani, 'Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo's Self-Determination', (2005) (80)305.
33. Nicholas Morris, 'Humanitarian Intervention in the Balkans', (Edited by Jennifer M. Welsh: Humanitarian Intervention and International Relations, Published in the United States by Oxford University Press 2004).
34. Bruno Simma, 'NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects', (1999) European Journal of International Law.
35. Jane Stromseth, 'Rethinking Humanitarian Intervention: The Case For Incremental Change, Humanitarian Intervention Ethical, Legal, And Political Dilemmas' (E D I T E D B Y J . L . Holzgreffe And Robert O. Keohane, Cambridge University Press 2003).
36. Ruth Wedgwood, 'The American Journal of International Law' (1999) (93)828, Editorial Comments: Nato's Kosovo Intervention.
37. Klinton W. Alexander, 'Nato's Intervention In Kosovo: The Legal Case for Violating Yugoslavia's "National Sovereignty" In The Absence of Security Council Approval', (2000).
38. Petr Valek, 'Is Unilateral Humanitarian Intervention Compatible with the U.N. Charter?', (2005) (26)4, Michigan Journal of International Law.

39. Antonio Cassese, 'Ex iniuria oritur: Are We Moving toward International Legitimate of Forcible Humanitarian Countermeasures in the World Community?' (1999) (10), EJIL.
40. Gareth Evans, 'The Responsibility to Protect- From an Idea to an International Norm, Responsibility to Protect' (2009) *The Global Moral Compact for the 21st Century*, (Edited by Richard H. Cooper and Juliette Voinov Kohler, palgrave Macmillan, 2009).
41. Gareth Evans, 'The Responsibility to Protect: Rethinking Humanitarian Intervention', (March 31-April 3, 2004) (98) *Proceedings of the Annual Meeting (American Society of International Law)*.
42. Peter Hilpold, 'From Humanitarian Intervention to the Responsibility to Protect, Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?', (2015) Brill Nijhoff.
43. Gareth Evans and Mohamed Sahnoun, 'The Responsibility to Protect', (2002), (81)6, *Foreign Affairs*.
44. Hans-Georg Dederer, 'Responsibility to Protect' and 'Functional Sovereignty', 'Responsibility to Protect' and 'Functional Sovereignty', *Responsibility to Protect (R2P) (2015) A New Paradigm of International Law?*, Brill Nijhoff.
45. Diana Amneus, 'The coining and evolution of responsibility to protect: the protection responsibilities of the State', (2013) *An Institutional Approach to the Responsibility to Protect*, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
46. Michael W. Doyle New Haven, *The Question of Intervention John Stuart Mill and The Responsibility to Protect*, (Yale University Press 2015).
47. Alex J. Bellamy, 'The Responsibility to Protect A Wide or Narrow Conception?', *Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?*, (2015) Brill Nijhoff.
48. Gentian Zyberi, 'Sharing the responsibility to protect: taking stock and moving forward', *An Institutional Approach to the Responsibility to Protect*, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
49. ICRC, *The Geneva Conventions and Their Commentaries*, qasur: <<https://www.icrc.org/en/war-and-law/treaties-customary-law/geneva-conventions>>.
50. Diana Amneus, 'The coining and evolution of responsibility to protect: the protection responsibilities of the State', (2013) *An Institutional Approach to the Responsibility to Protect*, Edited by Gentian Zyberi, (Cambridge University Press 2013).
51. David Scheffer, 'Atrocity Crimes Framing the Responsibility to Protect, Responsibility to Protect *The Global Moral Compact for the 21st Century*', (2009), (Edited by Richard H. Cooper and Juliette Voinov Kohler, palgrave Macmillan, 2009).
52. Qerim Qerimi, 'All You Can Do is Pray': Implications for Human Rights Advocacy of the Lack of Recognition of Ethnic Cleansing as an International Crime on its Own', (2018) (1)18, *Journal of Human Rights Practice*, 1-18, Policy and Practice Note, (Published by: Oxford university Press).
53. William Pace, Nicole Deller, and Sapna Chhatpar, 'Realizing the Responsibility to Protect in Emerging and Acute Crises- A Civil Society Proposal for the United Nations Responsibility to Protect- *The Global Moral Compact for the 21st Century*' (Edited by Richard H. Cooper and Juliette Voinov Kohler, palgrave Macmillan, 2009).
54. Roland Paris, 'The 'Responsibility to Protect' and the Structural Problems of Preventive Humanitarian Intervention, (2014) (21)5, *International Peacekeeping*.
55. Debora Valentina Malito, 'Morality as a Catalyst for Violence: Responsibility to Protect and Regime Change in Libya', (2019) *Politikon*.

56. Ramesh Thekur, 'Libya and the responsibility to protect Between opportunistic humanitarianism and value-free pragmatism', (2012), Situation Report Institute for Security Studies.
57. Alan J. Kuperman, 'NATO's Intervention in Libya: A Humanitarian Success?', "Libya, the Responsibility to Protect and the Future of Humanitarian Intervention", (2013), Palgrave Macmillan.
58. Paul R. Williams & Colleen (Betsy) Popken, 'Security Council Resolution 1973 On Libya: A Moment of Legal & Moral Clarity', (2011) (44)225, Case W. Res. J. Int'l L.
59. Heidarali Teimouri and Surya P. Subedi, 'Responsibility to Protect and the International Military Intervention in Libya in International Law: What Went Wrong and What Lessons Could Be Learnt from It?', Journal of Conflict & Security Law (2018) (23)1, (Oxford University Press 2018).
60. Sari Bernstein, 'The Responsibility to Protect After Libya: Humanitarian Prevention as Customary International Law', (2012) (38)1 Brooklyn Journal of International Law, Article 8.
61. Marcos Tourinho, 'Oliver Stuenkel & Sarah Brockmeier, "Responsibility while Protecting": Reforming R2P Implementation', Global Society, (Routledge 2016).
62. Andrea Carati, 'Responsibility to protect, NATO and the problem of who should intervene: reassessing the intervention in Libya', (2017) Global Change, Peace & Security 13.
63. Alan J. Kuperman, 'NATO's Intervention in Libya: A Humanitarian Success?', "Libya, the Responsibility to Protect and the Future of Humanitarian Intervention", (2013), (Palgrave Macmillan Edited by Aidan Hehir and Robert Murray 2013).
64. David Berman and Christopher Michaelsen, 'Intervention in Libya: Another Nail in the Coffin for the Responsibility-to-Protect?', (2012) (14) International Community Law Review, (Martinus Nijhoff Publishers 2012).
65. Aidan Hehir, 'The Permanence of Inconsistency, Libya, the Security Council, and the Responsibility to Protect', (2013) (38)1, International Security.
66. Sarah Brockmeier, Oliver Stuenkel & Marcos Tourinho, 'The Impact of the Libya Intervention Debates on Norms of Protection', (2016) (30)1, Global Society.
67. Thorsten Benner, Brazil as a norm entrepreneur: the "Responsibility While Protecting" initiative, (2013) Global Public Policy Institute, (GPPi working paper).
68. Xenia Avezov, 'Responsibility while protecting': are we asking the wrong questions?', (2013) Stockholm International Peace Research Institute, 2013.
69. Ramesh Thekur, 'Libya and the responsibility to protect Between opportunistic humanitarianism and value-free pragmatism' (2012) Situation Report, Institute for Security Studies.
70. Anne Peters, 'The Security Council's Responsibility to Protect', (2011), International Organizations Law Review 8 (Martinus Nijhoff Publishers).
71. Chelsea Koester, 'Looking Beyond R2p for an Answer to Inaction In The Security Council', (2015) (27), Florida Journal Of International Law.
72. Cedric Ryngaert and Hanne Cuyckens, 'The General Assembly', (2013), An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
73. Nicholas Turner, 'The Secretary-General', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
74. Gentian Zyberi, 'The International Court of Justice', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).

75. Daniel Fiott and Marie Vincent, 'The European Union, An Institutional Approach to the Responsibility to Protect' (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
76. Matthias Dembinski and Berenike Schott, 'Regional security arrangements as a filter for norm diffusion: the African Union, the European Union and the responsibility to protect' (2014) (27)2, Cambridge Review of International Affairs.
77. Rhona Smith And Conall Mallory, 'The European system of human rights', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
78. Jeremy Sarkin, 'The Responsibility to Protect and Humanitarian Intervention in Africa, Global Responsibility to Protect' 2 (2010), Martinus Nijhoff Publishers.
79. Dan Kuwali, 'Humanitarian Rights': 'Bridging the Doctrinal Gap between the Protection of Civilians and the Responsibility to Protect', (2013), Journal of International Humanitarian Legal Studies 4 (Brill Nijhoff).
80. Solomon A. Dersso, 'The African Union', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
81. Frans Viljoen, 'The African system of human rights', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
82. Mahasen M. Aljaghoub, Ibrahim M. Aljazy And Maysa S. Bydoon, 'The Arab League', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
83. Paulo De Tarso Lugon Arantes, 'The Organization of American States', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
84. Jody M. Prescott, 'The North Atlantic Treaty Organization', An Institutional Approach to the Responsibility to Protect, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
85. Stefan Kadelbach, 'The European Union's Responsibility to Protect, Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?', (2015) Brill Nijhoff.
86. Peter-Tobias Stoll, 'The Responsibility to Protect, One-time Incentive or Lasting Advancement for International law? Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?' (2015) Brill Nijhoff.
87. Raphaël van Steenberghe, 'The Notions of the Responsibility to Protect and the Protection of Civilians in Armed Conflict: Detecting Their Association and Its Impact Upon International Law', (2014) (6)1, Goettingen Journal of International Law.
88. Andrew Garwood-Gowers, 'The Responsibility To Protect And The Arab Spring: Libya As The Exception, Syria As The Norm?', (2013) (36)2, UNSW Law Journal Volume.
89. Astha Pandey, 'The Responsibility To Protect ("R2P") In International Law: Protection of Human Rights or Destruction of State Sovereignty?', (2013) 115, NLUJ Law Review.
90. Monica Hakimi, 'Toward a Legal Theory on The Responsibility to Protect', (2014) (39)247, The Yale Journal of International Law.
91. Savita Pawnday, 'Jaclyn Streitfeld-Hall, The Practitioner's Perspective: R2P at 15, global responsibility to protect' (2020) (12) Brill Nijhoff.
92. Simon Chesterman, 'R2P and humanitarian Intervention: From Apology to Utopia and Back Again', [Written for Robin Geiß & Nils Melzer (eds.), The Oxford Handbook on the International Law of Global Security (Oxford University Press, Forthcoming 2018).
93. E. Tendayi Achiume, 'Syria, Cost-sharing, and the Responsibility to Protect Refugees', (2015) (100)687, Minnesota Law Review.

94. Amy E. Eckert, 'The Responsibility to Protect in the Anarchical Society: Power, Interest, And The Protection Of Civilians In Libya And Syria', (2012) 41(1), Denv. J. Int'l. & Pol'y.
95. Simon Adams, 'Failure to Protect: Syria and the Security Council, (2015), Global Centre for the Responsibility to Protect.
96. Jenna B. Russo, 'R2P in Syria and Myanmar: Norm Violation and Advancement, global responsibility to protect' (2020) (12) Brill Nijhoff.
97. Terry D. Gill, "The Security Council", *An Institutional Approach to the Responsibility to Protect*, (Edited by Gentian Zyberi, Cambridge University Press 2013).
98. Karin Oellers-Frahm, 'Responsibility to Protect Any New Obligations for the Security Council and Its Members?', *Responsibility to Protect (R2P) A New Paradigm of International Law?* (2015) Brill Nijhoff.
99. Luke Glanville, 'Syria Teaches Us Little about Questions of Military Intervention, Into the Eleventh Hour: R2P, Syria and Humanitarianism in Crisis', (2014) (Edited by Robert W Murray, & Alsdair Mckey) E- International Relations United Kingdom.

III. Raporte ndërkombëtare

1. Danish Institute of International Affairs 1999 *Humanitarian Intervention, Legal and Political Aspects*, (1999)
2. Report of the International Commission on Intervention and State Sovereignty (ICISS), *The Responsibility to Protect* (2001), International Development Research Centre,
3. Mügr Kinancioğlu, 'The Principles of the non-intervention at the United Nations. The Charter Framework and the legal debate', (2005), European Institute and Visting Fellow, Centre for International Studies, 17.
4. Danish Institute of International Affairs, *Humanitarian Intervention, Legal and Political Aspects* (1999).
5. Danish Institute of International Affairs, *HUMANITARIAN INTERVENTION, Legal and political Aspects*, 1999 (1999).
6. Dajena Kumbaro, *The Kosovo Crisis in an International Law Perspective: Self-Determination, Territorial Integrity and the NATO Intervention*, (2001) (Final Report, for: North Atlantic Treaty Organisation, Office of Information and Press, 2001).
7. The Independent International Commission on Kosovo, *The Kosovo Report *Conflict *International Response *Lessons Learned*, (2000) Oxford University Press.
8. OSCE Kosovo *As Seen, As Told: An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission October 1998 to June 1999*, (Verification Mission October 1998 to June 1999, KOSOVO / KOSOVA) Organization for Security and Co-operation in Europe Office for Democratic Institutions and Human Rights.
9. Council of Europe: *Parliamentary Assembly, Recommendation 1385 (1998) Situation of the Kosovo refugees, asylum seekers and displaced persons*, 24 September (1998), 1385.
10. Committee of Ministers of the Council of Europe, *Federal Republic of Yugoslavia and Kosovo, International monitoring of the situation in the Federal Republic of Yugoslavia (FRY) and Kosovo in particular, Document prepared by the Directorate of Political Affairs*, (1998).
11. Report Of The Secretary-General Prepared Pursuant oo Resolutions 1160 (1998) and 1199 (1998) of the Security Council, Security Council, (S/1998/912 3 October 1998).
12. Julie Kim, *Kosovo Conflict Chronology: (1998) - March 1999 April 6, 1999*, CRS Report for Congress, Congressional Research Service ~ The Library of Congress, 1999.

13. Foreign Affairs Committee, *Response of the Secretary of State for Foreign and Commonwealth Affairs*, Fourth Report, from the Session(1999–2000), Presented to Parliament by the Secretary of State for Foreign and Commonwealth Affairs by Command of Her Majesty August 2000, para. 105, 1011, 115.
14. United Nations, International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, *Final Report to the Prosecutor by the Committee Established to Review the NATO Bombing Campaign Against the Federal Republic of Yugoslavia*, (1999).
15. 'Secretary-General Statements and Messages Secretary-General Presents his Annual Report to General Assembly', (1999) (Press Release SG/SM/7136 GA/9596).
16. House of Commons, *Foreign Affairs- Fourth Report, Foreign Affairs Committee Publications*, (Session 1999- 2000).
17. Kofi A. Annan Secretary- General of the United Nations, *We the Peoples' The Role of the United Nations in the 21'st Century*, (United Nations 2000).
18. Report of the Secretary-General's High-Level Panel on Threats, *Challenges and Change on A More Secure World: Our Shared Responsibility*, (2004) (A/59/565).
19. Report of the Secretary- General's on *In Larger Freedom: Towards Development, Security and Human Rights for All*, (2005) (A/59/2005).
20. Report of the Secretary-General, *Implementing the responsibility to protect*, (A/63/677, 12 January 2009).
21. UN Security Council *Report on Libya*, (14 March 2011) <https://www.securitycouncilreport.org/update-report/lookup_c_glkwlemtisg_b_6621881.php>.
22. UN Human Rights Council- 'Independent Fact-Finding Mission on Libya' <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/FFM_Libya/Pages/Index.aspx>.
23. 'Council Of The European Union', (14820/05), (22 November 2005) 13 <<https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST%2014820%202005%20INIT/EN/pdf>> qasur: 2 Korri 2020.
24. European Parliament recommendation to the Council of 18 April 2013 on the UN principle of the 'Responsibility to Protect' ('R2P') (2012/2143(INI).
25. Salil Shetty, Secretary General at Amnesty International, *Amnesty International Annual Report* (2014/2015) <<https://www.amnesty.org/en/latest/research/2015/02/annual-report-201415/>>.
26. Human Rights Watch, "We Live as in War", *Crackdown on Protesters in the Governorate of Homs, Syria*, (November 2011).
27. Human Rights Watch, (World Report 2012) (Events of 2011) <<https://www.hrw.org/world-report/2012/country-chapters/syria>>.
28. Human Rights Whatch, (World Report 2013) *Syria*, (Events of 2012) <<https://www.hrw.org/world-report/2013/country-chapters/syria#>>.
29. Human Rights Whatch, (World Report 2014) (Events of 2013) <<https://www.hrw.org/world-report/2014>>.
30. Human Rights Watch, (World Report 2015) *Syria*, (Events of 2014) qasur në: <https://www.hrw.org/world-report/2015/country-chapters/syria>>.
31. Human Rights Watch (Report 2016) *Syria* (Events of 2015) <<https://www.hrw.org/world-report/2016/country-chapters/syria>>.
32. Human Rights Watch Report 2019: *Syria*, Events of 2018, qasur në: <<https://www.hrw.org/world-report/2019/country-chapters/syria>>.

33. Human Rights Watch (Report 2020) *Syria* (Events of 2019) <<https://www.hrw.org/world-report/2020/country-chapters/syria>>.
34. Human Rights Watch Report 2021: *Syria, Events of 2020*, qasur në: <<https://www.hrw.org/world-report/2021/country-chapters/syria>>.
35. The Human Rights Council, 'Situation of human rights in the Syrian Arab Republic', Resolution adopted by the Human Rights Council at its seventeenth special session, S-17/1, (2011).
36. Human Rights Watch, 'Attacks on Ghouta', Analysis of A llegal Use of Chimical Wapons in Syria, (September 10 2013) <<https://www.hrw.org/report/2013/09/10/attacks-ghouta/analysis-alleged-use-chemical-weapons-syria>>.
37. Human Rights Watch, *Death by Chemicals, The Syrian Government's Widespread and Systematic Use of Chimical Wapons*, (May 1, 2017) <<https://www.hrw.org/report/2017/05/01/death-chemicals/syrian-governments-widespread-and-systematic-use-chemical-weapons>>.
38. House of Commons Foreign Affairs Committee, 'Global Britain: The Responsibility to Protect and Humanitarian Intervention', Twelfth Report of Session 2017–19, (Published on 10 September 2018 by authority of the House of Commons).
39. Louis Charbonneau, 'UN Chief Should Order Inquiry into Syria Hospital Attacks' Human Rights Watch, (31 July 2019) <<https://www.hrw.org/news/2019/07/31/un-chief-should-order-inquiry-syria-hospital-attacks>>.

IV. Dokumente: Ligje dhe Konventa Ndërkombëtare

1. Covenant of the League of Nations, (28 April 1919), <<http://www.unhcr.org/refworld/docid/3dd8b9854.html>> qasur 18 Prill 2018.
2. United Nations Charter, (United Nations 1945), e vlefshme në: <<https://www.un.org/en/about-us/un-charter>>.
3. 'Ligji kushtetues të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës' ("Fleta zyrtare e KSAK Nr. 6 më 25 Shkurt 1969).
4. 'Constitution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia' (1974), (Official Gazette of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia, no. 9/1974 (1974).
5. 'Krahina Socialiste Autonome e Kosovës', ("Gazetën Zyrtare të KSAK", nr. 4 të 27 shkurtit 1974).
6. 'The Interim accord of the Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo', (7 June 1999) S/1999/648.
7. Military Technical Agreement between the International Security Force ("KFOR") and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia', (9 June 1999).
8. The UN General Assembly, (2005) *World Summit Outcome*, (A/60/L.1).
9. Convention on the Prevention and the Punishment of the Crime of Genocide, (General Assembly resolution 260 A (III) (9 December 1948).
10. Rome Statute of the International Criminal Court, (Published by International Criminal Court, Netherlands 2011).

V. Raste gjyqësore

1. *Armed Activities on the Territory of the Congo (Democratic Republic of the Congo v Uganda)* [2005] ICJ Rep 168.
2. *Case Concerning Military and Paramilitary Activities in and Against Nicaragua (Nicaragua v. United States of America)*, (Merits, Judgment.), [1986] ICJ Rep 1986, p 14.
3. Corfu Channel case (Judgement) [1949] Rap. 1949 I.C.J., p.4.
4. ICJ, *Legality of Use of Force (Serbia and Montenegro v. Belgium)*.
5. *Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (Bosnia and Herzegovina v. Serbia and Montenegro)*, Judgment [2007], ICJ 2007.

VI. Rezoluta në OKB

1. UN A/RES/2625(XXV) (1970),
2. UN, GA Res. 377 (A) (1950).
3. UN, S/RES/688 (1991)
4. UN, S/RES/788 (1992)
5. UN, S/RES/813 (1993)
6. UN, S/RES/1123 (1997)
7. UN, S/RES/1132 (1997)
8. UN, S/RES/1181 (1998)
9. UN, S/RES/1270/ (1999)
10. UN, S/RES/1160 (1998)
11. UN, S/RES/1199 (1998)
12. UN, S/RES/1203 (1998)
13. UN, S/1999/328 (1999)
14. UN, S/RES/1244 (1999)
15. UN, S/PV.3988 (1999)
16. UN, S/1999/328 (1999)
17. UN, S/2005/740 (2005)
18. UN, S/RES/1674 (2006)
19. UN, S/RES/1706 (2006)
20. UN, S/RES/1653 (2006)
21. UN S/RES/1970 (2011)
22. UN, A/RES/65/265 (2011)
23. UN, A/HRC/17/45 (2011)
24. UN, S/RES/1973 (2011)
25. UN, S/RES/2016 (2011)
26. UN, A/66/551–S/2011/701 (2011)
27. UN, A/RES/66/176, (2011)
28. UN, A/RES/66/253 B, (2012)
29. UN, S/RES/2042 2012, (2012)
30. UN, S/RES/2043 2012, (2012)
31. UN, S/RES/2059 2012, (2012)
32. UN, S/RES/2118 2013, (2013)
33. UN, A/RES/68/182, (2014)
34. UN, S/RES/2139 2014, (2014)

35. UN, S/RES/2165 2014, (2014)
36. UN, S/RES/2170 2014, (2014)
37. UN, S/RES/2199, (2015)

VII. Njoftime për shtyp/deklarata

1. UN, Press Release, SC/6481, (26 February 1998).
2. NATO, Statement by the Secretary General, Press Statement Vilamoura (24 Sept. 1998).
3. Javier Solana, Secretary General of NATO, Press Release (1999)040 23 March 1999.
4. Javier Solana and Saceur, Gen. Wesley Clark, Press Conference, (Transcript 25 Mar. 1999).
5. Press Release SC/6659, SC/6659 (26 MARCH 1999).
6. Press Release, UN, SC/6659, SC/6659 (26 March 1999).
7. Press Release, UN, SG/SM/7136, (20 September 1999).
8. UN Secretary-General Ban Ki-moon's address at an event on "Responsible Sovereignty: International Cooperation for a Changed World", in Berlin, (2008) <<https://www.globalpolicy.org/component/content/article/154/26074.html>> qasur: 22 Mars 2020.
9. UN News, Global Perspectives Human Stories, 'Libya: Security Council, UN officials urge end to use of force against protesters' (22 February 2011) <<https://news.un.org/en/story/2011/02/367182-libya-security-council-un-officials-urge-end-use-force-against-protesters>>.
10. UN SC, S/PV.6498 (6498th meeting Thursday, 17 March 2011).
11. United Nations Secretary-General, *Statement on Libya*, (17 March 2011) <<https://www.un.org/sg>> qasur: 1 Prill 2020.
12. United Nations Secretary-General, *Secretary-General's message to Third Meeting of the Contact Group on Libya*, (Statements on 09 June 2011).
13. UNHCR, The UN Refugee Agency, *Libya*, (2017) <<https://www.unhcr.org/libya.html>>.
14. 'General Assembly of the United Nations General Debate Brazil H.E. Mrs. Dilma Rousseff', (President 21 September 2011) (66th Session), Statement Summary <<https://gadebate.un.org/en/66/brazil>>.
15. The JCMS Blog Insight from the Journal of Common Market Studies, 'The European Union and the Responsibility to Protect' <<http://jcms.ideason europe.eu/2020/05/13/the-european-union-and-the-responsibility-to-protect/>>.
16. António Guterres, United Nations Secretary-General, *Remarks to the Human Rights Council*, (27 February 2017).
17. Gareth Evans, 'Interview: The R2P Balance Sheet After Libya, The Responsibility to Protect: challenges & opportunities in light of the Libyan intervention, (Edited by Alex Stark, 2011) e-International Relations.
18. European Parliament, P7_TA(2011)0333, (7 July 2011) shih gjithashtu: European Parliament, P7_TA(2011)0387, (15 September 2011).
19. UN Security Council 6598th meeting, S/PV.6598, (3 August 2011).

20. UN Security Council, 6710th meeting Tuesday, S/PV.6710, (31 January 2012).
21. UN Security Council 6711th meeting Saturday, S/PV.6711 (4 February 2012).
22. UN Security Council, S/PRST/2012/10, (5 April 2012).
23. UN Security Council, S/PRST/2012/6*, (21 March 2012).
24. Paul Kawika Martin, 'Un General Secretary Ban Ki-Moon: 9/24/13 General Assembly Speech', (September 24, 2013).
25. UN Security Council, 7180th meeting, S/PV.7180, (22 May 2014).
26. UN Security Council S/PV.7825, (5 December 2016).
27. OHCA, reliefweb, 'Statement of the International Syria Support Group' (November 14, 2015), News and Press Release 14 Nov 2015.
28. UN Security Council, S/PV.7893, (28 February 2017).
29. Council of the EU, Brussels II Conference on 'Supporting the future of Syria and the region': co-chairs declaration, (25 April 2018) para 1
<<https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2018/04/25/brussels-ii-conference-on-supporting-the-future-of-syria-and-the-region-co-chairs-declaration/>>.
30. Council of the EU, 'Supporting the future of Syria and the region' - Brussels III conference, (12-14 March 2019)
<<https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-ministerial-meetings/2019/03/12-14/>>.
31. Council of the EU, 'Supporting the future of Syria and the region' Brussels IV Conference, (30 June 2020)
<<https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-ministerial-meetings/2020/06/30/>>.

VIII. Burime nga interneti

1. Momčilo Pavlović, 'Yugoslavia – the constitution of 1974 and some political results', (Transconflict 2013) < <http://www.transconflict.com/2013/04/yugoslavia-the-constitution-of-1974-and-some-political-results-19/>>
2. 'Kosovo Verification Mission' (KVM) (Government of Canada October 1998 - March 1999) <<https://www.canada.ca/en/departement-national-defence/services/military-history/history-heritage/past-operations/europe/kimono.html>>.
3. Bill Clinton, 'Transcript: Clinton addresses nation on Yugoslavia strike', (CNN March 24, 1999)
<<http://edition.cnn.com/ALLPOLITICS/stories/1999/03/25/clinton.transcript/>>.
4. UN Office on Genocide Prevention, and the Responsibility to Protect, 'Responsibility to Protect', <<https://www.un.org/en/genocideprevention/about-responsibility-to-protect.shtml>>
5. Global Centre for the Responsibility to protect, The Responsibility to Protect: A Background briefing', 1,
<<https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/the-responsibility-to-protect-background-briefing.pdf>>.
6. Barack Obama, David Cameron and Nicolas Sarkozy, 'Libya's Pathway to Peace', *The New York Times*, (April 14, 2011)
<<https://www.nytimes.com/2011/04/15/opinion/15iht-edlibya15.html>> qasur: 30 Prill 2020.

7. 'The UN Office on Genocide and the Responsibility to Protect, Security Council', qasur: <<https://www.un.org/en/genocideprevention/security-council.shtml>>.
8. Global Centre for the Responsibility to protect, *UN Security Council Resolutions and Presidential Statements Referencing R2P*, (2019) <<https://www.globalr2p.org/wp-content/uploads/2020/01/UNSC-Resolutions-and-Statements-with-R2P-Table-as-of-14-January-2020.pdf>>.
9. UN Office on Genocide and the Responsibility to Protect, 'General Assembly', qasur: <<https://www.un.org/en/genocideprevention/general-assembly.shtml>>.
10. Global Centre for the Responsibility to Protect, 'UN General Assembly Resolutions Referencing R2P', qasur në: <<https://www.globalr2p.org/resources/un-general-assembly-resolutions-referencing-r2p/>>.
11. The UN Office of Genocide Prevention and the Responsibility to protect, 'Secretary-General', <<https://www.un.org/en/genocideprevention/secretary-general.shtml>>.
12. Un Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect' <<https://www.un.org/en/genocideprevention/office-man>>.
13. The UN Office of Genocide Prevention and the Responsibility to protect, 'Secretary-General', <<https://www.un.org/en/genocideprevention/secretary-general.shtml>> qasur: 27 Qershor 2020.
14. The UN Office of Genocide and the Responsibility to Protect, 'Human Rights Council', <<https://www.un.org/en/genocideprevention>> qasur: 28 Qershor 2020.
15. Global Centre for the Responsibility to Protect, 'UN Human Rights Council Resolutions Referencing R2P' <<https://www.globalr2p.org/resources/un-human-rights-council-resolutions-referencing-r2p/>>.
16. UN Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect, 'Regional Organizations', <<https://www.un.org/en/genocideprevention/regional-organisations.shtml>>.
17. Reuters Staff, 'Arab League suspends Libya delegation', Reuters (February 22, 2011) <<https://www.reuters.com/article/libya-protests-league-idUSLDE71L2GK20110222>>.
18. Global Centre for the Responsibility to Protect, 'Group of Friends of the Responsibility to protect', <<https://www.globalr2p.org/group-of-friends-of-the-responsibility-to-protect/>>.
19. 'European Centre for the Responsibility to Protect', (University of Leeds) <<https://ecr2p.leeds.ac.uk/about-2/about/>>.
20. 'Asia- Pasific for the Responsibility to Protect', (The University or Queensland Australia) <<https://r2pasiapacific.org/team/our-staff>>.
21. 'Canadian Centre for the Responsibility to Protect' <<http://ccr2p.org/>>.
22. 'International Coalition for the Responsibility to Protect' <<https://www.devex.com/organizations/international-coalition-for-the-responsibility-to-protect-59778>>.
23. The UN Office on Genocide Prevention and the Responsibility to Protect, 'Civile Society', qasur: <<https://www.un.org/en/genocideprevention/civil-society.shtml>>.
24. European Centre for the Responsibility to Protect (ECR2P) Annual Lecture (Online), 'Leeds University', (26 November 2020) by Professor the Hon Gareth Evans, 2020 Annual Lecture – Professor Gareth Evans, <<https://ecr2p.leeds.ac.uk/ecr2p-annual-lectures/2020-annual-lecture-professor-gareth-evans/>>.

25. Ivan Šimonović, 'R2P: Operationalisation or Marginalisation?', (2017) Annual Lecture-European Centre for the Responsibility to Protect, <<https://ecr2p.leeds.ac.uk/ecr2p-annual-lectures/2017-annual-lecture/>>.
26. News Wires, 'Syria May have used chemical weapons in 2018, says watchdog', *France 24* (2021) <<https://www.france24.com/en/middle-east/20210412-syria-may-have-used-chemical-weapons-on-town-in-2018-says-watchdog>>.
27. The UN Refugee Agency, 'Syria emergency', (2021) <<https://www.unhcr.org/syria-emergency.html>>.
28. Neil MacFarquhar, 'Arab League Voted to Suspend Syria Over Crackdown', *The New York Times*, (Nov. 12, 2011).
29. United Nations Supervision Mission in Syria, 'UNAMIS Background' (2012), qasur në: <<https://peacekeeping.un.org/en/mission/past/unsmis/background.shtml>>.
30. Karen DeYoung, 'Syria Conference fails to specify plan for Assad', *The Washington Post*, (June 30, 2012)____<https://www.washingtonpost.com/world/national-security/syria-conference-fails-to-specify-plan-for-assad/2012/06/30/gJQAsPfeEW_story.html>
31. James Robbins, 'US and Russia agree Syria chemical weapons deal in Geneva', *BBC* (14 September 2013) <<https://www.bbc.com/news/av/world-middle-east-24090056>>.
32. 'Syria: Cameron and Obama threaten 'serious response'', *BBC* (25 August 2013) qasur: <<https://www.bbc.com/news/uk-23830590>>.
33. 'Syria crisis: Cameron loses Commons vote on Syria action', *BBC News* B30 August 2013, <<https://www.bbc.com/news/uk-politics-23892783>>.
34. UK Government, 'Chemical Wapons use by Syrian Regime', (UK Government Legal position, 2013) para. 3- 4, <<https://www.gov.uk/government/publications/chemical-weapon-use-by-syrian-regime-uk-government-legal-position/chemical-weapon-use-by-syrian-regime-uk-government-legal-position-html-version>>.
35. Paul Lewis, 'US attack on Syria delayed after surprise U-turn from Obama', *The Guardian* (31 August 2013) <<https://www.theguardian.com/world/2013/aug/31/syrian-air-strikes-obama-congress>>.
36. 'What is the Geneva II conference on Syria?', *BBC* (22 January 2014) <<https://www.bbc.com/news/world-middle-east-24628442>>.
37. 'Syria: US begins air strikes on Islamic State targets', *BBC* (23 September 2014) <<https://www.bbc.com/news/world-middle-east-29321136>>.
38. 'Syria war: US launches missile strikes in response to 'chemical attack'', *BBC*, (7 April 2017) <<https://www.bbc.com/news/world-us-canada-39523654>>.
39. 'Syria used chemical weapons on civilians in 2018: OPCW', *DW* (12.04.2021) <<https://www.dw.com/en/syria-used-chemical-weapons-on-civilians-in-2018-opcw/a-57168683>>.
40. Julia Masterson and Leanne Quinn, 'Arms Control Association', May 2021, qasur në: <<https://www.armscontrol.org/factsheets/Timeline-of-Syrian-Chemical-Weapons-Activity>>.
41. Amanda Macias, 'Trump orders targeted strikes in Syria to retaliate for suspected chemical weapons attack', *CNBC*, April 13 2018, <<https://www.cnn.com/2018/04/13/trump-to-address-the-nation-about-syria-nbc-news.html>>.

41. The UK Government', 'PM's press conference statement on Syria' (14 April 2018), The Prime Minister addressed the press with the following statement in Downing Street this morning, qasur në: <<https://www.gov.uk/government/speeches/pms-press-conference-statement-on-syria-14-april-2013>>.
42. Michelle Nichols, Russia casts 13th veto of U.N. Security Council action during Syrian war, Reuters, (September 19, 2019) <<https://www.reuters.com/article/us-syria-security-un-iduskbn1w42cj>>.
43. Global Centre for the Responsibility to protect, 'UN Security Council Resolutions and Presidential Statements Referencing R2P', <<https://www.globalr2p.org/wp-content/uploads/2020/01/UNSC-Resolutions-and-Statements-with-R2P-Table-as-of-14-January-2020.pdf>>.
44. Global Centre for the Responsibility to Protect, 'Syria' (2021) <<https://www.globalr2p.org/countries/syria/>>.

INDEKSI I KUPTIMEVE

Asociacion.....	26	<i>De lege ferenda</i>	103
Aziatike.....	26, 171		107, 175
<i>Adhoc</i>	45	Europiane.....	8, 96
Akti Final i Helsinkit (1975)	90		166, 167, 168, 171, 186
Autonomia.....	71, 72	Embargo.....	62, 79
	74, 77, 85, 88, 91, 119		99, 137
Agresioni.....	32, 45	<i>Erga omnes</i>	125
	66	<i>Ex post facto</i>	165
Avokim.....	171, 66	Grupi i Kontaktit.....	79
Armëpushim.....	85, 88		81, 82, 83, 88
	95, 142, 168, 191, 196, 199	Gjenocidi.....	V, 19
Asistencë humanitare.....	60		30, 34, 52, 57, 64, 96, 122, 112, 124, 1125,
Autorizim.....	V, 18		126, 128, 129, 130, 131, 134, 135, 152, 157,
	47, 48, 58, 60, 62, 64, 65, 67, 89, 92, 97,		159, 160, 161, 163, 166, 168, 171, 173, 178,
	98, 193, 104, 106, 108, 109, 117, 132,		181, 209, 2012
	133, 140, 149, 151, 154, 156, 164, 165,	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.....	12
	174, 195, 203, 206, 207, 209,		15, 16, 17, 26, 50, 102, 109, 126, 128, 164
<i>Bellum justum</i>	10	Gjykata Penale Ndërkombëtare...	127, 137
Bipolariteti.....	24		120, 193
Deklarat.....	7, 13	Holokausti.....	42
	14, 36, 56, 67, 75, 82, 91, 98, 99, 110, 119	<i>Inter alia</i>	10, 122, 139
	124, 134, 139, 148, 158, 161, 166, 171	Juridiksioni.....	7, 14
	175, 178, 189, 191		50, 51, 52, 101, 118, 119, 126, 174
Deklarata Universale për të Drejtat e		<i>jus cogens</i>	12, 17, 53
Njeriut.....	119		104, 127, 181, 207, 212.
Deklarata për Marrëdhëniet		<i>jus ad bellum</i>	36
Miqësore.....	13	<i>jus in bello</i>	36
<i>De lege lata</i>	102	<i>jus post bellum</i>	36

Konventa e Lidhjes së Kombeve.....	10	Paktit Veri- Atlantik (NATO).....	1
Kanali i Suezit.....	9	6, 23, 25, 30, 49, 56, 64, 69, 79, 82, 84, 85,	
13		89, 90, 91, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100	
Konferenca e Rambujesë (1999).....	87	101, 102, 103, 105, 106, 107, 1-8, 109, 110	
88, 89, 90, 91, 92, 99		112, 112, 136, 138, 139, 140, 141, 142, 144	
Konventat e Gjenevës (1949).....	127	146, 147, 150, 158, 165, 166, 170, 206, 207	
Kushtetuta.....	70	209	
71, 72		Pakti për të Drejtat Ekonomike Social dhe	
Marrëdhëniet ndërkombëtare.....	11	Kulturore.....	119
14, 21, 29		Përdorimi i forcës.....	10, 11
Marrëveshja e Dejtonit (1995).....	78	14, 15, 18, 35, 45, 60, 94, 97, 99, 102, 103,	
82		106, 146	
Ndërhyrja humanitare.....	V, VI	Perëndimore.....	14, 20
1, 3, 9, 10, 17, 20, 21, 22, 21, 26, 30, 31, 33		24, 25, 26, 52, 56, 59, 70, 146, 147, 148, 149	
36, 38, 39, 40, 41, 43, 44, 48, 49, 53, 64, 65		186, 201, 205, 207	
98, 103, 106, 107, 108, 1012, 1013, 205,		Përgjegjësia për të mbrojtur (PpM)....	1, 4, 5,
206, 208, 2011		6, 22, 27, 103, 111, 112, 114, 115, 116, 118,	
<i>Non grata</i>	86	120, 121, 122, 123, 125, 127, 128, 129, 130,	
Normë morale.....	V, 24	131, 133, 134, 135, 136, 139, 140, 141, 142,	
26, 27, 175, 181		143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151,	
Opinionit Publik.....	8	152, 153, 153, 155, 156, 157, 158, 159, 160,	
73		161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168, 169,	
<i>Opinio juris</i>	55	170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178,	
63, 104, 105, 107, 108, 174		179, 180, 181, 182, 198, 200, 202, 203, 204,	
Organizatat regjionale.....	6	208, 209, 2010, 2011, 2012	
65, 165, 2012		Përgjegjësia duke mbrojtur.....	144, 145
Perandoria Osmane.....	8	147, 148, 149, 150, 209	
Pakti “Briant Kellog”.....	10		
11, 39,			
Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike...	119		

Refugjat.....	33	Luftë.....	5
57, 80, 81, 82, 84, 89, 93, 94, 95, 96, 137,		8, 27, 28, 29, 31, 32, 34, 35, 93, 125, 184,	
143, 164, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 199,		185, 197	
201,		Lufta e Ftohtë.....	15
Studiuues.....	V	63	
VI, 1, 5, 6, 7, 9, 11, 21, 28, 29, 39, 42, 45, 49		Lufta e parë botërore.....	39
53, 54, 55, 57, 58, 64, 97, 103, 108, 111, 148		Lufta e dytë botërore.....	1
150, 175, 205, 206, 207, 209, 2011		17,	
Sovraniteti.....	1	18, 39, 40, 52, 93, 119, 189	
3, 9, 16, 18, 21, 22, 28, 32, 43, 48, 49, 50, 51		Luftërat e drejta.....	27,
52, 53, 54, 74, 112, 113, 114, 115, 118, 119		30, 33, 34, 35, 36, 48, 116	
120, 122, 129, 131, 135, 182, 185, 202, 205		Lidhja e Prizrenit (1878)	
206, 208, 209		70	
Kolonializm.....	8, 56	Praktika shtetërore.....	V,
121		10, 42, 104, 105	
Karta e OKB- së.....	V, 1	<i>Prima facie</i>	18
5, 11, 12, 17, 18, 38, 40, 41, 44, 45, 46, 50		Pakti Briand- Kellogg (1928)	11
51, 52,		39	
53, 56, 61, 97, 110, 120, 158, 161, 205,		Pranvera arabe.....	136
Kanali i Suezit.....	9	Sovraniteti.....	1, 3,
13		9, 16, 17, 18, 21, 22, 18, 32, 43, 48, 49, 50,	
Kanali i Korfuzit.....	16	51, 52, 53, 54, 74, 112, 113, 114, 115, 118,	
Kombi.....	9, 72	119, 120, 121, 122, 129, 131, 135, 182, 185,	
73, 91, 93		202, 205, 206, 208, 209,	
Konferenca e San Franciskos.....	13, 17	Siguria ndërkombëtare.....	10,
Kodifikim.....	53, 98	42, 65, 66, 67, 68, 116, 129, 133, 156, 158,	
108, 109, 120, 127, 129		161, 166, 167, 168	
Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin		<i>Status quo</i>	82
e Krimeve të Gjenocidit.....	173	Të drejtat civile.....	119
		Të drejtat Ekonomike.....	119

<i>Travaux préparatoires</i>	13, 16, 17	Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën..	127
Të drejtat e njeriut.....	10, 24, 26	Vetëmbrojtja.....	9, 109, 114
	33, 39, 40, 44, 45, 49, 50, 51, 52, 53, 73, 109	Veto.....	VI, 25
	113, 118, 119, 121, 131, 132, 146, 162, 168		33, 42, 47, 65, 66, 80, 87, 92, 101, 106, 107
	171, 173, 180, 208, 2012, 2013		117, 124, 133, 136, 155, 156, 164, 190, 194
Traktati i Londrës (1827)	38		195, 196, 198, 199, 200, 201, 202, 206, 207
Traktati i Shën Stefanit (1878)	69		2010, 2011
Tribunalit për Krime të Luftës në		Viktimë.....	78, 106
Ish- Jugosllavi.....	96		111, 122, 198
	86, 127, 128		

INDEKSI I AUTORËVE

A

Akuini, 7, 27, 28

Alexander, 101

Adams, 144, 202

Avezov, 149,

B

Brownlie, 9, 105

Benjamin, 38

Byers, 54, 104, 105

Brooks, 104, 105

Bellamy, 134, 135

Benner, 147, 148, 149

Binder, 200

C

Cuevas, 19

Chesterman, 39, 54, 64, 104, 105

Chomsky, 45

Cooper, 51, 67

Calpon, 78

Cassese, 103, 109

Careti, 142

Cuycker, 158

J

D

Daphné, 52, 53

Doyle, 124

E

Einze, 51, 54, 105

Evans, 113, 114, 15, 116, 117, 120

127, 176, 177, 178

Ercan, 121, 124, 175, 181

F

Frank, 62

G

Grotious, 7, 28, 29

Gray, 26

Grenwood, 42, 100, 107

H

Holzgreffe, 20,

Hehir, 22, 23, 24, 153, 174, 201

Hurd, 43

Hilpold, 121, 177

Hakimi, 176

Q

Jekins, 62

K

Kuperman, 141, 142

Kenkel, 146, 149

Koester, 156

L

Lauterpacht, 7, 28,

M

Menon, 32

Malcolm, 70, 72

Marriam, 93

Malito, 141

Marolly, 167

N

Nardin, 34

O

Oppenheim, 8

Orford, 36, 173

P

Pettison, 22

Popken, 140

Peters, 155

W

Qerimi, 128

R

Roberts, 19, 46, 47, 48, 63, 65, 108

Ryinker, 21

Rodley, 52

Ryngeart, 158

Russo, 203

S

Simma, 14, 15, 103, 207

Seybolt, 23

Simon, 39, 52

Stromseth, 98, 106, 109, 110

Scheffer, 128, 129

Stuenkel, 150

Smith, 167

Šimonović, 182

SH

Shaw, 41

T

Tomuschat, 67

Tohorino, 140, 150

Truner, 161

TH

Thekur, 114, 121,

Wheeler, 25

Walzer, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37

Weller, 80, 87, 88

Wedgwood, 103,

Williams, 140

Z

Zyberi, 128, 164, 181